

Jusuf BUXHOVI

## **DOSJA B.**

**Roman**

*(Ngjashmëritë e mundshme midis personazheve me realitetin janë të rastësishme)*

.....

### **EPILPGU SI PROLOG**

Në faqen e Autorit në internet, pa pritur e pa kujtuar, “u ringjall” adresa e parë, nga viti 1995, e hapur në “aol”, e mbyllur në vitin 2008, me rastin e kthimit në Prishtinë.

“Ndërhyrja” në internet nga adresa [anonimes@anonimus.aol](mailto:anonimes@anonimus.aol) në një volum prej 264 MB, u përcoll me derdhjen e disa shënimeve të paaautorizuara që vinin nga arkivat e mbyllura të disa shërbimeve informative, të shumtën nga ato gjermane: BND dhe MAD, nga procesverbalet e Gjykatës së Hagës, të UNMIK-ut dhe të EULEX-it, të shoqëruara me shkrime gazetash, fejtone si dhe fragmente të disa veprave letrare, historiografike, të cilat shoqëronin një dosje të quajtur “Dosja B”.

Anonimi thoshte se për tre vjet kishte qenë hetues special i gjykatës së EULEX-it në Kosovë, i përfshirë bashkë me të tjerë, në këtë rast nga i cili ishte tërhequr, (por jo edhe nga hulumtimi personal i rastit) pasi që në Gjermani, prej nga vinte, në rrethana tepër të dyshimta për të, ishte vrarë një dëshmitar i mbrojtur (Roja e burgut, përndryshe autor i ditarit të burgut). Sado që ishte thënë se ajo ishte një vetëvrasje, në të vërtetë, eliminimi i dëshmitarit të mbrojtur, kishte penguar hapjen e disa proceseve të tjera me anën e të cilave do të zbardheshin shumë nga vrasjet e bëra gjatë dhe pas luftës nga një qendër e krimit të organizuar.

Ndaj, i dëshpëruar nga realiteti gjyqësor si dhe prapaskenat me të cilat ballafaqoheshin të gjithë ata që luftonin të gërmonin diçka nga “dosja e fshehur”, hetuesi anonim gjerman do t’i drejtohet Autorit me dosjen fantome.

Me këtë rast, hetuesi anonim, përmend romanin “Dosja e hapur”, të botuar së voni, për të cilin thotë se “Dosja B” është pjesë e tij...

*Ky vlerësim nuk e kishte befasuar Autorin, ngaqë në art dhe krijimtari, krahasimet, ndërlidhjet si dhe identifikimet, qofshin ato edhe të pabesueshme me veprat, personazhet si dhe ngjarjet, janë të natyrshme dhe pjesë e kreativitetit si dhunti e përgjithshme.*

Kur m'u tha se duhej të shkoja në Prishtinë për të marrë pjesë në hetimin e një rasti tashmë të shënjuar si më i rëndësishmi i misionit ndërkombëtar EULEX dhe m'u la para një dosje e trashë, e kisha të qartë se gjendësia përballë një sfide të madhe me të cilën lidhej jo vetëm fati i karrierës sime, por edhe shumëçka tjetër që atje ishte thadruar gjatë kohës së protektoratit ndërkombëtar prej tetë vitesh dhe më herët në rrethanat e shpërbërja së ish Jugosllavisë nëpër të cilat kishte kaluar vendi gjatë atij procesi dhjetëvjeçar të ndeshjes për jetë a vdekje të dy realiteteve diametralisht të kundërta: dhunës shtetërore që kishte vendosur regjimi i Beogradit në emër të mbrojtjes “së sovranitetit shtetëror” si e drejtë ndërkombëtare dhe rezistencës institucionale paqësore, i popullatës shumicë (shqiptare) së fundit e kthyer në një kryengritje të hapur dhe luftë madje, që ndërkombëtarisht ishte kualifikuar “konflikt i armatosur...”

Edhe pse epilogu midis “të drejtës historike” me anën e armëve dhe të drejtës etnike-jetësore, me anën e rezistencës institucionale-paqësore, që kishte shkuar deri te rezistenca e armatosur, ishte vendosur nga ndërhyrja ushtarake e NATO-s me fushatën ajrore nga 24 marsi deri më 12 qershor 1999, kur me rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së Kosova ishte vënë nën mbikëqyrjen e përkohshme ndërkombëtare, megjithatë, e ashtuquajtura “kohë kalimtare” kishte vazhduar me konfrontime të pashmangshme shoqërore të karakterit social dhe kulturor pa përjashtuar këtu edhe ato politike, të natyrshme në një ambient të mbingarkuar nga traumat e së kaluarës ideologjike si dhe ato të natyrës hegjemoniste të freskëta në kujtesën e gjithë atyre që gjatë verës dhe vjeshtës së vitit 1998 si dhe në pranverën e vitit 1999, fushata e ushtrisë jugosllave i ktheu në refugjatë, të cilët gjetën strehim në Shqipëri, në Maqedoni dhe në vendet të tjera europiane.

Sidoqoftë, përzgjedhjes sime për një mision të tillë, mund t'i kishin ndihmuar edhe dy faktorë personalë, që gjendeshin në biografinë time të punës, që e posedonte EULEX-i. Fjala ishte për lidhjet e mia të dyanshme familjare me shqiptarët dhe serbët nëpërmes gjysheve (gjyshja ime nga ana e babës shfaqej shqiptare, ndërsa nga ana e nënës - serbe).

Gjyshja shqiptare nga ana e babës dhe gjyshja serbe nga ana e nënës vinin nga koha midis dy luftërave botërore dhe u takonin atyre që mund të merren si “rastësi të natyrshme” në kuadër të lidhjeve diplomatike dhe ekonomike të Rajhut gjerman me vendet e Ballkanit, të cilat duhej të kalonin edhe nëpërmes afrive njerëzore të cilat jo gjithnjë përcaktoheshin nga “interesa shtetërore”, siç mund të thuhet për martesën e gjyshit tim nga baba, Robert W. me shqiptaren Mari Sh., me të cilën ai ishte njohur para se të shkonte atashe ushtarak në Tiranë. Kjo kishte ndodhur fare rastësisht gjatë mbajtjes së manifestimit “*Mis Europa*”, kur në saje të lotarisë së biletës, koloneli gjerman kishte fituar të drejtën që gjatë darkës të shoqërojë përcjellësen e parë të “*Mis Europa*”, Mari Sh., që vinte nga Shqipëria. Ajo darkë lotarie në Romë dhe njohja me të kishte përcaktuar fatin e kolonelit gjerman dhe bukuroshes shqiptare, meqë aty, drejtpërdrejt kishte zënë fill një dashuri jetësore ndër më të natyrshmet dhe të veçantat njëherësh, e cila gjatë dy viteve ishte përcjellë me disa takime në Itali, për t'u kthyer në martesë (pasi gjyshi ishte caktuar atashe ushtarak i Rajhut në ambasadën gjermane në Tiranë në vitin 1937).

Natyrisht se martesës midis bukuroshes shqiptare Mari Sh., (nëpunëse e oborrit mbretëror), nga një familje shkodrane me origjinë nga Prizreni, me një atashe ushtarak

gjerman në Shqipëri, nuk kishte shpëtuar pa iu veshure dhe “interesa të tjera”, sado që ajo ishte fryt i një dashurie rasti.

Mund të thuhet se edhe martesë e gjyshit tim nga nëna, Heinc G., përfaqësues i firmës automobilistike “Mercedes” në Beograd, me aktoren e njohur të Teatrit Serb të Beogradit, Vera L., nuk do t’i shpëtojë anatemes së lidhjeve të “lozhës së lartë”, siç quheshin asokohe ato midis artistëve të njohur dhe përfaqësuesve të jashtëm nga metropolet europiane, të cilave kahun, por edhe fatin rëndom ua përcaktonin zhvillimet politike.

Ngjashëm kishte ndodhur edhe me martesën e industrialistit gjerman dhe artistes beogradase. Pas dy vitesh jete të lumtur bashkëshortore në Beograd, në prag të luftës së Dytë Botërore (pas prishjes së paktit të jugosllavëve me gjermanët), gjyshi im, Heinc G., bashkë me aktoren serbe, detyrimisht ishin kthyer në Berlin.

Biznesin e kishte zëvendësuar me një post në Ministrinë e Jashtme gjermane, ndërsa gjyshja ime Vera L., do të mbetet as në tokë e as në qiell, pra jashtë ëndrrës së saj jetësore për t’u ngjitur në skenat e teatrit gjerman. Kjo do t’i pengohet ngaqë nuk e kishte përvetësuar theksin gjerman, edhe pse kishte bërë çmos që këtë ta arrinte.

Pasi kishte mallkuar gjuhën gjermane, e përfshirë nga një thyerje e pashërueshme shpirtërore, gjyshja ime Vera L., nuk kishte jetuar gjatë. Kishte vdekur pak pa përfunduar lufta nga një anemi e pashpjegueshme që iu kishte shfaqur sapo kishte lindur time ëmë.

Gjatë atyre dy viteve të një jete të molisur, përherë në shtrat, ime amë kishte mbetur në duart e hallës Helga me të cilën ajo ishte rritur detyrimisht ngaqë gjyshi nga nëna, Heinc G., në vitet e fundit të luftës, si shumë të tjerë, ishte mobilizuar dhe dërguar në frontin e Normandisë, prej nga nuk ishte kthyer kurrë. Meqë, ime ëmë, Gerta, ishte rritur në duart e hallës Helga dhe pa ndonjë lidhje as me të atin e mbetur në luftë, aty kishin përfunduar edhe kujtimet për të ëmën, për të cilën dinte se vinte nga Serbia, por nga ato që ia kishte thënë hallë Helga, pa qenë e bindur në ishte serbe apo vllahe. Kjo për time ëmë dhe për mua as që kishte rëndësi, meqë me të na lidhnin vetëm disa fotografi të një albumi prej disa faqesh nga koha kur gjyshja Vera L., ishte aktore e njohur e teatrit të Beogradit në rolin e Ofelisë, të shoqëruar me disa fjalë në serbishte (nga një kritik i teatrit), të cilat im gjysh, Heinc G., i kishte shoqëruar me një përkthim në gjermanisht. Pak para se të vdiste ime ëmë, kishte kërkuar nga unë, që po pata mundësi, albumin t’ia dorëzoja Teatrit Kombëtar Serb në Beograd.

“Është pjesë e një biografie shpirtërore që nuk duhet të harrohet!”

Më vjen keq që porosinë e time ëmë nuk pata mundësi ta çoj në vend sepse albumi bashkë me disa kujtime të tjera ishte kallur me rastin e një zjarri që e ishte kapur shtëpinë tonë gjatë kohës kur ajo mbikëqyrej nga një kushërirë e jonë, e cila, nuk kishte qenë në rregull me shëndetin mendor.

Me gjyshen nga baba, shqiptaren Mari Sh., ishte më ndryshe. Atë e mbaja mend nga fëmijëria e hershme, fillimisht si një grua me pamje fisnike, të dashur dhe e afërt, ndërsa së voni, të rralluar nga mendja, si thuhej, ndonëse mua nuk më dukej e tillë. Përkundrazi, edhe kur i jepnin ilaçe të ndryshme dhe këtë e bënin kundër dëshirës së saj, ajo më mbante në prehër dhe më përkëdhelte flokët. Në atë prehje dashurie të ngrohtë ajo këndonte këngë në gjuhën e vet, pra në shqipe, që së voni, gjithnjë e më shpesh e përdorte në vend të gjermanishtes, të cilën pak nga pak e flaku fare.

Kthimi kah gjuha e vet dhe flakja e gjermanishtes për tim atë ishte shenjë e një thyerjeje të rëndë shpirtërore, që atë po e shkëpuste përditë e nga pak nga ne dhe nga kjo jetë,

shkëputje kjo që për mua, ndonëse erdhi ditën që i mbusha tetë vjet, dukej e pavërejtur, ngaqë me mua ruante gjithë dashurinë dhe afërsinë që i mungonte me të tjerët... Madje, edhe më vonë, pasi që të ketë vdekur dhe për tim atë kujtimi i saj paraqiste një ankth, që si do të shihet nuk do t'i ndahet kurrë, për mua gjyshja Mari, mbetej tepër e dashur, në prehrin e së cilës ndjeja një ngrohtësi të jashtëzakonshme që nuk e kisha përjetuar as te ime ëmë dhe te askush tjetër... Kjo kishte bërë që shumë nga fjalët që thoshte në gjuhën shqipe t'i mbaja mend në formën e mirëfilltë, Atyre, më vonë, ua kisha shtuar edhe ato që m'i kishte mësuar gjyshi Robert W., edhe për shtatë vjet të tjera sa ishte gjallë dhe thujse nuk e hiqte nga goja gjyshen Mari dhe kujtimin për të.

Lidhjet me gjuhën e gjyshes sime i kisha vazhduar edhe pas vdekjes së gjyshit me anën e ligjëratave të herë pas hershme te një lektor i gjuhës shqipe, Hans H. Ai, për disa vite kishte studiuar albanologjinë në Tiranë. I kishte ndërprerë pas shkëputjes së marrëdhënieve politike dhe shtetërore të Shqipërisë së Enver Hoxhës me Republikën Demokratike të Honekerit. Këtë shkëputje Hans H., e kishte shfrytëzuar që në vend se të kthehet në Berlinin Lindor, ishte kthyer në Berlinin Perëndimor. I punësuar si përkthyes i gjuhës shqipe në agjencinë e lajmeve DPA, kishte fituar edhe licencën për mbajtjen e kurseve fillestare të gjuhës shqipe. Nga kjo ai nuk kishte pasur gjithaq dobi, ngaqë pos meje dhe një somalezeje (bije të një diplomati që kishte kërkuar azil politik në RF të Gjermanisë), gjatë atyre katër vjetëve, nuk kishte pasur të interesuar të tjerë.

Ndonëse lidhjet me gjuhën e gjyshes sime të dashur Mari thujse kishin marrë fund pasi që kisha filluar studimet në Universitetin e Berlinit (në fakultetin juridik), megjithatë ishte ndjenja e të qenit edhe pjesë e saj, pra e trashëgimisë, që më mbante të lidhur për të... Kjo sa vinte e më shtoej jo vetëm nga kujtimet që kisha nga gjyshi (suvenire të ndryshme dhe disa libra në gjuhën shqipe dhe përkthime në gjermanishte), të cilat ruheshin në vitrinën kryesore të shtëpisë sonë, por edhe nga sjellja e tim atë Markus W., avokat i njohur, i cili, nga fundi i viteve të tetëdhjeta dhe fillimi i të nëntëdhjetave, ishte përfshirë në veprimtarinë e një shoqate të njohur humanitare, fillimisht në Bosnje dhe Hercegovinë dhe së fundi në Kosovë.

Para se të shkonte në Kosovë, më kishte thënë se po i hynte një pune të rrezikshme jo vetëm pse atje viktimat e Beogradit kishin nevojë për diçka të tillë, por edhe pse ato vuajtje, ata lot dhe atë gjak që po derdhej atje, i ndjente dhe i përjetonte në mënyrë të veçantë, si vuajtje të së ëmës, për të cilat thoshte se ishin edhe të tijat dhe tonat dhe “nuk mund të shtiremi sikur nuk po ndodh gjë...”

Ishin këto fjalë që ma krijuan një përmbysje të papritur nga brenda prej nga edhe gjendja ime mori një kah të papritur, atë të përjetimit të vuajtjes të përzier me ndjenjën e brejtjes së ndërgjegjes ndaj asaj që po ndodhte sy botës, veçmas kur me veprime humanitare nga jashtë, ajo sikur përligjej...

”Është një kalvar gjaku që po vazhdon... Vetëm këtu mund të kuptohen përmasat e kësaj tragjedie... Bëhet fjalë për një gjenocid shtetëror të kahershëm, të mbështetur nga memorandume dhe projekte të tjera shfarosëse të hartuara nga akademikë dhe klerikë, që mund të ndërpritet vetëm me një ndërhyrje ushtarake...”

Disa muaj pasi që kishte ndodhur fushata ushtarake e NATO-s dhe me rezolutën e KS të OKB-së të 10 qershorit 1244, Kosova ishte përfshirë nën administrimin e përkohshëm ndërkombëtar, im atë ishte kthyer në Berlin. Mbrëmjen që u takuam kishte thujse të njëjtin shqetësim nga takimi ynë i fundit, kur ishte larguar për në Kosovë. Mendova se e kishte nga

ato që kishte përjetuar gjatë atyre tri viteve atje, por pas një heshtjeje të ngarkuar me mëdyshje foli e tha se me këtë kishte marrë fund një kapitull tragjik, por atje e keqja nuk kishte përfunduar meqë kishte rrezik të ripërsëritej...

Kur m'i tha këto, një copë herë më shikoi sikur të kërkonte diçka prej meje...

“Ka një pleksje të çuditshme të shumë e shumë gjërave, shumë e shumë plagëve, shumë e shumë kurtheve dhe çka jo tjetër, që koha kalimtare mund t'u japë një kah të paparashikueshëm, madje të kundërt me atë që mund të pritet nga një çlirim i tillë, që nuk do të thotë se garanton lirinë e njëmendtë...”

Me këtë rast ai përmendi një “dosje të vjetër”, që ka mbetur e hapur dhe mund të prodhojë fatkeqësi të tjera...

Nuk desha ta çoj më tutje punën nga bindja se im atë shqetësimin mund ta kishte nga ato që kishte përjetuar atje. I thashë se kishte nevojë për një pushim dhe i urova ta gjente në familje dhe midis miqve që kishte. Por, ai ma ktheu se për të nuk kishte as çlodhje, as pushim e as qetësi, ngaqë atje, çuditërisht, kishte takuar vajin e së amës, që vjen nga një gjëmë e pandalshme...

U ndamë me një shqetësim në mes, që ma ktheu pamjen e mjegulluar të sime gjyshe, kur ajo rrinte në divanin e drunjtë pranë dritares me shikim të përhumur nga kopshti i mbushur me lule prej nga ajo me ato këngët e pakuptueshme gjithnjë e më shumë shkëputej nga bota që e rrethonte dhe i kthehej misterit prej nga kishte ardhur...

Kur u takuam pas një muaji, im atë dukej edhe më i shqetësuar. Shihej haptas se kthimi nga Kosova dhe përfundimi i misionit humanitar, ku ai kishte derdhur aq mund dhe përkushtim, jo vetëm që nuk e kishte qetësuar, siç shpresoja, por e kishte bërë edhe më të ndrojtur, fjalëpakë dhe të pavullnetshëm, saqë më shkoi mendja se pas gjithë atyre që kishte përjetuar atje, i duhej ndonjë bisedë me ndonjë psikolog, që të lirohej nga ngarkesa e atyre maktheve, të cilat hiqen vështirë... Madje, diçka të tillë e zura kalimthi në gojë, por ai tha se ishin pikërisht vitet e Kosovës dhe ato të herë pas hershmet në Shqipëri që jetës së tij i kishin dhënë një kuptim të veçantë, pa të cilat do të ndjehej i zbrazur dhe i humbur fare...

“Nuk kam të ndarë nga ajo botë... Një ditë do ta kuptosh fuqinë e saj të jashtëzakonshme...”

Desha t'i thosha se përjetimi i vuajtjes dhe identifikimi me të ishte shkalla më e lartë e ndijimit të njerëzores, qoftë si koncept religjioz ose filozofik, që jo secili është në gjendje ta bëjë. Por, hoqa dorë nga frika se në ato rrethana do të keqkuptohesha. I thashë se familja jonë (unë, bashkëshortja ime Adela si dhe fëmijët Matias dhe Gerd) kishin nevojë më shumë se kurrë për prind dhe gjysh siç kishte edhe ai nevojë për ne për ta përballuar vetminë që po e rrethonte...

Kjo, në të vërtetë, ishte hapësira e vetme ku bashkoheshim dhe pajtoheshim, qoftë edhe përkohësisht. Them kështu ngaqë takimet tona, kur ai vinte herë pas herë në orët e mbrëmjes dhe përpiquej sado pak të luante me Matiasin dhe Gerdin (edhe pse kësaj nuk ia dilte dhe pak nga pak ato bëheshin gjithnjë e më të ftohta), ishin kthyer në pjesë të një protokolli familjar, që përsëritej një herë në dy javë (të shtunave) dhe nuk zgjaste më shumë se një orë. Gjatë kësaj kohe, Adela, shërbente kafe shqeto të shoqëruar me torte molle. Im atë, ashtu fjalëpakë, pinte gjysmën e filxhanit të kafes dhe hante gjysmën e pjesës së tortës së mollës. Pastaj shkonte në dhomën e fëmijëve dhe kur kthehej nga andej (e gjitha zgjaste njëzet minuta), largohej ftohtas.

Ky ritual “prishej” vetëm me rastin e ditëlindjes së fëmijëve (Matiasit më 4 prill dhe Gerdit më 11 shtator). Me ta kalonte dy orë, sipas dëshirës së tyre (së pari në kopshtin zoologjik dhe pastaj në teatrin e kukullave).

I merrte dhe i kthente me taksi në të njëjtën kohë.

Në këto dy ditë, në njëfarë mënyre, fëmijët ndjeheshin ndryshe, meqë u plotësoheshin kërkesat dhe dëshirat (fillimisht ato për lodrat e më vonë edhe vizitat nëpër vende që atyre u pëlqenin dhe ku mund të argëtoheshin), por njëherësh dalloheshin edhe për nga atmosfera shumë e afërt midis tyre dhe gjyshit, me biseda të hapura, të cilat herë-herë përfshinin edhe çështje të cilat në shtëpi thuajse ishin të pamundura (rreth miqësisë midis djemve dhe vajzave), që për herë të parë u shtruan kur Matiasi i mbushi dhjetë vjet dhe Gerdi tetë vjet dhe nisi të kërkojë që gjatë këtyre kremteve të përfshiheshin edhe shokët apo shoqet e tyre. Im atë kishte pranuar me kusht që ato të mbaheshin në McDonald dhe më vonë edhe në ëmbëltoeren “Eisberg”.

Ndonëse me këtë gjendje thuajse u pajtuam të gjithë (zgjati për tetë vjet të plota dhe unë e dija se vetmia e tim atë plotësohej me disa hulumtime personale që ai i bënte rreth Kosovës dhe Shqipërisë), megjithatë, asaj i erdhi fundi kur mori vesh lajmin për emërimin tim hetues në misionin e EULEX-sit në Kosovë.

Për habi timen dhe të Adeles, por edhe të fëmijëve, me të cilët kaloi më shumë se një orë duke ua treguar domethënien e përrallave të vëllezërve Grim nga këndvështrimi i moshës së tyre që (Matiasi shkonte nga e katërmëdhjeta, ndërsa Gerdi në të dymbëdhjetën), atë mbrëmje ndenji në darkë, pranoi të pinte një “krigël” të madhe birrë të bardhë bavareze, të cilën me vite nuk e kishte futur në gojë, siç pranoi të fliste edhe për titullin e 19 të “Bayernit” në Bundesligën gjermane, që ato ditë e kishte fituar me ç’rast lavdëroi strategjinë e holandezit Von Gal për “posedimin e topit në çdo pjesë dhe qarkullimin me të”, duke e quajtur “koncept të ri të futbollit”, që sado që do të ketë kundërshtarë, do ta ndryshojë filozofinë e lojës, por edhe atë që e quajti “ngarendje të kotë pas topit”, që nuk paraqet gjë...

Kur përfundoi darka dhe po bëhej gati të largohej, pritja që të thoshte diçka rreth shkuarjes sime në Kosovë. Kisha nevojë për ndonjë këshillë apo porosi, veçmas për ato që dinte dhe i mbante të fshehura.

Por, e gjitha përfundoi me një marrje ngryk jo të zakonshme, të ngjashme me një ndarje të përhershme, që më futi të dridhura, sado që nuk dëshiroja t’ia pranoja vetes se e gjitha midis nesh mund të përfundonte me aq...

Me mundimin e asaj përshtypje, kaluan shumë ditë pa e parë tim atë. Nuk edhe as në takimin e të shtunës së parë dhe as në të dytën... Qenë të kota përpjekjet e herë pas hershme që të lidhesha me telefon. Vazhdimisht më vinte porosia nga Telekomit se numri që kërkoja ishte i shkyçur.

I shqetësuar se mund t’i kishte ndodhur diçka, desha ta vizitoja, sado që këtë nuk e kisha bërë prej vitesh, meqë kjo nuk i pëlqente. Nga kjo më ndali një postim në internet që më erdhi nga ai.

Bashkë me njoftimin se “i ishte dhënë në një udhëtim që mbase nuk do të përfundonte kurrë”, ma bënte me dije se në atashment gjendej shkrimi “*Koha e vdekjes*”, me paralajmërimin se “rrëfimi vazhdon”.

**“Koha e vdekjes”**  
(Pjesa e parë, nga Shkodra)

*...Ime Ëmë më kishe folur pareshtur për vendlindjen e saj, Shkodrën, prej nga si fëmijë e kishin lënë pasi që ishin vendosur në Tiranë...*

*Kur ime ëmë fliste për Shkodrën sikur përpiquej që me anën e kujtimeve të dashura në kujtesë t’i ruante ato që po ia merrte koha me të cilat ajo përpiquej pareshtur ta ushqente shpirtin në një hapësirë ku ajo, megjithatë, ndjehej e huaj...*

*Do të jetë pikërisht pikëllimi i saj i thellë që më kishte detyruar të kthehesha në Shkodër...*

*Me ndjenjën e një fajësie se ime ëmë nuk ia kishte dalë të jetë e lumtur pse kishte një mall të madh për atdheun nga i cili ishte shkëputur dhunshëm (fillimisht humbja e luftës dhe pas saj vendosja e komunizmit në Shqipëri), sapo mbërrita në Kosovë, vendosa që për pak të shkoja në Shkodër, edhe pse kjo ishte punë me rrezik, ngaqë udhëtimin duhej ta bëja ilegalisht.*

*Kësaj ia dola në sajë të një gazetari të “Rilindjes” nga Prishtina, gazetë kjo e njohur ditore në gjuhën shqipe prej kohësh ndaluar nga regjimi i Beogradit, që megjithatë botohej në Tiranë por edhe në Perëndim prej nga edhe shpërndahej.*

*Gazetari i “Rilindjes”, që dukej se atë rrugë e bënte shpesh (me ryshfete dhe mënyra të tjera), i mori përsipër të gjitha. Madje, ai më pajisi edhe me një dokument (letërnjoftim) të një kushëriri, që përfaqësojë në përgjigje moshës dhe dukjes sime. Më tha se përballë çfarëdo rreziku duhej të shtiresha torollak ose i marr fare. Këtu vetëm të tillët nuk bëhen hesap...*

*Rrugën nga Prizreni deri në Kukës e bëmë thuajse legalisht, me anën e një kombi ku kishte edhe udhëtarë të tjerë, saqë më zuri frika se mund të ishte ndonjë kurth i përgatitur nga dika nga të cilët na kishin paralajmëruar gjatë përgatitjes në Berlin se duhet ruajtur meqë ashtu rrezikonim edhe misionin tonë humanitar...U habita kur në pikën kufitare policët serbë as që na ndalën. Mjaftoi një përsëritje dhe shenja me dorë e shoferit njërit prej rojave që ne të vazhdonin rrugën drejt pikës kufitare shqiptare, të cilën, po ashtu e kaluam lehtë, pasi që ndihmësi i shoferit zbriti për pak dhe ndërroi disa fjalë me njërin që doli nga posta kufitare dhe prej andej u kthye brenda.*

*Por, pamja e kufirit shqiptar, fare e qetë, që e lamë mbrapa, me të shpejt u zhदारit nga një ndalje thuajse e papritur në kthesën e parë, në drejtim të liqenit. Sikur të kishim rënë në një pritë, kombi ynë me të shpejtë u rrethua nga njerëz të armatosur me tytë e drejtuar të armëve në drejtim të shoferit. Gazetari i “Rilindjes” ma bëri me dije se nuk duhej të shqetësohesha.*

*Dhe njëmend, pasi që shoferi dhe ndihmësi i tij dolën jashtë dhe në pjesën ku ata kishin ngrehur një tendë të leckosur ndenjën paksa, u kthyen me dy të tjerë, të cilët u ulën në pjesën e përparme dhe në vazhduam rrugën.*

*Në atë heshtje të trishtë, gazetari “Rilindjes” më tha se këtu diçka e tillë, prej dy-tre muaj, ishte pjesë e një normaliteti jo normal. Si me shaka përmendi “revolucionarët e kuq” që kanë ardhur në pushtet.*

*“Ushtria shqiptare thuajse është shpartalluar... Shumë nga oficerët e saj janë kthyer në mercenarë të bandave, të cilat kanë shpallur “feude autonome” ose edhe “të pavarura”,*

siç ngjet në jug të vendit... Kësaj gjendjeje i ka ndihmuar jashtë mase edhe thyerja e depove të armëve dhe hapja e kontrabandës së paparë me to në të gjitha anët e vendit, ku tashmë janë hapur edhe tregje të përhershme armësh. Për pak marka mund të blesh edhe një top të mirë sovjetik, po edhe pjesë të avionëve dhe raketa madje... Armët e lira dhe anarkia kanë kthyer edhe hakmarrjen dhe krimin e organizuar... Për t'i ikur kësaj gjendje, shumëkush po kërkon shpëtim jashtë vendit..."

Ç'është e vërteta kisha njoftime rreth një çrregullimi që kishte ndodhur gjatë marsit dhe prillit të atij viti në Shqipëri kur ishte përmbysur qeveria Berisha dhe vendi kishte rrëshqitur drejt anarkisë, që për ta penguar një luftë qytetare e cila për pasojë do të kishte hapjen edhe të një krize të re rajonale, u deshtë edhe ndërhyrja e vendeve perëndimore që t'ia ndalin flakën e të ngjashme. Por, nuk ma kishte marrë mendja se punët kishin shkuar deri aty sa vendi të kthehej në një gjendje ku bandat e armatosur bëjnë pushtetin...

"Shqipëria sikur ka mallkim të përhershëm gjendet kaotike ose diktaturat, që vazhdimisht ndërrojnë njëra-tjetrën... Nuk ka si që edhe këtë herë të mos jetë kështu..."

Tytat e armëve, nga postblloqe të bandave të armatosura, brenda një kohe të shkurtë, u përsëritën thuajse pas çdo kthese. Por, mjaftonin disa shenja të llambave elektrike nga brenda që jepeshin nga ata dy veta që morëm me veti në post-bllokun e parë, që rruga të vazhdohej pa ndonjë vështirësi.

Në atë gjendje të ankthshme e kalova gjithë pjesën tjetër të rrugës së vështirë malore me leqe, që zgjati deri në mëngjes. U ndalëm në pjesën ku përfundonin malet dhe fillonte panorama e një hapësire prej nga kodrinat përreth zbritnin në rrafshinat e thyera shthurshëm.

Gazetari i "Rilindjes" ma bëri me dije se aty merrte fund, si tha "linja e posaçme Kosovë-Shqipëri", e cila vazhdonte anasjelltas, dhe se aty, duhej të pritnim ndonjë makinë që lidhte atë pjesë me Shkodrën, udhë kjo që merrte së paku edhe dy orë...

Nuk vonoi dhe në një komb që na mori thuajse pa na pyetur fare, nisëm rrugën për në Veri...Një shi i imë që nisi pas pak dhe një mjegullim që na shoqëroi deri në hyrje të Shkodrës, thuajse pamundësoi pamjen e peizazheve nëpër të cilat kalonim...

Kur po bëhesha gati për ta pyetur gazetarin e "Rilindjes" se a do të përsëriten postblloqet e bandave të armatosura, ai foli e tha se rrugës prej nga do të kalonim nuk kishte banda të armatosura, ngaqë ajo, si rrugë nacionale që quhej, prej disa ditësh sigurohej nga njësi italiane të dërguara nga NATO për t'u mbrojtur shteti shqiptar nga vetërrënimimi i cilit i ishte nënshtruar. Ngjashëm ndodhte edhe me rrugët që nga Tirana çonin në Durrës, Vlorë e deri në Sarandë. Të tjerat vazhdonin të mbeteshin nën mbikëqyrjen e bandave, të cilat tashmë kishin shpallur edhe feudet e tyre "të pavarura".

"E përbashkët për këto banda është ideologjia evolucionare dhe mentaliteti puçist... Këtu historia vazhdon t'i përsërisë ngjarjet e tejkaluara ose të harruara ngjati..."

Para se të hynim në Shkodër, kaluam nëpër një postbllok me ushtarë italianë të fortifikuar me dy autobllinda. Ushtarët italianë na përshëndetën duke dhënë shenjën se rruga ishte e lirë.

Te ura e Drinit, sërish u shfaqën ushtarët italianë të shoqëruar nga disa policë shqiptarë të paarmatosur.

"Italianët, bashkë me disa vende perëndimore, kanë marrë përsipër riorganizimin e policisë së shpartalluar shqiptare. Besohet se ata shpejt mund ta marrin përgjegjësinë në

vend, ngaqë sekush tashmë e di se parakusht për përballimin e gjendjes së kaosit dhe të pushtetit të bandave është rikthimi i policisë shqiptare pa të cilën nuk mund të ketë as rikthimi të rendite të ligjit të cilit këtu tashmë i ka humbur fija...”

Fjalët e fundit më sollën të dridhura saqë më shkoi mendja të kthehesha aty për aty në Kosovë. Mbase këtë edhe do ta bëja po mos të ishte Gazetari i “Rilindjes”, që më tha se do të më shoqëronte, për aq sa kisha nevojë.

“E di se këtu nuk ke ardhur për turizëm...”

Desha t’i thosha se puna për të cilën kisha marrë atë rrugë mund të priste për ndonjë ditë më të mirë, ose të ngjashme, por ishte dora e tij në krahun tim që më bartte andej kah dukej se ishte qendra e qytetit ku më tha se duhej të pinim kafe dhe të pushonim paksa para se të fillonte puna.

Fjalët e fundit i theksoi paksa më shumë që të më lironte nga hamendjet e shumta që po më përplaseshin nga anë të ndryshme, që m’i kishte hetuar edhe ai. Por prej tyre nuk ia dola të lirohesha sa duhej edhe pasi që kaluam pjesën e rrugës së shtruar me gurë deri te veranda e një kafeneje, e cila gjendej në një ambient të ngjashëm me atë të çarshisë së Prizrenit.

Pasi i pimë makiatot italiane dhe rrezet e diellit të mëngjesit që vinin nga ana e liqenit na kishin ngrohur, më tha se ishte e udhës që të zija hotelin. Bëri me dorë nga ana e djathtë, në drejtim të një ndërtese që ngrihej mbi të tjerat.

“Është i vetmi hotel i sigurt për të huajt”.

Rrugës për te hoteli po bluaja fjalët që më në fund, duhej t’ia thosha Gazetarit të “Rilindjes” rreth kërkimit të një gjurme që ka të bëjë me dikë. Kjo do të mjaftonte që t’i kishte duart e lira për të trokitur në dyer të ndryshme, pa marrë parasysh se Gazetari mund të mos besonte. Tek e fundit, kjo as që kishte ndonjë rëndësi, ngaqë mosbesues do të shfaqej edhe po qe se do t’ia tregoja të gjitha fije e për pe. Kjo edhe ishte e arsyeshme në ato rrethana kur ata ballafaqoheshin me gjithfarë kurthesh dhe kurdisjesh që u vinin nga të gjitha anët, të cilave mund t’u paguanin çmim të madh deri te me kokë...

Dhe, me arsyetimin se po kërkoja dikë për një porosi dhe se për këtë më duheshin tri-katër ditë kohë, u shfaq edhe para recepsionistit tepër të sjellshëm, i quajtur Nikolin. Pasi i kreu formalitetet e duhura, ma bëri me dije se mund t’i drejtohesha për ndihmë në çdo kohë...

“Gjermanët janë të mirëseardhur në Shqipëri...”

Pa mbaruar mirë bisedën me recepsionistin, Gazetari i “Rilindjes”, pasi që i kishte kuptuar të gjitha, më tha se do të shfaqej pas katër ditësh. Pasi nuk pranoi të ishte mysafir imi në hotel, ma la një numër telefoni.

“Do të jem këndeje pari...”

Një copë herë përcolla largimin e Gazetarit të “Rilindjes”, që treti në kthesën e parë në të djathtë. Mandej, u ngjita në dhomën e katit të tretë, me shikim nga liqeni... Ashtu i vetmuar u përpoqa që ftohtësinë e ambientit dhe të panjohurat e tij të frikshme t’i përballoja me kujtimin e sime ëmë, që më kishte bartur deri këtu... Në mendje tashmë kisha emrin e rrugës (Kosova) dhe numrin e shtëpisë (44). E gjitha përcillej edhe me një përshkrim fare të mugët nga fëmijëria kur ajo, në vitin 1925, në moshën 8 vjeçare, ishin larguar nga Shkodra për në Tiranë. Nga ato që m’i kishte treguar ime ëmë, pa marrë parasysh se përshkrimet shpesh ndryshonin në përputhje me gjendjen e saj shpirtërore e cila sa vinte e bëhej më emocionale, pra nga ajo rrëmujë rrëfimesh, që koha mund t’i ketë ngatërruar edhe te unë,

*pamja e shtëpisë mund të ishte kjo: një ndërtesë e madhe dykatëshe, me shumë dhoma, një çardak me pamje nga liqeni, disa arra të mëdha përreth, kopshtit me pjergulla dhe lule të shumta, si dhe një vijë uji që kalonte vazhdimisht nëpër oborr, që e ndante në dy pjesë. Në pjesën e skajshme herë pas here shfaqej edhe një man i madh dhe disa qershi tutje të cilave fshihej një kapixhik që i lidhte me fqinjët. Nëpër atë deriçkë hynin e dilnin dy nga shoqet: Tanja dhe Shega. Ato i zinte në gojë gjithnjë e më shpesh, herë si nuse e herë si gra të thyera...*

*Aty, pra ime ëmë kishte qenë tejet e lumtur...Atë lumturi të ndaluar ia kërkonte shpirti i saj i thyer në vitet e fundit të jetës...Ajo lumturi e humbur ishte shkaktare e shembjes së saj të brendshme, që në njëfarë mënyre,përfshiu gjithë familjen tonë...*

*M'u bë se pamja e asaj shembje m'u kishte ngjitur edhe të nesërmen kur recepsionistit tepër të sjellshëm, ia nxora adresën e rrugës përpara dhe kërkoja të më udhëzonte...Pasi e shikoi, më tha se nuk ishte larg nga këtu dhe, nëse nuk, e kishte për ngut, pas një ore, mund të më shoqëronte deri atje.*

*Më tha se rruga, që kërkoja, dikur ishte ndër më të njohurat, që për gjysmë shekulli mbante emrin "Enver Hoxha", ndërsa nga viti 1992 e këndej quhet "Skënderbeu".*

*Pasi që i thash se shoqërimi deri atje do të më ndihmonte, dola jashtë dhe mora drejtimin e kafenesë përballë ku një ditë më parë, pas atij udhëtimi të mundimshëm, ishim ndalur me Gazetarin e "Rilindjes" dhe kishim pirë kafenë e parë në Shkodër.*

*Nga ajo pikë shikimi im u ndesh me pamjen e kështjellës dhe pjesën e skajshme të qytetit që lidhej me të. Tashmë e dija se ajo ishte një kështjellë antike, ndër më të rëndësishmet e atij qytetërimi në atë hapësirë. Ndërtimi i saj lidhet me legjendën e Rozafës, një nuseje e cila u desh të flijohej që ajo të ndërtohej. Nusen e re e zinte në gojë edhe ime ëmë...Thoshte se ajo u vetëvra ngaqë i mungonte dashuria që ia kishin marrë dhunshëm... Si e tillë ajo njihej edhe si rezidencë e mbretit të fundit ilir, Gencit. Rëndësinë e vet nuk e kishte humbur edhe në mesjetën e vonshme dhe në atë më të renë. Në prag të pavarësisë së shtetit shqiptar dhe më vonë, ajo ishte kthyer në një arenë lufte midis shqiptarëve dhe malaziasve. Këta të fundit, ia kishin dalë ta pushtonin, por nën trysinë e fuqive evropiane Shkodra i ishte kthyer Shqipërisë. Dija, po ashtu, se Shkodra, gjatë mbretërisë shqiptare, kishte qenë një qendër e rëndësishme kulturore e veriut, e lidhur me qytetërimin perëndimor, që pas fitores së komunistëve, ishte dashur t'i paguhet çmim i madh, ngaqë qytetërimi perëndimor ishte shpallur "reaksionar" me të cilin duhej qëruar hesapet me mjete revolucionare, siç kishte ndodhur, në të vërtetë, me likuidimin e intelektualëve dhe klerikëve më të rëndësishëm të qytetit...*

*Në atë pritje mendja më shkoi te Gazetari i "Rilindjes" dhe përkushtimi i tij për të më ndihmuar. Edhe pse ishte fjalëpak dhe i hollë nga mendja, më mbetej për ta vlerësuar drejt sjelljen e tij tepër fisnike, edhe pse nuk do të pranonte ndonjë shpërblim për këtë. Nga im atë e dija se fisnikëria e shqiptarëve ishte diçka e lindur, pjesë e një sjelljeje të natyrshme të tyre, veçmas ndaj të huajit... Shumë herë më kishte folur për kultin e mysafirit dhe besën për të cilën ata janë në gjendje të sakrifikohen pa as më të voglin dyshim... A nuk u pa kjo edhe nga gatishmëria e recepsionistit të ri për të më shoqëruar deri tek vendi që kërkoja?... Ky të menduar sikur po ma largonte ndjenjën e vetmisë dhe të frikës, që më kishte mbërthyer sapo ishte larguar Gazetari i "Rilindjes"...*

*Por, në atë përqasje, diçka që e kisha dëgjuar të flitej në veten e tretë, sikur po kalonte te unë dhe po m'i bashkonte pjesët e ndara për të cilat ime gjyshe, me gjuhën e ninullave, thoshte se herëdokur gjejnë njëra-tjetrën...*

*Mbase kushedi se ku do të shkoja me atë të menduar, po mos të ishte Nikolini, që po më thoshte se ishte aty të më shoqëronte.*

*“Kohëve të fundit vijnë shumë të huaj që kërkojnë pjesë të harruara ose të rrënuara të qytetit tonë... Sikur ka diçka të pashpjegueshme këtu?...Mbase kjo ka të bëjë me shkëputjen e dhunshme të kujtesës sonë që po sfidon në këtë mënyrë?...”*

*Fjalët e fundit i përsëriti gjithnjë me shikimin e drejtuar nga unë, sikur të kërkonte ndonjë përgjigje...*

*I pafuqishëm t'i bëja ballë asaj trysnie, desha ta hapja zemrën. Por, hoqa dorë nga frika se tregimi im mund t'i dukej pjesë e ndonjë mashtrimi ose shakaje ngaqë kishte lindur dhe ishte rritur në një ambient të shkëputur nga jashtë, që përjashtonte çfarëdo lidhjeje me të tjerët, veçmas me ato që vinin nga “pjesa armiqësore”. Nga im atë e dija se kishin qenë të kota përpjekjet e tij që ime ëmë të ruante të drejtën që të kthehej në vendlindje... Pas prishjes së regjimit komunist shqiptar me jugosllavët dhe lidhjet me Stalinin, gjermanëve të lindjes dhe të perëndimit njësoj u ishin mbyllur dyert e Shqipërisë. Kjo masë kishte goditur rënd lidhjet familjare dhe veçmas ato martesore, me ç'rast ishin shkatërruar dhunshëm familjet pa marrë parasysh jetën e përbashkët dhe fëmijët. Shteti komunist shqiptar, me një dekret kishte shpallur armiqësore martesat e shqiptarëve me të huaja para dhe gjatë luftës si dhe lidhjet farefisnore të shqiptarëve me jashtë. Kjo praktikë kishte vazhduar edhe me vendet simotra për nga ideologjia, pasi që shteti komunist shqiptar fillimisht kishte prishur marrëdhëniet me Jugosllavinë dhe më vonë, pas vdekjes së Stalinit dhe largimit të Moskës nga kursi i tij, edhe me Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera të kampit socialist. Shkëputja ideologjike me Moskën dhe satelitët e saj, kishte prekur shumë e shumë familje të ushtarakëve dhe të diplomatëve shqiptarë, veçmas të këtyre të parëve, të cilët, ishin martuar me ruse, polake, çeke, bullgare dhe të tjera gjatë studimeve ose specializimeve jashtë. Ky vendim kishte pasur për pasojë prishjen “vullnetare” të martesave me të huajat ose të huajt si dhe dëbimin e tyre nga vendi. Ndërsa, shqiptaret të martuara me të huaj jashtë vendit, njëanshëm ishin përjashtuar nga nënshtetësia shqiptare. Kjo kishte qenë arsyeja pse nëna ime ishte sëmure shpirtërisht. Im atë thoshte se ajo nuk mund ta pranonte gjendjen e shpalljes tradhtare dhe armike...*

*Por, ajo që e kishte qëlluar edhe më rëndë, kishte të bënte me njoftimet rreth ndjekjeve dhe persekutimeve që u bëheshin familjeve “të tradhtarëve” dhe “armiqve të vendit”, me ç'rast nga gjyqet revolucionare dhe pa kurrfarë mbrojtjeje juridike, ata dënoheshin me internim të përjetshëm në kampet e punës, ku shumë prej tyre lenin eshtrat...*

*Se brenga e nënës sime kishte qenë e drejtë, mësova sapo arritëm në vendin që kërkoja. Sapo iu afruam një shtëpie dykatëshe, së cilës edhe më tutje i rrinin prapa disa arra dhe një pjergull e vyshkur rrushi, Nikolini ma bëri me dije se ajo, gjatë kohës së diktaturës komuniste, kishte qenë fillimisht burg, qendër policore dhe gjykatë famëkeqe...*

*“Shtëpia i takonte familjes Sh. Pronarët e saj ishin larguar dhunshëm prej saj nën akuzën e ‘kulakëve’. Katër prej tyre ishin pushkatuar, ndërsa pjesa tjetër (i gjithë farefisi) ishin dërguar në një kamp pune.”*

Nikolini foli e tha se fatin e familjes Sh., e kishin përjetuar edhe shumë e shumë familje të Shkodrës dhe të rrethinës, siç e kishin përjetuar me mijëra të tjera në gjithë Shqipërinë komuniste. Nga një shënim që kishte lexuar, nga hyrja e partizanëve në Shkodër (më 28 nëntor 1944 e deri në vitin 1949) ishin pushkatuar 636 veta, kryesisht të rinj, ku kishte pasur edhe femra. Me dënime të rënda, në kampet e punës, ishin dënuar gjithsej 2576 veta. Me dekretet e shtetit komunist, ishin shpronësuar të gjithë pronarët e tokave, pronarët e fabrikave dhe të punëtorive private. Kjo praktikë kishte vazhduar, por edhe më e egër, edhe në vitet e tjera “të jetësimit të komunizmit autentik shqiptar”, kur burgjet dhe kampet e punës ishin mbushur me intelektualë dhe gjithë ata që ideologjia i kishte anatemuar “si revizionistë”...

“Shqipëria komuniste u shndërrua në një kamp të tmerrshëm përqendrimi, ku vritej shpirti, shpërllahej truri dhe ndalohej çfarëdo lirie...”

Kur po i dëgjoja ato që po m'i thoshte Nikolini, se si më bëhej se ashtu po shihja jo vetëm familjen e nënës sime të masakruar para komunistëve, të cilët ashtu kremtonin fitoren e përgjakur të komunizmit në atë vend, por edhe një pjesë timen, që asnjëherë nuk më kishte shkuar mendja se do ta përjetoja në atë mënyrë...

Pas një heshtjeje të rëndë, Nikolini më tha se pjesa më e madhe e atyre që ishin dërguar nëpër kampe pune kishin pasur fatin e zi...

“Vetëm katër veta, të moshuar dhe të rrëzbitur fare, nga familja Sh., mbijetuan vitet e rënda të burgjeve dhe të internimeve nëpër kampet e punës. Kthimi i tyre në Shkodër, pas rrënimit të diktaturës, në dhjetorin e vitit 1990, i kishte ngjarë një morti. Sepse, takimi me ta dhe të tjerët nga ajo kohë, kishte rikthyer kujtimin e njërit ndër tmerret më të mëdha që ia kishte përgatitur ideologjia komuniste vendit tonë...”

Në fund Nikolini, më tha se njihte njërin nga të mbijetuarit e familjes Sh.

“Ka kohë që po kalon nga gjyqi në gjyq për ta kthyer pronën e familjes...”

Fjalët e fundit të Nikolinit, ma rrotulluan gjendjen e rëndë që më kishte mbërthyer nga rrëfimi i tij për tragjedinë e familjes, veçmas ato që tha se për kalimin e tij nga gjyqi në gjyq, kështu që më shtynë të pyesja për zvarritjen. Nikolini më tha se arsyeja e kalimit nga gjyqi në gjyq lidhej me atë se trashëgimtari i vetëm i kësaj familjeje pengohet nga disa trashëgimtarë të shpifur nga radhët e spekulantëve të shumtë që tha se i kishte prodhuar koha e tranzicionit (kryesisht të lidhur me pushtetin e kaluar), dhe ishin shfaqur me tapi të rreme.

“Shqipëria është plot e përlot me të tillë, që kanë tjetërsuar por edhe uzurpuar pronat e familjeve të shpronësuar dhe të shkallmuara nëpër burgjet dhe kampet e diktaturës...Të lidhur me zyrtarë të korruptuar, gjyqtarë, noterë dhe avokatë, por edhe me politikanë nga hierarkia më e lartë e shtetit, kjo mafi po ua nxinë jetën gjithë atyre që diktatura i rrënoi brutalisht, duke i privuar nga prona, familja dhe liria...”

Duke folur për atë që e quajti “murtajë të demokracisë”, Nikolini tha se askujt nuk do t'ia merrte mendja se liria mund të kthehej në një ankth të tillë saqë njeriu për njeriun të kthehet në një ujë...

Kur i tha këto nuk la pa përmendur edhe ngjarjet e fundit, nëpër të cilat po kalonte vendi nga fillimi i asaj vere, kur shteti ishte shembur pikërisht nga ata që kishin përgjegjësinë për kthimin e lirisë, si një vlerë të përbashkët, që duhej të niste nga brenda dhe jo si mundësiqë të shfrytëzohet kundër saj, pra të kthimit në gjendje kaosi...

“Diktatura ka krijuar monstrumë, që po i hakmerren lirisë... Sidoqoftë, shpresa nuk duhet humbur...”

*Me ato përshtypje të trishta në kokë u ktheva në hotel. Më erdhi mirë që Nikolinit nuk i kisha folur për gjurmët e familjes, sepse do të mendonte se jam ndër ata matrapazë të shumtë, që kërkonin përfitime nga pronat...*

2.

Leximi i *“Kohës së vdekjes”*, edhe pse ma bëri me dije se im atë tashmë ishte larguar ndoshta përfundimisht prej nesh në kërkim të gjurmëve të familjes të së ëmës (gjyshes sime fisnike), ishte një paralajmërim i rëndësishëm dhe njëherësh një vërejtje se atje do të ballafaqohesha me atë që ai thoshte se “nuk mund t’i iket”, meqë shfaqet “si thirrje shpirti...”

Sidoqoftë, *“Koha e vdekjes”*, ndonëse me vonesë, kthente te një e kaluar, që deshëm a nuk deshëm, si pjesë e anashkaluar e trungut tonë familjar, ndërhynte në jetën tonë në një mënyrë të veçantë...

Dhe, do të ishte e natyrshme që pas atij lajmërimi në internet dhe dërgimit të pjesës së parë të *“Kohës së vdekjes”*, tim atë t’ia ktheja ndonjë fjalë. Së paku t’i falënderohesha që kishte zgjedhur atë mënyrë bashkëbisedimi, që për mua, në ato rrethana, kishte rëndësi shumë të madhe, meqë ma kthente babanë me një pamje ndryshe nga ajo që e kisha takuar së fundit, siç e kthente edhe kujtesën e një fatkeqësie të thellë në familjen tonë, të cilën nuk e kishim njohur e as përjetuar si të tillë, por që si do të shihet, do të na përfshijë, duke ia ndjekur gjurmët dhe shpaluar plagët... Por, hoqa dorë nga frika se çfarëdo që do të thosha mund të ndikonte që ai ta ndryshonte mendjen, pra që t’i kthehej heshtjes së atyre viteve që na kishte munduar të gjithëve, gjë që për mua kjo do të paraqiste humbje të dyfishtë.

Kur po rropatesha me këto mendime, që nuk më ndaheshin dhe kishte rrezik që ato të më ktheheshin në një lëmsh të madh, papritmas, në adresën time të internetit, u shfaq edhe një postim tjetër (*“Udhëzime për hulumtime”*).

Në ata njëzet e sa rreshta, nga përvoja e atij që kishte ndjekur nga afër zhvillimet në të dy anët shqiptare, veçmas ato në Kosovë gjatë tri viteve të fundit, pa një pa dy, im atë, bënte me dije se kishte qenë përherë mosbesues ndaj pranisë ndërkombëtare dhe mekanizmave që kishin filluar të vendoseshin atje nga anë të ndryshme me interesa të kundërta nga ç’ishte në gjendje t’i përballonte një vend i vogël me trauma të mëdha dhe me ngatërresa të hapura nga të gjitha anët, të cilave, nuk u duhej shumë që sërish të prodhonin kobe...

Kur thoshte kështu kishte bindjen se telashet e atjeshme kanë të bëjnë me trashëgiminë mentale, por edhe ideologjike të së kaluarës, që kishte ndërhyrë dhunshëm nga jashtë sa herë që ishte nevoja për një qetësi të brendshme...

Ç’është e vërteta, edhe pse pos bisedës së parë që kishim pasur pas kthimit, për vite me radhë nuk fliste fare për misionin dhe për ato që merreshin vesh nga shtypi dhe burimet e tjera rreth kohës kalimtare, por edhe rrugëve që do të çojnë te shpallja e pavarësisë së Kosovës pas tetë vitesh, megjithatë nga heshtja e tillë, mund të merrej vesh një pakënaqësi dhe shqetësim i thellë me atë që po ndodhte, që do të thyhej në një mënyrë të tillë, veçmas me vlerësimet rreth “gishtave të huaj kudo” me anën e të cilëve në njërin anë kanë futur në lojë faktorin fetar (“mbetjet fundamentaliste”) dhe në tjetrën, atë ideologjik (logjikën bolshevike dhe revolucionare të mentalitetit të puçeve). Këto, siç do të shihet, kanë ushqyer të keqen me të cilën do të përballem gjatë punës sime atje bashkë me të tjerët, ndonëse ato ndërlidheshin me mafinë ekonomike dhe politike, që për emërues të përbashkët kishin krimin e organizuar...

“Në Shqipëri kanë ardhur në pushtet garniturat e enveristëve, të përgatitur nga nomenklatura e fundit komuniste në Tiranë, e cila kishte pasur dorë në përzgjedhjen e ‘liderëve të demokracisë’, ndërsa në Kosovë, pushteti është kapur nga grupimet e majta revolucionare (një amallgam nga spektri i gjerë i lëvizjeve ideologjike evropiane të viteve të shtatëdhjeta dhe të tetëdhjeta ku kishin gjetur strehë disa prej tyre). Të tillët, pasi kanë shfrytëzuar hapësirën por edhe dobësitë e lëvizjes së rezistencës paqësore, si dhe përkrahjen e madhe të garniturave të pushtetarëve të Tiranës të interesuar për vasalë në Kosovë, së fundi kanë gjetur mbështetje edhe te partnerët e ndryshëm ndërkombëtarë, që për hesapet e veta (shteti i ardhshëm i Kosovës të shfaqet as mish e as peshk), janë ndihmuar të marrin pushtetin me të gjitha mjetet, pa përjashtuar këtu edhe sehirin përballë eliminimit të kundërshtarëve politikë me anën e vrasjeve...

Ato që sot anatemohen si shërbime të fshehta të partive politike dhe me të drejtë fajësohen për kriminalitet të organizuar politik dhe ekonomik të formave më të rënda (SHIK-u, Mbrotjtja e Atdheut dhe ndonjë formacion tjetër paramilitar nga radhët e veteranëve të luftës), nuk do të mund të vepronin pa aminin dhe madje edhe mbikëqyrjen e ndërkombëtarëve për nevojat e tyre...

-Si mund të shpjegohet fakti se nga paslufta e këndej, në një hapësirë tepër të vogël siç është Kosova, e mbuluar anembanë nga ombrella e sigurisë së NATO-s dhe e përgjuar nga shërbimet më të sofistikuar informative të botës, të vriten me dhjetëra aktivistë politikë (deputetë, kryetarë komunash, hetues policorë dhe të tjerë) dhe të mbeten të pakapur vrasësit e tyre?...

-Si është e mundur që administrata e UNMIK-ut, me gjithë ata hetues, prokurorë e përgjues të mos i bjerë në fije asnjë kriminel?...

-Si mund të shpjegohet fakti që mediat e njohura evropiane dhe ato botërore (*Der Spiegel*, *Die Welt*, *Le Mond*, *Gardian*, *New York Times* e të tjera), të shkruajnë për krim të organizuar në Kosovë, për mafi politike, të dalë nga komandantët e vetëshpallur dhe të shpifur, të kthyer në despotë të fuqishëm, duke cituar me emra dhe mbiemra bosët e krimit të organizuar nga informatat e shërbimeve informative të NATO-s, BND-së e të tjerave, ndërkohë që gjyqësia ndërkombëtare hesht?!

-Si është e mundur që shërbimet kompetente informative të NATO-s dhe vendeve të tjera perëndimore shpërndajnë informata të tilla (herë të shkëputura e herë të dizajnuara qëllimisht), ndërkohë që gjyqësori ndërkombëtar atje hesht, siç heshtin edhe mediatorët e fuqishëm të shtetit të Kosovës?

Natyrisht, se një farse të tillë një ditë duhet t’i vijë fundit. Jo për shkak të Kosovës, por për shkak të lëmshit atje, që prek dhe çrregullon interesat e caktuara për të cilat ndërhyri Perëndimi ushtarakisht. Andaj, pas dhjetë vjetësh të një gjendjeje të tillë dëshpëruese për qytetarët e saj, shpërthimi në opinion i rastit të një agjenti të vetëshpallur të SHIK-ut, ku ai pranonte se në kuadër të një komandoje ka marrë pjesë në disa vrasje politike dhe se për këtë, si i penduar kërkon dënim, me të drejtë vuri në lëvizje drejtësinë evropiane (EULEX). Por, nëse vazhdohet me përvojën e njohur të gjyqësorit të UNMIK-ut: zhurmë shumë e punë hiç, e gjitha mund të kthehet në një mashtrim tjetër, që për çmim mund të ketë sakrifikimin e vetëdijshëm të disa nga figurave që i kanë mbajtur në lojë dhe nuk iu duhen më?...

Meqë Kosova është një dosje e hapur, është e domosdoshme, që t’u hyhet dosjeve të shërbimeve sekrete (NATO-s, BND-së, MAD-it) dhe veçmas asaj të gjykatës së Hagës, ngaqë

shumë nga dëshmitë e dhëna atje, vërtetojnë se shumë nga lojtarët e skenës politike në Kosovë ishin pjesë e skenarëve të shërbimeve të ndryshme informative, që u përdorën për interesat e tyre dhe do të vazhdojnë të përdoren edhe më tutje...”

3.

Pas postimit të parë me *“Udhëzime për hulumtime”*, prisja njoftime të tjera rreth atyre që shfaqeshin si “pista hulumtuese” (dosjet e shërbimeve sekrete të NATO-s dhe BND-së, MAD-it), me anën e të cilave mund t’u hyhej në gjurmë vlerësimeve tepër të ashpra rreth faktorëve që kishin ndikuar në skenën politike shqiptare në Shqipëri dhe në Kosovë që ajo të kthehej si thuhej “në një pre të bosëve politikë të mbështetur nga mafia politike” të për zgjedhur “para dhe gjatë luftës nga faktorë të ndryshëm ndërkombëtarë”.

Por, kaluan kohë pa dërgesa të tjera. Në atë pritje të ethshme, kur hamendjet e shumta zhvendoseshin nga njëra anë në tjetrën dhe shpesh ndodhte zhytja në shpërqendrim, mendja më shkoi se mos ai postim, mund të mos ishte i tim ati, por ndonjë diversion nga dikush, që ia kishte thyer kodin dhe e shfrytëzonte adresën e tij?...

Kjo ishte fare e mundur. Veçmas kur dihej se misioni ndërkombëtar i EULEX-it në Kosovë rreth marrjes me një punë kaq komplekse siç ishte krimi i organizuar atje i thadruar për vite e vite, ishte në fokus të shumë e shumë faktorëve, të cilët ishin të interesuar ta çrregullonin atë qysh në nismë me thashetheme të ndryshme në mënyrë që të krijohet një lëmsh prej nga nuk do të dalë gjë prej gjëje pos zhurmës dhe mbrojtjes së atyre që ishin përgjegjës për gjithë ato që kishin ndodhur atje me gjithë praninë ndërkombëtare dhe monitorimin prej mekanizmave më të rëndësishme europiane dhe botërore?...

Këto dhe hamendje të tjera që m’u ngjiten për kokë dhe po më mundonin gjithnjë e më shumë thuajse më shtynë t’i shkruaj tim ati një si falënderim, që do të shërbente si shkas për të parë nëse ishin ato shkrime të tij, apo dikush fshihej prapa adresës së tij? Mbase këtë edhe do ta bëja, po mos të ishte logjika e thjeshtë e hetuesisë rreth mbrojtjes dhe mbajtjes së burimit edhe nëse dyshonte në të, në mënyrë që atë ta vilte edhe më tutje për aq sa kjo është e mundur... Çfarëdo ndërhyrje imja në këtë drejtim, do të prishte punë, madje edhe tek im atë, që kishte shumë arsye për një mënyrë të komunikimit tonë...

Sidoqoftë, pa lejuar që pritja të më kthehej në një peng, gjithë vëmendjen e përqendrova te rishqyrtimi i atyre që thuheshin në postimin e parë të *“Udhëzimeve për hulumtime”*, qoftë që me aq do të merrnin fund ato.

Tek e fundit, edhe po qe se e gjitha mund të ishte një kurdisje nga dika që hulumtimi im të futej në një qorrsoak, logjika e hulumtuesit e kërkonte që çdo burim dhe njoftim ngado që vinte, të rishqyrtohej deri në imtësi, meqë vetëm ashtu mund të ndahej shapi pre sheqerit.

Kështu, pasi që paraprakisht isha marrë me disa shkrime të *“Der Spiegelit”*, mars-prill të vitit 2000, me librin *“Ballkan Mafia”* të Nideckut, të botuar jo shumë kohë pas vendosjes së administratës ndërkombëtare atje, me studimin *“Kosova”* (versioni gjermanisht i botuar në Vjenë si literaturë shkolllore) të J.O. Schmitt si dhe disa analiza që ishin botuar në *“Institutin për hulumtime lindore”*, me lejen e autoriteteve europiane për hetuesit dhe prokurorët e EULEX-it, me të cilat na hapeshin dyert në të gjitha arkivat e shërbimeve sekrete të vendeve europiane që kishin marrë pjesë në misionin UNMIK, u paraqita në Arkivin Qendror të BND-

së “*Bundesnachrichtendienst*”(Shërbimi informativ federativ), në kuadër të të cilit gjendeshin: BfV - “*Bundesamt für Verfassungschutz*”(Shërbimi për mbrojtjen e rendit kushtetues)dhe MAD “*Amt für den Militärischen Abschirmdienst*“ (Shërbimi informativ ushtarak).

Kësaj adrese do t’i referohesha edhe pa “*Udhëzimet...*” ngaqë BND pas rrëzimit të Murit të Berlinit (1989), bashkimit të Gjermanisë dhe të shpërbërjes së BRSS-së, Gjermania kishte fituar një peshë tepër të madhe në raportet e reja gjeostrategjike. Si e tillë ajo ishte kthyer në një amëz të informacioneve, ku kishin gjetur vend shumë nga burimet më të rëndësishme të shërbimeve më të fuqishme botërore (CIA-es, KGB-së, STAS-it, UDB-së, MOSAD-it e të tjera), të cilat kishin luajtur një rol të madh në të gjitha përvijimet politike lindje-perëndim gjatë luftës së ftohtë. Në rrethanat e reja (shpërbërja e paktit të Varshavës dhe shpërbërja e Jugosllavisë), BND e kishte përballur me sfidat e këtyre ndryshimeve të mëdha, veçmas me ato që kishte prodhuar procesi i përgjakshëm i shpërbërjes së Jugosllavisë, ku lufta e drejtuar nga Beogradi kishte vënë në lëvizje qindra mijëra refugjatë, të cilët, adresë të parë kishin Gjermaninë. Në këtë zhvillim, me hapjen e dyerve refugjatëve, Gjermania ishte kthyer në një strehë të madhe humanitare, por njëherësh edhe në një arenë të forcave politike të etnive të ndryshme, sidomos të shqiptarëve, të cilët statusin e refugjatit të përkohshëm e shfrytëzonin për veprimtari politike në përkrahje të shtetit të Kosovës, të shpallur në vitin 1990 nga Kuvendi i Kosovës (Deklarata Kushtetuese, Kuvendi i Kaçanikut, Referendumi për Pavarësi), prej nga kishte dalë Qeveria dhe gjithë ai organizim që quhej edhe “Shtet paralel” i Kosovës, i cili, nga viti 1992-1999, “kokën” dhe “qesen” e kishte në Gjermani.

Bartja e organizimit politik të shqiptarëve në Gjermani (vendosja e kryeministrit të qeverisë në ekzil me disa ministra fillimisht në afërsi të Shtutgartit e më vonë në Bon), ndërli dhe me njëfarë tradite të veprimtarisë së migracionit shqiptar këtu (kryesisht antikomunistë pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, por edhe i viteve të shtatëdhjeta). Këta të fundit ishin përfshirë në grupimet majtiste dhe revolucionare, fillimisht ithtarë të irredentizmit ideologjik, ndërsa pas vitit 1981, do t’i bashkohen kërkesës për republikën e Kosovës në përbërje të federatës jugosllave, ashtu siç ishte kërkuar gjatë demonstratave të vitit 1968 dhe 1981 në Kosovë. Në rrethanat e reja, këto grupime të majta, fillimisht nën çatinë e një “*Fronti të kuq*” e herë si “*Fronti i kuq popullor*”, të bashkuar rreth “*Lëvizjes për Republikën Socialiste të Kosovës – LRSPK*”, më vonë “*Lëvizja për Republikën e Kosovës – LPRK* “me adresë” dhe “pa adresë” dhe deri te “*Lëvizja Popullore e Kosovës – LPK*”, pas themelimit të “*Lidhjes Demokratike të Kosovës*”dhe kthimit të saj në një lëvizje të fuqishme kombëtare, që kishte marrë përsipër edhe projektin e shtetndërtimit të Kosovës, shumë nga veprimtarët e saj ishin kyçur në radhët e saj.

Duke i njohur këto realitete jo gjithaq nga brenda, ishte e domosdoshme që sado kalimthi, të kaloja nëpër dosjet e BND-së. Me këtë rast u përqendrova vetëm te dosjet e lejuara për informim zyrtar nga (BfV), që kishin të bënin me grupimet politike nga vitet e shtatëdhjeta dhe të tetëdhjeta si dhe veprimtarinë e tyre në Gjermani dhe vendet përreth në mënyrë që të kisha qasje në të gjitha informatat e sistemuara të këtij shërbimi rreth çështjeve që ishin objekt imi i hulumtimit lidheshin me grupime të caktuara politike që kishin vepruar në Gjermani para dhe gjatë luftës e prej nga hapeshin thashetheme rreth fuqisë së tyre që kishin fituar prej andej. Spekulohej edhe me mundësinë e padronëve të tyre të padukshëm, por tepër të fuqishëm, lojërat e të cilëve i kishin luajtur, por që duhej të sakrifikohej që t’u fshiheshin gjurmët.

Edhe pse “informimi zyrtar” ishte tjetër nga “përdorimi zyrtar” i të dhënave (lejohej vetëm leximi aty për aty i të dhënave në praninë dhe mbikëqyrjen e rreptë të personit zyrtar), kapërcimi nëpër shumë prej syresh, jepte hollësi rreth migracionit politik nga vendet lindore (BRSS, Republikës Demokratike të Gjermanisë, Polonisë, Rumanisë, Jugosllavisë, Shqipërisë dhe të tjerave nga blloku socialist), të vendosur në Gjermani gjatë kohës së luftës së ftohtë si dhe lidhjet e tyre me vendet e Beneluksit, Austrinë dhe Francën, ku ata silleshin, prej nga pastaj, pas shumë e shumë analizash, duke ndjekur një veprimtari thuajse gjysmëshekullore, duhej të dilej te “*Dosja B*” dhe përmasat e saj të njëmendta. Ndaj, im atë kishte të drejtë kur ma bënte me dije se për të nxjerrë, qoftë një të vërtetë të vetme nga gjithë kjo hallakatë, duhet të nisesh nga rrënjët dhe jo nga degët...

Meqë dosjet ishin të sistemuara sipas shteteve prej nga vinin emigrantët, brenda tyre kishte nëndosje, sipas republikave dhe krahinave (BRSS dhe Jugosllavia) me shumë sosh, por edhe dosje të veçanta sipas përkatësisë kombëtare, të pakicave kombëtare ose kombësive, siç ishte rasti me ato të Jugosllavisë. Krahas kësaj, dosjet përcaktonin edhe përkatësinë ideologjike (komunist dhe antikomunist) dhe atë fetare (myslimanë - suni, shit; i krishterë - katolik, ortodoks; hebre; budist etj.). Dosjet e komunistëve ndaheshin në “informbyroistë-stalinistë”, “trockistë”, “maoistë”, “enveristë” e të tjerë. Ndërsa ato të “antikomunistëve” përfshinin grupimet e ndryshme nacionaliste të djathtëve (monarkistë, republikanë, irredentistët etj.), shumë prej tyre aleatë të vendeve perëndimore gjatë Luftës së Dytë Botërore, të cilët kishin qenë të detyruar të largohen nga ato pjesë sapo ishte vendosur sistemi komunist. Dhe kështu, sistemimet e tilla thuajse nuk kishin fund, siç nuk kishin fund edhe emrat e atyre me të cilët ishin marrë shërbimet informative.

Megjithatë, fillimisht më duhej të përqendrohesha te dosjet e migracionit politik shqiptar nga koha e luftës së ftohtë e deri te rënia e komunizmit në Shqipëri dhe shpërbërja e ish Jugosllavisë, në mënyrë që pastaj të kaloja edhe te dosjet e luftës së Kosovës (zyrtarisht quhej konflikt i armatosur) dhe ato të vendosjes së protektoratit ndërkombëtar në Kosovë, për të ndjekur veprimet e një pjese të madhe të aktorëve politikë në Prishtinë, të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, disa prej të cilëve prej kohësh ngarkoheshin me hipotekën e bashkëpunëtorëve të shërbimeve të ndryshme (veçmas atij sovjetik-rus, shqiptar, jugosllav, francez e të tjerë).

Këtu, në të vërtetë, shfaqeshin vështirësitë kryesore me të cilat do të përballem gjatë marrjes me atë problematikë, meqë “*Procesi B*” (nga i pari deri te ai i treti, në hetimet e të cilit do të përfshihem për tre vite), krahas fokusimit te disa emra konkretë, njëri prej të cilëve lidhej me hierarkinë më të lartë të luftës (komandant i Shtabit të Përgjithshëm i UÇK-së, post ky që kontestohet nga një pjesë e atyre që dikur i kishin takuar të njëjtit organizim ilegal), përhapej shkallë-shkallë në një rreth që prekte një spektër të gjerë, gjë që nxirrte në pah ndërlidhjet me “mentalitetin revolucionar” (i thadruar në grupimet “marksiste-staliniste”, nga mesi i viteve të shtatëdhjeta e deri në ato të nëntëdhjetat në Gjermani dhe Zvicër) me militantizmin politik të kësaj shtrese, e cila ia kishte dalë që të kthehet në faktor politik dominues pas lufte, prej nga e kishte marrë edhe pushtetin.

Por, edhe qasja kalimthi nëpër këto dosje tumirte qëndrimin, të cilit, në e parë nuk do t’i besoja, se në Gjermani dhe në vendet perëndimore, shumë nga ata që nga Kosova dhe pjesët e tjera të banuara me shqiptarë nga ish Jugosllavia (Maqedonia dhe Lugina e Preshevës), kishin kërkuar strehim politik në Gjermani, në vend se të ishin antikomunistë dhe

disidentë (siç ndodhte me shumë e shumë emigrantë të tillë nga Kroacia, Polonia, BRSS, Bullgaria dhe Rumania), shfaqeshin me bindje marksiste-leniniste të ndërlidhur me mentalitetin revolucionar (logjikën puçiste) si mjet politik për marrjen e pushtetit, i përdorur edhe në rrethanat e pranisë ndërkombëtare!

Sipas vlerësimeve zyrtare të shërbimit informativ gjerman (BND dhe atij ushtarak MAD) shumica e atyre që kishin kërkuar strehim politik në Gjermani gjatë viteve të shtatëdhjeta dhe tetëdhjeta, jo vetëm që ishin të thadruar me bindje staliniste, por ata ishin kthyer edhe në militantë enveristë, që punonin nën mbikëqyrjen e rrjetit të shërbimit informativ shqiptar të përhapur në disa vende perëndimore. BND (Shërbimi Informativ Gjerman), kishte të deponuara informata të shumta për kontaktet e emigrantëve politikë shqiptarë nga Kosova me përfaqësuesit e ambasadës së Shqipërisë në Austri, në Belgjikë, në Francë si dhe në Turqi. Aty ishin edhe faksimilet e letërkëmbimit të disave me agjentët e shërbimit informativ shqiptar, të maskuar nën maskën e përfaqësuesve diplomatikë ose të ndonjë përfaqësuesi tregtar. Kishte edhe transkribime të shumta të bisedave telefonike të personave të caktuar nga grupime me ambasadat shqiptare në këto vende, siç kishte edhe transkribime të bisedave “sy më sy” të disa aktivistëve të *këtij milieu* me diplomatët shqiptarë gjatë ndonjë darke “të fshehur” në ndonjë restorant ballkanik, ku “shkëmbeheshin informata”, kryesisht për demaskimin e “titistëve” në radhët e “gastarbajterëve” të shumtë, të cilët duhej mobilizuar që të përfshiheshin në organizatat marksiste-leniniste të lidhura me Shqipërinë.

Gjatë këtyre takimeve, aktivistët shqiptarë pajiseshin me fletushka marksiste-leniniste që botoheshin në Shqipëri si dhe me material tjetër propagandues (veprat e Enverit, veçmas “*Titistët*” dhe “*Vetadministrimi jugosllav si teori dhe praktikë revizioniste*”). Ato duhej t’u jepeshin “gastarbajterëve” (punëtorë të përkohshëm) shqiptarë nëpër klubet jugosllave, ku ata silleshin dhe pështilleshin, ndonëse dihej se ato drejtoheshin dhe mbikëqyreshin kryesisht nga shteti jugosllav dhe shërbimi i tij informativ, që llogaritej se ishte ndër më të përgatiturit e kohës. Aty ishin edhe disa fletushka të këtyre grupimeve ideologjike të botuara si të përkohshme (me nga dy-tre numra) në Gjermani kryesisht me artikujt propagandues të “*Zërit të Popullit*”, me plot e përplot thirrje për bashkimin ideologjik të shqiptarëve në luftë kundër “revizionizmit” jugosllav nën flamurin internacionalist!

Duke kaluar nëpër këto materiale, të shumtën si fletushka dhe pamflete politike, shihej lidhja fanatike e kësaj pjese të të përndjekurve politikë nga Kosova me stalinizmin shqiptar dhe me ideologun e tij. Kjo më së miri pasqyrohej me thirrjen: “*Të rrojë shoku Enver Hoxha, që po na ndriçon rrugën e veprimit*”, që shfaqej moto në programin e “*Frontit të Kuq Popullor*”.

Në atë rrëmujë informatash, që për t’i rënë në fije një lëmshi në dukje absurd të riformatizimit të lëvizjeve të majta nën ombrellën e “një fronti të kuq” në Perëndim, ia dola që të ruaj nofkat e disave, shumanshëm të kapur në rrjetin e agjenturave në trekëndëshin Tiranë-Beograd-Moskë.

Nga hulumtimet e mëvonshme, që lidheshin me kohën pas rënies së Murit të Berlinit, shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik dhe veçmas me Lëvizjen e rezistencës institucionale në Kosovë e deri te ajo e armatosur në fund të viteve të nëntëdhjeta, që i kishin paraprirë edhe ndërhyrjen ushtarake të NATO-s atje, hetova se disa nga revolucionarët e “frontit të kuq”, ishin kthyer kah shërbimet perëndimore (amerikan, francez, britanik dhe izraelit). Kjo i kishte

forcuar edhe më shumë, deri në atë shkallë sa ata të kthehen në faktorë kryesorë të politikës së vendit.

Por, gjithnjë duke kaluar nëpër dosjet e BND-së, fuqia e të apostrofuarve për kriminalitet politik dhe ekonomik, shumë prej të cilëve përfshinte edhe “*Dosja B*”, kishte kaluar nëpërmjet infrastrukturës politike dhe ekonomike të emigracionit politik shqiptar të instaluar kryesisht në Gjermani dhe Zvicër, që kishte vepruar nëpërmes mekanizmave ilegale ose formave të paligjshme. Të tillë kishin qenë “*Fondi i trepërqindëshit*”, i menaxhuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës e vendosur në Gjermani, si dhe Fondi “*Vendlindja thërret*” i menaxhuar nga dega e “*Lëvizjes Popullore të Kosovës (LPK)*” në Gjermani, me qendër në Dyseldorf.

Që të dyja këto fonde, ishin regjistruar “si fonde humanitare”, por sipas vlerësimeve të BND-së, ato ishin kthyer në mjet të fuqishëm politik: “*Trepërqindëshi*” në duart e Qeverisë së Kosovës në ekzil, me të cilin financohej veprimtaria e shtetit paralel në Kosovë (arsimi, shëndetësia, kultura, informimi dhe veprimtaritë e tjera). Ndërsa fondin “*Vendlindja thërret*” në duart e një grupi veprimtarësh të LPK-së, të cilët mbledhjen e fondeve e arsyetonin si ndihmë humanitare popullatës së përndjekur nga regjimi serb, ndërkohë që gjithandej kah shtriheshin shqiptarët në Gjermani dhe vendet e tjera europiane (si pjesë e diasporës, ose refugjatë), flitej për “detyrim patriotik ndaj atdheut” për nevojat e financimit të rezistencës së armatosur dhe më vonë edhe të UÇK-së.

Nëse “*Fondi i trepërqindëshit*” formalisht kalonte nëpër “*Bayerische HypoVerinsbank*” në Mynchen dhe “*Dardania bank*” në Tiranë, por që nuk i kishte shpëtuar keqpërdorimit të shumanshëm veçmas nga shfaqja e rezistencës së armatosur e deri te përfundimi i luftës (bëhej fjalë për manipulime të shumta me kontrata fiktive të blerjes së armëve, pastaj bartjes së fondeve të caktuara në duar të komandantëve të shpifur dhe të grupeve të tjera mafioze të instaluara nëpër hotelet luksoze të Tiranës dhe nëpër disa qytete të tjera perëndimore, e të tjera), edhe Fondi “*Vendlindja thërret*” formalisht rridhte në bankën gjermane “*Sparkasse*”. Por, siç ndodhte me fondin e qeverisë në ekzil, që kalonte edhe nëpër “xhepa të padukshëm”, edhe “*Vendlindja thërret*” ndiqte të njëjtën rrugë në mos edhe më keq, ngaqë ishte i lidhur me disa agjenci turistike, që merreshin në mënyrë ilegale me transaksione financiare nga vendet perëndimore në Kosovë si dhe shumë rrugë të padukshme që zbrazeshin të shumtën në Tiranë, po ashtu, midis komandantëve që rrinin nëpër hotelet luksoze të Tiranës dhe zyrtarëve të lartë të shtetit shqiptar nga radhët e socialistëve.

Për transaksionet e agjencive turistike nga vendet perëndimore për në Kosovë, BND njoftonte se ato lejoheshin edhe nga shteti jugosllav, i cili krahas mbikëqyrjes së derdhjes së parave, njëherësh, nëpërmes bankave, legalisht posedonte të gjitha mjetet që shkonin atje, gjë që, gjithnjë sipas shënimeve të BND-së, Beograd në këtë mënyrë, çdo vit shfrytëzonte rreth 500 milionë marka, shumë kjo që asokohe ishte e përafërt me gjysmën e buxhetit që armata jugosllave përdorte për luftë në Bosnje e Hercegovinë, Kroaci si dhe për mbajtjen e represionit policor-ushtarak në Kosovë.

Bie në sy se menaxhimit i paligjshëm i këtyre fondeve gjatë luftës dhe pas saj ishte zënë në gojë disa herë edhe nga shtypi gjerman, por edhe nga prokuroria federative, e cila në dy raste kishte kërkuar hetime dhe bastisje të disa personave të autorizuar për menaxhimin e tyre, por e gjitha, pos ndonjë konfiskimi të “mjeteve të punës” (kompjuterëve), kishte përfunduar pa ngritje të ndonjë padie. Disa gazeta gjermane, që kishin qenë shumë kritike

ndaj kësaj veprimtarie dhe në përgjithësi sjelljes së shtetit gjerman ndaj “separatistëve” shqiptarë (“*Der Spiegel*”, “*Focus*”, etj.), kishin theksuar se “gjyqësia gjermane nuk merrej me fondet e shqiptarëve ngaqë prej tyre kishin përfituar qarqe të caktuara politike dhe ushtarake nga hierarkia e lartë”. Gazeta “*TAZ*” e Berlinit, me një rast kishte shkruar se “nëpër fondet e luftës në Gjermani kanë kaluar miliona e miliona para të pista të narkomanisë ndërkombëtare, dhe se, prej tyre kanë përfituar edhe zyrtarë të lartë gjermanë, që pengojnë hetimet”!

Ngjashëm flitej edhe për fuqinë e kësaj paraje në Tiranë, ku thuhet se ajo kishte qenë mjet i fuqishëm, që kishte ndikuar edhe politikën shqiptare në nivelet më të larta, por edhe krijimin e qendrave kriminale, të cilat luftën, por edhe financimin e shtetit paralel të Kosovës e kishin shfrytëzuar për marketing politik si dhe për luftë të ashpër kriminale, midis “krahut të luftës” dhe “krahut institucional”, me një kufi “ndarës” aq të ngatërruar e të paqartë në një skenë të përbashkët që e tillë kishte mbetur për shumë kohë (gjatë dhe pas luftës dhe më vonë) nga qërimi i hesapeve midis grupeve kriminale.

Ndoshta kapitulli i fondeve të luftës si dhe menaxhimi i tyre me shumë e shumë keqpërdorime dhe dyshime do të mund të mbyllet, me fundin e luftës. Por, do të jetë “*Dosja B*” si dhe ato që do të dalin prej saj, ndonëse me kufizime, ku do të shihet se paratë e luftës, nëpërmes kanalesh të fshehta kishin vazhduar të përdoreshin për forcimin e grupeve të caktuara, me ç’rast, me metoda mafioze dhe kriminale kishin filluar të dominonin ekonominë, por edhe politikën e vendit deri te majat e saj gjithnjë për të keq. Kështu, nga këto para të pista, ishte mundësuar që prona publike e vendit (mijëra hektarë të kooperativave bujqësore, objekte ekonomike dhe shoqërore) të kthehet në plaçkë të disa komandantëve të luftës, të cilët, duke shfrytëzuar “autoritetin e luftës”, brenda një kohe të shkurtër ishin kthyer në milionerë.

Ky pasurim marramendës, i një grupi të caktuar, që dominonte edhe skenën politike të vendit si dhe kthimi i tyre në despotë partiakë dhe politikë, nuk do të ishte i mundur pa ndihmën e qarqeve të caktuara në radhët e faktorit ndërkombëtar të vendosjes, (fillimisht UNMIK-ut dhe mekanizmave evropianë, ndërsa pas pavarësisë misionit EULEX dhe zyrtarëve të tjerë të lartë të Bashkimit Europian). Siç do të shihet, qarqet e tilla, ishin të interesuara që të mbajnë në pushtet një klasë politike të korruptuar, përherë të shantazhuar, nga e cila do të përfitoheshin miliona, paçka se kjo shkonte në dëm të demokracisë, lirisë si dhe ardhmërisë së vendit.

Por, ky konstatim i një natyre politike, për një hetues që merret me një proces kompleks çfarë ishte ai rreth “*Dosjes B*”, sigurisht se mbetet i pavlerë përderisa të mos përfshinte dhe nxirrte para drejtësisë dhe përgjegjësisë ligjore gjithë aktorët e kësaj gjendje, me ç’rast pranimi i fajit për vrasje politike me paramendim të mos mbetej si vepër e një individi të penduar, siç shfaqet Vrasësi i Penduar, por vepër e një grupi të gjerë mafioz nga radhët e politikës, të cilët kishin shkuar aq larg saqë edhe kishin vararë.

Këto vrasje të shumta në Kosovës gjatë dhe veçmas pas luftës (shumica prej tyre intelektualë nga radhët e LDK-së, ushtarakë të lartë nga radhët e FARK-ut por edhe disa komandantë të njohur të UÇK-së nga radhët e ushtarakëve të ish armatës jugosllave, kryetar komunash, hetues, policë dhe deputetë të Kuvendit të Kosovës, inspektorë të ish shërbimit policor të Kosovës, që cilësoheshin “bashkëpunëtorë të okupatorit” e ndonjë biznesmen), ndonëse kishin mbetur të pazbuluara (me to ishin marrë hetues të UNMIK-ut e më vonë edhe

të EULEX-it), megjithatë në opinion gishti dyshues drejtohej kah SHIK-u i ashtuquajtura Shërbim Informativ i Kosovës i themeluar nga Drejtoria Politike e UÇK-së gjatë luftës dhe i rikonfirmuar nga e ashtuquajtura Qeveri e Përkohshme e Kosovës, e themeluar në Tiranë në maj të vitit 1999. Kjo qeveri dhe shërbimet e dala prej saj, edhe pse nuk ishte pranuar nga LDK dhe nga shumë anë ishte shikuar si një “puç i majtistëve” për marrjen e pushtetit të ndihmuar nga qeveria socialiste e Tiranës. Ajo kishte vazhduar të punojë njëanshëm dhe pa legjitimitet politik deri në dhjetor të vitit 2000, kur ajo dhe të gjithë mekanizmat e tjerë paralelë, ishin shpërbërë nga UNMIK-u, që me rezolutën 1244 të KS të OKB-së të 12 korrikut 1999, kishte marrë përgjegjësinë e plotë të administrimit të vendit. Por, edhe përkundër kësaj ndalese, me përfolje dhe pa to, ishte veprimtaria e SHIK-ut, si indi kryesor i Qeverisë së Përkohshme, që nuk kishte pushuar. Përkundrazi, i mbështjellë me vellon e një fuqie të padukshme, ky shërbim kishte vazhduar t’i shtrinte degët në të gjitha fushat e jetës, duke kapur institucionet nga brenda në formën e një rrjeti mafioz sekret, me ç’rast, me anën e dosjeve të sajuara nga shërbimet e huaja që kishin qenë të interesuara për sjelljen e njerëzve të tyre në pushtet, ishin eliminuar intelektualët e njemendte si dhe gjithë ata që nuk kishin qenë pjesë e kësaj mendësie. Nga disa artikuj të mbledhur nga një pjesë e shtypit vendor që botohej jashtë, vazhdimisht bëhej me dije për ekzistencën e kësaj qendre sekrete që vepronte haptas për të sjellë në pushtet mafinë politike nga radhët e “krahut të luftës”.

Dalja në opinion e Vrasësit të Penduar në verën e nxehtë të vitit 2010, me pohimet se kishte qenë pjesëtarë i SHIK-ut, se kishte marrë pjesë në disa vrasje, se ishte përgjegjës për njërën prej tyre (një inspektori të lartë të ish shërbimit policor të Kosovës) me ç’rast ai, krahas emrave të “skuadrës vrastare” kishte nxjerrë edhe emrin e “shefit të tyre”, (Komandant i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së nga krahui i “komandantëve të Tiranës”), realitetit politik të vendit përfundimisht ia kishte hequr perden e rreme prapa së cilës ishte zhvilluar një luftë e papastër për pushtet dhe për kapjen e shtetit në të gjitha nivelet me metoda kriminale dhe mafioze nga grupe të caktuara paramilitare. Ia kishte nxjerrë në pah edhe dyshimin e hapur të shumëkujt rreth lirisë dhe pavarësisë së parafytyruar ndryshe, e cila me të shpejt ishte kthyer në një pushtim tjetër në sajë të një komploti të strukturave të caktuara kriminale nga jashtë dhe brenda, për të cilin ishte punuar që moti, që shtetit të Kosovës t’i vihet guri i mullirit në qafë, në mënyrë që t’i shkatërrohet ardhmëria për të cilën ishte derdhur aq shumë mund, punë dhe gjak...

Dyshimi për “gurin e mullirit” në qafën e Kosovës nga brenda, në rrethanat kur pritej të jetësohej, siç do të ndodhë më në fund, në shkurtin e vitit 2008 kur kjo ishte bërë me përkushtimin e SHBA-ve dhe vendeve perëndimore, të cilat e kishin më se të qartë se faktorë të ndryshëm nga brenda dhe jashtë ishin bashkuar ta pengonin atë, mund të kuptohet edhe nga shënimet e disa dosjeve të shërbimeve informative (NATO-s, BND-së të tjerave nga vendet pjesëmarrëse në këtë mision), të cilat nga viti 2004 e këndeje kishin rrjedhur në opinion në faqet e shtypit të njohur (“*Der Spiegel*”, “*Die Welt*”, “*New York Times*”, “*Gardian*” e të tjera), të bartura me zhurmë të madhe në shtypin e Beogradit, prej nga herë pas herë, si shkëputje, kishin gjetur vend edhe në ndonjë cep të shtypit kritik vendor.

Në këto “shkëputje”, me emra e mbiemra, përmendeshin ato që cilësoheshin “grupe mafioze” dhe “qendra kriminale” në radhët e politikës, veprimtaria e të cilave vazhdimisht shihej e lidhur me komandantët e shpallur dhe të vetëshpallur, që kishin futur nën mbikëqyrje resurset kryesore ekonomike të vendit (nëpërmes privatizimit të montuar dhe formave të

tjera). Atyre u vishej monopoli si thuhej kriminal në fushën e tregtisë me naftë dhe derivate të saj, të tregtisë me duhan, të tregtisë me kafe, të pastrimit të parave dhe të veprimtarive të tjera të lidhura me mafinë ndërkombëtare (droga, prostitucioni, trafikimi me qeniet njerëzore e të tjera), të cilat Kosovën e kthenin në një pikë të zezë, me çka ajo duhej të privohej nga shtetësia, në mënyrë, që siç propagandonin Beogradi dhe Moska, t'i merret mundësia “që të rrezikojë rajonin...”

Edhe pse skenari i kthimit të Kosovës në një gogol ndërkombëtar ishte parandaluar pas ngjarjeve tragjike të vitit 2004, kur me ndërhyrjen e amerikanëve ishte kërkuar nga aleatët europianë që të punohet në jetësimin e shtetit të pavarur të Kosovës, para se të bëhet vonë, madje edhe me përfshirjen në këtë proces historik edhe të politikanëve të anatemuar për veprimtari kriminale dhe mafioze të përkrahur nga kundërshtarët e pavarësisë së saj, megjithatë, këto grupe mafioze nuk kishin hequr dorë nga përkushtimi i tyre i kahershëm, që edhe shtetin e Kosovës, ta kthejnë në plaçkë të tyre...

Natyrisht se “*Dosja B*”, ndonëse e përqendruar te kidnapimet dhe vrasjet politike nga “komando vrastare” gjatë dhe pas luftës, nuk mund të kuptohej e as të zbërthehej pa thellimin në këto dokumente.

Ishte fjala për dy “dosje” thuajse paralele të shfaqura nga mesi i vitit 2004. Njëra vinte nga Shërbimit Informativ i NATO-s nën shifrën e punës “*Për rrënjët e krimit të organizuar në Kosovë dhe përfshirjen e faktorëve politikë në të*”, ku pozicionimi mafioz dhe kriminel shihej i ndërlidhur edhe me faktorin ideologjik, që çonte te lidhjet e dikurshme të tyre me grupet marksiste-leniniste si dhe riaktivizimin në përputhje me konceptin e ri që strukturat ideologjike të ruhen dhe të forcohen edhe në rrethanat e pluralizmit demokratik me anën e mafisë politike e cila duhet të shfrytëzojë të gjitha resurset kriminale për të ardhur në pushtet prej nga ata do të kthehen në oligarkë të fuqishëm sipas motos “oligarkë të të gjitha vendeve të tranzicionit, bashkohuni në një imperium të ri”.

Dhe “dosja” tjetër ishte e Shërbimit informativ ushtarak gjerman MAD (“*Amt für den Militärischen Abschirmdienst*” në kuadër të BND-së), qëllimi i së cilës ishte konfirmimi i dosjes së NATO-s, rreth asaj se mafia politike e Kosovës me rrënjët në luftë tashmë po vepronte në kuadër të konceptit të imperiumit të oligarkëve të rinj, që vinte nga Moska, në formën siç paralajmëronte im Atë se atje historia po i përsëriste ngjarjet (mendonte te ardhja në pushtet e garniturës politike të mendësisë revolucionare dhe rrënimi i elitës intelektuale), që botës shqiptare i sollën fatkeqësi të vazhdueshme edhe në rrethanat kur duhej ta rimerrte veten...

### ***“Koha e vdekjes”***

*(Pjesa e dytë: nga Shkodra)*

*Martin SH., që e solli Nikolini në kafenenë përballë hotelit prej nga fillonte pjesa e çarshisë së vjetër, doli se ishte xhaxha i sime ëmë. Ishte i vetmi nga katër vëllezërit dhe dy motrat që i kishte mbijetuar terrorit komunist shqiptar. Mësova se vëllai i madh, Marku dhe i treti, Marashi ishin pushkatuar sapo u kishin rënë në duar partizanëve, ndonëse aleatëve u kishin premtuar se i ashtuquajturi “pushtet popullor” do të respektonte të gjitha shtresat*

qytetare si dhe ato politike që do të legjitimoheshin në “zgjedhjet demokratike”, të cilat do të mbaheshin së shpejti. Pra, me anën e këtij mashtrimi, partizanët, si me shumë e shumë të tjerë, që i kishin takuar administratës dhe ushtrisë që kishte krijuar qeveria shqiptarë e dalë nga Asambleja Kushtetuese e Tiranës nëntorit të vitit 1943, i kishin qeruar hesapet atypër aty.

Në të vërtetë, Mark SH., si ushtarak që ishte (i anatemuar gjatë kohës së pushtimit italian si nacionalist dhe i burgosur dy herë për veprimtari patriotike), i përfshirë në forcat ushtarake shqiptare në detyrën e komandantit të divizionit të veriut, përgjegjës për mbrojtjen e vijës kufitare Shkodër-Plavë-Guci-Pazar i Ri-Pejë, kishte luftuar deri në frymën e fundit kundër partizanëve. Luftën kundër partizanëve e kishte filluar sapo e kishte marrë detyrën e komandantit të vijës mbrojtëse të Veriut, duke iu kundërvënë aradheve jugosllave në pjesën e Sanxhakut e deri në veri të Kosovës, të cilat, në këto fronte, bashkëvepronin me partizanët shqiptarë. Pjesa e popullatës së atjeshme ishte mbrojtur me sukses edhe nga sulmet e vazhdueshme të çetnikëve të Drazha Mihailoviqit. Pas tërheqjes së forcave gjermane kah veriu, kolonel Mark SH., me disa njësi të zgjedhura, ishte përqendruar në pjesën e Shkodrës për ta mbrojtur atë nga partizanët shqiptarë dhe jugosllavë, që po i afroheshin në të dy anët (nga veriu dhe jugu). Sulmeve partizane, të ndihmuar nga sovjetikët dhe aleatët, u kishte bërë ballë deri sa kishte pasur municion. Kur i kishte shpenzuar edhe fishekët e fundit, bashkëluftëtarëve u kishte urdhëruar që të largoheshin sa më parë në mënyrë që të mbroheshin nga hakmarrja partizane. Me dy veta që nuk e kishin lënë vetëm, ishte rrethuar nga partizanët, të cilët e dëshironin të gjallë në mënyrë që ta pushkatonin publikisht. Kjo edhe kishte ndodhur të nesërmen në qendër të qytetit, kur vetë i teti ishte pushkatuar në mes të ditës. Ashtu i vrrarë, me parullën “kuisling” në trup, ishte lënë deri të nesërmen.

Edhe i vëllai Marashi, zëvendës prefekt i qytetit, i cili ishte pushkatuar nga partizanët, pas një gjyqi revolucionar që i ishte bërë ashtu shpejt e shpejt, bashkë me njëzet e shtatë të tjerë, (gjykatës, noterë e të tjerë), kishte qenë armik i përbetuar i komunistëve. Ai, madje, këtu ua kishte thënë haptas para se ta pushkatonin.

Vëllai i dytë, Gjergji dhe Martini, ishin burgosur dhe torturuar në mënyra më çnjerëzore për më shumë se një vit në burgjet komuniste nën akuzën “e spiunëve” gjermanë. Në ato rrethana ata kishin nënshkruar gjithë ato që u ishin veshur (gjoja futja në shërbimin e spiunazhit gjermanë gjatë kohës së fashizmit, marrja e detyrave për sabotimin e pushtetit popullorë e të ngjashme). Strumbullar i këtyre akuzave kishte qenë ime ëmë, e vlerësuar madje “përgjegjëse për spiunet gjermanë në Shqipëri”, me të cilat, thuhej se kishte mbajtur lidhje të vazhdueshme dhe madje, disa herë me këtë detyrë, me avion të Wermachtit, kishte ardhur edhe në Shqipëri!

Në fund të atij gjyqi revolucionar, Gjergji dhe Martini ishin dënuar me vdekje. Me vdekje ishte dënua edhe ime ëmë, ndonëse nuk kishte marrë pjesë në proces... Pas një pritjeje prej një viti, Gjykata e Lartë, dënimin me vdekje ua kishte kthyer në burg të përjetshëm. Kështu, Gjergji ishte dërguar në kampin e Spaqit, ndërsa Martini në burgun e Burrelit.

Edhe motrat e sime ëmë, tezeta Filja dhe Dranja, të pamartuara, ishin burgosur. Fillimisht ishin akuzuar për pjesëmarrje në një organizatë kundërrevolucionare, por meqë ishin të reja (Filja 16 vjeçare dhe Dranja 18 vjeçare), aktakuza ishte përqendruar te dhënia e ndihmës një grupi diversantësh (dërgim ushqimi, veshmbathje dhe bartje informatash në

adresa të caktuara). Ishin shpallur fajtores dhe dënuar me internim në një kamp pune Filja dhjetë vjet, ndërsa Dranja 12 vjet.

Pa ndonjë gjyq, nëpër internime (kampe të punës) kishin kaluar e gjithë familja, pa përjashtim gra, fëmijë dhe të moshuar, si dhe një pjesë e farefisit të vendosur në rrethinë të Shkodrës pas shpërnguljes nga Kosova në dimrin e vitit 1912 kur ajo ishte pushtuar nga serbët, sado që shumë prej tyre, nga kushtet e rënda jetësore, për vite të tëra nuk ishin parë mes veti.

Martin Sh., një copë herë më shikoi me mosbesim. Edhe pse Nikolino i kishte thënë se ishte një gjerman, i cili, në kalim e sipër për në Kosovë, në një mision humanitar, ishte ndalur paksa në Shkodër ngaqë si fëmijë kishte njohur një grua shkodrane, të martuar për një kushëri të vetin gjerman, e cila i kishte folur aq shumë për këtë qytet saqë, në shenjë të nderimit të kujtimit të saj si dhe të mallit që shprehte për vendlindjen e saj të ndaluar, kishte vendosur ta vizitonte...

Ndonëse mosbesues ndaj gjithçkaje, Martin SH., ishte përqendruar aty ku më së shumti më rrinte mendja, pra te trangu i rrënuar i familjes. Tha se kishte mbetur vetëm ai, një shkretan, meqë edhe disa nga kushërinjtë e largët, pas rrëzimit të diktaturës komuniste, si shumë shqiptarë të tjerë, kishin marrë botën në sy.

“Kush u vra, kush vdiq në burgje, ndërsa motrave u humben gjurmët nëpër kënetë... Gruaja e Marashit, që ishte me barrë, u vetëvra... E fejuara e Martinit, po ashtu u internua diku... Mirë që gjermanja i shpëtoi kësaj murtaje (fjalën e kishte për nënën time)... Mbase ka lënë dike mbrapa?... Së paku diku të na ruhet fara... Nuk i dihet jetës... Ripërtërihet ku nuk pritet...”

Pas një heshtje të mbushur me ofshama të thella, Martin SH., iu kthye çështjes së pronës, e cila, prej viti në vit bartet nga njëri gjyq në tjetrin.

“Nuk e kam gjithaq për lekët, meqë jeta ime, me ta dhe pa ta, ashtu ka mbarue... Por, e kam për me e dëshmue se ajo asht pjesë e shpirtit tonë, e qenies sonë, që ndonëse duket se po shuhet, këtë nuk duhet me e pranue...”

Tha se do të luftojë deri në frymën e fundit për ta rikthyer edhe pse kishte të bënte me mafiozë që janë në gjendje edhe të vrasin...

“Vetëm gjatë këtij viti, për këto punë, në Shkodër, janë vra shumë veta... Bandat komuniste kanë lanë mbas farën e tyre të keqe kudo... Nuk hiqen lehtë ata nga pushteti dhe gjaku...”

Kur po ndaheshim, mbasi përmenda largimin për në Kosovë, Martin SH., më tha se në Prizren, prej nga vinin të partë e tij, kishin një kushëri. Mezi lidhi emrin Lekë SH., argjendar...

“Nëse ka pasë fat me i shpëtue thikës së shkaut, dyshoj se ka mundë me i shpëtue hakmarrjes komuniste...”

Nuk ma merrte mendja se ndarja me Martin SH., do të ishte aq e rëndë për mua. Në njërën anë ishte fati i zi që kishte përcjellë një familje të tërë nga hakmarrja e komunistëve ndaj nacionalistëve dhe në tjetrën anë ishte fati tragjik i dajës (xhaxha i nënës sime) që e dëgjoja ashtu i trishtuar pa qenë në gjendje t’ia pranoja të vërtetën, nga frika se jo vetëm që nuk do ta besonte, por mund ta merrte edhe si përpjekje për ta futur në kurth për ndonjë përndjekje tjetër me të cilin përfundimisht do të shpallej i çmendur...

*Por, ndryrja e të vërtetës para një njeriu të shkatërruar tmerrësisht tashmë po më ballafaqonte me një vrarje të ndërgjegjes, që nuk ma kishte marrë mendja se mund të ishte e tillë sa të ma merrte edhe gjumin. Në atë përpëlitje me ato që m'i kishte thënë Martin SH., të cilin tashmë po e përfetoja si dajë dhe njeri tepër të afërm, në vuajtjen e të cilit sado pak duhej të merrja pjesë, befaz më shkoi mendja prapë ta takoja dhe së paku tërthorazi t'ia tregoja të vërtetën. Mbase kjo do t'i ndihmonte më shumë se të tjerat, siç do të më ndihmonte edhe mua?...*

*Me këtë mendim në kokë kërkova nga Nikolini që të më lidhte edhe një herë me të po atë ditë, meqë të nesërmen nisesha për në Kosovë.*

*Nikolini e kishte kërkuar kahmos gjatë gjithë ditës Martinin. Aty ku rrinte (në një strehimore humanitare holandeze) i kishin thënë se nuk ishte kthyer atë natë e as të nesërmen. Ngjashëm i kishin thënë edhe në klubin e shahut në Parrucë, ku ai kalonte pjesën më të madhe të kohës.*

*I pikëlluar pa masë, të nesërmen nga mesdita, sapo erdhi Gazetari i "Rilindjes", morëm rrugën e kthimit për në Kosovë...*

*Në furgonin e parë u nisëm drejt Milotit, të njëjtës rrugë prej nga kishim ardhur. Por, tash atë po e bënim ditën. Ajri i rëndë brenda dhe tollovia e komunikacionit në rrugë, që përballlohej me vështirësi, udhëtimin e bënin të bezdisshëm. Kjo shtoej edhe më shumë nga pamja e zyrtë e mjedisit tepër të stërkequr nëpër të cilin kalonim plot e përplot me mbeturina të hedhura skaj rrugës, me deponi hekurishtesh dhe pjesë të veturave të dala jashtë përdorimit, me kioske të stërmbushura me gjithfarë plaçkurinash e ku nuk mungonin edhe ushqimet (nga perimet e deri te mishi), që kundërmonte rënd...*

*Kalimi nëpër këtë hallakamë bëhej edhe më i padurueshëm, ngaqë nga hapi në hap, furgoni ndalej edhe nga shitës rrugës, që futeshin brenda me enë uji, me lëngje, me byrekë dhe çka jo tjetër, që t'i rrasnin në fytyrë...*

*Kështu zgjati deri në Milot, ku u ndalëm dhe prej nga duhej ta merrnin rrugën për në Prizren.*

*Në atë pritje që për fat nuk zgjati shumë, u shfaqën edhe shitësit e armëve. Ishin disa të rinj me armë të lehta në dorë (pistoleta, kallashë e ndonjë bombë dore) me një çmim nga 30 deri në 100 marka. Fishekët shkonin nga një markë.*

*Kur po largoheshin, pasi që askush nuk ua mori mallin, lanë pas fjalët "nuk duhet habitur nëse shkau ju faron..."*

*Rrugën për në Kosovë m'u duk se po e merrnim me të njëjtin furgon me të cilin kishim ardhur në këtë anë. Kjo më qetësoi paksa, meqë ashtu përballloheshin të gjitha pengesat e rrugës (postbllloqet e rrugëve dhe madje edhe kufiri që na priste pas disa orësh, aty nga mëngjesi).*

*Këtë sikur ma pohoi edhe gazetari i "Rilindjes", që sapo u nisëm, u mbështet nga xhami dhe mbylli sytë.*

*Por, mua nuk po më zinte gjumi. Përkundrazi, në atë shalakatje të furgonit të përballjes me rrugën e keqe dhe kthesat e mëdha, jashtë dëshirës, m'u qepën për kokë fjalët e dajës, Martin Sh., rreth hakmarrjes komuniste si dhe tmerrit nëpër të cilin kishte kaluar jo vetëm familja e tij, pjesa më e madhe e popullatës së Shkodrës dhe e gjithë Shqipërisë.*

*"Ndaj nesh kishte hakmarrje të dyfishtë: si nacionalistë dhe si kosovarë... Çmimin e së parës duhej ta paguanim pse kështu kërkonte ideologjia komuniste që drejtonte shtetin*

shqiptar, ndërsa të së dytës se kështu kërkonin vëllezërit jugosllavë, të cilët jo vetëm që drejtonin lëvizjen komuniste në Shqipëri dhe Kosovë, por edhe atë të shuarjes së çfarëdo vetëdije irredentiste, që duhej të luftohej bashkërisht, sidomos te kosovarët në Shqipëri dhe në Kosovë, prej nga ajo, me krijimin e 'Shqipërisë së Madhe', kishte ushqyer gjatë fashizmit..."

Edhe pse daja, Martin SH., nuk m'i kishte thënë hollësitë e këtij kalvari, atë dhe përmasat e tij në një vend si ishte Shqipëria e pushtuar dyfish (nga komunizmi dhe Jugosllavia) i merrja me mend nga hakmarrja antifashiste me të cilën ishin përballë gjermanët pas humbjes së luftës, kishte qenë thuajse e pamëshirshme në rrënimin e ekonomisë së vendit si dhe infrastrukturës së gjithmbarshme, pa kursyer as rrugët, as urat, as ujësjellësit, as vijat e ujitjes e as kanalizimet madje. Siç kishte qenë rrënuese edhe fushata e denacifikimit, e cila kishte përfshirë edhe vlerat kulturore dhe shpirtërore gjermane (monumentet, muzetë, teatrot, arkivat, bibliotekat, universitetet, licetë dhe çmos tjetër).

Megjithatë, ndarja e Gjermanisë, me Murin e Berlinit në mes, që do të zgjatë për gjysmë shekulli, preku rënd qenien gjermane, ngaqë njeriu në Lindje iu nënshtrua terrorit ideologjik komunist me të cilin ai duhej të privohej nga çdo vlerë. Për ndryshim nga fushata e denacifikimit të pjesës Perëndimore, e cila pushoi pas katër vitesh kur u shpall Republika Federale e Gjermanisë shtet i pavarur, i mbikëqyrur nga aleatët perëndimorë me doktrinën se "humbja e luftës duhet kthyer në fitore të paqes", në Lindje, Republika Demokratike e Gjermanisë (Deutsche Demokratische Republik), nga Moska u kthye në një poligon të luftës së ftohtë, me "popullin socialist gjerman", si pararojë të saj. "Populli socialist gjerman", sipas Moskës, duhej të kthehej në një model të fitores së socializmit ndaj kapitalizmit, ku ideologjika duhej të mundte nacionalen dhe nacionalizmin.

Kështu, "modeli i kombit socialist", si doktrinë ideologjike, u kthye në referencë jo vetëm të bashkimit të mundshëm gjerman, por edhe të kombeve të tjera, me të cilën duhej të zgjidheshin që të gjitha vështirësitë dhe padrejtësitë historike të trashëguara nga e kaluara imperialiste. Natyrisht se "kombi socialist gjerman, jugosllav, shqiptar, rumun, hungarez" dhe të tjerët, duhej të kalonte nëpër procesin e detyrueshëm të zhveshjes nga "mbeturinat nacionaliste", meqë këtë e kërkonte "njeriu i ri socialist" dhe vetëdija ideologjike. Nuk është për t'u habitur pse nga Stalini në vitin 1952, kancelarit të parë gjerman, Adenauer, iu propozuar bashkimi gjerman, në një shtet "neutral socialist", gjë që u refuzua nga kancelari gjerman me thënien ironizuese "më mirë një gjysmë e plotë se sa dy gjysma të zbrazëta..."

Me këtë formulë, në një federatë ballkanike socialiste që do të quhej "Ballkania", u desh të bashkoheshin edhe Bullgaria, Jugosllavia, Shqipëria dhe Rumunia, e ku do të zgjidheshin njëherë e përgjithmonë problemet nacionale të Shqiptarëve (në Kosovë) të Bullgarëve (në Maqedoni), të Rumunëve (në Moldavi dhe Banat të Jugosllavisë) për të cilat u derdh aq shumë gjak nga Kriza Lindore e këndej...

Dhe kur u pa se këto modele po kundërshtoheshin nga brenda, siç ndodhi me rastin e Jugosllavisë, kur Tito u largua nga tutela e Stalinit dhe kur ndodhën lëvizjet antikomuniste në Hungari dhe në Gjermaninë Lindore (1950-55) që u shuan me gjakun e derdhur që e shkaktoi armata sovjetike në këto vende, Gjermanisë iu vu muri nga ana e regjimit të Honekerit, ndërsa nacionalistët dhe reaksionarët, siç i quante Moska intelektualët e shumtë që nuk kishin treguar ndonjë vullnet për modelin e kollhozëve sovjetikë, u burgosën dhe shumë prej tyre u dërguan në kampe të punës dhe aso të përqendrimit deri në Siberi.

*Si fëmijë, në Berlin përjetova Murin dhe ndarjen e tmerrshme gjermane. Nga dritarja në katin e katërt të banesës sonë në Aleksandërplaz, si në shuplakë të dorës, shihja pjesën lindore të Berlinit me tanket ruse dhe rojet e armatosura me tyta të drejtuara nga ana jonë, që gjuanin në gjithë ata që merrnin mundimin të kalonin murin për në pjesën perëndimore. Nga aty, deri sa im atë i ngjyrosi xhamat me një ngjyrë të bardhë të turbullt, shihja të vrarë dhe të masakruar, që silleshin nga pikat e ndryshme të mureve. Më kujtohet se si im atë, fliste me shumë pikëllim për një pjesë të kushërinjve dhe të miqve që kishin mbetur në pjesën lindore, dhe që shumë prej tyre, ngaqë nuk ishin pajtuar me Murin e as me diktaturën komuniste, ishin burgosur ose me “masën e përkohshme të edukimit”, ishin dërguar dhunshëm në pjesët e tjera të vendit prej nga nuk ishin kthyer kurrë...*

*Kur kishte rënë Muri i Berlinit, natën e 9 tetorit 1989, im atë, bashkë me ne, me lot sy, te porta e Brandenburgut, ku kremtohej rrënimi i Murit, kishte pritur më kot të takonte kushërinjtë ose miqtë...*

*Ngjashëm kishte pritur edhe dy-tri netët e tjera deri sa, më në fund, kishte humbur shpresën se do të takonte më të dashurit...*

*Nga pamja e thellë e pikëllimit të tim ati në fytyrë më ndau paralajmërimi se po i afroheshim kufirit jugosllav.*

*Ishin dy të rinj të veshur me të zeza, gjysmë të maskuar dhe të armatosur me kallashë, që pasi hynë brenda dhe një copë herë na shikuan sikur të kërkonin dike midis nesh, na uruan rrugë të mbarë me fjalët se “një ditë do t’i vijë fundi këtij mundimi...”*

*Pjesa tjetër e rrugës, nga zona neutrale deri te roja jugosllave, ndonëse ishte e shkurtër, m’u duk tepër e ankthshme. Atë e bënte edhe më të theksuar një agshol i mundimshëm i cili hapte pamjen e një ambienti të trishtë me bunkerë gjithandej dhe me tanke me tyta të drejtuara nga Shqipëria... Skaj tyre shiheshin edhe ushtarë të veshur me mushama gri që ecnin si të përgjumur...*

*Ecja e ngadalshme e furgonit nëpër atë ambient u ndal në pjesën e skajshme të daljes, pikërisht para një grumbulli policësh, që prisnin të gatshëm për nisje. Aty na u tha të zbrisnim me ato që kishim dhe të kalonim te një barakë tutje, në të cilën ende nuk kishte depërtuar drita e atij mëngjesi të mugët.*

*Përcjellësi na tha se duhej të prisnim aty deri sa të kthehej për ne. Dolëm të heshtur dhe të ndrojtur, ndërkohë që policët që pritnin hynë qetas në furgon.*

*Pritja në barakën e skajshme i ngjante një heshtje varri. Dymbëdhjetë udhëtarët që bëmë rrugën e përbashkët, të rrasur pranë njëri-tjetrit, nga frika dukeshin si të përgjysmuar. Kjo gjendje sikur mori fund pas dy ose më shumë orësh, kur erdhi një i panjohur, dhe sikur të na njihte, na tha se pas pak vinte një kamion, që do të na hidhte në pjesën tjetër të kufirit dhe prej andej, sekush ia bën sipas dëshirës.*

*Rrinte para nesh me një duhan në gojë, që e mbante si të ngjitur për buzë dhe thyente gishtat. Pas pak u dëgjua një bori aty afër, pas së cilës, ai na dha shenjë se duhej t’i shkonim pas. Ashtu të shtangur dolëm nga pjesa e mbrapme e barakës tutje një hendeku të madh, të mbushur me predha të zbrazura dhe hekurinash të shumta, nëpër të cilat ngatërroheshim. Tutje saj kaluam skaj disa ushtarëve të bezdisshëm, që nuk na vunë veshin fare, dhe pas një shkurre, dolëm në një si rrugë malore, ku gjendej një kamion i madh.*

*Ashtu të ndrojtur, hipëm një nga një në pjesën e barrës, ku ishin dy ulëse të gjata dërrase. Të heshtur dhe të frikësuar pa masë zëmë vend në to dhe me padurim pritëm lëvizjen e makinës, që pas pak, u drejtua rrugës që çonte për në pjesën e Kosovës.*

*Rruga deri te restoranti i parë skaj liqenit, ndonëse ishte e shkurtër, mbase dy-tri kilometra, në të dy anët e mbushur me armatime të ndryshme nga më të lehtat e deri te të rëndat dhe togje të shumta ushtarësh në gjendje gatishmërie, dukej sikur parakalim i të dënuarve me vdekje nëpër eshalonin deri te ekzekutimi...*

*Përshtypja e të dënuarve me vdekje në pritje të ekzekutimit nuk m'u hoq as kur zbritëm para restorantit të parë, e nuk m'u hoq as atëherë, kur gazetari i "Rilindjes", zuri një taksì, me të cilën duhej të shkonim në Prizren.*

*Gjatë gjithë kohës më bëhej se ndodhesha në kufirin tashmë të rrënuar gjermano-gjerman, atë që e mbaja mend si fëmijë nga dritarja e banesës në Aleksanderplaz, kur perdja e hekurt jo vetëm që ndan, jo vetëm që krijonte realitete të ndryshme, por poshtëronte tmerrësisht njerëzit deri në humbjen e dinjitetit të fundit...*

#### 4.

Kur më kishin mbetur edhe pak ditë para se të nisesha në Kosovë për të marrë pjesë në hetimin e "Dosjes B.", prapë më erdhi postimi i quajtur "Udhëzime për hulumtimin". Si rëndom, vinte nga adresa e tim ati, gjashtë muaj pas postimit të fundit.

"Në udhëzime..." kishte vetëm disa fjali, ku thuhej se në vitet 1997-1999, Shqipëria ishte përfshirë në trazira të përgjakshme, të shkaktuara nga pinjollët e komunistëve, të cilët rikthyen dhunën revolucionare...

"Perëndimi parandaloi vetëshkatërrimin e shtetit shqiptar, por nuk e ndaloi edhe rikthimin e mentalitetit majtist në pushtet... Kjo i solli dëme të mëdha edhe çështjes së Kosovës, siç do t'i sjellë edhe në të ardhshmen..."

Një copë herë ndoqa fjalët për rikthimin e dhunës revolucionare dhe të revolucionarëve të veshur me petkun e demokracisë...

Kujtesa ime riktheu me shpejtësi ca nga imazhet e shkëputura që kishin mbetur kryesisht nga shtypi i kohës që vinte asokohe prej andej nga mund të fitohej përshtypja se ngjarjet tragjike në Shqipërinë e atëhershme shfaqeshin si një çrregullim shoqëror me pasoja politike nga dështimi i tranzicionit në një vend të varfër, ku regjimi komunist kishte qenë ndër më të egrit në botën lindore...

Thuhej se përmbysja e sistemit komunist në Shqipëri, ishte pritur me shpresën e madhe se vendi do të ndryshojë për të mirë brenda një kohe të shkurtë, meqë këtë ia ofronin resurset e shumta natyrore (bregdeti ndër më të përshtatshmit, bjeshkët me shumë oksigjen, kushtet tepër të mira klimatike për bujqësi dhe blegtori), si dhe popullsia e re me një entuziazëm të madh, e cila kishte marrë pjesë në procesin e ndryshimeve.

Nga përcjellja e shënimeve të BND-së si dhe ato që kishte përgatitur referati për informim i Ministrisë së Jashtme (Auswertigesamt) bashkë me disa analiza të fjetura prej vitesh në dosjen "Shqipëria e viteve të nëntëdhjeta", shihej qartë se shkaktarin për ngjarjet tragjike të viteve 1997 duhej kërkuar pikërisht te fakti se përmbysja e sistemit komunist në këtë vend, nuk kishte ndryshuar mentalitetin komunist, të njeriut të mbaruar sipas urdhrave, i

gatshëm që t'u nënshtrohet rrethanave pluraliste për të mbetur në pushtet me çdo kusht me ndihmën e “juniorëve” të konvertuar në “demokratë”. Nuk kishte bërë zap as atë nga “demokratët” që në ato rrethana merrej si e drejtë e ligjshme që pushteti të kthehej në një dhunë ndaj së djeshmes ndaj së cilës mund të përdoreshin që të gjitha mjetet.

Kjo ishte parë edhe në zgjedhjet e para shumëpartiake, të cilat i kishte fituar Partia Socialiste (ish Partia e Punës e Enver Hoxhës), e cila për president kishte zgjedhur ideologun e Enver Hoxhës, Ramiz Alinë, i njohur për vazhdimin e rrugës së diktatorit Hoxha pas vdekjes së tij në vitin 1985 e këndej me metoda edhe më ekstreme (vazhdimi i mëtutjeshëm i kolektivizimit, mbajtja e kampeve të punës, racionalizimi i ushqimit, e të tjera masa shtrënguese) edhe në rrethanat kur komunizmi kishte filluar të tregonte shenjat e reformave të detyrueshme në vendet lindore.

Kështu, Shqipëria parlamentarizmin e kishte pritur në frymën e konfrontimeve të ashpra shoqërore dhe politike mbi bazat ideologjike të ngjashme me logjikën e puçeve dhe kundërpuçeve, në Shqipërinë e viteve të njëzeta. Pas fitores së komunistëve të konvertuar brenda natës në socialistë, ajo që quhej e djathtë (Partia Demokratike) nuk e kishte të vështirë që në mënyrë demagogjike ta vërë në veprim mllëfin antikomunist dhe madje të mobilizojë një pjesë të madhe të shoqërisë shqiptare (të persekutuarit gjatë kohës së komunizmit që sipas vlerësimit të përgjithshëm kapnin një të katërtën e popullatës si dhe të rinjtë, që kërkonin me çdo kusht ndryshime radikale)...

Lëvizja e përcjellë me konfrontime të ashpra midis “socialistëve” dhe “demokratëve” dhe kërcënonte me shfaqjen e anarkisë, më në fund solli zgjedhjet e parakohshme (pas një viti). Siç pritej, ato u fituan nga Partia Demokratike dhe “demokratët” e mentalitetit rural (të quajtur “malokë”), të cilët, punën e parë që bënë, ishte largimi i parakohshëm i komunistit Ramiz Alia nga posti i presidentit. Më në fund, Sali Berisha, lider i lëvizjes demokratike në Shqipëri, i njohur për rrënimin e sistemit komunist, zuri vendin e presidentit.

Nga shënimet e shumta në dosjen “*Shqipëria e viteve të nëntëdhjeta*” mund të shihej se ardhja e “demokratëve” në pushtet, ndonëse u prit me shumë shpresa, nuk solli tjetër pos ashpërsimin e brendshëm mbi bazat e qërimit të hesapeve me të kaluarën jashtë perceptimit të çfarëdo realiteti si dhe rrethanave të reja, me ç’rast, iu hap rruga një hakmarrjeje ndaj komunistëve, e cila u kthye në një fushatë rrënuese edhe ndaj atyre vlerave, të cilat duhej të shërbenin si një urë ndërlidhëse me të tashmen dhe të ardhmen. Kështu, fillim i proceseve gjyqësore ndaj kreut komunistë (të vesë së Enver Hoxhës, Nexhmije, së cilës i ngarkoheshin kuturu shumë e shumë krime të sistemit, pastaj Ramiz Alisë dhe të tjerëve nga garnitura e fundit komuniste), si dhe atmosfera e mitingjeve në to u përcoll edhe me veprime vandale të përvetësimit të dhunshëm të pronave si dhe rrënimit të pasurisë shoqërore (fabrikave, kooperativave bujqësore, fermave, plantacioneve të shumta e deri te prerja e pamëshirshme e pyjeve, diku-diku pa u kursyer edhe parqet e qyteteve).

Dhuna e shfrenuar, për të cilën në disa shënime sekrete thuhet se në shumë pjesë u ndez nga strukturat paramilitare të regjimit komunist të ushtruara enkas për diçka të tillë, nuk kurseu as spitalet, as shkollat dhe as objektet e rëndësishme të kulturës (bibliotekat, muzetë, galeritë e arteve). Shkatërrimit fizik i shumë nga këto objekte u përcoll edhe me vjedhjen e veprave të artit dhe ekspoziteve tepër të rëndësishme nga trashëgimia kombëtare, shumë prej të cilave për pak lekë ranë në duart e mafiozëve dhe u nxorën jashtë vendit. Ngjashëm u veprua edhe me arkivat e shtetit, prej nga u vodhën ose u shkatërruan shumë nga regjistrat e

pronës, tapitë dhe dokumentet zyrtare përfshirë këtu edhe procesverbalet gjyqësore, por edhe dosjet policore, të hartuara gjatë diktaturës, shumë prej të cilave, edhe ashtu ishin asgjësuar ose retushuar nga Sigurimi i Shtetit nga fillim i trazirave antikomuniste e këndej.

Sjellja vandale ndaj pronës publike si dhe ndaj institucioneve të vendit u përcoll edhe me ndryshime radikale në gjithë aparatin e administratës shtetërore pa çarë kokën për anën profesionale. Me të ardhur në pushtet, Partia Demokratike filloi fushatën e heqjes me shkarkim të të gjithë eprorëve policorë, prokurorëve, gjykatësve dhe drejtuesve të sektorëve të administratës në të gjitha nivelet me arsyetimin se i takonin nomenklaturës komuniste dhe diktaturës. Ngjashëm u veprua edhe në armatë dhe në shërbimin e sigurisë kombëtare prej nga ishte e pritshme që shumë prej tyre të angazhoheshin si mercenarë partiakë ose nga shërbime të huaja për organizimin e “njësive të revoltës” të drejtuara kundër qeverisë dhe shtetit shqiptar.

Heqjet ose shkarkimet arbitrare përcilleshin po ashtu me emërime arbitrare të aktivistëve të Partisë Demokratike, shumë prej të cilëve militantë pa ndonjë përgatitje profesionale, silleshin nga rrethet (kryesisht nga Tropoja prej nga vinte presidenti Berisha) ose nga Veriu i vendit (Shkodra me rrethinë) me arsyetimet se “duhej përmirësuar dëmet e mëdha të diktaturës komuniste ndaj veriut dhe gegëve”!

Këto dhe veprime të ngjashme sollën përkeqësimin e klimës shoqërore dhe politike veçmas në ambientet urbane deri në atë masë, sa që në disa pjesë të ndryshme të vendit (në jug), militantët e socialistëve zunë të “vetorganizoheshin” si thuhej në mbrojtje “kundër malokëve të veriut”, që për vendin do të thoshte paralajmërim i futjes në një konflikt të brendshëm me pasoja të rënda, ngaqë historikisht dihej se Shqipëria mund të ekzistonte si shtet vetëm mbi ekuilibrat e brendshëm shoqërorë dhe politike veri-jug dhe assesi ndryshe.

Në disa raporte sekrete nga Tirana, nga vitet 1995-1996, qeverisë gjermane i bëhej me dije se Shqipëria po shkonte drejt një kaosi të pashmangshëm me pasoja të rënda për vendin por edhe për rajonin, ngaqë çrregullimet e brendshme do të mund të shfrytëzohen nga jashtë që ajo të ndizej njëherësh nga të gjitha anët. Tërhiqej vërejtja për rolin e grekëve në jug, që do të mund ta instrumentalizonin pakicën e atjeshme greke për rihapjen e çështjes vorioepirote, plagë kjo e njohur nga viti 1914, siç mund ta joshte ngjashëm dhe Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë, të cilat, nuk kishin ngurrar me kërkesa për njohjen e pakicave të tyre para shtetit shqiptar qoftë edhe aty kur pjesëtarët e tyre numërohen me gishta.

Përkeqësimit të gjendjes së përgjithshme që shoqërohej me kriminalitet të llojllojshëm, nga grupe mafioze dhe banda që vepronin haptas, para të cilave shteti ligjor thuajse kishte kapitulluar, i ndihmoi shumë shqetësimi që kishte sjellë instalimi i piramidave financiare nëpër bankat e vendit, që po merrte përmasa gjithnjë e më të mëdha. Edhe pse shtetit shqiptar prej kohësh i vinin vërejtje të shumta nga të gjitha anët (Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Europiane dhe banka të shteteve të ndryshme) për rrezikun nga piramidat financiare, ato jo vetëm që nuk po ndaleshin, por edhe përkraheshin deri sa ato nuk vonoi dhe pëlçitën, duke shkaktuar rrëmujë financiare në vend deri te kolapsi bankar i shtetit...

Në ato rrethana të turbullta kur haptas po rrezikohej genia e shtetit shqiptar, për të mbetur me çdo kusht në këmbë, partia e Berishës falsifikoi edhe zgjedhjet. Kjo i dha rast të mirë opozitës socialiste për të vërë në veprim revoltën e popullit të mashtruar nga sistemi i piramidave ku shumëkush kishte humbur çfarë kishte.

Sipas burimeve të shumta, që kishin përcjellë ngjarjet e marsit-majit të vitit 1997, revolta e nisur në jug, që me të shpejtë ishte shtrirë në pjesën më të madhe të vendit, ishte kthyer në një kryengritje të armatosur kundër qeverisë së Berishës. Qendrat kryengritëse udhëhiqeshin nga ushtarakë dhe policë të larguar njëanshëm nga sistemi i Berishës, e ku nuk mungonin edhe deputetë të majtë si dhe ish zyrtarë të lartë të sistemit të përmbysur komunist.

Kur vendi po rrezikohej nga një luftë e brendshme qytetare, Berisha shpalli gjendjen e jashtëzakonshme dhe nisi ushtrinë, siç thuhej “për rrënimin e bandave kriminale të udhëhequra nga ushtarakët e Enver Hoxhës”.

Por, u pa se “bandat komuniste” jo vetëm që nuk u shkatërruan, siç pritej, por ishte ushtria dhe policia e shtetit, që u rrënuar pa u futur mirë në këtë përballje. Oficerë dhe ushtarakë nëpër zona iu bashkuan kryengritësve dhe prej andej filluan marshimin drejt Tiranës. Në Vlorë, bërthama kryengritëse e drejtuar nga Zani Çausi dhe mafiozë të ndryshëm bashkë me deputetët socialistë, kishte shpallur “Revolucioni demokratik”, të përkrahur edhe nga shumë intelektualë dhe shkrimtarë të mendësisë socrealiste, që duhej të përfshinte gjithë vendin.

“Revolucioni i vonuar demokratik” mbështetej edhe nga disa militantë nga Gjermania dhe Zvicra, pjesëtarë të grupeve marksiste-leniniste në Perëndim, të lidhur me regjimin e Enver Hoxhës.

Nuk vonoi dhe nga kërcënimi i “Revolucioni demokratik” që vinte nga Vlora dhe pjesët e jugut të vendit, shteti shqiptar thuajse kapitulloi. Në këtë kaos, shpërbërja e ushtrisë shqiptare dhe e policisë u përcoll me hapjen e depove të armëve, prej nga brenda një kohe të shkurtër prej tyre u shpërndanë, e të shumtën u vodhën qindra mijëra armë të kalibrave të lehta, por edhe të mesme...

Prania e pambikëqyrur e armëve në duart e kryengritësve dhe të turmave, që pajiseshin me të madhe, hapi kapitullin e fillimit të një lufte qytetare në vend, me mbi katër mijë viktima brenda disa ditësh, që po mos të ishte ndërhyrja e forcave italiane (me pëlqimin e NATO-s), do të kthehej në një plojë gjaku, që nuk mund të përfundonte ndryshe pos me ndërhyrjen e vendeve fqinje (gjoja me pretekstet e mbrojtjes së pakicave), që nuk do të thoshte tjetër pos copëtim të shtetit shqiptar nga brenda.

Nga shënimet e shumta që merreshin me ngjarjet e përgjakshme në Shqipëri si dhe shpëtimin e shtetit shqiptar nga vetëshkatërrimi në sajë të Perëndimit që nuk e lejoi një gjë të tillë, meqë kjo krizës ballkanike i jepte përmasa tepër të rrezikshme dhe të paparashikueshme, si “fitues” shiheshin socialistët, për të cilët thuhej se ishin pjesë e trashëgimisë së diktaturës më të egër komuniste në lindje, rikthimi i të cilëve në pushtet me anën e “Revolucionit të përgjakshëm demokratik”, kishte kënaqur Beogradin, Athinën dhe Moskën, prej nga atyre kishin filluar t’u vinë mbështetje.

Por, në dosjen që merrej me “*Shqipërinë e të nëntëdhjetave*”, në prag dhe pas ngjarjeve tragjike nëpër të cilat kaloi vendi, shihej se nuk prekej fare çështja e Kosovës, sikur të mos ekzistonte edhe pse dihej se në Tiranë prej vitesh ndodhej një pjesë e qeverisë në ekzil bashkë me infrastrukturën e të gjitha niveleve dhe sektorëve prej nga drejtohej edhe shteti paralel në Kosovë, praninë e të cilit Parlamenti shqiptar ndër të parët e kishte njohur, ndërkohë që presidenti Berisha shqiptarëve të Kosovës formalisht ua njihte edhe shtetësinë shqiptare.

Në “*Udhëzimet...*” e fundit, megjithatë, thuhej se rikthimi i mentalitetit majtist në pushtet “i solli dëme të mëdha edhe çështjes së Kosovës, siç do t’i sjellë edhe në të ardhshmen, ngaqë revolucionarët shfaqeshin me ‘oreolin e çlirimtarëve’ të gatshëm për ta marrë pushtetin politik në vend...”

Krejt në fund, ky vlerësim, përcillej me një adresë së cilës gjithsesi dhe sa më parë duhej t’i referohesha:

“*Politisches Archiv des Auswertigesamtes*”, D-Albanien, NO.143 (*Arkivi Politik i Ministrisë së Jashtme Gjermane, D-Shqipëria, NO.143*).

Po atë ditë, me nxitim kalova nga njëra pjesë e Berlinit në tjetrën, edhe pse m’u desh tri-katër ditë kohë t’ia filloja punës atje, që kushtëzohej me një lejeje të veçantë për hulumtim nga Ministria e Jashtme.

Hyrja në këtë arkiv, ku ruheshin të gjitha dokumentet e diplomacisë gjermane nga koha e themelimit të shtetit gjerman më 1871 e këndej, mund të kthehej në një shëtitje nëpër mjegull po mos të ishte udhëzimi (D-Albanien, NO.143). Kjo më solli te referati Europa Juglindore, prej nga, në pjesën e majtë, më doli përpara një raft i madh me dosje të shumta, të renditura sipas shifrave, që nga aty dukeshin fare të pakuptueshme. Pas pak, udhëzuesja më hodhi përpara dhjetë sosh me shifrën: TÛ-AL/1878-1912. Më tha se më prisnin edhe dhjetë të tjera. Përpara më la shifrat: Ö-DE-AL/1912-14; AL-DE-1914-1918 dhe AL-DE/1943-1944.

Një copë herë shikova me vëmendje dosjet e mbushura plot e përplot me dokumente. Dy prej të parave lidheshin me Kongresin e Berlinit, korrik-gusht 1878, ndërsa të tjerat, gjithnjë të ndërlidhura me Kongresin e Berlinit, përfshinin kohën nga vjeshta e vitit 1878 e deri në fund të vitit 1881.

Nuk e kisha të qartë se si duhej të kapërceja nëpër to, meqë ishte fjala për një kontekst historik dhe diplomatik tepër të gjerë, për të cilin kisha disa njohuri elementare, por jo aso të një hulumtuesi, që përqendrohet te çështjet e caktuara. Tek e fundit, unë isha një hetues që merrej me një problematikë të caktuar që lidhej me një proces gjyqësor dhe assesi me një hulumtim historik. Dosjet që kisha para lidheshin me historinë e shqiptarëve në një kohë kur në hapësirën europiane të Perandoria Osmane po shfaqeshin shtetet nacionale (të grekëve, rumunëve, serbëve, malaziasve), por jo edhe me kohën dhe rrethanat që merrja në shqyrtim.

Sidoqoftë, pa qenë në gjendje që t’u jepja përgjigje atyre që po më silleshin nëpër kokë, ishte ndërhyrja e “*Udhëzimieve...*” të fundit, që më kishte ardhur aq papritmas kur po merresha me dosjen e “*Shqipërisë së nëntëdhjetave*” si një urdhër që tashmë e kisha pranuar, që më kishte drejtuar në “*Arkivin politik të Ministrisë së Jashtme Gjermane*”. Kjo kishte ndodhur atëherë kur duhej ta rrumbullakoja atë që thuhej në “*Udhëzimet...*” për ngjarjet e vitit 1997 në Shqipëri si dhe ndikimin në Kosovë, që thuhej se e kishin ndikuar dhe mund ta ndikonin zgjidhjen përfundimtare të saj me kthesën politike shqiptare kah e majta dhe mendësia revolucionare, që ndonëse në Lindje po merrte fund, te shqiptarët sikur po ripërtërihej në saje të veprimeve perfide të Beogradit, Moskës dhe Athinës.

Përballë kësaj trysnie, nuk më mbetej tjetër, pos të kapërceja nëpër dosjet që kisha para, me shpresën se mbase mund të ishin dokumentet në to që mund të më kapnin për dore deri te ajo dera e fundit ku duhej të dilja.

Megjithatë, ballafaqimi nismëtar me protokollet e Kongresit të Berlinit si dhe vendimet që kishin dalë aty, veçmas pika IX, XIII dhe XXIV, po më fusnin në një atmosferë,

ku çështja shqiptare, kur Fuqitë e Mëdha të kohës shqyrtonin rrethanat në Perandorinë Osmane si dhe fatin e shteteve nacionale në pjesën europiane në raport me Rusinë, si një enti e cila lidhej me fatin e Perandorisë Osmane, Vilajetin e Kosovës e nxirrte në qendër të vëmendjes, madje si referencë kryesore që do të ndikojë edhe në zgjidhjen e saj pa marrë parasysh çfarë do të jetë. Në dosjen e dytë, përthekoheshin dokumentet që lidheshin me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, nga mbajtja e saj në Prizren, në 10 qershor 1878, zhvillimet në të deri në fund të atij viti, ku një pjesë e madhe e dokumenteve lidheshin me atentatin në Gjakovë ndaj Maxharr Pashës gjeneral me prejardhje gjermane i quajtur Ludwig Karl Detroit, i cili kishte qenë pjesë e delegacionit osman në Kongresin e Berlinit të drejtuar nga ministri fanariot Karatheodej Pasha.

Dosja e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, me vilajetin e Kosovës si epiqendër të lëvizjes së gjithëmbarshme shqiptare prej nga do të prononcohet politikisht për herë të parë ajo që do të quhet shqiptarizëm, krahas shumë e shumë letrave dhe peticioneve që shqiptarët i kishin dërguar Konferencës së Berlinit nga të gjitha anët (nga Prishtina, Shkodra, Dibra, Ulqini, Manastiri, Janina, Selaniku e gjetiu) si dhe diaspora shqiptare (Itali, Egjipt, Rumani e gjetiu), shoqërohej edhe me raporte të shumta të konsujve gjermanë, austriakë, rusë, italianë e francezë nga vilajetet shqiptare në Perandorinë Osmane, të cilat, ajo i kthente në qendër të vëmendjes të Fuqive të Mëdha Europiane, pa marrë parasysh tretmanin e “status quo-së”, që i ishte dhënë prej tyre për një kohë të caktuar, nga frika se ajo rrëronte marrëveshjet rreth sferave të interesit veçmas ato austro-ruse në këto pjesë.

Në të vërtetë, nga dosja e dytë e në të tretën, sado kalimthi, binte në sy se sado që Kosova dhe çështja shqiptare (me kërkesën për autonomi brenda Perandorisë Osmane) nga Konferenca anashkalohej me arsyetimin se “Kongresi nuk merrej me çështjet e brendshme të Perandorisë”, megjithatë, ngjarjet nga tetori i atij viti dhe për dy të tjera me radhë (deri në fund të vitit 1881), jo vetëm që e kishin shtyrë të merrej me të, por zhvillimet në vilajetin e Kosovës nga koha e krizës së Plavës dhe Gucisë, ajo e Hotit dhe Grudës, Ulqinit dhe Tivarit, kjo e fundit e kthyer në një demonstrim ushtarak të gjashtë fuqive europaine në ujërat e Adriatikut kundër forcave shqiptare që mbronin këto qytete nga dorëzimi Malit të Zi, e kishin detyruar tri herë t’i ndryshojë qëndrimet.

Nga dokumentet në dosjen e tretë (tetor 1880 - dhjetor 1881), shihej qartë se në këto zhvillime tepër dinamike në njërën anë midis shqiptarëve dhe Fuqive të Mëdha, Malit të Zi dhe Perandorisë Osmane në tjetrën anë, shfaqej Qeveria e Përkohshme e dalë nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit me qendër në Prizren dhe Gjakovë, forcat ushtarake të së cilës (rreth katër mijë) nga Kosova ishin dërguar në Veri për ta mbrojtur Ulqinin dhe Tivarin... Kjo luftë, e cila kishte filluar me forcat ushtarake të Malit të Zi qysh në Plavë dhe Guci, kishte vazhduar pastaj në Grudë e Hot për t’u bartur përfundimisht nga pjesët e Shkodrës në Ulqin dhe Tivar. Kështu, lufta mbrojtëse ndaj turreve herë pas here të ushtrisë malaziasë ndaj viseve shqiptare, para Ulqinit ishte kthyer në një luftë me ushtrinë perandorake, e cila, para fuqive europiane ishte zotuar se do të përdorë forcën ushtarake që t’i dorëzojë Ulqinin Malit të Zi, në përputhje me vendimet e Konferencës së Ambasadorëve të mbajtur në Stamboll, me të cilën duhej të përmbylej kapitulli i marrëveshjes kufitare midis Malit të Zi dhe Perandorisë Osmane.

Dorëzimi i Ulqinit nga forcat osmane Malit të Zi, njëherësh i kishte hapur rrugën edhe rrënimit të Qeverisë së Përkohshme të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit karshi Fuqive të Mëdha Europiane dhe Perandorisë Osmane, si dhe hakmarrjes së ashpër të Portës së Lartë kundër

vilajetit të Kosovës, ku brenda tri vitesh, shqiptarizmi jo vetëm që doli me program politik për autonominë me një vilajet të përbashkët shqiptar (nga katër sosh sa i njihte Perandoria Osmane), por në rrugë e sipër, jetësoi edhe idenë e qeverisë shqiptare brenda kësaj kornize politike, që do të kurorëzohet 31 vjet më vonë, me shpalljen e pavarësisë së shtetit shqiptar, më 28 nëntor 1912 në Vlorë, sado që Kosova, si gjeneratori kryesor i gjithë këtij zhvillimi historik, mbeti jashtë tij.

Duke shfletuar dokumentet që përthekonin zhvillimet politike nga shuarja me gjak e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe të Qeverisë së Përkohshme që doli prej saj, veçmas nga ato që nxjerrin në pah ngjarjet tepër domethënëse jo vetëm për gjenezën e shtetit shqiptar, por edhe për ecejaket që do të çojnë te fillimi i fundit të Perandorisë Osmane (Revolucioni Xhonturk i vitit 1908 dhe luftërat ballkanike të vitit 1912), siç kishte ndodhur edhe gjatë Bizantit, ndarjes së kishave në shekullin XI, luftës me ushtritë osmane në vitin 1389, luftërave austro-turke të viteve 1696-1730 dhe ngjarjeve të tjera ku vazhdonte thyerja perëndim-lindje, Kosova ose Dardania antike prapë shfaqej epiqendër e tyre, duke i ndikuar ato drejtpërdrejt, gjë që nuk ishte parë si duhet ose ishte anashkaluar qëllimisht nga historiografia më e re politike e Europës Juglindore. Në dosjen e pestë dhe të gjashtë thuajse të gjitha dokumentet e hapura diplomatike dhe ato të mbyllura flisnin për Kosovën si një e këtyre zhvillime me të cilat ndërlidhej edhe çështja shqiptare... Kështu, Revolucioni Xhonturk i verës së vitit 1908, pikën e kthesës e kishte arritur në Kuvendin e Krerëve shqiptarë në Ferizaj, prej nga ata kishin kaluar në anën e xhonturqve...Nga Ferizaj vinte edhe ultimatum i njohur që i ishte drejtuar sulltan Hamidit për rikthimin e parlamentarizmit, me çka kishte marrë fund koha e despotizmit osman...

Ngjarjet e Kosovës gjatë verës, vjeshtës dhe dimrit të vitit 1912 (kryengritja e madhe e Kosovës, Katërmëdhjetëpikshi i Shkupit, luftërat ballkanike në tetor, shpallja e pavarësisë së Shqipërisë në nëntor dhe fitorja e luftës së vende ballkanike ndaj Perandorisë Osmane), rikthyen historinë në epiqendër të saj, në pikën ku ajo ishte para pesëqind vjetësh. Ky kapërcim, nga njëra botë në tjetrën, Kosovës nuk ia hoq ployën e gjakut nëpër të cilën ajo do të kalojë përgjatë një shekulli, nga lufta në luftë, me ndryshime kufijsh, herë e shkëputur nga trangu i vet, e herë e përfshirë në të, duke u kthyer kështu në një arenë tragjike ndër më të mëdhatë e rajonit, që si e tillë do të vijë edhe deri te koha jonë, kur për t'u ndaluar kjo, u desh ndërhyrja e NATO-s ndaj Beogradit.

Duke shfletuar dokumentet e shumta të luftërave ballkanike, ato të Luftës së Parë Botërore dhe të Dytës, Kosova lëvizte tragjikisht herë kah Beogradi, herë kah Tirana, por kishte edhe kohë kur mbi trupin e saj të vogël Fuqitë e Mëdha hiqnin kufi të dhunshëm, duke e kthyer në një monedhë kusuritjeje mes veti po edhe me aleatët e tyre, siç kishte ndodhur në vitet 1916-1918 kur Fuqitë e Boshtit pasi që të kenë hequr pushtuesit serbë dhe malazias prej saj e kishin ndarë në dy zona (austriake dhe bullgare), ndërsa në vitet 1941-1944 prapë ishte ndarë në tri zona (italiane në kuadër të asaj që quhej Shqipëri e Madhe), në atë gjermane (me Mitrovicën e deri në Vuçitërnë) dhe me zonën bullgare (me Preshevën dhe Shkupin). Kjo ndarje, nëpër zona, kishte përfunduar nga nëntori i vitit 1943, pra pas kapitullimit të Italisë, kur Rajhu gjerman kishte vendosur që pasi të anulohet aneksimin italian bashkë me krijesën e saj të quajtur "Shqipëri e Madhe", të bashkojë pjesën më të madhe të trojeve etnike shqiptare në një Shtet të Pavarur Shqiptar. Formalisht kjo u mundësua me mbajtjen e Asamblesë Kushtetuese në nëntor të vitit 1943 në Tiranë, prej nga do të dalë Këshilli Nacional Shqiptar

dhe Qeveria Shqiptare me kryeministër Xh. Mitrovicën. Këtij zhvillimi historik për shqiptarët ndër më të rëndësishmit nga Lidhja e Parë Shqiptare e Prizrenit i kishte paraprirë mbajtja e Lidhjes së Dytë të Prizrenit, në Prizren. Shteti i bashkuar shqiptar ishte njohur zyrtarisht nga Berlioni me kusht që të jetë neutral dhe të lejojë stacionimin e forcave gjermane përderisa të zgjatë lufta botërore.

Ajo që binte në sy te Shqipëria e pranuar nga Berlioni ishte dominimi i qeverisë së Tiranës, por edhe i politikës së gjithëmbarshme të vendit, nga kosovarët dhe Kosova. Xhafer Deva, Xh. Mitrovica, Bedri Pejani dhe të tjerë nuk mbikëqyrnin vetëm administratën qeveritare, por edhe sistemin mbrojtës dhe të sigurisë (ushtinë dhe xhandarmerinë shqiptare), që kryesisht përbëhej nga kosovarë. Kështu, Berlioni, me bashkëngjitjen Kosovës pjesët e Sanxhakut si dhe të Maqedonisë perëndimore (Tetovës, Gostivarit, Dibrës dhe Kërçovës), nëpër viset e bashkuara shqiptare krijonte një brez sigurie tepër të rëndësishëm në pjesën më strategjike të Ballkanit Perëndimor në një gjatësi prej më shumë se njëmijë kilometrash që lidhte Bosnjën me Greqinë. Ishte paraparë se nga këto pjesë të krijohej një armatë e fuqishme me rreth 30 mijë vullnetarë, të cilët, krahas pajisjes me armatimet më të mira gjermane, do të ushtroheshin nga ushtarakët gjermanë. Parashihej që kjo forcë ushtarake shqiptare të pamundësonte fitoren e partizanëve si dhe depërtimin e fuqive aleate nga bregdeti shqiptar për në brendi të gadishullit.

Por, brezi shqiptar i sigurisë në veri dhe veri-lindje e deri në Greqi kundër depërtimeve sllavo-komuniste në trojet shqiptare pati fatin e Rajhut të Tretë. Ndonëse nga vullnetarët u mobilizuan dy divizione (“Skënderbeu” në Kosovë dhe “Hanxhar” në Sanxhak) me mbi 15 mijë ushtarë, megjithatë, me fillimin e tërheqjes së Armatës gjermane E nga Greqia dhe Shqipëria për në veri (në frontin e Sremit) në nëntor të vitit 1944, divizionet mbrojtëse të quajtura si “Forca të Lidhjes Shqiptare”, nuk qenë në gjendje që t’u bëjnë ballë njëherësh luftimeve në dy fronte: me partizanët shqiptarë dhe jugosllavë, të cilëve, në lindje, u erdhën në ndihmë partizanët sovjetikë dhe ofensivës së madhe të çetnikëve të Drazha Mihailloviqit. Forcat e shqiptare, në frontin lindor, ishin të përqendruara në vijën mbrojtëse Sanxhak-Mitrovicë-Podujevë-Preshevë dhe në atë Shkup-Tetovë-Gostivar-Dibër. Vija e parë komandohej nga kolonel Fuad Dibra, ndërsa e dyta nga Xhemë Gostivari, i cili, me vete kishte edhe një numër të madh të forcave balliste. Luftimet kundër partizanëve jugosllavë, të cilëve iu bashkuan edhe disa aradhe shqiptare si dhe çetnikëve, në vijën e veriut (nga Sanxhaku deri në Preshevë), filluan qysh në shtator dhe zgjatën deri nga fundi i nëntorit. Ndërsa ato në vijën lindore (Shkup-Tetovë-Gostivar-Dibër), filluan sapo kapitulluan bullgarët (në tetor kur edhe u mor Shkupi), ndërsa përfunduan në dhjetor.

Raportet nga këto fronte, ndonëse kryesisht të kompiluara nga burime jugosllave dhe të aleatëve, bënin të ditur se cak i të gjitha luftimeve ishte ripushtimi i Kosovës nga forcat partizane, gjë që do të ndodhë përfundimisht në nga fundi i nëntorit të vitit 1944. Nga këto raporte, megjithatë, merret vesh se në Kosovë, do të vazhdojë rezistenca kombëtare sapo aradhet partizane (shqiptare dhe jugosllave) të kenë proklamuar fitoren e tyre ndaj “forcave fashiste, atyre kuislingë dhe të reaksionit”.

Dosja NO.4 me titull pune: *“Kryengritja në Kosovë, ose kundërrevolucioni”*, e sajuar nga burime të ndryshme (jugosllave, sovjetike, por edhe britanike), për nga gjaku, terrori si dhe dhuna ishte e ngjashme me *“Gollgotën”* e Freundlihut, ose *“Ditarin ballkanik”* të Trockit nga luftërat ballkanike të vjeshtës dhe dimrit 1912, kur ushtria serbe dhe ajo malaziasë kishin

hyrë në Kosovë, duke vënë në shënjestër popullatën shqiptare, me ç'rast, sipas burimeve në dosjen e gjashtë, ishin vrarë mbi 150 mijë shqiptarë dhe po aq ishin dëbuar për në Shqipëri dhe Turqi.

Këtë herë Golgota e Kosovës gjakosej nga brenda edhe nga vetvetja, pasi që komunistët shqiptarë të ndihmuar nga ata jugosllavë, jo vetëm që kishin fituar luftën, por edhe kishin marrë pushtetin... Marrja e pushtetit përcillej me një hakmarrje ndaj gjithë atyre që nuk ishin të brumit të tyre, në radhë të parë intelektualët patriotë, e mbi të gjitha, ata që në ato rrethana kishin luftuar për bashkimin kombëtar.

Ideja e bashkimit kombëtar ishte shpallur armiqësore, reaksionare, ndërsa ata që ishin në anën e saj, ishin shpallur armiq, reaksionarë, kuislingë dhe çmos.

Me këtë anatëmë ata ishin burgosur, ishin vrarë. Dhe vrasja e paraparë vinte në mënyrë të ndryshme, herë me anën e mobilizimit të të rinjve duke i dërguar në frontet e luftës në veri (Srem), e herë duke i pushkatuar rrugës, siç kishte ngjarë në masakrën e Tivarit (mbi katër mijë viktima), por edhe pjesët të tjera të vijës së Adriatikut (Shibenik, Zarë e të tjera). Kulmi i hakmarrjes ishte Drenica dhe shuarja me gjak e kryengritjes së armatosur shqiptare kundër ripushtimit sllavo-komunist të Kosovës gjatë vjeshtës dhe dimrit 1944-45, kur partizanët jugosllavë të ndihmuar nga ata shqiptarë, shpallën gjendjen e luftës si dhe shpërthimin e “kundërrevolucionit”.

Dosja mbyllej me njoftimet për mijëra e mijëra të vrarë nga forcat partizane jugosllave në Drenicë dhe pjesët e tjera si dhe fushatën “pastruese” në gjithë vendin kundër “armiqve dhe reaksionit”, fushatë kjo që do të përfundojë me aneksimin e Kosovës nga ana e Beogradit.

Kosova prapë u shpall Serbi!

Ishte ky një ndëshkim tjetër vrastar që Shqipëria të mos jetë më kurrë Shqipëri!?

Kur u mbyll dosja dhe gjithçka imja dukej se po sharronte në pellgun e një gjaku, që mbetej i freskët, papritmas koka ime e turbullt krijoi mendimin rreth *Shqipërisë Kosovë*, një zhvendosje që mund të rikthente çrregullimin historik midis qendrës dhe periferisë shqiptare?...

Ky përvijim, që më erdhi aq befasisht ndoshta si diçka me të cilin duhej të zhdëmtoheshin përjetimet e tmerrit që vinin nga dokumentet që kisha para, megjithatë, sikur nxitë në mua ndeshjen e ashpër midis *viktimës* dhe *vrasësit*, të atij që ishte i gjykuar për asgjësim dhe të tjetrit që këtë e bënte me përkushtim dhe bindje të plotë!

Përplasja në mua e ndijimit të *viktimës* dhe të *vrasësit*, ma ringjallën përfytyrimin, në njërën anë të gjyshes nga baba, shkodranes Mari Sh. dhe në tjetrën anë, të gjyshes nga nëna, beogradases Vera L.

Kjo më futi të dridhura të jashtëzakonshme, meqë ashtu dhe në atë mënyrë, po hetoja prishjen e një qetësie të brendshme nga ato që deri më dje i kisha parë të paluara si pjesë e kujtesës familjare në kalim e sipër dhe hiç më shumë...

### ***“Koha e vdekjes”***

*(Pjesa e tretë: në Prizren, verë e vitit 1998)*

*Dita ishte në të sosur kur qetësia shurdhe u trazua nga një ndërhyrje e papritur e forcave policore serbe në qendrën e qytetit, në sheshin e shatërvanit, aty ku gjendeshin pak qytetarë.*

*Siç ndodh rëndom në ato rrethana, kur shfaqet paniku, ikja ku këmbët koka mbetet e vetmja mundësi, prandaj edhe unë u përfshiva në të. Fillimisht iu vura pas tre-katër vetave që u drejtuan rrugicës, e cila nga pjesa e pasme e kishës ortodokse çonte përpjetë, andej nga shtëpitë vinin e rralloheshin dhe sosnin në kodrinën që lidhej me kalanë e qytetit. Pas pak, pa ditur as vetë pse, lakova një rrugice të mbushur me drunj dhe gurë të shpërndarë në të dy anët, saqë vështirë kalohej. Shihej se aty po punohej dhe se nuk kishte kalim tutje. I vetëm dhe i frikësuar nga heshtja dhe vetmia e frikshme, ndalova skaj turrës së drurëve. I mbështetur për të, me shikim nga qyteti, po përpiqesha të kapja pamjet që kisha lënë pas. Por, nga ajo pikë, nuk vinte tjetër pos çative të përthyera dhe pemëve që mbulonin shumëçka... Me përshtypjen e njeriut të humbur diku ose të atij që nuk kishte ndonjë vlerë, si shumica aty, vendosa të kthehesha në hotel.*

*Por, në të dalë nga rrugica, ishte njëri që më doli përpara dhe më përshëndeti me mirësjellje, që pasi ia ktheva në anglisht dhe i thashë se jam gjerman, u hap sikur të kishte takuar dikë të njohur.*

*Në një gjermanishte të rrjedhshme zuri të tregonte për atë që kishte ndodhur para pak çastesh në qendër të qytetit.*

*“Kanë pasur kohën e plaçkitjes... Këtë e kanë për detyrë...”*

*Kur e pa se nuk po e kuptoja sa duhet, nisi të shpjegojë se në pjesët e ndryshme të qytetit ku është e përqendruar tregtia (pazaret me mallra ose shitoret me qarkullime), pasi që, me anën e agjentëve që sillen andej, heton derdhjen e parave, të cilat rëndom vijnë nga jashtë, policët ndërhyjnë gjoja për të kapur ndonjë vjedhës, stërshitës duhani apo ndonjë trafikant të devizave... Agjentët civilë, shoqërohen nga njësi speciale, të cilat rrethojnë pjesë të caktuara, duke qëlluar brutalisht blerësit ose edhe ndonjë kalimtar. Kjo hallakamë zgjat përderisa agjentët e policisë të gjejnë paratë e hetuara... Për t’u dukur si ndërhyrje me të cilën vihet rregull, lidhet ndonjë nga agjentët e maskuar, ose ndonjë kalimtar i rastit, që pasi të legjitimohet në polici, lirohet... Krahas devizave, plaçkiten edhe mallra të caktuara me vlerë (duhan, pije alkoolike dhe pajisje të lehta elektronike: telefona, radio, fotoaparate dhe kamera).*

*Mbasi më tha se ishin mësuar me atë sjellje, sikur të dëshironte të më lironte nga frika që më hetohej lehtë, nisi të fliste për Gjermaninë, në të cilën, si gastarbajter, nga mesi i viteve të shtatëdhjeta deri para pak kohe, kishte kaluar mbi njëzet vite të jetës (në Sigburg, në afërsi të Bonit).*

*Pa më lejuar që ta pyesja për kthimin nga Gjermania kur nga këtu njerëzit bëjnë çmos për të ikur dika, shtoi se ishin rrethanat, që e kishin detyruar të gjendej pranë familjes, por edhe aty ku e lypte puna...*

*Fjalët e fundit i theksoi veçmas, sikur të dëshironte të ma bënte me dije se tashmë po i afroheshim luftës, nga e cila nuk kishte shpëtim...*

*Nuk dija se çfarë t’i thosha, pos që lëviza kokën në shenjë pohimi... Me siguri se në ato rrethana, një takim i tillë i papritur, do të mund të shërbente si shkas për ndonjë njohje, veçmas kur ai njihte Gjermaninë dhe pranonte se puna dhe qëndrimi atje i kishte dhënë kuptim jetës së tij.*

*Mbase edhe do të largohesha, ashtu i heshtur, po mos të ishte ai që më tha se i thoshin Liman G. dhe mund t'i drejtohesha në çdo kohë...*

*"Gjermanisë ia kam borxh jetën..."*

*Kur m'i tha këto, se si më shkrepì ta pyesja për Lekë SH. Një copë herë u mata dhe më në fund nxora fjalët që më silleshin si nyje.*

*Më tha se ishin miq.*

*Dhe për ta dalluar fjalën "miq" nga kuptimi i përgjithshëm, veçmas nga ai që ka te gjermanët, më tha se vajza e kushëririt të afërm, (Lezja), ishte e martuar për djalin e tij të vetëm, Prizrenin...*

*"Ka kohë që gjenden në Angli dhe kanë një vajzë..."*

*I bindur se nuk e kisha pyetur kot, shtoi se Lekë SH. mund ta takoja në argjendarinë e tij, në pjesën e shatërvanit, ballaballë kishës.*

*U ndamë mbasi e falënderova. Fjalët e tij se e dinte ku mund të më gjente, që po më ndiqnin si copëza të shkëputura, po ma lehtësonin kapërcimin nga njëra rrugicë në tjetrën drejt hotelit "Theranda".*

*Të nesërmen, gjithnjë me mendjen te argjendaria e Lekë SH., pasi u paraqita në zyrën e shoqatës humanitare vendore "Nëna Terezë", për ç'gjë kisha kërkuar edhe autorizimin nga Zyra në Prishtinë me arsyetimin e "shqyrtimit të gjendjes humanitare", iu drejtova qendrës së qytetit. Rrugën për atje e bëra skaj lumit. Ishte i mbushur me ujë të rrëmbyeshëm nga shirat pranverore, që ato ditë nuk kishin pasur të ndalur. Në rrethanat e rëndomta, shushurima e ujit, ajri me lagështi që vinte nga ana e bjeshkës si dhe rrezet e buta të një dielli që herë pas here dilte nga retë dhe natyrës i jepte shkëlqim, do t'i ndihmonin një përjetimi të veçantë, po të mos ishte ndjenja e një frike, që po më kapërthente nga brenda, e cila thuajse më pushtoi fund e krye sapo iu afrova urës së gurtë dhe pashë policët, që legjitimonin secilin që kalonte nëpër të.*

*Nuk e dija si duhej vepruar. Të vazhdoja për ku isha nisur, ose të kthehesha? Kjo e fundit do të më mbronte paksa nga ndonjë telash me policinë serbe, që ndonëse e kisha lejen për qëndrim treditësh në Prizren, megjithatë, do të mund të kthehej në një shkas që leja të më hiqej, shkurtrohej ose të zhvlerësohej fare nëse policia do të më vihej prapa.*

*Me këto hamendje hetova se kisha bërë disa hapa në drejtim të urës prej nga nuk kishte më kthim prapa. Kështu, me lejen e qëndrimit në dorë, iu afrova patrullës së policisë çastin që ata me mjaft brutalitet e shkëputën një të ri nga të tjerët, që e lidhën dhe e futën në autobлиндën e cila priste në anën tjetër të urës, prej nga ajo, pas pak u largua me alarm.*

*Kjo mjaftoi që sakaq të boshatisej gjithë rruga që shpinte te ura e lumit në qendër. Hetova se isha vetëm përballë policëve serbë. Ata po ma bënë me shenjë t'u afrohesha. Ruajta qetësinë dhe gjithnjë me lejen në dorë u afrova te ai që rrinte para të tjerëve. E përshëndeta në anglisht dhe ia ofrova lejen. Për habi ma ktheu në anglisht dhe pasi ia lëshoi një sy m'u drejtua me urimin që të kaloja sa më mirë këtu...*

*Të tjerët ma hapën rrugën dhe po ashtu më përshëndetën sikur të më njihnin. Madje, në të dalë të urës, njëri më tha se këtu njerëzit e vullnetit të mirë gjithnjë janë të mirëseardhur dhe mund të kërkoja çfarëdo ndihme prej tyre.*

*Ia ktheva se këtë do ta bëj me kënaqësi po qe se do të kem nevojë dhe thuajse i mpirë vazhdova në drejtim të shatërvanit, i cili ishte thuajse i thatë. Aty, heshtja shurdhe po më*

trazohej nga mbetjet e pamjes së pakmëparshme të brutalitetit policor ndaj një të riu, që i lidhur ishte futur në autobлиндë ndërkohë që ndaj meje aktrohej sjellja “miqësore”.

Se do të ballafaqohesha me situata të tilla tepër provokuese kjo m'u kishte bërë me dije edhe në Vjenë, por edhe në drejtorinë e misionit në Prishtinë sapo ishim mbledhur, me ç'rast na ishte thënë se misioni ynë humanitar,ndonëse nuk shikohej me sy të mirë nga regjimi i Beogradit, nuk do të pengohej haptas. Përkundrazi, ne edhe mund të ndihmoheshim sa për sy e faqe, ndërsa mund ta pësonin jo vetëm vullnetarët dhe të tjerët të përfshirë në misionin tonë, por edhe shfrytëzuesit e këtyre ndihmave dhe shërbimeve...

Sidoqoftë,ne duhej t'u përshatashim rrethanave dhe t'i shfrytëzonim ato në shërbim të misionit tonë humanitar.

Me ato mendime në kokë, mora rrugën kah kisha ta kërkoj argjendarinë e Lekë SH., me shpresën ta takoja sa më parë në mënyrë që të ndërlidhesha me ato që i kisha mësuar nga takimi në Shkodër me Martin SH., të mbijetuarin e vetëm të terrorit komunist nga familja e ngushtë e sime amë (xhaxhait),i cili, i shkallmuar shpirtërisht dhe fizikisht, po përjetonte dhunën e mafisë shqiptare, që kishte kapur shtetin nga të gjitha anët, duke e kthyer në një plaçkë të veten...

Edhe pse Martin SH., mezi kishte nxjerrë nga kujtesa emrin e tij nga dyshimi, siç thoshte, se edhe ai dhe familja e tij në Kosovë nuk mund të kishte fat më të mirë nga ç'e kishin të tjerët aty ku kishte shkelur thembra e sllavo-komunistëve, megjithatë, nga takimi i rastit që kisha me Liman G., në pjesën e epërme të qytetit ngjitur me kalanë,mora vesh se Lekë SH., jo vetëm që kishte mbijetuar, por ai kishte edhe familje dhe farefis me të cilin ata ishin miqësuar. Kjo sikur po m'i largonte paksa pamjet e pakmëparshme trishtuese te ura bashkë me zyminë që kishte mbërthyer atë pjesë...

Por, ishte ballafaqimi i papritur me argjendarinë “Prizreni” në vendin siç ma kishte përshkruar Liman G., që ma ktheu përjetimin e keq. Përpara kisha një lokal të demoluar dhunshëm nga jashtë dhe nga brenda, prej nga shihej se ishin plaçkitur gjithë ato që kishin qenë në vitrina (stoli ari dhe argjendi, suvenire qelqi si dhe bizhuteri të ndryshme), ndërsa të thyera kishin mbetur disa punime artizanati nga druri dhe dy-tri miniatura të varura në murin ballor.

Nga gjurmët e paprekura jashtë (copat e xhamave të thyer në trotuare, pjesët e thyera të dyerve si dhe perdet e hequra deri poshtë), fitohej përshtypja se thyerja dhe plaçkitja e lokalit sapo kishte ndodhur...

Por, nga ato që mora vesh nga shitësi i farave dhe kikirikëve përballë, kishte katër ditë që ajo pamje rrinte e tillë.

“Isha ndër të parët që e pashë dhe mbase do të largohesha, po mos të ishin dy policë, që u shfaqën aty dhe pasi shënuan diçka dhe vunë shiritat me të cilët ndalohej qarkullimi andejpari, u larguan...Të nesërmen erdhën edhe disa policë të tjerë, të shoqëruar me nëpunës civilë, që po ashtu shënuan diçka dhe u larguan... Dje, nuk i pashë më shiritat ndalues...”

Meqë nuk dëshiroja të hapja ndonjë dyshim te shitësi i farave dhe kikirikëve, pa i bërë ndonjë pyetje së paku rreth pronarit Lekë SH.,u largova. Nuk e di as vetë, se si këmbët më çuan andej nga një ditë më parë kisha ikur bashkë me të tjerët pas bastisjes policore në qendrën tregtare.

*Ndoshta ashtu i hallakatur do të ecja edhe më tutje po mos të ishte dikush që më doli para. Ishte Liman G., që pasi e mora veten nga habia, më tha se më kishte pritur mbas atyre që kishte marrë vesh se ç'kishte ndodhur me argjendarinë e Lekë SH.*

*“Ishte një plaçkitje e paralajmëruar, si shumë e shumë të ngjashme në këto kohë, që ishte pritur se do të ndodhte...”*

*Liman G., pastaj tregoi se pronari Lekë SH., për të cilin e kishte pyetur dhe ia merrte mendja se kjo nuk ishte rastisje, ishte mirë, i strehuar në një vend të sigurt, duke pritur zhvillime të reja.*

*Fjalët “i strehuar” dhe “duke pritur zhvillime të reja”, me të cilat sikur më bëhej me dije për rëndësinë e tij, sa nuk më shtynë që të anashkaloja ose ta tërhiqja fare kureshtjen e shfaqur gjatë takimit tonë të parë, ngase nga Drejtoria ishim të paralajmëruar që të shmangnim çfarëdo bisede ose lidhjeje me persona që sipas zyrtarëve të Beogradit, ishin të përfshirë në “veprimtari terroriste”...*

*Sikur t'i kishte hetuar hamendjet e mia, Liman G., më zuri për krahu dhe më tha se, pasi që kisha pyetur për të dhe këtë ia kishte treguar, Lekë SH., dëshironte të më takonte. Ndoshta edhe do të kërkoja ndonjë shkas t'i ikja takimit, por ishte pikërisht ai pikëllimi i thellë i sime amë rreth humbjes së familjes që ia kishte marrë edhe dashurinë e natyrshme për tim atë, mua dhe jetën në përgjithësi kur për të kishte nevojë më së shumti siç kishim nevojë edhe ne për të, që më shtyri të ecja andej nga më çonte ai...*

*Me atë shqetësim thuajse nuk kisha vërejtur fare rrugicat nëpër të cilat po kalonim dhe që kishin sosur në pjesën e jashtme të qytetit, ku fillonin vreshtat e shumta, që derdheshin nëpër kodrinat që zbritnin në Drin.*

*U ndalëm para një shtëpie të strukur nën kurorat e disa lisave dhe pemëve të shumta që i rrinin sipër nga të gjitha anët. Lehja e qenve dhe hapja e një dore të drunjtë nga brenda, na përballën me një ambient fare të qetë thuajse të fshehur në natyrë. Një copë herë mbetëm ashtu të rrethuat me freskinë dhe qetësinë e ambientit i cili dukej se i mungonte fryma e njeriut.*

*Nuk vonoi dhe nga pjesa e skajshme u shfaq një mesoburrë, që na urdhëroi mirëseardhje dhe na priu në drejtim të derës së brendshme, prej nga, nëpërmes një korridori të zbrazët, kaluam në një hapësirë, e cila dukej se i takonte një shtëpie tjetër, që kishte hyrjen nga ana e kundërt. Sidoqoftë, mesoburri që na priu, kërkoi të uleshim në pjesën ballore, në një kanape të ngjitur për murin e veshur me dërrasa.*

*Tha se quhej Lekë SH., dhe se aty ndodhej përkohësisht, ngaqë në Prizren, nuk ndjehej më i sigurt. Tregoi se pjesa tjetër e familjes (bashkëshortja me tre fëmijët: dy djem dhe një vajzë) ka ditë që gjendeshin në pjesën e Hasit, te kushërinjtë.*

*“Kështu e ka lufta...Ishte e pashmangshme, por e domosdoshme...”*

*Fjalët për luftën i tha prajshëm, sikur të fliste për diçka pa të cilën nuk bënte. Pastaj heshti dhe po më shikonte sikur të kërkonte t'i tregoja pse kisha pyetur për të.*

*Heshtja dhe shikimi pyetës më mbushën me siklet, të cilin nuk mund ta hiqte as shpalimi i së vërtetës se isha aty për të folur për diçka të përbashkët që na lidhte, që edhe po t'ia tregoja fije e për pe të gjitha, vështirë që do t'ia hante mendja, e nuk do të ma hiqte edhe ndonjë rrëfim tjetër, që do të mund të lidhej me atë që ai e quante gjendje lufte (sado që kësaj ai mund t'i besonte kur dihej se shumë nga misionarët humanitarë, në të vërtetë, ishin edhe pjesë e shërbimeve të ndryshme informative).*

*Dhe, kur ndodhesha përballë asaj që mbase të trilloja diçka, në mënyrë që të tërhiqesha disi nga gjithë ai lëmsh që nuk po më lëshonte, goja ime mezi nxori emrin e Martin SH., dhe të falat që ia çonte nga Shkodra.*

*Përmendja e Martin SH., sikur ia ndryshoi gjendjen fund e krye mesoburrit që e kisha përpara nga një kureshtar i matur në një tjetër gjithë shqetësim. Ndryshimin po ia shfaqte fytyra e skuqur all, sytë që i fërkonte si dhe këmbët që po i dridheshin papërmbajtshëm. Paksa i liruar nga trysnia e sikletit të pakmëparshëm, thashë se, krahas punës humanitare që bëja, prej kohësh po merresha edhe me një hulumtim, që lidhej me viktimat e komunizmit në Shqipëri nga lufta e deri te koha e përmbysjes së komunizmit, dhe se kjo më kishte çuar edhe te familja e Martin SH., i cili kishte zënë nëgojë edhe emrin tuaj si pjesë e saj...*

*“Ai kishte dyshime se mund t’i kishit shpëtuar dhunës së pasluftës...”*

*Pasi mori veten paksa tha se Lekë SH., që kishte zënë në gojë Martin SH., nuk i kishte bërë ballë terrorit sllavo-komunist.*

*“Unë jam i biri dhe kam lindur në një qytezë (Brezinci) të Kroacisë, gjashtë muaj pas pushkatimit të tij nga komunistët...Im atë, Leka, bashkë me gjashtë të tjerë nga Prizreni, u burgos nën akuzën, si thuhej, për pjesëmarrje në “veprimtarinë kundërrevolucionare”, që kishte organizuar Nacionaldemokratja shqiptare (NDSH) nga fillimet e saj... Aktakuza e ngarkonte edhe me veprimtari spiunazhi, që gjoja e kishte zhvilluar nëpërmes një kushëriri nga Shkodra e martuar me një oficer të Vermahtit gjermane, sado që Nacionaldemokratja dhe Vermahti nuk shkonin së bashku... Sidoqoftë, martesë e kushërirës sonë nga Shkodra, që nuk e njihnim fare, me oficerin gjerman, tragjedisë sonë ia dha edhe një shkas më tepër...”*

*Përmendja e kushërirës së martuar me oficerin gjerman seç ma rrotulluan gjendjen, saqë atë e vërejti edhe Leka, i cili u ndal për pak dhe ndoshta do ta ndryshonte rrjedhën e rrëfimit, po mos të ishte ndërhyrja ime rreth asaj pse teajo martesë shihte shkakun e tragjedisë?*

*“Fare thjeshtë. Sepse, në njërën anë u shpallëm kuislingë dhe në tjetrën shqiptaromëdhenj. Kuisling na shpallën komunistët shqiptarë dhe jugosllavë, që ishin bashkuar gjatë luftës, ndërsa shqiptaromëdhenj na shpallën komunistët e bashkuar, por edhe nacional-shovinistët serbë ngaqë kështu do të mund të vazhdonin programet e tyre për zhdukjen e popullatës së mbetur në viset brenda kufijve të Serbisë e më vonë edhe të Jugosllavisë, të pushtuara nga viti 1877-1912, që i kishte përligjur fillimisht Konferenca e Ambasadorëve e Londrës, ajo e Paqes në Paris si dhe Marrëveshja e Jaltës. Kishte, megjithatë, periudha të shkurta kohore kur këto traktate famëkeqe u zhvlerësuan. Kështu ndodhi gjatë Luftës së Parë Botërore, në vitet 1916-1918. Pas kapitullimit të Serbisë nga ushtritë e Boshtit, shumë nga viset shqiptare përjetuan një bashkim të përkohshëm. Kështu ndodhi edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur në vitin 1941, pas shpërbërjes së Jugosllavisë së Versajës, një pjesë e Kosovës dhe e Maqedonisë Perëndimore, iu bashkuan të ashtuquajturës “Shqipëri e Madhe” nën kurorën e Italisë. Por, mbas kapitullimit të Italisë, në vjeshtën e vitit 1943 dhe hyrjes së ushtrisë gjermane në këto pjesë, me çka edhe u anulua pushtimi italian, ishte e natyrshme që patriotët shqiptarë, në përputhje me rrethanat, ku për herë të parë mund të thuhet se pajtoheshin e drejta etnike me atë historike, ta thoshin fjalën e tyre. Kështu, në Prizren, u mbajt Kuvendi i Dytë i Lidhjes Shqiptare, i cili doli me platformën për themelimin e shtetit të pavarur shqiptar. Mbi platformën e Kuvendit të Dytë të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, në tetor të atij viti, në Tiranë u mbledh Kuvendi i Asamblesë*

*Kushtetuese, prej nga doli edhe qeveria e parë shqiptare, ku shumicën e përbënin patriotët kosovarë, gjë që paraqiste një zhdëmtim të vonuar historik për rolin dhe kontributin e madh që dha Kosova dhe kosovarët për Shqipërinë nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e deri te shpallja e pavarësisë, në vitin 1912. Kjo qeveri u njoh edhe nga Rajhu gjerman, me të cilin u lidh një marrëveshje për praninë e përkohshme të ushtrisë gjermane në Shqipëri e cila luftonte komunizmin...*

*Si e tillë, Qeveria Shqiptare, u vu në shënjestër të frontit antifashist shqiptar, që drejtohej nga komunistët jugosllavë si dhe aleatët perëndimorë. Mosbesues ndaj saj ishin edhe disa forca nacionaliste shqiptare (nga radhët e Legalitetit – partisë së mbretit Zog dhe të tjerë), të cilët, të pakënaqur që ajo drejtohej nga rryma e njëmendtë nacionaliste, e cila ia kishte dalë më së shumti t’u ofrohej parametrave të programit të Rilindjes Kombëtare për jetësimin e një Shqipërie etnike në përputhje me shtrirjen që kishte dhe të lidhur me përkatësinë qytetërimin perëndimor, e shihnin si qeveri kuislinge, që do të marrë fund me fundin e Hitlerit.*

*Pra, në vend se të përkrahej, shteti i parë i pavarur shqiptar i vitit 1943, zuri të sulmohej nga brenda, nga vetë shqiptarët, të shpërndarë në tabore të huaja. Ishte ky paralajmërimi i një kobi tjetër, me të cilin bota shqiptare do të përballet pas pak, që për çmim kishte sakrifikimin e Kosovës dhe të viseve të tjera që trungut shqiptar iu shkëputën dhunshëm në vitin 1912 nga pushtuesit fqinjë. Këtë herë, pushtuesit “e vjetër”, nuk kishin nevojë të mundoheshin gjithaq, ngaqë u ftuan nga vetë shqiptarët.*

*Kështu, pas largimit të gjermanëve dhe hyrjes së partizanëve shqiptarë dhe atyre jugosllavë dhe marrjes së pushtetit me dhunë prej tyre, pasi që Kosova iu dha shpërblim jugosllavëve për “ndihmën vëllazërore” gjatë luftës, filloi hakmarrja ndaj nesh.*

*Familja jonë ishte ndër të parat që u vu në shënjestër. Natyrisht se shkasi për këtë tashmë ishte i gatshëm (martesa e një kushërirë nga Shkodra me një oficer gjerman).*

*Por, edhe pa atë shkas do të ndodhte e njëjta, sepse familja jonë gjatë gjithë kohës kishte qëndrim patriotik. Këtë e kishte manifestuar gjatë luftës së parë kundër pushtimit serb të Kosovës, duke u vënë në shërbim të frontit kombëtar në të gjitha rrethanat (ngapjesëmarrja në radhët e Komitetit të Kosovës, në Lëvizjen Kaçake dhe në radhët e Forcave të Lidhjes së Dytë të Prizrenit).”*

*Rrëfimi i mëtutjeshëm i Lekës rreth hakmarrjes partizane ndaj familjes së tij dhe të tjerëve në Kosovë pas hyrjes së partizanëve shqiptarë dhe atyre jugosllavë ishte thuajse i njëjtë me atë që kisha dëgjuar në Shkodër nga Martin SH.,(vrasje pa gjyq, bastisje, deportime, mobilizime të dhunshme të të rinjve si dhe dërgimi i tyre për në frontet e tjera në Jugosllavi ku shumë prej tyre nuk ishin kthyer kurrë, e mbi të gjitha, hapja e frontit të Drenicës kundër forcave patriotike që kishin rezistuar kundër ripushtimit sllavo-komunist të Kosovës, me ç’rast në forma të ndryshme ishin vrarë mbi pesëdhjetë mijë shqiptarë).*

*Kjo gjendje kishte vazhduar edhe pas “fitores ndaj kundërrevolucionit”, ngaqë nuk reshtnin përpjekjet e nacionalistëve shqiptarë kundër vendosjes së regjimit komunist. Patriotët e shkapërderdhur në grupe të vogla të rreshtuar në Organizatën Nacionaldemokratike Shqiptare NDSH, përpiqeshin që ta mbanin të gjallë frymën e rezistencës duke shpresuar se do të kenë ndihmën e fuqive perëndimore, veçmas britanikëve, me misionarët e të cilëve kishin pasur lidhje të mira edhe gjatë luftës. Kjo shpresë ata i kishte mbajtur për dy vjet me radhë, me ç’rast grupet e vogla të “kaçakëve” kishin vepruar në pjesë*

të ndryshme të vendit, edhe pse ushtria dhe policia jugosllave, e cila i ndiqte hap pas hapi, rezistencën e tyre e shfrytëzonte për të ushtruar terror ndaj popullatës së pambrojtur, shumë prej të cilëve pastaj, detyroheshin të braktisnin vendin në drejtim të Turqisë, ose në Shqipëri, ku e pësonin edhe më keq, ngaqë atje antikomunistët ndëshkoheshin edhe më rënd. Në këto rrethana, pas kalimit të krahut ushtarak për në Greqi, ishin tërhequr përfundimisht nga kjo strategji.

*“Ngjashëm u veprua edhe me familjen tonë, që thuajse u shua e tëra... Ime amë shpëtoi në sajë të asaj se im atë, që e dinte se si do të shkonin punët pas fitores së partizanëve, e kishte dërguar te familja e saj në Has me kërkesën që prej andej sa më shpejt të dërgohej në Kroaci, ku një pjesë e madhe e tyre, para luftës, por edhe gjatë saj, punonin si furrtarë të njohur, punë këtë që më vonë e kishin zgjeruar edhe me ëmbëltore dhe me një rrjet argjendarie në disa qendra bregdetare.*

*Në kujtim të tim at më pagëzuan Lekë... Në Kroaci, ime amë, nuk u shërua dot nga dhimbja për humbjen e babës... U mund nga një sëmundje e rëndë shpirti nga e cila edhe vdiq... Mbaj mend (isha pesë vjeç) kur për herë të fundit më mori në prehër dhe me një zë gjysmë vaj e gjysmë këndim e me lot në sy fliste diçka për takimin me tim atë, për një dasmë që i gëzohej... Po atë mbrëmje vdiq... E varrosën në pjesën e zabeli ngjitur me shtëpinë tonë, që më vonë u kthye në varrezë familjare...”*

*Rrëfimin e ndali për pak, që të freskohej me një gotë ujë, që tha se i duhej për ta lagur fytin e tharë. Pastaj vazhdoi të tregonte për jetën në Kroaci, tek dajallarët, ku kishte kryer shkollën fillore dhe atë të mesme në gjuhën kroate. Në Kosovë kishte ardhur për herë të parë vetëm nga mesi i viteve të gjashtëdhjeta, kur pas ndryshimeve politike, (përmendi rënien e Rankoviqit), i liruar dukshëm nga mbërthimi i dhunës shtetërore që deri më atëherë i kishte ardhur nga Beogradi dhe në sajë të asaj se me ndryshimet e reja kushtetuese ishte barazuar me njësitë tjera federative, vendi kishte filluar të zhvillohej ekonomikisht, ndërkohë që me themelimin e institucioneve arsimore dhe kulturore të të gjitha niveleve (akademisë së shkencave dhe të arteve, universitetit në gjuhën shqipe, radiotelevizionit, teatrove, bibliotekës kombëtare dhe të tjerave), edhe në planin arsimor dhe kulturor po shpaloste identitetin kombëtar.*

*“I trimëruar nga këto zhvillime, vendosa të kthehem në Kosovë. Dajallarët më ndihmuan të hap një argjendari në Prizren pikërisht aty ku familja ime atë zeje e kishte ushtruar me gjenerata të tëra dhe ishte ndër më të njohurat në atë pjesë të vendit. Me ndihmën e disa ustallarëve të vjetër, ia dola që punishten ta kthej në një qendër të filigranit tradicional, i njohur ngaherë për stolitë e rralla me serm (ramët, thikat, pjatat, ikonat, kutitë e duhanit, lulet e ndryshme dhe veças zambakët), me të cilat pasqyrohej një pjesë e identitetit tonë nga lashtësia.*

*Asokohe u martova. Me Norën u njohëm gjatë manifestimeve muzikore “Muzgjet e Prizrenit”. Ajo ishte violinistja e parë e shoqërisë “Agimi”, që u nderua me shpërblimet e manifestimit “Zambaku i Prizrenit”, të cilin e dhuronte punëtoria ime. Dorëzimi i shpërblimit nga ana ime u kthye në një shkas për takimet tona të ardhshme, që pas një viti, përfunduan me martesë.*

*Ishte një martesë e lumtur (me dy fëmijë: djalin Prizrenin dhe vajzën Therandën). Por, asaj martese të lumtur i erdh fundi nga një aksident tragjik komunikacioni. Në udhëkryqin midis Prishtinës dhe Lipjanit, vetura në të cilën gjendej ajo me dy shoqe, u ndesh me një*

kamion prej nga të tria humbën jetën në vend. Dhe kështu, dita që duhej ta kremtonim njëzetvjetorin e martesës, u kthye në një ditë të përhershme zie për mua dhe fëmijët tanë, meqë asokohe filloi edhe shkapërderdhja e pashmangshme e familjes sonë, e kushtëzuar nga gjendja e përgjithshme në vend nga mesi i viteve të tetëdhjeta e tutje, kur në skenën politike doli hegjemonizmi i Beogradit me kërkesën për rrënimin e autonomisë së Kosovës, të cilën e sendërttoi në mars të vitit 1989 me anën e tankeve, që si kundërpërgjigje nga ana jonë pati, fillimisht shpëputjen nga Serbia e më pas edhe shpalljen e pavarësisë...

Në ato rrethana, kur ndër të parët iu bashkova lëvizjes kombëtare që drejtohej nga "Lidhja Demokratike e Kosovës" me betimin se do t'i mbetem besnik përkushtimit për shtetin e Kosovës, që ishte shpallur dhe duhej të jetësohej pa marrë parasysh sakrificat dhe çmimin që kërkonte, fëmijët (Prizrenin - tetëmbëdhjetë vjeç dhe Therandën - gjashtëmbëdhjetë vjeçe) i dërgova përkohësisht në Kroaci...

Por, siç u pa, "përkohësia" u kthye në një gjendje ndarjeje, që mund të jetë edhe e përhershme, ngaqë zhvillimet me kthesa të ashpra (lufta në Slloveni e në Kroaci edhe në Bosnje dhe Hercegovinë dhe pushtimi ushtarak i Kosovës), hapën kapitullin e përgjakshëm të shpërbërjes së ish Jugosllavisë me pasoja të paparashikuara dhe kushtëzuan një sjellje tjetër në përputhje me rrethanat... Kështu, në pamundësi që të ktheheshin në Kosovë, por edhe të jetonin të qetë në Kroacinë e përfshirë nga lufta, (gjysma e së cilës ndodhej nën mbikëqyrjen e serbëve vendorë), u pajtova që Prizreni dhe Theranda, bashkë me një pjesë të familjes së dajallarëve, të kalonin në Londër, te njëri prej kushërinjve të tyre i cili prej vitesh atje punonte si argjendar.

Pas një kohe, mora vesh se im bir, Prizreni ishte martuar me një prizrenase (Lezen), e cila, po ashtu, asokohe, si shumë të rinj nga Kosova, kishin kërkuar strehim në Londër. Edhe familja e Lezes ishte ndër ato që kishte pësuar keq pas ripushtimit të Kosovës nga sllavo-komunistët, ngaqë njëri prej tyre (Lazër G.) kishte qenë Ballist i njohur. Pas dy vitesh u kishte lindur vajza, që e kishin pagëzuar Kosova, ndërsa Theranda, pas shumë e shumë përpjekjesh, ia kishte dalë të regjistrohej në një kolegji të njohur në degën e biokimisë, ku mësova se para pak kohesh u diploma...

Te kjo pikë, me fjalët "ç'e do që kështu e ka jeta dhe valët e saj", Leka përfundoi rrëfimin për familjen... Ndjehej i mallëngjyer sikur midis tij dhe fëmijëve të kishte marrë fund çdo gjë, pra që nuk do të shiheshin më...

Kjo më shtyri që t'i them se në këtë të keqe kishte edhe diçka të mirë, pra largimi dhe shkollimi i fëmijëve në Londër.

Fjala "largim", që e nxora butësisht, sakaq ia ndryshoi gjendjen me kthimin e pamjes së një mllefi në fytyrë.

"Largimin tonë përherë e ka dashur Beogradi... Ka vepruar vazhdimisht që Kosova të mbetet me sa më pak shqiptarë të kthyer në myslimanë ose në turq dhe me sa më shumë serbë... Për këtë qëllim ka përdorur luftën, por edhe politikën shtetërore (shpërnguljet e shqiptarëve për në Turqi si dhe fushatat e kolonizimit të Kosovës me popullatë serbe nga Kroacia, Mali i Zi dhe Bosnja)... Lufta në të cilën kemi hyrë, pa marrë parasysh se me çfarë fjalësh përcillet, dhe pa marrë parasysh se prej kujt do të shfrytëzohet më shumë ose më pak, ka këtë qëllim..."

Desha t'i thosha se fjalën "largim" nuk e kisha marrë si "ikje" ose "braktisje" e përhershme e vendit, siç e dëshironte Beogradi, por si një masë e përkohshme, që një pjesë e

të rinjve, në vend se të rrezikohen nga dhuna shtetërore serbe dhe të sakrifikohen madje, në vend se të shkollohen nëpër bodrume dhe të ndiqen nga policia serbe, ishte më e drejtë të shkolloheshin jashtë në mënyrë që nesër a pasnesër, kur të marrë fund çmenduria e Beogradit, të kthehen... Por, ishte ndezja e tij me fjalët se këtë e dëshiron Beogradi dhe të ngjashme, të thëna me shumë mllef, që këtë ma pamundësoi.

Ndoshta, po mos të ishte ndërhyrja e LiOmanit se “për me shkue përkohësisht në Europë nuk asht njëjtë si me humbë në Anadoll”, për të cilën tha se “i ka edhe të mirat e veta, sepse mbijetesa këtu, por edhe lufta kërkojnë groshët e tyre”, e gjitha do të merrte fund si provokim i ndonjë humanitari, që këtu shihet me mosbesim ngase të tillë kishte pasur jo pak që i kishte futur Beogradi të maskuar për qëllime të veta.

Fjalët e Limanit Lekën e kthyen aty ku ishte, pra te rrëfimi. Por këtë herë, kaloi nga familja te çështjet që kishin të bëjnë me luftën, që sipas tij kishte filluar me një vorbull tepër të rrezikshëm, ku jo vetëm që mund të humbej gjithë ajo që ishte arritur deri më tash, por edhe ardhmëria...

“Vorbullën e rrezikshme” dhe “humbjen e të arriturës” e me të edhe të ardhmes, Leka i lidhte me skenarët tepër perfidë të rikthimit të çështjeve aty ku i kishte lënë mbarimi i Luftës së Dytë Botërore, pra te një tradhti ideologjike midis Beogradit dhe Moskës qoftë edhe në rrethanat e pluralizmit, sipas pazarit të Moskës, siç kishte ndodhur me rezolutën e Bujanit dhe anulimin e saj me arsyetimin se do të jetë ideologjia komuniste dhe internacionalizmi proletar ai që i zgjidh të gjitha plagët imperialiste...

“Beogradi ka diplomaci, ka politikë, ka ushtri, ndër më të fortat në rajon, ka armë ndër më të shumtat dhe mbi të gjitha ka shërbime informative ndër më perfidet, me anën e të cilave është në gjendje t’i futë gishtat kudo... Tash po shihet se meqë shteti i pavarur i Kosovës, i shpallur në mënyrë legjitime me Kushtetutën e Kaçanikut, edhe përkundër dhunës shumëvjeçare të ushtruar nga prania e forcave policore dhe ushtarake si dhe terrori shtetëror, me probleme e pa problem ka mbijetuar, dhe se ai si realitet politik nuk mund të anashkalohet më dhe në të gjitha variantet do të merret parasysht edhe nga faktori ndërkombëtar i vendosjes kur çështjet e pazgjdhura të dala nga shpërbërja e Jugosllavisë të vihen në tryezën e gjelbër politike. Beogradit i duhet lufta që ta rrënojë këtë realitet, në mënyrë që nga ajo që do të dalë prej saj, ku sekush e di se përjashtohet rikthimi në gjendjen e ripushtimit të vendosur me rrënimin e autonomisë, më 23 mars 1989, me anën e partnerëve që lufta kaçakçe i futë në lojë (kapedanët e shpifur dhe gjithfarë ujemi nga diaspora), t’i hyhet një pazari tjetër me amerikanët dhe rusët?...”

Fjalët për “luftën kaçakçe”, që Leka thoshte se i duhet Serbisë më shumë se kurrë, e nxitën Limanin që të flasë pak më ndryshe, me çka u hapën çështje që ashtu dhe nga ai rrafsh, ishin tepër domethënëse për t’u kuptuar kahu i zhvillimeve të mëvonshme.

Fillimisht, Limani tha se lufta u duhej edhe shqiptarëve, meqë shteti paralel i kishte shpenzuar të gjitha mundësitë që kishte, por u duhej edhe të tjerëve, që shohin hesape në të...

“Pa luftë nuk hiqet shkau...”

“Lufta nuk bëhet dosido dhe nga kushdo... Lufta nuk bëhet me kaçakë dhe asi që vijnë të maskuar sillen vërdallë me lista në duar për t’i qëruar hesapet, si thonë, me tradhtarë... Dhe kush janë tradhtarët sipas tyre?... Intelektualët e njohur... Shkrimtarët e njohur... Historianët e njohur... Gazetarët e njohur... Janë të gjithë ata që kanë marrë pjesë në procesin shoqëror dhe politik të ngritjes së Kosovës pjesë të barabartë të federalizmit

jugosllav, që më vonë, pasi që kjo u rrënua dhunshëm nga Millosheviqi, morën përsipër themelimin e lëvizjes kombëtare të drejtuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës prej nga u vu në binarët historikë krijimi i shtetit të Kosovës, që një ditë do të jetësohet pa marrë parasysh sfidat nëpër të cilat po kalon dhe do të kalojë... Për të tillët sot nëpër oda dhe kruzhocë të ndryshme, nga komisarë dhe komandantë të vetëshpallur, që vijnë nga Tirana ose Gjermania dhe Zvicra, hapen lloj-lloj shpifjesh... Në disa pjesë, ku janë krijuar të ashtuquajturat zona të lira, aktivistët e LDK-së dhe gjithë ata që për vite i kanë takuar pushtetit vendor dhe kanë bërë çmos që fëmijët të mos mbesin pa shkolla, të sëmurët të mos mbesin pa mjekë dhe ilaçe dhe çmos tjetër që jeta të mbahet edhe në ato rrethana, nën akuzën “e tradhtarëve”, tash ndiqen, kërcënohen, po edhe vriten nga shtabe të panjohura lufte dhe gjykata të vetëshpallura revolucionare...”

Kur po i thoshte këto, Lekës sërisht iu kthye zemërimi i pakmëparshëm... Ai tashmë nuk po fliste, por çirrej me fjalët në gojë se nëse hyhet në luftë, atëherë kjo duhet të bëhet kundër pushtuesit shekullor dhe assesi kundër vlerave intelektuale dhe kombëtare që janë krijuar me aq mund...

“Kjo është luftë për rikthimin e ideologjisë, gjë që pa marrë parasysh si do të marrin fund pazaret midis të mëdhenjve, ku nuk përjashtohet mundësia që edhe Beogradi të paguajë njëfarë çmimi për krimet e bëra, në pushtet do të sjellë revolucionarët, ata që kërkojnë dhunë dhe rrënim të çdo vlere qytetëruese. Kosova nuk do të fitojë tjetër, pos që do t’i nënshtrohet hakmarrjes staliniste-enveriste të përgatitur tashmë për një gjë të tillë sipas detyrave të marra nga dika, që e gjitha të kthehet në një luftë vëllavrasëse, siç ndodhi edhe pas asaj botërores...”

Luftën vëllavrasëse, Leka e shihte si një murtajë që po përhapej me të madhe brenda asaj që i thoshte “UÇK” (fjala ishte për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës), ku sipas tij, në njërën anë ishin komisarët (kryesisht majtistë nga radhët e LPK-së - Lëvizjes Popullore të Kosovës nga diaspora, me shtabet politike në hotelet luksoze të Tiranës) dhe në tjetrën “Farkistët” (fjala ishte për Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës). Këta të dytët, të përkushtuar që rezistenca e armatosur të jetë institucionale dhe e drejtuar prej oficerëve të profesionit, shumë prej tyre fillimisht të përfshirë në kuadër të Forcave të Mbrojtjes Territoriale të Republikës së Kosovës (të shkapërderdhura nga viti 1993 pas burgosjes së shtabit dhe një pjese të madhe të oficerëve drejtues që e bëri Beogradi), iu kishin përgjigjur ftesës së kolonel A. Krasniqit në cilësinë e Ministrit të Mbrojtjes të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të marsit të atij viti, për t’u futur në luftën e Kosovës.

Por, sipas Lekës, futja e tyre për në luftën e Kosovës, që të shumtën kishte kaluar nëpërmes Shqipërisë, ku prej kohësh vepronin edhe kampet e stërvitjes, të hapura nga një marrëveshje e vitit 1991 midis Ramiz Alisë dhe presidentit Rugovë, së voni kishte marrë kahun e një rivaliteti midis “dy krahëve”, që pak më vonë ishte kthyer në një konfrontim të hapur.

Se kjo luftë nuk mund të ishte pa hesape të ndryshme nga shumë anë, këto i pohoi edhe Limani, i cili, prapë tha se “shkau nuk hiqet pa luftë dhe pa ndihmën e aleatëve”.

“Mund të flasim si të duam, por lufta ka filluar... Me dëshirë, apo pa dëshirë, tashmë jemi futur në të... Nuk kemi si t’i ikim... Po ashtu, edhe për hesapet e ndryshme në të, mund të filozofohet pareshtur, por kjo nuk e ndryshon faktin se në të, krahas atyre që nuk pajtohen mes veti, janë të përfshirë shumë e shumë patriotë të devotshëm si dhe militantë që janë të

gatshëm të sakrifikojnë çdo gjë, edhe jetën... Andaj, të luftojmë me çfarë kemi, por të bashkuar... Nëse për këtë nuk jemi të vetëdijshëm, atëherë nuk meritojmë as lirinë e as shtetin...”

“Në këtë luftë, nga anë të ndryshme, tashmë po luftohet shteti. Dhe siç po shihet, aty ku ndiqen dhe vriten intelektualët, do të luftohet edhe liria...”

Limanit nuk i pëlqyen fjalët e Lekës. Edhe pse nuk dëshironte që të zihej, tha se, njëherë për njëherë, mungojnë të dyja: shteti dhe liria, ndërkohë që gatishmëria për to deri te gjaku, nga pjesa më e madhe e luftëtarëve që marrin armën në dorë, është shumë e madhe...

Biseda sigurisht se do të vazhdonte edhe më me të njëjtat përplasje, po mos të dëgjohej një trokëllime në derën e jashtme, të cilën Leka e mori si shenjë se duhej të largohej sa më parë.

“Kjo është pjesë e luftës sonë”.

Kur po largoheshim në drejtim të rrugës që nxirrte prej nga kishim ardhur, Limani pranoi se Leka ishte pjesëtar i një njësi të shkapërderdhur të rezistencës, të themeluar prej vitesh në kuadër të vetëmbrojtjes vendore, që përpiquej të parandalonte përçarjen e brendshme, e cila vinte nga grupe të armatosura që kërcënonin veprimtarët që punonin në kuadër të rezistencës institucionale. Tha se të tillët, që i quajti “Farkistë” dhe në disa luftime me forcat pushtuese serbe kishin arritur suksese të ndjeshme (përmendi luftën e Loxhës dhe ndonjë tjetër), ishin të kërcënuar dyanshëm: nga brenda dhe dihej prej kujt dhe nga jashtë, nga pushtuesit...

Pjesën tjetër të rrugës e kaluam heshtas. Nëpër kokë po më silleshin fjalët e Lekës rreth përçarjeve të brendshme të nxitura nga karshillëqe vendore dhe të ngjashme ku ngatërrohen hesapet e ndryshme, për të cilat flitej e përflitej nganjëherë, por jo që puna të kishte shkuar deri aty që “grupe të armatosura revolucionarësh” të merrnin përsipër burgosjet, maltretimet, po edhe vrasjet e “tradhtarëve”, që vinin nga radhët e atyre që i takonin “shtetit paralel”, të drejtuar nga intelektualë të njohur, që prej vitesh i kishte rezistuar dhunës shtetërore të Beogradit në një formë të paparë deri më atëherë...

Kur hymë në pjesën e qytetit që çonte kah qendra, Limani më tha se duhej të ndaheshim. Më premtoi se po t’i jepej rasti do të më kërkonte në Prishtinë.

“Të shpresojmë se Leka do t’ia dalë...”

Atë natë nuk vura gjym në sy... Edhe pa fjalët e Limanit që m’i tha në ndarje, e kisha fare të qartë se Leka ishte i rrezikuar... Në atë gjendje thuajse tragjike, e vetmja gjë që sadopak më ngushëllonte, ishte ajo që fëmijët e Lekës (Prizreni dhe Theranda) gjendeshin në Londër, larg mallkimit të zhdukjes nga njëra luftë në tjetrën nëpër të cilën po kalonte familja e gjyshes sime të dashur, Mari Sh.

Nuk vonoi dhe lajmin për zhdukjen e Lekës (kapjen e tij nga “grupet e armatosura revolucionare” përgjegjës të vetëshpallur për qërimin e hesapeve me intelektualët dhe aktivistët e njohur të shtetit paralel të anatemuar prej tyre si tradhtarë) ma solli në Prishtinë Liman G.

Ishte një ditë nga ato të fillimit të shtatorit me diell të shndritshëm por të qetë, kur Limani, që po më priste te depoja qendrore e shoqatës “Nëna Terezë” në pjesën veriore të Prishtinës, më tha se para dy ditësh, nga persona të maskuar, Leka ishte ndalë në rrugën që çonte për në Has (në afërsi të Urës së Drinit) dhe nën kërcënimin e armëve ishte marrë prej tyre për në pjesën tjetër, në drejtim të Rahovecit për në Malishevë. Kjo ishte parë nga afër

*prej dy vetave që ishin me të dhe kishin qenë në gjendje që t'u kundërviheshin rrëmbyesve, por ai kishte kërkuar që të rrinin të qetë dhe të t'u ktheheshin punëve që bënë prej vitesh, ngaqë mund ta pranonte çdo të keqe por assesi vrasjen mes veti për hesape të huaja...*

*M'i dha emrat e tyre që e kishin parë ndalimin e dhunshëm të Lekës dhe u largua si i thyer.*

*"Ishte amaneti i tij për mos me u shkrepë armët mes nesh, që po më ndalë pa e ba timen..."*

*Lajmin për zhdukjen e Lekës e përjetova shumë rënd. Drejtuesve të misionit ua bëra me dije se çfarë po ndodhte asokohe në Kosovë në rrethanat kur ofensiva e forcave policore dhe ushtarake serbe, e përcjellë me zhurmë mediale nga Beogradi, tashmë kishte filluar të kremtohej me të madhe si "fitore ndaj terroristëve shqiptarë" siç quheshin pjesëtarët e UÇK-së. Kërkova që për këtë të njoftoheshin të gjithë vëzhguesit e jashtëm dhe forumet ndërkombëtare për t'u parë njëherë e mirë se kush janë, në të vërtetë, pjesëtarët e "komandove revolucionare" që vepronin nëpër pjesë të ndryshme, madje edhe andej prej nga Beogradi lajmëronte fitore të plotë "ndaj terroristëve"...*

*Këtë çështje e shtrova edhe me një oficer të lartë gjerman, i stacionuar në Maqedoni në kuadër të misionit vëzhgues të OSBE-së për Kosovën. Bisedën e zhvilluam në lagjen Bitpazar të Shkupit, në një ambient që të përkujtonte ndonjë paralagje të përlyer të Stambollit. Oficeri gjerman që kishte informata të shumta rreth asaj çfarë ndodhte në Kosovë dhe në rajon, pasi i shënoi gjithë ato që ia thashë dhe mori përsipër që çështja të dërgohet me të shpejtë në të gjitha forumet ndërkombëtare të pranishme në Maqedoni dhe gjetiu, pos të tjerash, nuk përjashtoi mundësinë që edhe Beogradi të ketë futur "komandat revolucionare", të maskuara me uniforma të UÇK-së, për t'i qëruar përfundimisht hesapet me intelektualët dhe aktivistët, të cilët prej vitesh ishin përfshirë në konceptin dhe veprimtarinë e lëvizjes institucionale, por shtoi se nuk mund të mohohet fakti se mentaliteti "revolucionar" është pjesë e lëvizjes ilegale, e pranishme në disa qarqe të diasporës shqiptare e përqendruar në Gjermani dhe në Zvicër...*

*"Të tillët sot trumbetojnë me të madhe se janë themelues dhe drejtues të UÇK-së...Një gazetë e tyre (pamflet tipik ideologjik), i ka faqet e mbushura me komunikata për burgosje të atyre që quhen tradhtarë dhe bashkëpunëtorë të Beogradit (kryesisht aktivistë të LDK-së, bartës të shtetit paralel) dhe madje edhe për ekzekutimin e tyre... Kjo është tepër shqetësuese kur diçka e tillë botohet në Gjermani dhe shpërndahet në vendet e tjera perëndimore!..."*

*Me t'u kthyer në Prishtinë, gjithë vëmendjen e përqendrova te zbardhja e fatit të Lekë SH.. Përpiqesha të merrja ndonjë njoftim nga Liman G., por lidhjet që kishim u shkëputën fare nga fundi i shtatorit dhe fillimet e tetorit kur Beogradi shpalli të përfunduar "me sukses" fushatën për eliminimin e "lëvizjes terroriste" dhe të shtabeve të tyre "vrastare", që si thuhej "kishin terrorizuar edhe popullatën e pafajshme shqiptare nëpër katunde".*

*Në përputhje me këtë fushatë, një gjeneral serb në Prishtinë, në një konferencë për shtyp me përfaqësuesit e mediave botërore, doli me disa të dhëna tepër shqetësuese, sipas të cilave, "komandat terroriste", për të cilat tha se ishin "militantë marksistë-leninistë" nga lëvizja ilegale e diasporës të drejtuar nga oficerë enveristë të armatës shqiptare, gjatë pranverës dhe verës së atij viti, në të ashtuquajtura "zona të lira" (përmendi Drenicën, Dukagjinin dhe një pjesë të Hasit), kishin vrarë 123 qytetarë të përkatësisë shqiptare, kishin burgosur me qindra të tjerë (edhe të përkatësisë serbë dhe rome), shumë prej të cilëve ishin*

ekzekutuar në tërheqje e sipër, ndërsa një pjesë e tyre ishin marrë me vete përtej kufirit në Shqipëri “si plaçkë lufte”.

Gjenerali serb tha se shërbimet informative të Beogradit, por edhe ato të vendeve kryesore perëndimore, kishin ngritur dyshimin se disa prej këtyre pengjeve, me ndërmjetësimin e oficerëve “të pensionuar” të ushtrisë shqiptare, kishin përfunduar në duar të trafikantëve me qeniet njerëzore. Përmendi një qendër të tillë në Veri të Shqipërisë (shtëpi e verdhë) dhe një tjetër në afërsi të Tiranës (spitali dikurshëm ushtarak) prej nga organet njerëzore, nëpërmes aeroportit të Tiranës, transportoheshin jashtë.

Edhe pse shumë nga ato që thoshte gjenerali serb ishin pjesë e propagandës për qëllime të caktuara, megjithatë, fati i Lekë SH., që ishte kidnapuar nga “komandat revolucionare” kohë më parë dhe ishte dërguar në drejtim të Malishevës, ku flitej për burgje private dhe qendra ndalimi të UÇK-së (Likovc, Kleçkë, Llapushnik e të tjera), si dhe disa raste të tjera për të cilat tashmë nga familjarët ishte njoftuar edhe misioni ynë si dhe përfaqësuesit e Kryqit të Kuq, tregonte se në këtë luftë, ku kishte interesa të ndryshme dhe hesape të shumta nga e kaluara, po ndodhnin krime të rënda dhe se duhej parë se kush qëndronte prapa tyre...

Në atë gjendje pafuqie më kujtoheshin fjalët e Martin SH., në Shkodër, që kur më pat folur për kushëririn e tij në Prizren, Lekë SH., se “edhe nëse u ka shpëtuar rastësisht thikave të shkieve, hakmarrjes së komunistëve nuk kishte si t’i ikte!...”

## 5.

Më në fund arrita në Prishtinë. Fluturimin dy orësh nga Berlini deri në kryeqytetin e Kosovës u përpoqa ta kthej në një fashë të qetë mendjeje, të shkëputesha nga moria e letrave, dokumenteve dhe të tjerave me të cilat isha marrë gjatë kohës përgatitore. Por, në fillimishte uturima e motorëve, që pas pak u kthye në një fishkëllimë të lehtë dhe pastaj dridhërimat e herë pas hershme të aeroplanit gjatë kalimit nëpër zbrazëtitë e ajrit, që më mbajtën të shtangur për ulëse bashkë me ato që dëshiroja t’i shmangia, ndërhyrja e të cilave ma krijonte një lëmsh edhe më të madh në kokë.

Ulja e qetë e aeroplanit si dhe takimi i parë me policët, doganierët dhe së fundit udhëtimi me taksi deri në hotel, se si ma krijuan përshtypjen e kapërcimit të shpejtë nga një përfytyrim me shumë pamje të lëvizshme që ngatërronin njëra-tjetrën në një realitet të ngurtë, të panjohur dhe mosbesues.

Kësaj përshtypje i ndihmoi edhe atmosfera e ftohtë gjatë asaj mbrëmje marsi me shi të fortë, të përcjellë me stuhi, që zgjati deri vonë.

Megjithatë, mëngjesi i të nesërmes, me një diell të shndritshëm që dukej sikur kishte ndaluar në një pikë prej nga gjërat të dukeshin sa më të natyrshme, duhej t’ia hapte rrugën një dite çlodhëse, çfarë edhe e kisha parafytyruar, atë të diele para se të nesërmen të përballesha me hetimin e “Dosjes B”, të paralajmëruar tashmë si nismë për nxjerrjen e “peshqve të mëdhenj” para drejtësisë, një sfidë kjo e madhe jo vetëm për EULEX-in, por edhe për besimin ndaj pranisë ndërkombëtare në përgjithësi, që me kalimin e kohës ishte luhatur dhe kishte filluar të shihet me dyshime të mëdha.

Por, ishte ndërhyrja tjetër e një letre në adresën e internetit, nga ato që herë pas herë më vinin nga im atë si “*Udhëzime për hulumtime*”, ku më bëhej me dije se e gjithë puna ime në Prishtinë duhej të përqendrohej te zbardhja e fatit të Lekë SH.

“Gjurmët i kanë humbur diku në Malishevë!!!”

Disa herë e shikova “*Udhëzimin...*”, që mbyllej me fjalën “*Malishevë*” të shkruar me shkronja të mëdha me tri pikëçuditëse në fund. Edhe pse për të dija diçka nga disa raporte që atë e lidhnin me shfaqjen e grupeve të armatosura gjatë verës dhe vjeshtës së vitit 1998 si dhe luftimeve që ishin zhvilluar në atë pjesë kryesisht të banuar me shqiptarë, nuk më kishte shkuar mendja se mund të kthehej në pikë kryesore të hetimi tim.

Edhe pse u përpoqa që në takimin e parë me sheshin që hapej në drejtim të Kuvendit të Kosovës, të përqendrohesha te pamja e përmendores së heroit kombëtar Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, të lirohesha nga Malisheva, megjithatë uturima e saj më ndiqte pas, gjë që më shtyri një copë herë të sillem nga njëra pjesë e sheshit te tjetra që të shkëputesha prej saj, ndjekje kjo që sikur u fashit paksa pasi që u ula te kafeja në cepin e sheshit, ku tashmë disa shitës ambulantë kishin hapur librat.

Por, edhe aty, kur po rrufitja kafen që më erdhi shijshëm, se si m’u bë se po dëgjoja tim atë që po më thoshte se “*Dosja B*” fund e krye lidhet edhe me rastin Lekë SH., kushëririn e gjyshes sime Mari SH.

Në të vërtetë, nga shkrimet e herë pas hershme, që më vinin në adresën e dikurshme të internetit *atol.com*., im Atë në “*Koha e vdekjes*” vazhdonte shpalosjen e fatit të familje së gjyshes sime të dashur, Mari SH., duke ndjekur gjurmët e një tragjedie të pandalshme nga fundet e luftës botërore e deri në kohën tonë, fillimisht në Shqipëri e më vonë edhe në Kosovë dhe gjetiu gjithandej nga ishte degëzuar ajo, por nuk ma thoshte mendja se fati i njërit prej kushërinjve të saj të fundit, Lekë SH., mund të kthehej në një shkas, që si do të shihet, do të ndikojë gjithë hetimin deri aty sa edhe të tërhiqem prej tij.

Ndonëse ditës sime të parë në Prishtinë fjala “*Malishevë*” iu kthye në një përndjekje të vazhdueshme që sikur qëllimisht përcillte çdo gjë dhe madje si parafjalë u rrinte edhe atyre që gjendeshin në menynë e restorantit ku drekova, megjithatë, të nesërmen, sapo arrita qendrën e EULEX-it dhe vura takimet e para me drejtuesit e misionit, trysnia e saj thajse m’u largua fare.

Me siguri se ishin dosjet e shumta, që pas pritjes së shkurtër nga përgjegjësi i misionit dhe fjalët e tij për hetimin si sfidë të sfidave me të cilën drejtësia europiane fillonte ta arsyetonte praninë këtu po edhe të tregonte përkushtimin që vendit t’i kthehej rendi dhe ligji i nëpërkëmbur prej vitesh nga grupe të caktuara politike për të cilat tha se kishin zënë peng institucionet kryesore të vendit, përqendrimit tim i kishin dhënë një kah çfarë, në të vërtetë, duhej ta kishte hulumtimi i një rasti të tillë, që sipas kryeprokurorit “*Dosja B*” nuk ishte rast i veçantë, por pikë kyçe për ta ndriçuar vorbullën e një krimi të organizuar dhe si të tillë për ta nxjerrë para drejtësisë.

“Duhet pasur parasysh se Vrasësi i Penduar, është i pandehur për krime të rënda, të kryera në bashkëveprim me një grup të organizuar të lidhur me politikën dhe qarqe të tjera kriminale dhe mafioze me shtrirje të gjerë nga koha e luftës e këndeje, por njëherësh është edhe dëshmitar i mbrojtur i hetuesisë...”

Kryeprokurori dhe prokurori i çështjes, që hetimi të ishte gjithëpërfshirës, kishin paraparë që hetimi i përbashkët nga gjashtë hetuesit që vinin nga vende të ndryshme

europiane (Franca, Holanda, Belgjika, Gjermania, Spanja dhe Anglia), duhej të kapte disa pista “të veçanta”: ato të vrasjeve gjatë luftës, të vrasjeve pas luftës, të vrasjeve të dëshmitarëve të shumtë duke përfshirë edhe ata të mbrojtur, të vrasjeve të motivuara për fshehjen e gjurmëve të krimeve ekonomike të shpallura si vetëvrasje, si dhe krimin e organizuar, në të cilin ishin të përfshirë liderë të lartë politikë të vendit kryesisht nga radhët e komandantëve të luftës, për të cilët dyshohej se kishin shfrytëzuar institucionet e shtetit për këto qëllime.

Si emërues i përbashkët i të gjitha pistave shfaqej SHIK (shërbim klandestin informativ, i themeluar gjatë luftës në kuadër të UÇK-së, të shumtën nga radhët e militantëve të LPK-së, shërbim ky që kishte vazhduar edhe gjatë kohës së Qeverisë së Përkohshme të themeluar në Tiranë, në mars të vitit 1999 dhe kishte vazhduar edhe gjatë administrimit ndërkombëtar të Kosovës, e deri në vitin 2008, kur ishte shpallur pavarësia e vendit).

Me emrin e këtij shërbimi klandestin, që kishte vepruar thuajse legalisht gjatë gjithë kohës dhe ishte më se e qartë se duhej ta kishte pasur edhe mbështetjen e jashtme, veçmas nga SHISH (Shërbimi Informativ i Shqipërisë) dhe disa faktorë të tjerë, lidhej edhe gjithë ajo që përfshihej në “*Dosjen B*”, që si pikënisje kishte të ashtuquajturën “Komando vrastare”, të dyshuar për kidnapime, maltretime dhe vrasje gjatë dhe pas luftës.

“Vrasësi i Penduar, i akuzuar për kidnapime dhe vrasje të organizuara, njëherësh edhe dëshmitar kryesor i padisë, mbetet referencë kryesore e të gjitha pistave të veçanta hulumtuese... Është fjala për një kullë të ngritur nga një domino, lëvizja e së cilës e mban por edhe mund ta rrënojë saora atë...”

Në udhëzimet e rastit, Kryeprokurori theksoi se shfaqja e Vrasësit të Penduar në këtë cilësi, ndonëse do të duhej që rastit t’i sillte përparësi, megjithatë, nëse ndodh që përgjegjësia penale e tij, si “rast i veçantë” shkëputet nga fokusimi i gjithë çështjes, procesit mund t’i kthehet në një problem të madh, ngaqë mund t’i shfajësojë ose t’i qesë në plan të dytë grupet mafioze dhe kriminale të cilave u takoi ai si dhe veprat e tyre, që nuk ishin personale, por pjesë e veprimeve të organizuara kriminale për qëllime politike.

“Është fjala për një lëmsh kriminal me shtrirje të shumanshme, që duhet t’i ndiqet filli, pa marrë parasysh ku çon dhe çfarë nxjerr në shesh...”

Ndërkohë që Kryeprokurori po fliste haptas për mbi njëqind e sa vrasje me motive politike dhe kriminale të kryera gjatë dhe pas luftës për të cilat drejtësia ndërkombëtare në bashkëpunim me atë vendore nuk ka qenë në gjendje të japë ndonjë përgjigje edhe atëherë kur disa prej tyre janë paralajmëruar dhe atentatorët thuajse kanë vepruar në pikë të ditës (siç ishte vrasja e dy deputetëve të Kuvendit të Kosovës, gjashtë hetuesve policorë që ishin marrë me hetimin e krimeve të rënda, disa intelektualëve nga radhët e LDK-së si dhe këshilltarit të lartë të vetë Presidentit të Kosovës – komandant i FARK-ut), Vrasësi i Penduar, që për herë të parë kishte folur haptas për një “Komando vrastare” së cilës i kishte takuar po më kthehej në një Jonus me dy fytyra në një regjisor të miteve antike, i cili me “*deus ex machina*”, ishte në gjendje që ta mbyllë shfaqjen sado tragjike të ishte.

Dhe në atë përvijim me heronjtë e antikës, që rëndom kremtoheshin si të vrarë (pra viktimë) dhe i zhytur në atmosferën e një antidrame bashkëkohore ku vrasësit kremtohen (si heronj) ndërsa të vrarët nënçmohen (si tradhtarë), që kushedi se ku do të më çonte, ndjeva të më thuhej se pista të hulumtimit tim ishin krimet e kryera gjatë luftës, me çka mbetsha në

atmosferën e dramës dhe të antidramës, të tragjedisë dhe të antitragjedisë, ku vetëm kodi i vrasjes përcaktonte “heroin” ose “tradhtarin” nga pikëvështrimi i “fituesit”, pra i të fortit...

Edhe pse dëshmitari Vrasësi i Penduar, vetakuzohej për krime pas luftës, megjithatë, kryehetuesi kishte paraparë tri seanca dëgjimore me të, ngaqë ai, si pjesëtar i UÇK-së, njëherësh (pavarësisht rrethanave që e kishin sjellë te ajo pikë) vetëdeklarohej që i kishte takuar SHIK-ut gjatë luftës, duke u përfshirë në këtë shërbim edhe gjatë kohës së Qeverisë së Përkohshme të dalë nga “krah i luftës”, të themeluar në Tiranë, në mars të vitit 1999, (pa pjesëmarrjen e partisë kryesore politike LDK-së, që kishte drejtuar shtetin paralel gjatë tetë viteve për ç’gjë asaj i ishin veshur hipotekat e “tradhtisë” e të ngjashme). Ky fakt kishte rëndësi të madhe, ngaqë sipas informatave bazike edhe Vrasësi i Penduar i kishte takuar kësaj partie nga themelimi e deri në prag të luftës, duke marrë pjesë në strukturat e pushtetit vendor.

Pas bisedës së gjatë dhe hollësive të tjera midis hetuesve, që për herë të parë gjendeshin në një tavolinë të përbashkët për t’i ndarë punët dhe detyrat, prokurori ma la përpara “*Dosjen B*”. M’u tha se kisha dy ditë kohë të merresha me të, para se të ballafaqohesha me të pandehurin. Ajo ishte e shoqëruar edhe me një “dosje përcjellëse”, atë të dokumenteve të gjithëmbarshme, me të cilën duhej të merresha pasi që t’i kisha rënë në fund të parës.

“Ky nuk është një rast i veçantë, por një histori e tërë...”

Me jehonën e fjalëve për një histori të tërë, hapa “*Dosjen B*”. Shfletimi i saj duhej të bëhej në dhomën e veçantë të hetuesisë, nën vëzhgim të vazhdueshëm, ngjashëm me dëshmitarët e mbrojtur.

Dosja ishte ndarë në tri pjesë tematike:

- a) Shënimet biografike;
- b) Veprimtaria politike dhe
- c) Veprimtaria kriminale

Në pjesën e parë ose Shënimet biografike shfaqej më e rëndësishmja, ngaqë ajo duhej të nxirrte në pah veçoritë dhe faktorët domethënës nga pikëpamja individuale dhe ajo shoqërore, që kishin çuar te veprimet kriminale, të cilat, në këtë rast lidheshin ngusht me faktorin e dytë, pra atë shoqëror i motivuar politikisht, i cili në rrethanat e mendësisë patriarkale dhe të mentalitetit folklorik-fisnor, si në rrethanat e përmytyjeve të mëdha çfarë ishin ato të viteve të tetëdhjeta dhe të nëntëdhjeta, ishte ndikuar edhe nga stereotipet e kodit *tradhtar-hero*, me ç’rast *vrasja* e tradhtarit merret si *heroizëm*.

Në shënimin numër 2 (shifra B/41), thuhet se Vrasësi i Penduar ishte rritur në një familje në dukje tipike patriarkale për nga organizimi i brendshëm (me 21 anëtarë, 15 meshkuj dhe 6 femra, me zot shtëpie e të tjera), por që nga jashtë dukej ndryshe. Arsytet duhet kërkuar te statusi shoqëror dhe politik që kishte kjo familje pas luftës kur ajo ishte anatemuuar si armiqësore: ngaqë gjyshi i tij, gjatë luftës në shërbim të qeverisë së Xhafer Devës, ishte akuzuar edhe për pjesëmarrje në organizatën nacionaliste “*Nacionaldemokratja Shqiptare NDSH*”, e cila kishte luftuar komunizmin dhe njëherësh kishte kërkuar një bashkim kombëtar shqiptar demokratik. Në ato pak shënime, thuhet se gjyshi i tij, si pjesëtar i NDSH-së, në mungesë, ishte dënuar me burgim të përjetshëm, por nuk sqarohet se çfarë kishte ndodhur me fatin e tij, gjë që mund të kuptohej se ai ishte “zhdukur”, që do të thotë se ishte likuiduar diku, siç u kishte ndodhur shumë e shumë nacionalistëve shqiptarë që do t’u humbin gjurmët pas

luftës. Në këto rrethana, i ati, si më i vjetri (kishte edhe dy vëllezër të tjerë), nga vitet e pesëdhjeta kishte punuarrojtat pyjesh. Ndërsa dy vëllezërit po ashtu ishin roje nate: njëri në Spitalin Psikiatrik në dalje të qytezës dhe tjetri në ndërmarrjen komunale që merrej me higjienë.

Në shënimin 6 (Shifra B/42), thuhet se Vrasësi i Penduar, si fëmijë i katërt (pas tri motrave), kishte lindur më 22 tetor 1969. Ishte rritur jetim, meqë pas dy muajsh i kishte vdekur i ati. Përkujdesjen për të dhe familjen e kishte marrë përsipër daja, nga një katund aty afër, që sikur mezi kishte pritur që vdekjen ta shfrytëzojë që nipit t'i ofrojë një jetë pak më të mirë nga ajo në familjen e përbashkët.

Por, nga shënimi 7 (Shifra B/43), del se pas tri vitesh në katundin afër, familja e Vrasësit të Penduar, prapë ishte kthyer nën kulmin e përbashkët, në periferi të Qytezës. Kjo kishte ndodhur pasi që daja kishte vdekur në një fatkeqësi komunikacioni bashkë me dy të bijtë. Mbas kësaj tragjedie ishte rrënuar i gjithë biznesi familjar (një mulli elektrik), që kishte kaluar në duart e një ortakut, i cili, pak nga pak e kishte përjashtuar familjen nga biznesi.

Në këto rrethana, pra i detyruar që të jetojë nën mbikëqyrjen e xhaxhallarëve, Vrasësi i Penduar kishte filluar shkollën fillore në Qytezë, të cilën e kishte kryer me sukses të shkëlqyeshëm. Të mesmen e kishte vazhduar në Ferizaj. Ndërsa pas përfundimit të saj kishte vazhduar studimet në Universitetin e Prishtinës, ku kishte diplomuar me kohë dhe me sukses mesatar.

Sipas shënimeve 7,8 dhe 11 (Shifra C/12), del se në vitin e dytë të studimeve Vrasësi i Penduar, ishte dënuar me 30 ditë burgim për pjesëmarrje në demonstratat e studentëve të marsit 1981, në Prishtinë.

Shënimi pasues, nga fundi i vitit 1981 atë e nxjerr prapë në burg për “propagandë armiqësore”(përhapjes së disa pamfleteve me fjalime të Enver Hoxhës, të nxjerra në fletushkën “Zëri i Kosovës”, të botuar nga grupet marksiste-leniniste në Gjermani, e futur ilegalisht në Kosovë) si dhe “për përfshirjen në një grup irredentist, që vepronte për shpëputjen e Kosovës prej Jugosllavisë dhe për bashkim me Shqipërinë staliniste”. Pasi që i ishte hequr akuza “e marrjes pjesë në një grup armiqësor irredentist ” për çfarë, sipas ligjit penal do të mund të dënohej nga 3 deri në 9 vjet burg, nën akuzën për “propagandë armiqësore”, sipas ligjit për kundërvajtje, ishte dënuar me tre muaj burgim. Gjatë procesit gjyqësor në Gjykatën Komunale të Ferizajt, kishte deklaruar se në Konviktin e Studentëve në Prishtinë, ku banonte, disa persona të panjohur silleshin me fletushka, por u kishte mbetur larg ngaqë shpërndarësit e tyre nuk ishin studentë dhe shpesh shiheshin “me dyshime”.

Por, siç kishte ndodhur në raste të tilla, kur studentët e dënuar e humbnin të drejtën e studimit (përkohësisht – për një vit, ose përgjithmonë), Vrasësi i Penduar nuk ishte prekur nga këto masa. Kishte vazhduar studimet, të cilat i kishte kryer në vitin 1983. Në vjeshtë të atij viti, kishte shkuar në shërbimin e detyruar ushtarak në Armatën Popullore të Jugosllavisë. Ishte kthyer pas njëmbëdhjetë muajsh. Në shtator ishte punësuar arsimtar në Shkollën Fillore të Qytezës. Mbas një viti ishte martuar me një nëpunëse nga Qyteza, me të cilën ishte njohur sapo ishte kthyer nga shërbimi ushtarak. Fëmija i parë (djali Dritoni) u kishte lindur pas dy vjetësh, ndërsa vajzat (Shpresa dhe Edona) në vitin e tretë dhe të katërt të martesës.

Vrasësi i Penduar do të dalë nga heshtja disavejçare, kur do të gjendet në kryesinë e degës së Lidhjes Demokratike të Kosovës në Qytezë. Në shtator të vitit 1990, pasi që do të

marrë pjesë në grevën e përgjithshme të Sindikatave të Kosovës, përjashtohet nga puna ngaqë nën akuzën e njërit nga organizatorët e tyre.

Këtu në të vërtetë fillon pjesa e dytë, ajo e veprimtarisë politike, ku ai shihet i angazhuar thuajse në të gjitha aktivitetet e shtetit paralel në kuadër të institucioneve të tij vendore, veçmas në ato që lidheshin me organizimin e arsimit shqip.

Për këtë veprimtari ishte burgosur disa herë nga autoritetet policore serbe, por nuk kishte hequr dorë nga misioni.

Në verën e vitit 1998, pas daljes në skenë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, shënohet angazhimi i tij në luftë, i përfshirë në një “njësi vendore”, të lidhur me Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës FARK, që më vonë i kishte takuar të ashtuquajturës Zonë e Nerodimes. Nga dokumenti 13 (Shifra G/11) del se “njësiti vendor” kishte pasur trembëdhjetë veta.

Njësiti kishte operuar në hapësirën midis Qytezës në drejtim të Ferizajt nëpërmes maleve që lidhnin Grykën e Carralevës me Nerodimen dhe Sharrin, por nga të dhënat me mangësi, nuk fitohet ndonjë pasqyrë e qartë e veprimeve luftarake të tij.

Nga deklaratat e mëvonshme të Vrasësit të Penduar dhe disave që kishin qenë pjesë e “njësiti vendor”, mund të kuptohet se i gjithë njësiti ishte marrë me “hulumtime”, pra me mbledhjen e “të dhënave” rreth prapavijës, pra të shënjitimit “të bashkëpunëtorëve” të Beogradit dhe “pasivizimit” të tyre.

Në të vërtetë, këtu dhe te kjo detyrë ka fillin ajo që në shënime kualifikohet “veprimtari kriminale”. Dokumentet 14, 17 dhe 21 (Shifra C/12), të përcjella edhe me një dosje shtesë (me dëshmi të mëvonshme nga Vrasësi i Penduar dhe të disa bashkëluftëtarëve para hetuesve të UNMIK-ut, por edhe atyre të Hagës), bëjnë të ditur se nga mesi i verës 1998, kur edhe kishte filluar ofensiva e madhe e forcave policore dhe ushtarake serbe për “likuidimin e grupeve terroriste dhe bazave të tyre” (me këtë mendohej UÇK), Vrasësi i Penduar ishte përfshirë në kuadër të të ashtuquajturit SHIK (Shërbim Informativ) i UÇK-së. Nga deklaratat e Vrasësit të Penduar (të dhëna gjatë bisedave me agentët e ndryshëm ndërkombëtarë të disa shërbimeve informative të koduara “tepër sekrete”), shihet se në kuadër të këtij shërbimi ishte marrë me “përgjimin e veprimtarisë së bashkëpunëtorëve të Beogradit në radhët e LDK-së dhe të strukturave të shtetit paralel në pjesën e Nerodimes”, siç ishte marrë edhe me “përcjelljen e agentëve të Beogradit të infiltruar në UÇK”.

Këtë veprimtari e kishte vazhduar edhe me rastin e krijimit të Ministrisë së Brendshme të Qeverisë së Përkohshme (të drejtuar nga “krahu i luftës”) në Tiranë nga marsi i vitit 1999 e deri në janar të vitit 2000, kur ajo ishte shpërbërë zyrtarisht nga autoritetet ndërkombëtare. Sipas deklaratave asnjëherë të konfirmuara, Vrasësi i Penduar kishte vazhduar të vepronte në kuadër të SHIK-ut edhe për një kohë, sado që kjo ishte demantuar nga disa drejtues të SHIK-ut. Në dokumentin 17 (Shifra C/12), është e deponuar një deklaratë në 16 faqe A-4, ku Vrasësi i Penduar, flet për “Komandën vrasëse” në kuadër të SHIK-ut, së cilës i kishte takuar me gjashtë të tjerë (përmenden emrat dhe mbiemrat e tyre si dhe emrat e drejtuesve “në hije” – njëri prej tyre komandant i lartë në hierarkinë e UÇK-së dhe më vonë politikan i rëndësishëm nga “krahu i luftës”, prej nga kishin marrë detyrat për likuidimin e personave të caktuar).

Në dokumentin 21 (shifra C/12), përfshiheshin disa deklarata me shkrim rreth pjesëmarrjes në vrasje të atyre që ishin quajtur “bashkëpunëtorë të armikut” dhe “agjentë të

Beogradit” gjithnjë sipas udhëzimeve të marra nga “drejtuesi në hije”, nga i cili ishin marrë armët dhe informacionet e tjera për veprim të atypëratyshëm. Vrasësi i Penduar pranonte se kishte marrë pjesë në vrasjen e ish inspektorit të shërbimit policor të Kosovës në Prishtinë dhe në disa atentate të tjera, prej nga viktimat kishin marrë plagë të rënda.

Krahas dhënies së dëshmive (kryesisht personale) rreth veprimtarisë kriminale të “Komandës vrasëse”, me ç’rast ato lidhen për vepra të konfirmuara (vrasjet e personave të caktuar të cilat prej vitesh hetoheshin), me interes shfaqen edhe të dhënat rreth strukturës organizative të “Komandës” deri në vitin 2008 si dhe të financimit të saj, që sipas tij, lidhej me strukturat shtetërore (Agjencia e privatizimit dhe bosët e disa firmave që drejtoheshin nga ish komandantët e luftës, kryesisht nga pronat e uzurpuara). Vrasësi i Penduar flet për një rreth të gjerë mafioz, nga radhët e politikës që kishin përfituar nga ky shërbim, i cili, gjithnjë sipas porosive të “drejtuesve në hije”, kishte përgatitur terrenin për ngritjen e shpejtë të komandantëve në politikë. Krahas vrasjeve, kërcënimeve dhe shantazheve të shumta, rol të madh kishte luajtur edhe forcimi i bazës së tyre ekonomike nëpërmes uzurpimeve dhe përvetësimit të njëanshëm të pronave publike në emër “të privatizimit” (banesave, tokave, pompave të benzinës dhe objekteve të tjera), punë kjo që, sipas deklaratave të Vrasësit të Penduar, kishte filluar menjëherë pas luftës për të vazhduar deri në shpalljen e pavarësisë. Prandaj do të deklarojë se “17 shkurti 2008 paraqet një ngjarje historike për Kosovën (shpallja e pavarësisë), por njëherësh paraqet edhe një datë tragjike për të, meqë në këtë ditë, autorët e krimit, me “oreolin e çlirimtarëve” dhe ndihmën e disa qarqeve ndërkombëtare, do të legjitimojnë shtetin si pronë të patjetërsueshme të tyre!...”

Me këtë deklaratë, tepër domethënëse për hetimin e këtij rasti dhe të nxjerrjes në pah të një realiteti të dhimbshëm politik, përfundonte edhe informacioni për jetën dhe veprën e Vrasësit të Penduar, të ndarë në tri pjesë (biografia, veprimtaria politike dhe veprimtaria kriminale).

## 6.

“*Dosja përcjellëse*”, e cila kishte mbi njëmijë faqe me dokumente, shënime, dëshmi dhe raporte të ndryshme të shërbimeve informative (në formën e censuruar) dhe të udhëzimeve për hulumtime të mëtejshme, paraqiste fondamentin e “*Dosjes B*”, mbi të cilën duhej të ngrihej akuza për vepra penale ndaj pjesëtarëve të komandove të caktuara të SHIK-ut, të kryera gjatë luftës, menjëherë pas luftës dhe në vitet në vijim, deri te shpallja e pavarësisë së Kosovës, në shkurt të vitit 2008.

Kështu, përballja me “*Dosjen përcjellëse*”, pos që kërkonte shumë kohë për lexim informativ të aq shumë dokumenteve dhe shënimeve përcjellëse nga burime të ndryshme shpeshherë të papërputhshme ose qëllimisht të ngatërruara, njëherësh kërkonte edhe përqendrim tematik dhe procedural të çështjes, ngaqë prej saj duhej nxjerrë aspektet e inkriminimit individual nga ai ekipor, siç pretendohet në deklarinimin penal, siç duhej veçuar edhe peshën e vendimeve ekipore tek vendimet individuale (në rastin konkret përshkrimin veç e veç të rolit të secilit në veprën e kryer – atentatet dhe vrasjet).

Meqë i gjithë procesi i hetimit, i ndarë në gjashtë pista hetuese nga gjashtë hetues, duhej të krijonte kornizën e padisë së përbashkët, kjo nënkuptonte edhe ndërlidhjen e të gjithë faktorëve brenda një tërësie, ku doemos pjesëmarrja “e painkriminuar” në “komandon

vendore” gjatë luftës, nuk mund të mbetej e shkëputur nga tërësia e as jashtë lidhjes me veprimtarinë kriminale gjatë dhe pas luftës, veçmas kur kjo e fundit, pohohej dhe pranohej dhe tashmë ishte objekt i aktakuzës që duhej të ngrihej. Duke rrënuar në këtë drejtim, “*Dosja përcjellëse*” megjithatë, ofronte disa indikacione se “komanda vendore” së cilës i kishte takuar Vrasësi i Penduar gjatë luftës, ishte përfshirë në “zbulimin” e disa “tradhtarëve”, ndalimin si dhe përcjelljen e tyre drejt shtabit të Malishevës, dy prej të cilëve u kishin humbur gjurmët në atë pjesë.

Edhe pse këto informata ishin pjesë e disa bisedave informative, që hetuesit e Hagës, i kishin zhvilluar, në formën e “intervistimeve” me persona të ndryshëm, (si të tilla, pa ndonjë verifikim të ri hetues, nuk mund të përfshiheshin në akuzë), megjithatë, bënin me dije nga duhej të sillsha në punën time të mëtutjeshme, e cila mund të kthehej në një flluskë sapuni pa dëshmitë e Vrasësit të Penduar meqë vetëm ato mund të hidhnin dritë se çfarë kishte ndodhur me personat e ndaluar që ishin dërguar për në Malishevë dhe Llapushnik, që shënoheshin si të zhdukur.

Mbetja te kjo çështje, tashmë më kërkohej edhe nga “*Udhëzimet për hulumtimin*” nga im atë, i cili, në gjithë atë problematikë, i interesonin vetëm gjurmët e kushëririt të familjes së gjyshes sime, prizrenasit Lekë SH., të cilat kishin humbur në atë drejtim, pra nga Malisheva me çka sikur më krijohej bindja se të gjitha rrugët e fatkeqësive dhe tragjedive çonin kah Malisheva. Madje, në postimin e fundit, ai m’i përkujtonte dhe emrat e dy agjentëve gjermanë (T.B. dhe N.H.), të cilët të maskuar në një mision humanitar gjatë luftës, me detyrë kishin marrë pjesë drejtpërdrejt në përcjelljen e vullnetarëve shqiptarë nga Gjermania në luftën e Kosovës (azilkërkues me statusin e “duldung-ut”), për të cilët qysh më parë dihej se në Gjermani merreshin me “denoncimin” e “tradhtarëve” në diasporë (kryesisht intelektualë nga radhët e LDK-së që kishin kërkuar strehim politik por vepronin në kuadër të strukturave të shtetit paralel), punë që e kishin bërë edhe në luftë, në kuadër të një “komandoje” që, si thuhej, merrej me “pengimin e veprimtarisë së bashkëpunëtorëve të policisë serbe në radhët e UÇK-së”.

Të dhënat e agjentëve gjermanë nga radhët e misionëve humanitare dhe vëzhguesve të tjerë të shërbimeve inteligjente bashkë me ato të shërbimeve ushtarake nën shifrën “top secret”, rreth veprimtarisë së “vullnetarëve” nga Gjermania me këtë statut të pranishëm në luftë, edhe pse shumë prej tyre, për nga dija ushtarake dhe ajo policore, ishin injorantë të vërtetë, kisha pasur rastin t’i shihja. Disa pjesë të tyre i kisha edhe me vete, ndonëse ato nuk mund të përdoreshin si dëshmi për kurrfarë hetimi, ndërsa të tjerat e dija ku mund t’i gjeja, po të më duheshin. Në të vërtetë, ato ishin tepër tronditëse, jo pse asaj lufte i mungonin tmerret ndër më të nduarduartat me të cilat ishte ballafaquar popullata e pambrojtur gjatë “aksioneve spastruese” të policisë dhe ushtrisë jugosllave gjatë verës dhe vjeshtës së vitit 1998 si dhe pranverës së vitit 1999, por edhe për shkak të veprimeve të disa grupeve “të vullnetarëve” nga diaspora, kryesisht nga Gjermania, në disa pjesë “të zonave të lira”, ku ata, me lista të gatshme nga hajmet gjermane, kishin marrë pjesë në të ashtuquajturat “komando spastruese” kundër “bashkëpunëtorëve të Serbisë”, të shumtën ishin veprimtarë të LDK-së, të përfshirë në institucionet vendore të shtetit paralel (arsim, shëndetësi, kulturë dhe solidaritet të përgjithshëm). Shërbimi Informativ Gjerman (BND) dhe ai i Inteligjencies Ushtarake (MAD) kishin evidentuar 124 refugjatët shqiptarë në Gjermani, që “si vullnetarë lufte” ishin marrë me punë të tilla në Kosovë, ndër ta, 27 si kërcënues e dhunues femrash, 32 lidheshin me

ushtrimin e torturave dhe rrahjeve brutale në vendet publike, 17 veta kishin marrë pjesë si roje në qendrat “lëvizëse” të të burgosurve, por që edhe gjatë ushtrimit të kësaj “detyre patriotike”(gjithnjë sipas shumë dëshmimeve të të mbijetuarve) kishin ushtruar dhunë, ndërsa për 8 veta raportohej se kishin marrë pjesë edhe në vrasje.

Ndaj këtyre të fundit, ishin hapur edhe hetime, por ato kishin mbetur të përfunduara, ngaqë shërbimi informativ nga burimet e veta në Kosovë dhe hetuesia, kishte të dhëna të sigurta se katër prej tyre, në forma të paqarta ishin vrarë në muajt e parë pas luftës “gjatë përdorimit të armëve nëpër ahengjet nëpër katunde”, dy të tjerë ishin vrarë gjatë luftës (po ashtu në rrethana të paqarta, por me dyshimin se ishin likuiduar nga brenda nga frika se mund “të pëshpëritnin” nëse merren në pyetje nga hetuesit gjermanë ose të tjerë), ndërsa dy të tjerë shfaqeshin të zhdukur (me dyshimin se të likuiduar nga policia serbe, kishin përfunduar në varrezat masive diku në Serbi).

Edhe përkundër kësaj, organet e hetuesisë gjermane bashkë me ato të shërbimit informativ, për “nevoja të brendshme”, kishin vazhduar të mblidhnin informata rreth veprimtarisë së “vullnetarëve” shqiptarë nga radhët e refugjatëve politikë nga Gjermania që ishin përfshirë në luftën e Kosovës. Në këtë punë, krahas hetuesve ligjorë, ishin përfshirë edhe katër ekipe hulumtuesish (sociologë, psikiatër, politologë dhe kriminologë), të cilët, sipas interesimit kishin intervistuar një pjesë të mirë të personave në diasporën shqiptare në Gjermani, të cilët në forma të ndryshme kishin marrë pjesë në veprimtarinë e shtetit paralel dhe të rezistencës së armatosur por edhe në luftë (oficerë dhe regrutë shqiptarë që kishin dezertuar nga armata jugosllave, inspektorë të shumtë që kishin punuar në shërbimet policore dhe ato informative jugosllave dhe aktivistë të tjerë).

Është me interes të thuhet, se në ato qindra dhe mijëra faqe, që edhe më tutje mblidhen në një dosje të përbashkët të BND-së (Shërbimit Informativ Gjerman), me sqarimin “që pasi të sistemohen, do t’u lihen në dispozicion edhe analitikëve dhe studiuesve të ndryshëm që merren me këtë problematikë”, ishin iniciuar trajtesa të veçanta nga pikëpamja sociologjike, psikologjike, publicistike dhe e kriminalistikës. Kjo punë analitike referencë të përbashkët kishte dilemën: si ishte e mundur që një kategori e të rinjve në moshë të re (10-15 vjeçare), të ikur nga dhuna serbe nga ambientet rurale nga fillimi i viteve të nëntëdhjeta e këndeje, brenda dhjetë ose më pak vitesh të qëndrimit në Gjermani, të përfshirë në sistemin arsimor dhe edukativ gjerman, të frymëzoheshin me një urrejtje të tillë kundër shtetit paralel dhe frymës intelektuale, kur do të duhej të ishte e kundërta?

Me këtë rast, shtrohej edhe pyetja rreth asaj se ç’ishte ajo forcë shtytëse, që disa nga këta të rinj, me imazh tepër të mjegulluar të Kosovës që e lanë, t’i kthejë në dhunues dhe vrasës të saj, siç del nga sjellja e tyre atje?...

Sociologu Sigfrid H., ndonëse ishte mundur që të gjente njëfarë mbështetje te mentaliteti folklorik dhe vetëdija e kanunit ku vrasja shfaqej si “çështje nderi” por edhe te qëndrimi i njohur te shqiptarët “se armikun duhet kërkuar së pari nga brenda për ta luftuar e pastaj pushtuesin”, megjithatë, nga hulumtimi i gjendjes familjare, pastaj asaj sociale e mbi të gjitha i faktorëve që kanë të bëjnë me atmosferën e pamjes dhe të përjetimit të gjendjes së krizës së vendit nga jashtë, nxjerr njëfarë përfundimi se refugjatët shqiptarë në Gjermani si dhe diaspora prej kohës i ishin nënshtruar ndikimit të vazhdueshëm të propagandës së grupeve majtiste, të vendosura në vitet e shtatëdhjeta dhe të tetëdhjeta si dhe përpunimit prej tyre “me

ide të luftës çlirimtare” për “bashkim kombëtar” si një ilaç me të cilin do të përfundonin që të gjitha “vuajtjet” dhe padrejtësitë historike.

Për sociologun Sigrfrid H., ky indoktrinim i natyrës ideologjike (propagohej bashkimi me Shqipërinë enveriste), ishte i ngjashëm me atë të natyrës fundamentaliste që klerikët fanatikë vahabi zhvillonin midis refugjatëve turq dhe të tjerëve nga vendet islamike, me të vetmin dallim, se ai nuk zhvillohej nëpër xhami, por nëpër “klubet shqiptare” dhe “takime familjare”, në të cilat, në rrethanat e paraluftës dhe ato të luftës në Kosovë, përfshiheshin i madh e i vogël.

Por, apologët e luftës, në rolin e militantëve “të çlirimit kombëtar” dhe “të bashkimit kombëtar”, përqendrimin parësor dhe kryesor e kishin te indoktrinimi me urrejtje kundër Lëvizjes Kombëtare për liri, barazi, demokraci dhe shtet të pavarur, të drejtuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës, e themeluar nga elita intelektuale e Kosovës. Për drejtuesit e LDK-së, të shumtën intelektualë të njohur, që ishin në krye të shtetit paralel dhe të institucioneve të dala nga ky organizim, për të cilin kishin votuar thuajse të gjithë shqiptarët e Kosovës, thuhej se ishin “titistë”, pra “tradhtarë të shitur te Beogradi”, që “punonin për interesat e Serbisë” dhe të ngjashme.

Rituali i anatemës “së tradhtisë”, me shfrime nacionaliste, mbretëronte thuajse pa përjashtim në tubimet maratonike, të cilat doemos përcilleshin edhe “me aktivitete kulturore” (një përzierje e kësaj muzikor-folklorik me recitime patetike-patriotike dhe skeçe të ngjashme që ngjallnin dalldi kolektive). Ato përfundonin me mbledhjen e “ndihmave vullnetare për luftën”.

Nga këto tubime dalldisëse, urrejtja ndaj “shtetit të Kosovës” dhe gjithë atyre që ishin përfshirë në të, “të pushtuar nga tradhtarët”, krijonte paradigmen emocionale midis “viktimës” (atyre që kishin ikur prej tij) dhe të “tradhtarëve” (që kishin mbetur në të “në shërbim të Beogradit”), gjë mbi këtë ndërtohej edhe pikënisja e “patriotizmit” të klubeve, që nënkuptonte fillimisht diferencimin kundër “tradhtarëve shqiptarë” si dhe shpalljen luftë atyre që pengonin “çlirimin” e Kosovës dhe “bashkimit kombëtar” (paçka se ata ishin pjesë e elitës intelektuale, krijues të rëndësishëm letrarë, studiues po ashtu të mirënjohur, të cilët përkohësisht ishin larguar nga krijimtaria për t’u marrë me politikë në përputhje me përgjegjësinë historike së cilës nuk mund t’i iknin në ato rrethana).

Sociologu Sigfrid H., ekuivokun “tradhtarë - çlirimtarë” e shihte të ndërtuar nga ky diskurs emocional mbi të cilin pastaj nuk kishte qenë e vështirë që ata që ishin kthyer në atdhe pas dhjetë vitesh “si luftëtarë” fiksim emocional dhe psikologjik kishin “spastrimin” e vendit nga “tradhtarët”, gjë që, me armë në dorë, disa prej tyre nuk e kishin pasur të vështirë të vepronin si dhunues, kriminelë dhe vrasës madje, të bindur se ashtu dhe vetëm ashtu po i shërbenin çështjes, por njëherësh nxirnin hak edhe për “humbjen e atdheut” nga “tradhtarët”, që “me politikën paqësore i shërbenin Beogradit dhe vetëm Beogradit”!

Sigfrid H. Jep të dhëna se disa prej të rinjve, të indoktrinuar fanatikisht me këtë frymë, sapo ishin përballur me realitetin, e kishin parë se diçka nuk është në rregull. Por, meqë shumë prej tyre ishin të mbikëqyrur nga “komandantë” të panjohur dhe të rreptë, kishin marrë ikën edhe pse e kishin paguar me kokë. Por, ata që disi ia kishin dalë që të kthehen në Gjermani (përmenden rreth 137 persona), me trauma të rënda, kishin kërkuar ndihmë psikiatrike, ndërsa disa të tjerë u ishin drejtuar organeve policore që të merren në mbrojtje nga pasojat.

Edhe psikologu Helmut B., i cili kishte drejtuar një ekip të psikologëve si dhe mjekëve të psikiatrisë, të cilët me shumë përkushtim ishin marrë me këtë fenomen, flet për trauma të rënda psikike tek shumë të rinj, që kishin marrë pjesë në luftë jo vetëm në ambientet e caktuara (“zonat e çliruara” të kthyer në feude të komisarëve dhe të komandantëve ku ata kishin ushtruar terror), por edhe para se të shkonin atje, gjatë qëndrimit disaditësh në Shqipëri, në të ashtuquajturat “kampe ushtrimesh ushtarake”, ku thuhej se çdo gjë kishte pikënisje deklarimin “solemn” kundër “tradhtarëve” dhe “titistëve” të “krahut të paqes” e pastaj edhe të baraspeshimit të luftës së “oficerëve titistë” nga radhët e FARK-ut me “ushtrinë jugosllave” e të ngjashme. Ky realitet i pakapshëm për shumë të rinj që kishin vendosur t’i bashkoheshin luftës, kishte qenë tragjik për disa prej tyre, ngaqë pse “nuk u ishte dhënë leja” për “ushtrime ushtarake”, kishin mbetur të shkapërderdhur rrugëve të Shqipërisë në kthetrat e gjithfarë mafiozëve dhe përfituesve të luftës, me të cilët vendi ishte i mbushur plot e përplot dhe mezi pritnin “që ata që nuk i pranonte lufta me arsytimin se u mungonte gatishmëria e konfrontimit me tradhtarët”, të merrnin përsipër “t’i rikthenin në Gjermani”, rrugë kjo që shumë të rinjve përgjithmonë ua kishte humbur gjurmët...

Organet gjermane të hetuesisë dhe ato policore, nga familjarë që kërkonin gjetjen e fëmijëve të tyre në Shqipëri ose gjetiu, kishin marrë shumë e shumë kërkesa, por edhe padi konkrete ndaj disa personave që ishin marrë me rekrutimin e të rinjve për luftë.

Psikiatri Rajan H., kishte mbledhur shumë e shumë rrëfime tronditëse të të rinjve që kishin kaluar nëpër ecejaket e luftës së Kosovës, por edhe të paraluftës (qëndrimit në Shqipëri), që del të kishte qenë një përzierje kriminale-mafioze ndër më të paparaturat deri më atëherë në ato anë, ku disa pacientëve nën tretmanin e mbikëqyrjes së mbyllur shumëvjeçare, krahas shumë e shumë fiksimeve makabre, në halucinacione u përvijohen edhe trafikantët e organeve njerëzore!

Kriminologu Marsel Z., pasi që kishte analizuar qëndrimet e sociologëve, psikologëve dhe shënimet e ndryshme të “përgjuesve” nga radhët e shërbimeve informative që kishin përcjellë nga afër ato që kishin ndodhur në Kosovë para dhe gjatë luftës, sillte disa konkluzione se shumë nga të rinjtë që kishin ikur nga Kosova gjatë viteve të dhunës policore, me vete kishin sjellë përjetimet e dhunës dhe të tmerrit, nga të cilat ata jo vetëm që nuk ishin çliruar, por te shumë prej tyre, ato ishin kthyer në fiksime negative, që kishin arritur deri te sindromi i krimit... Për të tillët, krimi, pa marrë parasysh ndaj kujt (e rëndësishme ishte mundësia për të), paraqiste një “çlirim”... Meqë shumë prej tyre, për arsye të ndryshme as që kanë qenë në gjendje të kenë kontakt me forcat policore dhe ushtarake serbe, “viktimën” e kishin kërkuar në radhët e veta...

Marsel Z., sjell si moto fjalët që i kishte thënë njëri nga pacientët e një klinike psikiatrike “kam ardhur për të vlarë dhe do të vras...”, me ç’rast ai shpjegon gjendjen mentale të atyre që krimi si hakmarrje u ishte kthyer në fiksim të pashërueshëm shpirtëror, ishin të motivuara drejtpërdrejt nga interpretimi i njëanshëm i atyre që ndodhnin në Kosovë. Kështu, pacienti 18 vjeçar N.Z., me prejardhje nga Drenica, sapo kishte shkuar në Serbicë (Skenderaj në shqip), i maskuar me syze dhe një kapuç të rrasur deri në qafë dhe armën e fshehur nën bluzën e trashë, kishte kërkuar gjellëtoren “Drenica” (në qendër) dhe pasi që kishte hyrë në të, kishte qëlluar në drejtim të një kamerieri që po shërbente. Bashkë me kamerierin kishte vlarë edhe dy mysafirë, të cilët kishin mbetur të përplasur me kokë mbi pjatat e groshës. Ishte larguar me klithjet “Vdekje Arkanit!...”

Kushërinjtë, që e kishin nxjerrë disi nga tollovia e krijuar dhe ia kishin dalë që t'ia humbnin gjurmët aty për aty, e kishin nisur për në Gjermani, madje duke kaluar nëpër Serbi, e kishin dorëzuar te familja.

Ndonëse në vendlindje ishte kremtuar “si atentator” i një “skuadre të UÇK-së” që kishte kryer një “urdhër për ekzekutim”, i shpallur prej kohësh ndaj pronarit të gjellëtores “Drenica”, ku muaj më parë, gjatë një fushate zgjedhore, komandanti i njohur i paramilitarëve serbë, Arkan, bashkë me paramilitarët e tij kishte hyrë aty dhe sipas propagandës serbe të plasuar edhe nëpër mediat perëndimore që i kishin bërë jehonë, kishte ngrënë groshë me “votuesit” e tij shqiptarë, familja e tij në Gjermani e kishte fshehur këtë fakt. I ati, hetuesve policorë, u kishte thënë se i biri, që kishte pasur probleme psikike (ndonëse kjo nuk ishte parë nga kartela e tij mjekësore), kishte humbur diku në një ambient të panjohur ku ishte rrëzuar dhe lënduar dhe kishte humbur madje edhe orientimin...

Por, i ati, që së paku përkohësisht kishte fshehur të vërtetën e qëndrimit të të birit në Kosovë dhe vrasjen e bërë në gjellëtoren e Serbicës (Skenderajt në shqip), nuk ia kishte dalë që ta shpëtonte të birin nga psikiatria, ku ai ishte dërguar me çrregullime të thella shpirtërore dhe kishte mbetur përgjithmonë si pacient me tretman të mbyllur, e as të vërtetën që kishte dalë nga rrëfimet e tij të thëna gjatë terapisë. Me atë rast ai kishte folur për fiksime të tij nga fjalët e të atit gjithë ulërimë për “tradhtarët” që duhet vrarë “për me ia zbardhë fytyrën Drenicës heroike”, pasi që në televizor kishte parë storjen e qëndrimit të Arkanit në vendlindjen e tij tek po hante groshë me disa bashkëvendës...

“Kreva urdhrin e tim et!...”

Klithmat e tilla, thotë kriminologu, kanë prodhuar vrasës.

“Kriminelët duhet kërkuar në radhën e atyre që i kanë ushqyer këto fiksime dhe i kanë drejtuar për interesa të caktuar, siç ishte likuidimi i kundërshtarëve politikë dhe ideologjikë gjatë luftës, të shumtën për të ardhur në pushtet, ose, si në rastin e vrasësit në gjellëtoren e Drenicës, për ta shëruar ndërgjegjen e papastër nga të qenit bashkëpunëtor aktiv i regjimit serb, siç del nga dosja e Shërbimit Informativ, për të atin e “atentatorit” të Drenicës, që pasi kjo i ishte bërë e ditur nga hetuesi gjerman i çështjes, për çka edhe e prisnin pasojat (anulimi i statusit të azilantit), kishte bërë vetëvrasje.

Duke u ndërlidhur me kërkesën e kriminologut Marsel Z., rreth përgjegjësisë penale ndaj atyre që kishin vepruar që të rinjtë të indoktrinohen me fiksime kriminale, politologu Matias R., i cili si reporter lufte një kohë të mirë e kishte kaluar në Kosovë para dhe gjatë ofensivës së forcave policore dhe ushtarake serbe gjatë verës dhe vjeshtës së vitit 1998, ndonëse do të duhej të jepte një përgjigje nga pragmatizmi politik i rrethanave, befason me qëndrimin se “historikisht, gjatë dy shekujve të fundit, Serbia ua ka përcaktuar shqiptarëve *heronjtë* dhe *tradhtarët* në përputhje me interesat e veta dhe se edhe këtë herë po ndodh kështu...”

Por, sipas politologut Matias R., “*heronjtë*” dhe “*tradhtarët*” të përcaktuar nga Serbia në përputhje me interesat e saja, kanë qenë antipode, meqë “*heronjtë*” kryesisht shfaqen si personalitete historike të dizajnuar nga Beogradi dhe propaganda e tij (feudalë konservatorë përkrahës të sulltanit, pastaj kaçakë, klerikë që kanë mbrojtur përkatësinë turke të shqiptarëve dhe të ngjashëm e deri te ata që kanë qenë bashkëpunëtorë të shërbimeve informative jugosllave) të cilët ndonëse shihen “edhe në luftë” kundër Beogradit, në të vërtetë, me veprimet e tyre gjoja “çlirimtare” mbrojnë pozicionet antihistorike në raport me çështjet

kombëtare, sidomos në prag të pavarësisë kombëtare dhe më vonë pas njohjes së shtetit shqiptar të përgjysmuar. Ndërsa si “*tradhtarë*” rëndom shfaqen intelektualët nacionalistë dhe gjithë ata luftëtarë, të cilët, në rrethanat vendimtare historike, interesat kombëtare i lidhnin me interesat gjeostrategjike dhe gjeopolitike në përputhje me programet kombëtare të dala nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, me të cilat iu vunë themelet Rilindjes Kombëtare.

“Shumë prej këtyre personaliteteve të rëndësishme të historisë shqiptare, që drejtuan lëvizjen kombëtare për pavarësi me moton e kthimit kah qytetërimi perëndimor, pas Konferencës së Londrës dhe vendimeve të saj të njohura, përkundër që u luftuan në mënyra të ndryshme dhe disa prej të cilëve edhe u vranë me perfiditet, propaganda e Beogradit, me gjithfarë shpifjesh dhe marifete të tjera, ia doli t’ua krijojë edhe anatemen e bashkëpunëtorëve të vet po edhe të qendrave të ndryshme europiane dhe si të tillë u shpallën edhe tradhtarë të çështjes kombëtare...”

Ishin ata kryesisht intelektualë dhe patriotë të devotshëm, që nuk u pajtuan me pushtimet serbe por as me një shtet shqiptar të përgjysmuar... Ishin po ata patriotë që dhanë aq shumë për pavarësinë e Shqipërisë, por shteti shqiptar i la pa atdhe. Ndërsa logjika e shtetit, me të cilën përballej Shqipëria (pranimi ndërkombëtarisht si dhe ratifikimi i kufijve me shtetet që kishin përfituar me copëtimin e saj), shumë prej tyre i ktheu në kundërshtarë të shtetit shqiptar (të Nolit apo të Zogut), që u vranë nga regjimet shqiptare në krye ‘të rebelimeve’ të kurdisura (Bajram Curri e të tjerë), ose vdekja i gjeti edhe jashtë, në migrim të dënuar nga gjyqet e Tiranës dhe ato të Beogradit njëherësh, siç ngjau me patriotin Hasan Prishtina...

Në këto rrethana Beogradi ia doli që lëvizjen irredentiste shqiptare të themeluar në vitin 1918 ta përçajë dhe një pjesë të mirë të veprimtarisë së patriotëve shqiptarë (luftën kaçake), ta drejtojë për qëllime të veta, siç ishin masat ‘hakmarrëse’, ofensivat policore-ushtarake kundër ‘kaçakëve dhe jatakëve të tyre’, që rëndom drejtoheshin kundër popullatës së pambrojtur, që për pasojë kishin shpërnguljen e detyrueshme të tyre për në Turqi dhe gjetiu...”

Duke mbrojtur qëndrimin rreth asaj se shqiptarëve Beogradi, por edhe të huajt, ua kanë caktuar gjithmonë “heronjtë” dhe “tradhtarët” si dhe fuqinë e këtij diskursi në sjelljen politike të shqiptarëve, e cila, me përjashtim të konceptit të Rilindjes Kombëtare, që ka qenë në përputhje me shqiptarizmin dhe interesat e tyre për shtet të pavarur dhe përkatësi perëndimore, përherë ka qenë në përputhje me interesat e huaja, të shumtën ato të Beogradit, Matias R., vlerëson se kjo ka përfshirë edhe gjithë zhvillimet politike nga lufta e dytë botërore e këndeje e deri te lufta e fundit.

“Beogradi ka përcaktuar rrugën e Shqipërisë kah Lindja si dhe mbetjen e saj në kthetrat e stalinizmit më të ashpër në Europë... Kjo u solli dëme të jashtëzakonshme shqiptarëve në Shqipëri, por edhe shqiptarëve etnikë në pjesët e ish Jugosllavisë (Kosovë dhe Maqedoni Perëndimore)... Enver Hoxha dhe lëvizja komuniste shqiptare fund e krye ishte e themeluar dhe e drejtuar prej jugosllavëve për interesat e tyre... Hoxha ishte një krijesë e Beogradit i kremtuar ‘hero’, që mbeti i tillë edhe atëherë kur pas rezolutës së Informbyrosë të vitit 1948 u prishën marrëdhëniet midis dy vendeve...”

Edhe pse në dukje të dy vendet komuniste ishin të papajtueshme dhe pareshtur zhvillonin propagandë të ashpër ideologjike kundër njëra-tjetrës, megjithatë, Beogradi bëri çmos që Hoxha të mbetej në krye të shtetit shqiptar si stalinist, ndërsa Shqipëria një Gulag trishtues europian...

Propaganda ideologjike midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, ndonëse me valë të ndryshme dhe pozicionime stalinizëm-antistalinizëm, ndikoi që në Kosovë të forcohet rryma enveriste, e cila i duhej si shumë Beogradit për qëllime të ndryshme, siç i duhej edhe Bashkimit Sovjetik për ndonjë fesat për ndërhyrje në të dy vendet për t'i rikthyer nën tutelën e Moskës.

Në këto kushte, nga ilegaliteti, shfaqet edhe lëvizja revolucionare për bashkim me Shqipërinë, që nuk ishte tjetër pos formë e përsëritur e irredentizmi ideologjik, sipas recetave internacionaliste në kuadër të doktrinës së njohur ideologjike për “vetëvendosjen e popujve” brenda kampit socialist... Shumë nga patriotët shqiptarë që nuk u pajtuan me realitetin e ndarjes shqiptare, ranë pre e këtyre klisheve ideologjike... Të tillët duhet kuptuar, por assesi të stigmatizohen ideologjikisht, por as të kremtohen si nacionalistë!

Formula e irredentizmit ideologjik, Enverin e ktheu në ‘hero’ gjithëshqiptar...

Ky absurditet duket tepër i pakuptueshëm, kur mbusheshin burgjet me të burgosur politikë shqiptarë dhe kjo dukej se rëndonte edhe më shumë raportet e të dy vendeve deri aty sa të shiheshin në një gjendje të përhershme lufte. Por, del fare i kuptueshëm kur shihet në përputhje me politikën e Beogradit që shqiptarëve t'u përcaktohen heronjtë dhe tradhtarët sipas interesave jugosllave...

Pra, kur mungonte çfarëdo fryme nacionaliste dhe demokratike, ngaqë ato ishin shuar me gjak gjatë dhe pas luftës (rasti i Nacionaldemokratikes shqiptare NDSH), “heronjtë” e rinj të shqiptarëve shfaqeshin enveristët dhe stalinistët nga lëvizja e ilegalitetit, të cilëve në vitet e shtatëdhjeta dhe ato të tetëdhjeta, me propagandën e tyre enveriste-staliniste, do t'ua mbajnë ison grupet e emigrantëve politikë në perëndim (Gjermani, Belgjikë dhe Zvicër).

Të fiksuar nga ideologjia si dhe kornizat e saj ku duhej kërkuar hapësirë “për interesat kombëtare”, me dashje apo pa dashje, të tillët ishin kthyer në agjitorë të Enver Hoxhës dhe të regjimit të Tiranës prej nga ata i merrnin qëndrimet e gatshme që duhej të kishin karshi ngjarjeve në Kosovë, siç ishte ajo rreth kërkesës për Republikën e Kosovës në përbërje të federatës jugosllave, e manifestuar në demonstratat e mëdha shqiptare në Kosovë gjatë nëntorit të vitit 1968 dhe e rishfaqua në demonstratat e vitit 1981.

Kërkesa për Republikën e Kosovës, e dalë nga inteligjencia shqiptare në Kosovë dhe e pranuar nga pjesa më e madhe e shqiptarëve dhe si e tillë e kthyer në një moto të kërkesave të tyre politike për barazi, fillimisht nuk u pranua nga enveristët shqiptarë, meqë, siç thoshte Enveri ‘ajo ishte karrem i titistëve kundër shqiptarëve dhe kundër Shqipërisë’...

Më vonë, pas ngjarjeve të vitit 1981, kur u pa se Kosova nga unitaristët serbë dhe nga sovjetikët dëshirohej të shfrytëzohej si karrem për një konflikt të ri, në të cilin do të përfshiheshin Beogradi dhe Tirana, që për ta fashitur, do të ndërhynte Moska, me çka ajo rikthente Shqipërinë në Paktin e Varshavës, por edhe Jugosllavinë e pas Titos e largonte nga lëvizja e mosinkuadrimit ku ajo kishte një vend udhëheqës për në kampin socialist gjithnjë në përputhje me doktrinën e Brezhnjevrit rreth sovraniteti të kufizuar, pra kur pa se ku po çonin këto zhvillime prej nga ai mund të dilte humbës i dyfishtë, Enver Hoxha përkrahu kërkesën për Republikën e Kosovës duke e quajtur atë ‘të drejtë të pakontestueshme të shqiptarëve të Kosovës për barazi’.

Por, edhe kthesa për Republikën e Kosovës në përbërje të federatës jugosllave, u kushtëzua me ideologjinë staliniste. Kjo kërkesë duhej të kthehej në armë të re të përkrahësve të tij në Jugosllavi...”

Politologu Matias R., nxjerr përfundimin lapidarik “se socializmi liberal titist, i përkratur shumanshëm në botë, në Kosovë dhe pjesët e tjera të Jugosllavisë ku banonin shqiptarët, përkundër faktit se nga viti 1968 dhe veçmas me ndryshimet kushtetuese të vitit 1974 Kosova faktikisht doli nga tutela serbe dhe u pozicionua në federatë dhe filloi të ndërtojë institucionet kombëtare (universitetin në gjuhën shqipe, akademinë e shkencave dhe arteve, institutet hulumtuese shkencore, veprimtarinë botuese si dhe institucionet e kulturës: tetarin, filmin, baletin, operën dhe të tjera), pati për alternativë enverizmin stalinist...”

“Një fatalitet për shqiptarët, sipas skenarit të Beogradit, me ç’rast stalinistët dhe enveristët u kthyen në ‘heronj’, ndërsa intelektualët që themeluan institucionet kombëtare në Prishtinë gjatë viteve të shtatëdhjeta dhe të tetëdhjeta dhe ia dolën që të afirmojnë idenë për barazi në federatën jugosllave, u shpallën ‘tradhtarë’...”

Ai thotë se ishte karremi serb për “heronjtë” dhe “tradhtarët” që funksionoi edhe në luftën e fundit deri aty sa që kjo t’ia përcaktojë edhe profilin politikës së ardhshme.

“Në Kosovë Perëndimi fitoi një luftë gjeostrategjike, e cila me fitoren e enveristëve dhe neostalinistëve ndaj intelektualët properëndimorë që ia vunë themelet shtetësisë së Kosovës si dhe ardhjen e tyre në pushtet, rrezikon një humbje gjeopolitike?...”

Edhe pse kishte disa mospajtime midis vlerësimit të politologut Matias R., dhe sociologut Sigfrid S., ku ky i fundit, anatemën “*heronj - tradhtarë*” e vendoste në një kontekst më të gjerë socio-historik, duke e ndërlidhur me normat e kanunit dhe me faktorët e tjerë, megjithatë, të pakontestueshme mbeteshin qëndrimet e Matias R., rreth ndikimit të enverizmit në lëvizjen ilegale të Kosovës menjëherë pas luftës e deri në vitet e shtatëdhjeta si dhe irredentizmit ideologjik, që i parë nga këndvështrimi i fakteve të shërbimeve informative perëndimore, shpjegohej lehtë me konceptin e Serbisë, që ngritja e Kosovës në nivel të federatës jugosllave siç ndodhi me ndryshimet kushtetuese të vitit 1974 si dhe forcimi i subjektivitetit të saj ekonomik, arsimor, kulturor dhe në fushat e tjera, ku shqiptarët nga pakica kombëtare u ngritën në një faktor të rëndësishëm etnik me fuqi politike, duhej të pengohej e madje edhe të luftohej me “alternativën” enveriste-staliniste, siç ndodhi nga viti 1981, siç do të ndodhë edhe gjatë luftës së fundit...

“Nëse shumë indikacione flasin për atë se fitili i demonstratave të vitit 1981 u ndez nga Beogradi, me çka i krijoheshin rrethanat për ta filluar procesin e rrënimit të rrugës së Titos e me këtë të merrnin frenat e një Jugosllavie sipas interesit serb, siç u pa edhe nga puçi i Millosheviqit ndaj Kushtetutës së vitit 1974, si dhe sistemi i gjithëmbarshtëm federativ, atëherë është fare afër mendsh se po kjo linjë, inicioi dhe drejtoi raportet e brendshme shqiptare midis lëvizjes institucionale të drejtuar nga intelektualët më të njohur të vendit që krijuan shtetin paralel dhe forcave majtiste nga lëvizja ilegale marksiste-leniniste brenda dhe jashtë vendit, në dobi të këtyre të fundit, aq më tepër kur kjo luftë e përgjakshme vendosej në Shqipëri, ku sekush mund të gjuante gurin dhe të fshihte dorën pa ndonjë vështirësi, e ku këta të fundit, kishin përkras të natyrshëm ideologjikë por edhe aso që Kosovën dëshironin ta mbanin plaçkë të politikës së Tiranës për kusuritje me Beogradin dhe të tjerët...”

Këto vlerësime politologu Matias R., i mbyllte me përfundimin se siç kishte ndodhur në fund të luftës së dytë botërore, kur Beogradi kishte caktuar fatin e shqiptarëve, ndonëse këtë herë, në sajë të rezistencës së atjeshme po edhe të ndërhyrjes së armatosur të NATO-s, e humbi Kosovën, megjithatë, Serbia në formë të ndryshme, ruajti ndikimin mbi një spektër të

caktuar të forcat politike të atjeshme, shumë prej të cilëve mbesin pjesë e “Dosjes së fshehur” të Beogradit prej nga edhe u drejtuan dhe mund të drejtohen gjithnjë...

Edhe pse marrja me vlerësimet e sociologëve, psikologëve, politologëve dhe kriminologëve gjermanë, sikur dukej se më kishte larguar paksa nga përqendrimi të “*Dosja B*”, megjithatë ajo po m’i rikthente në kokë ato që m’i kishte thënë im atë gjatë takimit të fundit, por edhe ato që herë pas herë më vinin nga ai në adresën e internetit, rreth kurthit të religjionit (fundamentalizmit islamik) si dhe ideologjisë si një mjet të përshtatshëm që Beogradi e kishte përdorur kundër shqiptarëve gjatë shekullit të kaluar, që duhej pasur parasysh në të gjitha rastet, meqë ai paraqet mallkimin kryesor të një fatkeqësie të përsëritshme nga duhet kërkuar të gjitha përgjigjet qofshin ato edhe që nuk lidhen drejtpërdrejt më të.

Me atë përshtypje iu ktheva edhe shënimeve të agjentëve gjermanë (T.B.) dhe (N.H.) që po atë mbrëmje i nxora nga moria e letrave të shumta që kisha me vete.

Por, letrat e agjentëve gjermanë (gjithsej 53 faqe në A-4, bashkë me disa skica dhe fotografi të pamjeve të ambientit që lidhte Malishevën dhe kalimet nga ana e Përdrrinit dhe e Carralevës), me shënimet hyrëse, nuk lenin përshtypjen se aty mund të kishte diçka tronditëse, që mund t’u shkonte hetimeve rreth veprimtarisë së Vrasësit të Penduar gjatë luftës, gjë që disa edhe i kapërceja pa ndonjë përqendrim. Kështu ndodhi deri te faqja 32, kur agjentët gjermanë, pas përshkrimeve të hollësishme rreth gjendjes së rëndë humanitare në pjesën e Carralevës me shumë e shumë katunde të djegura, popullatë që zhvendosej nga njëra pjesë e vendit në tjetrën duke kërkuar strehim të përkohshëm, gjatë qëndrimit të tyre disaditorë në trekëndëshin Shtimje - Lipjan - Drenicë ku ishin përqendruar te disa biseda me banorët e atyshëm, ku vëmendja kthehej te zhdukja e disa personave, gishti drejtohej kah një “komando vendore”, e cila asokohe, kidnaponte “persona të dyshimtë”.

Siç del nga shënimet vijuese të agjentëve gjermanë (T.B.) dhe (N.H.), “shpërqendrimi” i tyre nga ofensiva policore-ushtarake serbe në drejtim të Drenicës dhe në Dukagjin (pasi që ata prapë do t’i kthehen asaj pjese), dhe përqendrimi “i përkohshëm” në këtë pjesë, vinte nga një ndalim rasti në Qendrën Psikiatrike të Shtimjes, ku duhej të lenin disa dërgesa me ilaçe si dhe të shihnin nevojat e tjera të kësaj qendre, e cila, ishte e vetmja, që gëzonte “njëfarë azili” të përgjithshëm, ku nuk futeshin as “pushtuesit” serbë e as “çlirimtarët” shqiptarë, gjë që kishte ndikuar që me të çmendur të përziheshin edhe të tjerë që kërkonin njësoj shpëtim nga të dy anët...

Ndër të tillët del të kishte qenë edhe një grua nga rrethina e Lipjanit, e cila kishte kërkuar të bisedonte me misionarët gjermanë për një hall që kishte. Gruaja e shthurur ngaqë askush nuk ia vinte veshin (madje edhe ishte kërcënuar që ta mbyllte gojën), kishte thënë se i shoqi, gazetari i “*Rilindjes*”, ditë më parë, ishte ndaluar në rrugë e sipër për në rrethinë të Lipjanit, nga tre persona, që i kishin thënë se kishin urdhër ta dërgonin te Komandanti vendor, me arsyetimin se duhej të bisedohej rreth një informate të gazetës. E shoqja thoshte se kjo ndalje, që ajo e quante kidnapim, ishte përcjellë nga një fqinjë i saj i parë, i cili kishte qëlluar aty, i strehuar.

Edhe pse me Komandantin vendor nuk ia kishte dalë të takohej, megjithatë, nëpërmes një kushëriri të largët, nga ai kishte marrë një posi me të cilën i bëhej me dije se “me gazetarin kishte biseduar rreth një shkrimi në gazetë” dhe “pas asaj bisede ai kishte qenë i

lirë”. Kushëriri, që ia kishte sjellë porosinë e Komandantit vendor, i kishte thënë se rasti do të hetohej, por duhej pasur parasysh se në atë kohë lufte njeriu shkon si qeni në rrush...

Nga shënimet e agjentëve gjermanë del se ata, pasi që i kishin ndihmuar bashkëshortes së gazetarit të zhdukur, që të kthehej te fëmijët (kishte vajzën dy vjeçe dhe djalin e sapolindur), ajo u kishte thënë se i shoqi kishte me vete edhe një *“Ditar lufte”*, që vazhdimisht e mbante në trup, gjë që sipas saj, kjo mund të kishte qenë arsyeja kryesore që mund t’i ishte kthyer në kob. Ajo u kishte treguar edhe për lidhjet e tij me misionarë dhe gazetarë të huaj që vazhdimisht e takonin sapo kthenin në atë pjesë, po edhe në Prishtinë. Agjentët gjermanë, pastaj kishin biseduar me fqinjin e saj, i cili u kishte dhënë disa informata të rëndësishme rreth identitetit të kidnapuesve si dhe veprimtarisë së tyre në ato anë, që përcillej me shqetësim.

Kështu, në shënimet e fundit agjentët gjermanë sillnin edhe disa të dhëna të tjera rreth gjashtë personave të zhdukur (të kidnapuar nga *“komando vendore”*, ku bënte pjesë edhe Vrasësi i Penduar), fati i të cilëve nuk dihej. Po ashtu, agjentët gjermanë bënë të ditur se *“Komando vendore”* kishte ndaluar *“përkohësisht”* shumë persona në atë anë, disa prej të cilëve ishin keqpërdorur fizikisht, siç del se ata kishin mbledhur edhe haraç nga shitësit dhe tregtarët e kërcënuar me armë, disa prej të cilëve, bashkë me familje ishin shpërngulur në drejtim të Maqedonisë. Pra, për agjentët gjermanë të maskuar si misionarë, *“Komando vendore”* për nga sjelljet, nuk paraqiste tjetër pos një pjesë të zullumit, që banorëve të kësaj ane u kishte ardhur pasi që trupat serbe dhe njësitë paramilitare ishin larguar përkohësisht në marsin e vitit 1998 për t’u kthyer në nëntor të atij viti.

Dikur vonë u ndava nga shënimet e agjentëve gjermanë. Rasti i gazetarit të *“Rilindjes”* dhe zhdukja e tij shfaqeshin si pikë kyçe, prej nga duhej t’ia nisja hetimit rreth veprimtarisë së Vrasësit të Penduar gjatë luftës. Njoftimi për *“Ditarin e luftës”*, që e kishte mbajtur me vete, gjithë çështjes i jepte një dimension shumë më të thellë, meqë mund të ishin pikërisht të dhënat në të, si motiv qendror për kidnapimin dhe zhdukjen e tij?... Aq më tepër kur dihet se për shkak të informatave që kishin rreth atyre që kishin ndodhur para dhe gjatë luftës në të gjitha skutat e vendit si dhe lidhjeve me burimet e brendshme dhe të jashtme, disa gazetarë të *“Rilindjes”* (kryesisht korrespondentë vendorë) kishin qenë në shënjestër të faktorëve të ndryshëm të përfshirë në luftë. Kështu, katër prej tyre ishin vrarë gjatë luftës dhe tre të tjerë menjëherë pas luftës. Këto vrasje kishin mbetur të pasqaruara, por gjithnjë me dyshimin e hapur se në to, sado që nuk përjashtohej edhe roli i gishtave të shërbimeve informative të Beogradit, kishin marrë pjesë grupe nga *“shërbimet speciale”* që operonin nën firmën e UÇK-së.

Ky dyshim, madje, rritej edhe më shumë nga vetë dëshmitë e disa komandantëve dhënë hetuesve të UNMIK-ut (me rastin e mbajtjes së dy proceseve ku ishin dënuar nën akuzën e *“ndalimit të paligjshëm dhe keqtrajtimit të qytetarëve”*), e më vonë edhe para hetuesve të Tribunalit të Hagës, ku ishte pranuar *“ndalimi i disa qytetarëve me dyshimin se kishin bashkëpunuar me armikun”* si dhe *“mbajtja e përkohshme”*, por që përgjegjësia për zhdukjet dhe vrasjet, gjithnjë ishte bartur te persona të tjerë (roje burgjesh, kujdestarë e të tjerë), dëshmitë e të cilëve kishin munguar, ngaqë ata ose ishin vrarë gjatë luftës, ose pas saj në mënyra tepër të dyshimta, veçmas kur ata përgjoheshin nga hetuesit ndërkombëtarë.

Por, deklaratat e Vrasësit të Penduar për gazetarin e “*Rilindjes*” si dhe disa të ngjashme çështjet i kthente te pika ku ato duhej të sqaroheshin. Mendja me shkoi te “*Ditari i luftës*”, që ruante të fshehtat e mëdha, që gazetarit iu kishin kthyer në kob.

Kisha bindjen se nëse autori i tij nuk i kishte shpëtuar vdekjes, ditari, herdokur do të dalë...Sepse, fjala është e pavdekshme...

Ato çaste në mua po fliste moralisti dhe jo hetuesi...

### **“Koha e vdekjes”**

( Diku në Norvegji - “ *Fletëza nga Ditari i Dushkajës*” )

Në verandën e madhe të shtëpisë së drunjtë, me pamje nga deti, shikimi përhumbej në pikën që lidhte kaltërinë e ujit me peizazhin e bjeshkëve gri e natyrshme për një ambient verior. Dukej se edhe rrezet e diellit të shndritshëm të atij shtatori duhej t’i ndihmonin asaj pamjeje, e cila mund të përjetohej vetëm në rrethana të tilla.

Për Besim L. dhe familjen e tij (bashkëshorte dhe tri vajzat) të vendosur prej më shumë se një viti në pjesën e një fjordi të strukur, shtëpia e shkëputur paraqiste kufijtë e një bote në dukje të qetë, por të mbyllur dhe të rrudhur nga brenda me ankthe të pandalshme, që nuk i largonte as largësia e as harresa më e thellë.

Besim L., e kisha takuar në ditët e fundit të shtatorit të vitit 1998, në udhëkryqin midis Klinës dhe Prishtinës gjatë një vëzhgimi njëditorë në pjesët e Drinit në prag të përfundimit të ofensivës së verës dhe vjeshtës të forcave policore dhe ushtarake serbe ndaj UÇK-së. Zyrtarët serbë bashkë me disa vëzhgues ndërkombëtarë na kishin ftuar në ato pjesë për të parë, siç thoshin pareshtur, gjendjen e rëndë të popullatës shqiptare pas çlirimit nga “terroristët shqiptarë”, siç i quanin kryengritësit shqiptarë. Në atë pjesë, të rrethuar me autoblanda ushtarake si dhe njësi të shumta këmbësorie, që edhe më tutje lëviznin në drejtime të ndryshme duke vringëlluar armët, rrinin kruspull shumë qytetarë (disa qindra, kryesisht gra, fëmijë dhe të moshuar) me plaçka në duar dhe pamje të tmerrit në fytyrë. Kishte edhe të plagosur, për të cilët përkujdesej një ekip sanitar i Kryqit të Kuq ndërkombëtar. Ekipi ynë, po ashtu, ishte aty që të njoftohej me gjendjen e tyre, në mënyrë që pastaj të kyçej, si thuhej në marrëveshjet me qeverinë e Beogradit, në rehabilitimin mental dhe material të tyre. Sipas kësaj marrëveshjeje, krahas ndihmës shëndetësore në vend, asaj humanitare në ambientet e tyre të banimit (po qe se ato ishin dëmtuar gjatë veprimeve të domosdoshme ushtarake në përndjekje të terroristëve dhe për to jepeshin leje nga autoritetet zyrtare), ekzistonte mundësia edhe për “dërgimin e përkohshëm” të personave të caktuar jashtë vendit për trajtime të veçanta shëndetësore gjithnjë në bashkëpunim me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar si dhe përfaqësuesit e Komitetit Ndërkombëtar për Refugjatë me qendër në Shkup, të cilët merrnin përsipër procedurën e migrimit të përkohshëm.

Në ato rrethana, ndonëse kishim pak kohë, duhej të merreshim me vlerësimin e gjendjes shëndetësore (kryesisht mentale) si dhe asaj sociale në mënyrë që të nxirrnim një përfundim rreth ndërhyrjes sonë humanitare aty.

*Edhe pse ishte e qartë se Beogradi aty kishte përzgjedhur shumë nga viktimat e ofensivës policore-ushtarake që t'i paraqiste si viktimat të "terroristëve shqiptarë", megjithatë, ishte gjendja e papushtetshme ose me pushtet të më të fortit, pra të atij që mbante armën, në ato pjesë të vendit, që prej kohësh ishte kthyer në terror të njëmendtë.*

*Nga bisedat sado të shkurtra me qytetarët e mbledhur në kampin e hapur policor-ushtarak të Klinës, fitohej përshtypja se aty kishte pasur brutalitet, vrasje dhe madje edhe dhunime, që u shkojnë gjendjeve të tilla...*

*Kjo ishte edhe e pritshme në ato rrethana.*

*Megjithatë, në atë mori të fatkeqëve, shumë prej të cilëve, të tmerruar as që ishin në gjendje t'i mbikëqyrnin mendimet dhe as fjalët, ishte njëri thuajse i shkalluar fare, që pareshtur çirrej me fjalët në gojë për vrashtarët dhe vrasjet që nuk kishin fund...*

*"Të gjithë janë vrashtarë!..."*

*I shkalluari quhej Besim L. Zyrtarët serbë na njoftuan se fjala ishte për një agronom të njohur, drejtues i disa plantacioneve të kombinatit bujqësor në pjesën e Dushkajës, ndër më të mëdhatë e vendit për prodhimin e mollëve, rrushit, qershive, kajrive, pjeshkave...*

*"Ja kanë dhunuar tri vajzat dhe i kanë hedhur në liqen... Por, nuk janë kënaqur me aq... Së fundit i kanë hyrë edhe në shtëpi që t'ia dhunojnë edhe gruan dhe tri vajzat e mitura..."*

*Zyrtari serb tha se, si çdo njeri që mbron familjen, edhe agronomi, kur kishte parë se terroristët, pasi që ia kishin dhunuar gruan, po u afroheshin edhe vajzave të mitura, e kishte kapur armën dhe kishte shkrepur në drejtim të dhunuesve. Me këtë rast kishte vrarë dy prej tyre, ndërsa të tretin, në ikje e sipër e kishte plagosur...*

*Ndërsa zyrtari serb po fliste për dhunuesit nga radhët e "terroristëve", një polic solli një dosje, nga e cila nxori disa foto, ku shiheshin dy të vrarë, me maska, identiteti i të cilëve jepej vetëm me iniciale, si tha për arsye sigurie.*

*"Fjala është për një grup terroristësh, të njohur për organet tona, që ka operuar prej tre muajsh nëpër Dushkajë, duke terrorizuar qytetarët e pafajshëm, duke kërkuar të holla në emër të luftës... Të tillët, hynin nëpër shtëpi, silleshin me brutalitet ndaj atyre që nuk bashkëpunonin me ta dhe ky bashkëpunim do të thoshte nënshtrim i plotë urdhrave të tyre, me ç'rast ata, krahas plaçkës në emër të luftës, vinin në shënjestër vajzat, të cilat kërkonin t'i mobilizonin 'për luftë', shumë prej të cilave pastaj shfrytëzoheshin për prostitucion jashtë vendit...Ato që nuk pranonin këtë farë lloji 'mobilizimi', dhunoheshin haptas, pos dikush ua ngjiste dorën, siç ndodhi me vajzat e agronomit..."*

*Pas atyre që zyrtari serb dhe përfaqësuesi i policisë rajonale i thanë për të pranishmit rreth "terroristëve" si dhe viktimave të tyre të shumta, ku kishte edhe disa reporterë nga agjencitë e njohura botërore (BBC dhe CKN), dukej sheshazi se rasti i Besim L., ishte përzgjedhur që t'i shërbente propagandës së Beogradit që në njërin të arsyetonte përdorimin e fushatës së armatosur "në mbrojtje të popullatës së pafajshme nga terroristët" dhe në tjetrën anë të aktronte humanizmin ndaj viktimave, siç ndodhi me Besim L., dhe familjen e tij që aty për aty iu lejua "mundësia" e migrimit "të përkohshëm" jashtë vendit për arsye humanitare... Në ato rrethana tepër të rënda, kjo na ngushëlloi paksa, ngaqë së paku dikujt, do t'i ndihmohej të largohej nga rrethi tragjik i luftës, ku kishte vetëm viktimat të pafajshme... Po atë ditë (diku në orët e vona të natës), në hyrje të Shkupit Komisionit Ndërkombëtar për Refugjatë si dhe Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, ua dorëzuam Besim L. dhe familjen e tij.*

Bashkë me dy përfaqësues të Kryqit të Kuq në Prishtinë (një mjeke gjermane dhe një psikiatër suedez), u përkujdesëm që ai udhëtim të dukej si pjesë e ndonjë shpëtimi, sado që kësaj nuk i besonte bashkëshortja Drita e shkallmuar fare, që mundohej të mbahej paksa para vajzave të mitura, ndërkohë që Besim L., vazhdonte të mbetej në gjendjen e shkalluar gjithnjë me çirrjet për botën vrastare dhe vrastarët që i shihte gjithkund, që dukeshin edhe si lutje për shpëtim... Para se t'i afroheshim kufirit, Drita, nga trupi nxori një qese dhe ma dha thuajse fshehurazi. Nuk tha tjetër pos nisi të qante me një dënesje tepër të mundimshme, që mundohej ta mbante brenda para vajzave të trishtuara...

Hetova se qesja kishte disa letra ose dokumente, gjë që me të shpejtë i futa në pjesën e trupit...

Ashtu i mbajta gjatë gjithë rrugës. Vetëm pasi hyra në dhomë dhe e kyça derën disa herë, nxora qesen dhe e hapa. Ishin disa fletë të shkëputura me titull **“Ditari i Dushkajës”**.

Nën tryshninë e çirrjeve “se bota është vrastare”, se “vrastarët ishin ngado”, të cilat nuk po më shqiteshin nga mendja, bashkë me pamjet e trishtuara të vajzave të mitura të cilat kur i dorëzuam në anën tjetër të kufirit dukeshin edhe më të shkallmuara, kalova nëpër ato pesëdhjetë e sa fletë të shkëputura, të cilat mbylleshin me fjalët:

“Kjo botë është vrastare... Vrasësit janë ngado dhe të përhershëm... Nuk ka shpëtim prej tyre...”

Fjalët për botën vrastare dhe për vrasësit e përhershëm, Besim L., po i thoshte edhe në Norvegjinë e largët. E gjeta në të njëjtën gjendje, siç e kisha parë në shtatorin e vitit 1998, në kampin policor-ushtarak në Klinë...

### **“Ditari i Dushkajës”**

1.

*Pranverë e vitit 1998, diku në Dushkajë...*

Në fillim ishte dimni i fortë që na mbajti të shkëputun nga bota jonë e rrudhun në hapësinën midis Sukës dhe Liqenit...

Syni i pranverës jo vetëm që nuk na e ktheu pjesën tjetër të botës me të cilën gjithnjë ishim të lidhun, por nisi me na e vu dhunshëm rrethin e mbylljes... Kjo u pa, në njanën anë (në drejtim të Sukës) me vendosjen e postbllokut të policisë serbe, që u kthye në të përhershëm, ndërsa në tjetrën anë (në drejtim të Sukës), ishin njerëzit me maska që shfaqeshin papritmas dhe vendosnin për lejen e qarkullimit... Në mes të këtyne pikave, mbetej Liqeni i hapun, si mundësia e vetme për me e kalue rrethin e mbylljes... Por, kalimi nëpër të ishte fare i paparashikueshëm dhe me rreziqe të panjohuna, ngase nuk dihej se kush kishte pushtet mbi të...

Sidoqoftë, jeta vazhdonte dhe ne duhej me iu përshtatë rrethanave... Por, e keqja e kësaj përshtatje ishte se në pjesën tonëtashma nuk kishte pushtet, qoftë edhe ai i “shtetit paralel” me të cilin ishim mësue prej vitesh, ngaqë gjithë ata që ishin përfshi në të ndiqeshin herë nga patrullat e policisë serbe, e herë nga grupe të armatosuna e me maska, që thoshin se ishin pjesëtarë të UÇK-së, dhe po ashtu ndiqeshin edhe nga grupe të armatosuna, që ndonëse

për nga uniformat dukeshin sikur paramilitarë serbë, flisnin shqip dhe thoshin se u takonin “*Njësitë të vetëmbrojtjes vendore*” nga Oseku, që i komandonte njëfarë Mushk Jakupi.

Këta të fundit, madje, thoshin se do të rikthenin “pushtetin lokal në përputhje me vullnetin e popullit që do të shprehej në zgjedhjet e lira”, të cilat “do të mbaheshin së shpejti...”

“Këtu nuk do të ketë ma as pushtet të Rugovistëve, as të UÇK-së e as të ndonji grupi tjetër terrorist... Do të ketë pushtet të popullit të lirë...”

2.

*Pranverë e vitit 1998, diku në Dushkajë...*

Nga pjesa e Sukës së Hereqit erdhën të shtënat e para, të cilat u përsëritën disa herë gjatë ditës...

Kjo bante me dije se tashma luftën e kishim në mesin tonë, siç e thoshin ata që herë pas herë shfaqeshin me maska dhe flisnin për të si për çashtje të pashmangshme...

“Pa luftë nuk hiqet shkau...”

Fjalët për luftën e pashmangshme dhe shkaun, që thoshin se e do vetëm plumbin shoqëroheshin me ato për “tradhtinë” e rugovistëve. Edhe atyne u lidhej plumbi për kokë, si hakmarrje...

Disa, madje, thoshin se plumbi i parë është për rugovistët, ndërsa i dyti për shkijet...

Se dikush e kishte përnjëmend kur fliste kështu, kjo u pa me kidnapimin e dy aktivistëve të ditëve të para të Lidhjes Demokratike të Kosovës G. Z., dhe C. Y., arsimtarë në shkollën fillore në Dushkajë, për të cilët thuhej se me nga një gurë të lidhur për qafe ishin hedhur në Liqe...

3.

*Pranverë e vitit 1998, diku në Dushkajë...*

Të shtënat e armëve u ndëgjuen edhe nga ana e Liqenit... Nga mbramja, ato u shoqnuen edhe me hedhje predhash nga maja e Sukës, kuishin njishtë tankiste si dhe ato raketore të armatës jugosllave. Nga aty mbikëqyrnin gjithë Dushkajën dhe Dukagjinin dhe ishin në gjendje me rrahë çdo pikë në çdo kohë deri në Qafë të Morinës dhe në Bitesh të Deçanit...

Fuqinë e tyre e treguen valët e Liqenit, që erdhën të fryeme si kurrë ma parë në pjesën lindore deri te vneshtat, ku nxorën shumë peshq të ngordhun...

Atë natë pati prani të madhe të “*Njësitë vendore*” (paramilitarëve të Mushkit nga Oseku), që vepronin në kuadër të atyre serbe... Me disa autoblinda, me flamujt e Serbisë dhe atë kombëtar shqiptar, u vendosën para kafesë “Liçeni”...

Ndezën një zjarr të madh dhe iu shtruan pijes...

Në mëngjes, lanë gjurmët e zjarrit të shuem dhe shishet e birrave “Peja” të shpërndame gjithandej...

4.

*Pranverë e vitit 1998, diku në Dushkajë...*

Nga mesdita, një autoblindë e policisë u ndal para shtëpisë sime... Ishin dy veta, pa armë, që po më kërkonin...

Ime shoqe (Drita) zuni me u dridhë. Më përcolli deri aty ku po më pritnin ata me veshin cingare për me marrë vesh çfarë po kërkonin prej meje...

Policët më thanë se më kërkonin në Drejtorinë e Kombinatit, dhe se ishin aty për me më shoqnue dhe me më sigurue në të dy drejtimet.

Sime shoqe i thashë se nuk duhej me u brengosë...

“Vneshtat nuk dinë politikë e nuk njohin as luftë, por donë vetëm hyzmet...”

Kishte kohë që nuk kisha kalue rrugës që për vite e baja çdo ditë. Mbasi kaluem pjesën e digës së madhe si dhe kodrinën që zbriste nga Radoniqi, u ndalëm te Drejtoria e Kombinatit.

Vendi dukej i shkretë... Disa makina bujqësore si dhe pajisje të tjera në parkingun përballë jepnin për me kuptue se aty thuejse nuk punohej.

Megjithatë, mbrenda kishte njëfarë gjallnie. Drejtori i dhunshëm, që sapo kishte ardhë, (një inxhinier agronomie nga Leskovci dhe disa bashkëpunëtorë të tjerë), më pritën mirë. Ma bani me dije vendimin e politikës, por edhe faktin se kombinati duhej me u mbajtë gjallë ngaqë, si tha, na ushqente...

Më tha se të gjithë punëtorët e përhershëm, që ishin në pushim dimnor, dhe ata të përkohshmit, që fillonin punën nga pranvera e deri në vjeshtë, duhej të thirreshin në punë. Shtoi se do të marrin pagat simbas vendimeve të maparshme me të gjitha të drejtat që ua garanton ligji i punës.

“Jam përkohësisht këtu, i emnuem nga politika. Por, ju që keni ngrit këto plantacione, edhe ma tutje, me të gjitha kompetencat profesionale, duhet me vazhdue me i drejtue ato siç keni ba edhe ma parë...”

Desha me i thanë se ai dimën dhe pranvera kishin sjellë shumëçka që munden me ndikue edhe nëpunën e kombinatit (mendjen e kisha te fillimet e luftës si dhe te shfaqja e grupeve të ndryshme të armatosuna), por ishte ndërhyrja e tij e shpejtë me të cilën ai preku telin që doja me e rrahë...

“Na do ta shikojmë punën e tokës dhe të bukës, e shteti të sigurisë...”

5.

*Pranverë e vitit 1998, diku në Dushkajë...*

Lufta po i afrohej gjithnjë e ma shumë pjesës sonë... Luftimet e herë mbas hershme nisnin nga ana e Sukës së Hereqit dhe përhapeshin deri te pjesa e Liqenit... Flitej se luftimet po përhapeshin edhe në pjesën e epërme të Rekës dhe shkonin deri te kufini... Një mbramje, u pa edhe një togë e UÇK-së që kaloi nga pjesa e digës në drejtim të Sukës së Cërmjanit... Mbas pak erdhën dy ushtarë (pa maska) që më kërkuen... Ishin të sjellshëm, sado që dukeshin të frikësuem...

Në afërsi të digës më priste njani, që tha se ishte komandant i njësitit të UÇK-së nga radhët e Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK), që tashma gjendeshin në Dukagjin, të përfshirë në luftimet për të cilat tha se po zhvilloheshin me sukses, edhe përkundër vështirësive.

Për Kolonelin dhe oficerët e shumtë shqiptarë të shkapërderdhun nëpër luftat që zhvilloheshin në Kroaci dhe Bosnje e Hercegovinë pas agresionit të Beogradit ndaj këtyne vendeve që kishin shpallë pavarësinë, kisha ndëgjue shumë herë.

Sikur ta kishte pritë atë takim prej kohësh, Koloneli ma bani me die se ishte oficer i profesionit nga radhët e ish Armatës Jugosllave, nga e cila ishte largue çastin që ajo ishte vënë

në shërbim të regjimit të Beogradit. Fillimisht iu kishte bashkue ushtrisë kroate, ndërsa ma vonë kishte kalue në ushtrinë e Bosnjës dhe Hercegovinë, ku kishte luftue kundër armatës jugosllave deri pas nënshkrimit të marrëveshjes së Dejtonit...

“Përfundimi i luftës në Kroaci me fitoren e kroatëve si dhe asaj në Bosnje dhe Hercegovinë, ia hapën rrugën luftës së Kosovës, ku duhej ta kishin vendin gjithë ata që kishin luftue nëpër frontet e huaja...”

Tha se në Kosovë, nëpërmes Shqipërisë, kishte hy para pak kohësh bashkë me shumë e shumë oficerë të tjerë dhe luftëtarë të shumtë në saje të një marrëveshjeje që ishte arritur ditë ma parë në një vend perëndimor (Norvegji) midis forcave patriotike (legale dhe ilegale), që të bahet lufta e përbashkët, që do të drejtohet nga ushtarakët e profesionit dhe do të financohet nga paratë e popullit që për vite ishin derdhë në fondin e Trepërqindshit dhe fondet e tjera të ngjashme.

Bani me dije se e gjithë Dushkaja së shpejti do të shpallet zonë e lirë.

Kishte bindjen se forcat e luftës do të shtohen dita-ditës përderisa të çlirohej i gjithë vendi...

“Kjo luftë është e jona dhe për ne... Ajo nuk bahet vetëm me pushkë, po edhe me punë: kush me nxanës, kush në fushë e kush në ndonji punëtori...”

Biseda jonë e parë kishte me qenë e mangët, madje edhe jo e sinqertë, po qe se nuk do të shtroja edhe çashtjen e grupeve të armatosuna, që prej kohësh silleshin me maska dhe deklaroheshin si pjesëtarë të UÇK-së.

“Nuk përjashtohet mundësia që në këtë luftë ka gjithfarë ujemi... Kjo, madje, është edhe e pritshme kur dihet se sekush atë e sheh për interesa të veta...Të tillët po na qesin telashe... Demonstrjnë arrogancë, kërcënime dhe dhunë madje... Na quajnë tradhtarë dhe kërcënohen se kanë me na heqë flamën para shkaut dhe çmos tjetër...”

Ato që ia thashë, sikur e zunë ngushtë kolonelin. Më kapë për krahun dhe ecëm disa hapa vetëm, paksa të larguar nga përcjellësit, të cilëve u dha shenjë të prisnin ku ishin.

“Kam ndëgjue edhe për të tillë... Nuk e di prej nga vijnë e kush po i drejton... Por, kam me ba çmos për me ua shkurtue kambët... E kam njohtue edhe shtabin tonë si dhe Shtabin e Përbashkët të Dukagjinit... Armët i kemi kapë jo për me e rrënuë atë që është ndërtue me mund dhe djersë e që na ka majtë gjallë, por për me e heqë pushtuesin... Jemi pak për me luftue kundër njani-tjetrit, sidomos intelektualët që janë shpirti i kombit tonë si dhe ekspertët e fushave të ndryshme të shkolluem”.

Foli me mllëf, veçmas për parullat (përsëritjet me grusht) me të cilat irritonin me të drejtë atdhetarët që prisnin liri dhe demokraci dhe jo ideologji komuniste... Ma dha një numër telefoni me iu lajmëruë në çdo kohë. Po ashtu, ma la edhe emnin e një ndërmjetësi (L.C.), me të cilin ishte në lidhje të përhershme... Ndërmjetësi ishte një teknik imi, që e njihja mirë...

Në ndamje më mori ngryk... Më premtoi se kishim me u pa së shpejti për me e kremtue lirinë për të cilën është derdhë mund, dije dhe gjak për breza të tanë...

“Kosova është e jona... Na jemi të saj... Shteti që e kemi shpallë ka me u ba patjetër pa marrë parasysh ata që nuk e donë dhe përpiqen me e pengue të shtimë nga armiqtë tanë shekullorë, të cilët janë të tmerruem se këtë herë jemi në anën e duhur dhe me miq të duhur e të fortë...”

*Pranverë e vitit 1998, diku në Dushkajë...*

Punën në plantacionin e vneshtave dhe atë të mollëve, e filluem me telashe të mëdha deri sa një ditë, nga mesi i verës u ndal fare...

Në fillim ishte mungesa e madhe e punëtorëve, që nuk iu përgjigj thirrjes, ndërsa ma vonë edhe kërcënimet nga ana e grupeve me maska (të shumtën prej dy-tre vetave), që zinin prita nëpër pjesë të skajshme...

Qenë të kota edhe përpjekjet e shumta të ndërmjetësit të kolonelit për Dushkajën, t'i pengonte grupet me maska kundër punëtorëve.

Ndodhi madje, që në afërsi të digës, ku ata shfaqeshin herë mbas herë dhe mbikëqyrnin hyrje-daljet në pjesën tonë, ndërmjetësi i kolonelit të ngatërrohet me ta deri në atë masë sa që ishin kapë edhe armët. Sigurisht se ato edhe do të shkrepnin, po mos të ishte ndërhyrja e papritun e disa punëtorëve të armatosun, që i rrethuen ata me maska dhe kërkuen me u largue menjëherë me kërcënimin që mos të shkelin ma në këtë pjesë...

“Nuk e duem luftën me maska e aq ma pak për me u vra ndër veti...”

Treshja me maska iku, por mbrapa la kërcënimin se tradhtarët i pret plumbi...

7.

*Pranverë e vitit 1998, diku në Dushkajë...*

Një pjesë e punëtorëve, nën mbikëqyrjen e ndërmjetësit të kolonelit (teknikut L.C., oficer rezervë), ishin përfshi në “njësitin vetëmbrojtës”.

Kjo ishte ba në marrëveshje me kolonelin, në përputhje me konceptin se njësitet e shkapërderdhuna, në grupe të vogla, duhej të formoheshin në të gjitha pjesët e vendit dhe, sipas nevojës, të vepronin edhe jashtë vijave të frontit...

“Njësitë e vetëmbrojtjes” mbikëqyreshin nga ushtarakët e profesionit që caktoheshin nga Shtabi i Zonës së Dukagjinit. Ata doemos u nënshtroheshin autoritete të institucioneve vendore dhe nuk ishte e thanë për me veshë uniforma...

Ndërmjetësi i kolonelit, mbikëqyrësi L.C., ma bani me dije se “Njësitë e vetëmbrojtjes” kishin për detyrë me mbetë në punë, pa marrë parasysh se çfarë ka me qenë qëndrimi i drejtorisë së dhunshme...

“Për ne puna ashtë luftë dhe lufta punë...”

Po ashtu tha se pararoja e ushtrisë sonë (falën e kishte për punëtorët e plantacionit) ka me u gjetë në ballë të luftës çastin që ka me fillue operacioni i ushtrisë serbe kundër luftës çlirimtare...

8.

*Verë e vitit 1998, diku në Dushkajë...*

Luftimet sikur anashkaluen pjesën tonë... Ato u bartën në pjesën tjetër, në drejtim të Drinit...

Ndodhi që në këtë kohë, brenda natës u hoqën postbllloqet e policisë serbe në drejtim të Sukës dhe në udhëkryqin e rrugës që lidhte Dushkajën me Gjakovën... Në ato pjesë, thuhej se lëviznin lirisht patrullat e UÇK-së...

Pak ma vonë, erdhën lajme se forcat policore serbe ishin largue edhe nga udhëkryqi i Klinës në drejtim të Pejës, siç ishin largue edhe nga pjesa e Përdrinit në drejtim të Rahovecit dhe Malishevës...

Emisioni shqip i radios gjermane “*Dojçe Velle*” njoftonte për “zonat e lira” të UÇK-së në Drenicë, Përdrin dhe Dukagjintashma të lidhunra mes vete...

9.

*Verë e vitit 1998, diku në Dushkajë...*

Katundit tonë zu t’i kthehej jeta...

Në fillimi ishte ardhja e papritun e vajzave të mia, Dardanës dhe Doruntinës nga Prishtina (e para studente e mjekësisë në vitin e katërt dhe dyta studente e drejtësisë në vitin e dytë) si dhe Dafinës nga Gjakova (maturante e gjimnazit), dhe pak ma vonë edhe ardhja e studentëve të tjerë (gjithsej gjashtëmbëdhjetë), të cilët vendit i dhanë gjallni të papame...

Të rinjtë mblidheshin te kafe “Liqeni”.

Atyne u bashkoheshin edhe të tjerë nga rrethina, që në njëfarë mënyre, ishin të përfshimë në rrjedhat e luftës...

Ishte një përjetim i veçantë që na mbushte me shpresa se liria po vinte...

Por, nuk vonoi dhe ajo atmosferë nisi me u prishë...

Fillimisht ishte ndërhyrja e një grupi me maska, që kërkuen mos me ba ahengje në kohë lufte, që pasi nuk ua vuni kush veshin (ngaqë të rinjtë dhe të rejat, kush ma shumë e kush ma pak ishin të përfshimë në rezistencën e armatosun) dhe u kërkue prej tyre andejpari me i heqë maskat dhe mos me përshëndetë me grushtin lartë, ata lanë pas kërcënimin se “punët do të rregulloheshin edhe ndryshe”.

Në orët e hershme të mbramjes, kur të rinjtë po vallëzonin, ishte një predhë, që nuk u pa se nga erdhi, që ra aty afër të rinjve tanë, i mori jetën njanit (studentit Z.U.) dhe plagosi randë tri vajza.

10.

*Verë e vitit 1998, diku në Dushkajë...*

Dy ditë bana përpjekje me e takue ndërmjetësin e kolonelit, teknikun tim L.C., drejtuesin e “njësitit të vetëmbrojtjes” në pjesën tonë.

Ditën e tretë, erdhi njani nga pjesa e Sukës dhe ma dha lajmin e zi se ndërmjetësi i kolonelit, teknik L.C., që po e kërkoi nëpër tokë e qiell, ishte gjetë i vramë në breg të Liqenit... Kishte dekë nga një plumb në kokë nga afërsia dhe mandej ishte gjuajtë në ujë.

“Valët e liqenit e nxorën trupin jashtë...”

I dërguemi më tha se gjatë asaj nate ishin vra, në pjesë të ndryshme, edhe katër të tjerë, që i takonin “njësitit të vetëmbrojtjes”. Edhe dy të tjerë ishin zhdukur...

“Sot mbasditë vorrosen...”

Kur mbeta vetëm nisa me u dridhë... Po më lëshonte forca dhe kisha me u shembë, po mos të vinte Dardanja, e cila ma kishte hetue shqetësimin sapo ishte larguar bashkëbiseduesi i panjohur.

Nuk ia tregova të gjitha, ama, ia bana me dije se në pjesën e Liqenit, kishte pasë luftime dhe disa të vramë nga ana jonë...

Të tjerat nuk ia tregova... Por, mjaftuen këto që Dardanja të shqetësohet. Tha se do të shkonte menjherë në pjesën ku ndodhej spitali vendor, në afërsi të Sukës, ku shkonte herë mas here, për me ndihmue...

11.

*Verë e vitit 1998, diku në Dushkajë...*

Te vorret e Sukës, pesë vorre të reja po prisnin trupat e pajetë të pjesëtarëve të “Njisitit vetëmbrojtës”.

Të vrarët punonin në Plantacionin e Vreshtave nën drejtimin e ndërmjetësit të kolonelit, teknikut L.C., trupi i të cilit u bart i pari në drejtim të vorrit...

Kohëve të fundit kishin marrë pjesë në disa luftime “të padukshme” në pjesë të ndryshme kundër forcave policore serbe, që po tërhiqeshin në drejtim të Drinit...

Punë të dobishme kishin ba sidomos në mbrojtjen e mjeteve të punës të Plantacionit dhe të reparteve prodhuese të Kombinatit në atë pjesë si dhe ruajtjes së tyre nga shkatërrimi i parapmrë për me u pamundësue prodhimi...

“Maqinat dhe veglat e prodhimit janë tonat...E japim edhe shpirtin për to...”

Se vrasjet ishin të dyshimta dhe se ky dyshim lidhej me fjalët që ato ditë përhapeshin rreth përçarjeve të mëdha midis vetë “Shtabit të Dukagjinit” mbi bazat e përkatësisë (“krah i luftës”–“krah i paqes”), kjo u pa edhe nga mospjesëmarrja në vorrim e përfaqësuesve të “Shtabit të Dukagjinit”, edhe pse u tha se ishin njoftue me kohë...

Vëllai i teknikut të vramë më tha se andejpari nuk kishte kurrfarë luftimesh.

“Vëllau më tha se kishte një takim me punëtorët rreth ruejtjes së disa maqinave të një reparti prodhues në Bec... Shkoi pa armë...”

Mbas vorrimit, i vëllai i teknikut, më përcolli deri te pjesa e digës. Gjatë rrugës folëm për gjendjen tonë në ato rrethana, ndaj të cilës ai ishte tepër mosbesues. Më tha se i vëllai ia kishte ba me dije për përçarjet në “Shtabin e Dukagjinit” si dhe ofensivën e madhe serbe, e cila pritej me fillue ato ditë nga të katër anët... Koloneli i kishte thanë se Beogradi po përgatiste një hakmarrje të madhe ndaj nesh...

Në ndarje, me një brengosje të madhe më tha se Koloneli kishte çue fjalë mos me hy në fesatë me “komisarët me maska”, e as me komandantët e shumtë që krekosen nëpër oda e ahengje, por as mos me heqë dorë nga “vetëmbrojtja” dhe organizimi institucional i luftës...

“Duhet me ba çmos me ruajtë lidhjet me oficerët dhe krahun e shtetit...”

Fjalët për “krahun e shtetit” i theksoi posaçërisht, tue ba me dorë nga unë, toka dhe vendi përreth.

“Na po luftojmë për liri dhe shtet dhe jo për ideologji...”

12.

*Mesi i verës 1998, diku në Dushkajë...*

Se ofensiva e ushtrisë serbe tashma kishte fillue, kjo u mor vesh nga disa predha që erdhën nga ana e rrethinës së Gjakovës, ku thuhej se ishin rikthyer disa grupe “vullnetarësh” (ai i Mushkut Jakupit të Osekut) në përbamje të paramilitarëve serbë.

Të nesërmen u fol edhe për lëvizjet e para të këtyne grupeve në drejtim të Hereçit...

Aty kishte pasë një shkëmbim të shkurtë zjarri me pararojat e UÇK-së...

Mbas dy ditësh, erdhën lajme të tjera shqetësuese rreth luftimeve në rrethinën e Rahovecit si dhe futjen e forcave policore dhe ushtarake atje...

Ata që sillnin lajmet përpiqeshin mos me ra gjithaq në sy nga frika se mund të shpalleshin “hafije të shkijeve”...

Në ato rrethana me kot u mundova me kutpue se çfarë po ndodhte tutje Dushakjes sime, ngaqë e dija se atë që e ke te gardhi, e ke edhe në shtëpi...

Ashtu kryenëvete kalova digën dhe shkova deri te drejtorja e Kombinatit, me shpresë se atje do të takoja dikë, së paku rojet...

E para gja që më ra në sy ishte se në pjesën nga ana e digës e deri te rruga e asfaltit që shkonte kah Drini nuk kishte kurrfarë postblloqesh e as lëvizje të grupeve të armatosuna, të cilat, gjatë atyne dy muajve të fundit, shfaqeshin mbas secilës kaçubë.

Për habi, nuk kishte as lëvizje makinash e as ndonjë lëvizje kalimtaresh, thuejse çdo gja kishte pushue me jetue atje...

Të njajtën pamje e ndesha edhe te drejtorja e Kombinatit... Askund kambë njeriu... Disa makina të shkatërrueme dhe pajisje të tjera të shkapërderdhuna andejpari frikësonin...

Ashtu i vetmuem, fillova me u trishtue... Ndoshta edhe për atë senuk isha në gjendje me i dhanë sqarim gjithë asaj që po ndodhte...

Nga kjo përhumbje më nxori dikush që më doli para sikur me pasë pikë prej qielli.

Ishte miku i fëmijërisë, Z.A., nga Suka, arsimtar i historisë. Bashkë ishim në filllore dhe bashkë ishim edhe në bankat e gjimnazit në Gjakovë... Na ndanë studimet: mua agronomia në Zagreb, e atë Filozofiku në Prishtinë... Kishim kohë pa u pa.

Një copë herë shikimet tona u përballën sikur me kërkue ndonji përgjigje për atë që nuk e kuptonim por që ishte pjesë e realitetit tonë...

“Uroj që ky mos të jetë fundi...”

Kur m’i tha këto, shikimin e drejtoi nga pjesa e Pashtrikut.

Për me u dhanë kuptim atyne që tha nisi me tregue se si katundet gjithandej Drinit kishin fillue me u shpërngulë në drejtime të ndryshme: kush nga Peja e kush në drejtim të Prizrenit... Tha se ka edhe asi që nuk e dinë as vetë nga shkojnë, pos që ikin diku...

“Shkau po rikthehet...”

Mbasi m’i tha këto, u largue ashtu heshtas siç kishte ardhë...

Nuk e di se si mendja ime ndaj atyne fjalëve krijoi përgjigjen se “shkau as që ashtë largue, por na ia kemi krijue vetit këtë mashtrim...”

Kjo më solli të dridhme të tjera, edhe pse dielli i mesditës po më gjuante pingul mbi kokë...

Dikur, mora rrugën e kthimit...

Në atë ecejake të mundimshme, dikush i brendshëm, i futur apo i strukun në mue ngaherë, po që nuk e kisha vërejtë dhe kjo tashma nuk kishte randësi, dëshpërimit tim po i thoshte:

“Duhet me jetue...”

Fjalët që po më vinin nga brenda, sikur nuk i pranonte pjesa tjetër imja, ajo që po më drejtonte në atë mjegullim...

“Si me jetue kur jeta po vritet?... ”

“Atëherë, vrite vdekjen!... Tjetër nuk ka...”

13.

*Mesi i verës 1998, diku në Dushkajë...*

Në shtëpi po më prisnin vajzat (Dardana, Doruntina dhe Dafina) bashkë me disa të rinj dhe të reja (kryesisht studentë, përfshi në mbrapavinë e luftës).

Që të gjithë ishin gjithëshqetësim dhe të tronditun...

“Paramilitarët kanë nisë me depërtue në drejtim të digës... Njisitë e tyne shihen skaj vneshtave... Herë mbas here hedhin ndonjë granatë në drejtim të liqenit...”

Për Shkëlqimin (student i drejtësisë), që i tha këto, ma brengosëse ishte tërheqja e luftëtarëve nga vijat e frontit në afërsi të Hereçit dhe pjesët e tjera në drejtim të Junikut dhe bjeshkëve...

“Dushkaja dhe Reka po zbrazen edhe nga popullata...Njerëzit, që deri me dje ishin pjesë e luftës ose që i kishin ndihmë asaj me çfarë kishin, kanë fillue me e marrë ikën ngaqë kanë mbet të pambrojtun... Thuhet se në Isniq dhe në disa pjesë kah Drini katunde të tana po grumbullohen... Njerëzit kanë mbetë si miza në mjegull...”

Fjalë të ngjashme, “me të nime”, u thanë shumë e shumë... Dhe sa ma shumë që thuheshin, hutinë e banin edhe ma të madhe, ndërsa shqetësimin ma të pranishëm...

Dikur, njani tha se nuk kishte me qenë keq që edhe te na me u shtrë puna e sjelljes sonë kur shkau po kthehej...

Dardana ndërhyri me fjalët se “kjo nuk ka me ndodhë kurrë...”

Ra një heshtje trishtuese...

Në atë gjendje tepër të randë, më duhej me thanë diçka, çka do, për me ua kthye paksa besimin të rinjve... Por, çka mund të thoshte njeriu i shkretënë atë mjegull që kur çohet len mbrapa tmerrin e vdekjes?...

Për me e përballue disi shpërthimin e mendimeve të liga, që po më silleshin nëpër kokë, fola e thashë se “duhet me qëndrue...”

Ndonëse edhe këto fjalë më trishtuen, ngaqë tingëllonin gjithë ironi në kohë vrastare, në të cilën ndodheshin, megjithatë, ato sikur mbushën me shpresë të rinjtë, që po më shikonin sikur nga unë të varej fati i tyne, i yni dhe i gjithë vendit...

Nga druajtja se atë “me qëndrue”, të rinjtë mund ta merrnin “me luftue”, që për mue, në ato rrethana, kishte me qenë e njajtë me një vetëvrasje, që askush nuk do ta donte, e përçolla me fjalët se “nuk do t’i lëshojmë votrat tona... Nuk do të bahemi refugjatë...”, që i binte se luftërat mund të vinin e mund të shkonin, se vrasësit mund të vinin e mund të shkonin, që dhunuesit e shumë mund të vinin e mund të shkonin, por na do të rrimë në Dushkajë...

“Dushkaja ashtë jeta jonë... Dushkaja ashtë edhe ...”

Aty u ndala dhe nuk kishte nevojë ta çoja deri në fund, ngaqë u kuptue çka desha me thanë, pra vorri ynë...

14.

*Mesi i verës së vitit 1998, diku në Dushkajë...*

Lufta sikur na kishte anashkaluar... Të shtënat e paradokohshme, që sa vinin e rralloheshin dhe shurdhoheshin sa ma shumë që largoheshin, nisën me uzavendësue me gjuajtje të predhave nga maja e Sukës dhe ajo e Hereçit... Në fluturim e sipër mbi ne, shihnim vijën e hollë që linin deri te kufini ku edhe shpërthenin tue mbushë me gjëmim gjithë Rekën e Keqe...

Nga lajmet që na vinin nga ata që ishin shkëputë nga lufta (të plagosun ose shumë të tjerë nga radhët e rezistencës vendore, që nuk ia kishin dalë për me u ba pjesë e saj për shkak të përçamjeve të njohuna që kishin shpërthye para se me fillue ofensiva serbe), merrej vesh se lufta ishte humbun...

Përkundër kësaj, trishtuese ishin rrëfimet e ndryshme që përhapeshin (herë tue u smadhue e herë tue u ngatërrue me gjithfarë gjanash), që ishin ma të randa se vetë humbja...

Dhe, në këto rrethana, kur asgja nuk varej prej nesh, pos asaj se a do të baheshim pjesë e atyne që shpërnguleshin me teshë e kuteshë nga shtëpitë e tyne dhe përfundonin në disa hapësina të mëdha grumbulluese (në Klinë, në Isniq, në Malishevë e gjetiu ku kishte pasë zona të lira), ato që i kisha thanë rreth asaj se “kemi me qindrue”, i dhanë shkas idesë që qëndresa jonë me u pasqyrue me shpalljen e “*Dushkajës së lirë*”.

Të rinjtë biseduen gjatë për kuptimin e saj, në mënyrë që të mos kthehej në një tallje të shumanshme.

Si përfundim doli qëndrimi se “*Dushkaja e lirë*”, nuk paraqet gjendjen e lirisë si e drejtë elementare njerëzore për me qenë të lirë dhe të barabartë me të tjerët, por të kërcënimit dhe të rrënimit të saj mizor me anën e armëve deri në asgjasim, gja që nënkuptonte edhe detyrimin që, në ato rrethana, kjo edhe të mbrohej...

“Këtu nuk po kërkohet heroi, por shpirti liridashës...”

15.

*Fundi i verës së vitit 1998, diku në Dushkajë...*

Pak nga pak “*Dushkaja e lirë*”, po “fryhej” dita-ditës me të ardhun nga pjesë të ndryshme të Dushkajës, por edhe tutje saj...

Të tillë ndoshta e kishte ba një intervistë e gjatë e Dardanës dhanë reporterit të BBC-së, i cili, para dy ditësh ia kishte dalë të futej në këtë pjesë me një ekip të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar.

Nga mbamendja po sjell pyetjet dhe përgjigjet e Dardanës, me të cilën na kishte dalë zani.

BBC: Ç’është kjo “*Dushkaja e lirë*”, kundërpërgjigje “zonave të liria” të luftës, që nuk janë më, apo ndonjë ironikundër luftës dhe pasojave të saj, të cilat sot kudo janë të pranishme në këtë pjesë?...

Dardana: *Është fjala për lirinë, si e drejtë elementare njerëzore, që duhet t’u garantohet të gjithëve...Këtu, si po shihet, liria jo vetëm që është shkelur, por ajo po vritet në mënyrën më mizore në emër të disa parimeve, siç është ai i mbrojtjes së sovranitetit shtetëror, që në të vërtetë është kthyer në pretekst lufte.*

“*Dushkaja e lirë*” paraqet një thirrje botës së lirë që të ndërhyjë këtu në mënyrë që nga këtu jetës t’i kthehet dinjiteti dhe vlerat e saj nga të cilat ne që moti jemi privuar...

BBC: Por, këtu liria po kërkohet me armë?...

Dardana: *Është arma ajo që e ka sulmuar dhe e ka vrarë lirinë... Është arma, e Beogradit, ajo që është kthyer në kriter të lirisë... Andaj, duhet për të shihet dallimi midis lirisë së kthyer në armë kundër lirisë dhe armës për liri kundër armës...*

BBC: “*Dushkaja e lirë*” tashmë po kthehet në një “azil” ku gjejnë “paqe” të përkohshme viktimat e luftës. A mund të kthehet kështu ky vend në një kamp të madh të

refugjatëve, përgjegjësinë e të cilit, për qëllime humanitare, duhet ta marrë menjëherë bashkësia ndërkombëtare?...

Dardana: *Bota e lirë demokratike, ka për detyrë politike dhe morale kudo të ndihmojë viktimat e agresioneve. Këtë e obligon edhe karta humanitare e OKB-së... “Dushkaja e lirë” paraqet një rast shumë të mirë për këtë, në mënyrë që pastaj t’u hapet rruga edhe zgjidhjeve politike...*

BBC: Dhe krejt në fund, nga sa mund të merret vesh te ju, “Dushkaja e lirë”, krahas Beogradit, për kundërshtarë të paepur ka edhe një rrymë të luftëtarëve shqiptarë të njohur si ithtarë të ideologjisë staliniste... A ju shqetëson kjo?...

Dardana: *Kundërshtari ynë kryesor është dhe mbetet regjimi pushtues i Beogradit, që si po shihet edhe me këtë rast, luftën po e shfrytëzon si mjet për t’i qëruar hesapet me shqiptarët në përputhje me projektet e njohura hegjemoniste mbi të cilat janë ushtruar disa gjenocide ndaj nesh, siç ishte ai i vitit 1912-1913 dhe i vitit 1994-1945 me rastin e pushtimit të Kosovës nga ushtria serbe dhe malazeze gjegjësisht ajo jugosllave e drejtuar nga komunistët.*

*Natyrisht se edhe ideologjia komuniste për ne mbetet një armike e madhe, meqë ishte fitorja e komunizmit në Shqipëri dhe në Jugosllavi në mbarim të luftë së Dytë botërore që na futi në një diktaturë të re së cilës iu pagua një çmim i madh.*

*Nuk përjashtohet mundësia që edhe në radhët e luftëtarëve shqiptarë të ketë grupe me bindje marksiste-leniniste, siç ishte rasti me shfaqjen e disave me maska, të cilët kërkojnë zgjidhje ideologjike për Kosovën, të ngjashme me atë të pasluftës kur ajo u aneksua nga Serbia. Kjo është edhe e natyrshme, ngaqë komunistët jugosllavë kanë themeluar dhe drejtuar Partinë Komuniste të Shqipërisë, e cila, punën e parë që ka bërë, ishte shkelja e vendimeve të Konferencës së Bujanit, me të cilat kërkohej bashkimi kombëtar pas fitores ndaj fashizmit...*

*Pra, nuk përjashtohet mundësia që këto grupe marksiste dhe leniniste të kenë fituar hapësirë edhe në këtë luftë, mbasi që, si u pa, Beogradi dhe Moska kanë ndikim të madh te Tirana dhe socialistët shqiptarë, që kanë ardhur në pushtet dhe në njëfarë mënyre vazhdojnë të ndihmojnë po edhe rekrutojnë aleatët e tyre në Kosovë në mënyrë që zgjidhjes së saj, që nuk mund të jetë ndryshe pos në përputhje me vullnetin tonë të shpallur në vitin 1991 për shtetin e pavarur, t’i krijohen kurthe të ndryshme me të cilat tashmë jemi mësuar...*

*Populli ynë tashmë i ka të gjitha të qarta dhe di të ndajë shapin prej sheqerit... Pra, na kërkojmë liri, demokraci dhe assesi ideologji majtiste e aq më pak komunizëm...*

*Ne duam t’i takojmë kulturës dhe qytetërimit perëndimor ku edhe i kemi rrënjët...*

*“Dushkaja e lirë”, pse jo, sjell edhe këto mesazhe.*

BBC: Urojmë që të ndodhë kjo...

16.

*Fundi i verës së vitit 1998, diku në Dushkajë...*

*“Dushkajës së lirë” po i delte zani edhe jashtë Dushkajës... Asaj po ia mësytin të zhvendosun nga katundet përreth, por edhe vise të tjera nëpër të cilat ushtria dhe policia serbe, pas ofensivës ushtarake, kishte rikthyer gjendjen e terrorit policor dhe ushtarak të papame deri më atëherë, tue lanë mbas shkatërrim dhe viktima të shumta...*

Me gjithë që të shkëputun nga bota jonë, tashma dinim për masakrën e madhe të Rahovecit në Tegenë e atjeshme, me mbi katërdhetë të vramë, të cilët kishin kërkuar strehim atje... Ngjashëm flitej edhe për masakra të tjera në viset përreth Malishevës dhe nëpër Drenicë me shumë e shumë të vramë (të shumtën fëmijë, gra dhe pleq)...

Në ato rrethana, të rinjtë tanë bashkë me shumë e shumë të tjerë që u kishin ardhë në ndihmë përkujdeseshin jo vetëm për fëmijët dhe gratë, por edhe për të plagosurit dhe të moshuemit...

Në ndihmë kishte ardhë edhe një shoqatë e jashtme humanitare si dhe Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, që kishte dërgue dy ekupe shëndetësore bashkë me ilaçe, të vendosuna prej tyre në dy tenda të mëdha...

Të pranishëm ishin edhe vëzhgues të ndryshëm ndërkombëtarë që ndërroreshin vazhdimisht...

Por, *“Dushkaja e lirë”*, ashtu si ishte, një oazë midis një shkretine, po vëzhgohej gjithnjë e më shumë nga grupe të ndryshme ushtarake (kryesisht paramilitare), najtë siç vëzhgojnë bishat grabitqare viktimat e tyre të ardhshme... Për orë të tana ndaleshin te pjesa e digës me tytat e armëve të drejtues nga pjesa jonë...Kjo i frikësonte të rinjtë, të cilët kërkonin ndërhyrjen e vëzhguesve ndërkombëtarë dhe të përfaqësuesve të Kryqit të Kuq...

Një mbramje, si erdhën dhe prej nga pikën vetëm ata mund ta dinë, u shfaqën edhe komandosët e maskuar me uniforma, që thoshin se i takonin UÇK-së, edhe pse na prej kohësh dyshonim për këtë...

Banin armë të lehta... U larguen papritmas ashtu si erdhën... Mbas lanë kërcënimin që sa më parë të merrte fund *“Dushkaja e lirë”*, meqë sipas tyre, ajo nuk ishte tjetër pos pjesë e propagandës së Beogradit për me mashtrore botën, kur po e kallej Dukagjinin, Drenicën, Përdrinin dhe pjesët e tjera të vendit...

“Kjo është tradhti!”

Edhe na e dinim se Beogradi bante përpjekje që *“Dushkajën e lirë”* me e shfrytëzue për qëllimet e veta, siç ishte mundue prej vitesh që edhe organizimin tonë në kuadër të shtetit paralel (arsimin, shëndetësinë, vetëmbrojtjen, solidaritetin dhe të tjerat), me të cilin prania e Serbisë, e mbështetun mbi sistemin represiv policor dhe ushtarak, ishte rrudhë në pushtues të thjeshtë, me e paraqitë si pjesë të “tolerancës” ndaj “separatizmit shqiptar”, ndërkohë që kishte bërë çmos që shteti paralel me dështue, sidomos në fushën e arsimit dhe të vetëmbrojtjes ku jepej prova kryesore e shtetndërtimit tonë...

Sidoqoftë, na e dinim se tashma lojës po i vinte fundi, dhe se sjelljes sonë po ashtu po i vinte fundi... Madje, na e dinim se ky fund ka me qenë tragjik, i përgjakshëm, siç ishte edhe i pjesës tjetër të përfshime në këtë luftë...

Na po ashtu e dinim, se tragjedia jonë, që ishte e pashmangshme, nuk ka me ardhë nga ndonji fushatë policore-ushtarake të ngjashme me ato që kishte përdorë Beogradi gjatë asaj vere dhe vjeshte ndaj pjesëve të tjera (Dukagjinit, Përdrinin, Drenicës...), ngaqë na nuk ishim pjesë e fronteve të luftës, por viktimat e saj, që megjithatë vëzhgoheshin nga të gjitha anët (përfaqësuesit e shoqatave humanitare, ata të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar si dhe gazetarët e shumtë)...Dhe, nëse përjashtohej fushata ushtarake-policore, atëherë mbetej që ajo me u krye nga “grupet terroriste” ose “mercenarët” e ndryshëm, të ardhur nga “pjesë të ndryshme” me “detyra të caktueme” (përmendeshin fanatikë islamikë që kishin luftue në Bosnje), për të cilët Beogradi fliste gjithnjë e më shumë...

Se mund ta pësonim në këtë mënyrë, pra nga ndonjë “hakmarrje e brendshme”, këtë ma bani me dije edhe Lush Galani, një roje e vneshtave, që e njihja prej vitesh si punëtor të mirë dhe të ndershëm...

U takuem gjoja rastësisht në afërsi të digës, ku ktheja herë mbas herë për me pa “pjesën tjetër të botës”, ndonëse prej kohësh e shkretë...

Në krahë kishte një armë të re, ndryshe nga çiftja e vjetër (të shumtën pa fishek) që e mbante si roje e vneshtave.

Në të vërtetë, arma e re që mbante, ishte pjesa kryesore e porosisë që duhej për me dalë nga ai takim “rasti”.

Me pamjen e njeriut tepër të shqetësuar, të atij që kryente detyra, që deri më atëherë kishin qenë detyra pune, foli e tha se “armën e re e kishte për me e përdorë” siç i kishin thanë “kundër lepujve”...

“Ka fillue gjuetia e lepujve...”

Me lot në sy, tregoi se i kishin nxjerrë nga kolibat dhe i kishin vendosë thuajse pa dëshirë në shtëpitë e shkreta në katundet përreth.

“Janë tuajat, na kanë thanë... Nëse ndonjeni prej nesh, si me shaka me fjalët ‘jemi mësue me kolibat tona’, ka shprehë mospajtimin, ka ardhur depçiku në ballë ose ndonjë plumb në gojë...”

Tha se disa të rinj i kanë veshë policë, disa të tjerë janë marrë nga paramilitarët dhe nuk dihet se ku janë çue... Ndërsa të tjerëve u kanë dhanë armë...

“Ka ardhë stina e gjahut dhe armët mund t’i përdorni për qejf kundër lepujve dhe çfarëdo që ju del para nga Pashtriku e deri në Shkëlzen...Tash e tutje nuk jeni ma rrogëtarë, por bejlerë të këtij vendi...”

U largue i heshtun dhe tepër i dëshpruem me fjalët se “nuk ka gja ma keq se kur rrogëtarit i jepet arma dhe i thuhet shkrep nga të duesh...”

17.

*Fundi i verës së vitit 1998, diku në Dushkajë...*

Në atë hakërrim me mendimet e liga në kokë dhe me pamjen enjë “hapësire gjahu të lirë”, ku “mund të vriteshin lepujt” dhe çdo gjallesë tjetër në të, shikimi ma kapi pamjen e Sukës, ndërsa mendja ma zuri Tyrben atje dhe dervish Cenën bashkë me dervishët dhe myhibët fanatikë në të, që nuk i ndahen kurrë...

Mbaj mend se herën e parë, si fëmijë, atje më kishte çue gjyshja, e cila, natën e Shëngjergjit e kalonte në Sukë. Gjatë gjithë rrugës, në qerren e drunjtë, kishte folë për “baballarët” dhe fuqinë e tyne të jashtëzakonshme për me i shërue sëmundjet e shpirtit... Zinte në gojë dervish Mallutën dhe mrekullitë e tij për me i ba me barrë gratë shterpa, por edhe me ua heqë qoftëlargun atyne që merreshin të shkalluem...

Dhe kështu, takimi im i parë me atë ambient, nuk kishte mundë me qenë tjetër, pos një kureshtjeje e përzieme me frikë, që fitohet nga moria e njerëzve aty, ziqri i dervishëve gjatë gjithë natës si dhe përkulja nënshtruese deri në shkallmim e të pranishmëve atij rituali tëshoqëruar edhe me lutjeve të pakuptueshme që thuheshin prej tyne (një përziemje midis çirreve dhe këndimit), që zgjatnin nga perëndimi i diellit e deri te lindja e tij...

Gjatë gjithë asaj kohe gjyshja sillej si e luejtun... Përkulej, lëvizte dhe herë pas herë tue i ra vetes me grushta (gjoksit e kokës), nxirrte disa psherëtima mbyttëse...

Në mëngjes, e gjitha kishte marrë fund me sjelljen disa herë rreth bunarit, ku thuhej se kishte gjarpinj dhe mbajtjen një copë herë të kokës deri në qafë në ujin e një lugu të madhe të drunjtë aty përballë...

Ashtu e lagun dhe me një pamje të frikshme, gjyshja më kishte zanë për dore deri te qerrja që po na priste...Në atë teposhtëze ishim pjesë e një numri të madh që ashtu nga tallandia njizet e katër orëshe ktheheshim në realitetin e ndruajtur me bindjen se ishim të mbrojtun nga e liga...

Vite ma vonë, pasi që kisha krye studimet dhe isha punësue si agronom në Kombinatin Bujqësor, isha kthye në Sukë...

Ishte kjo një vizitë pune, ngaqë plantacioni i vneshtave shtrihej deri te pjesa lindore e Sukës, ku parashihej të ngriheshin disa objekte mirëmbajtëse...

Mbasi që dervishët dinin për planet e kombinatit rreth ndërtimeve të objekteve mirëmbajtëse aty dhe, përkundër ankesave të shumta në të gjitha anë nuk ia kishin dalë me i pengue, gjithë shpresat i kishin varë te mirëkuptimi im ndaj kërkesës së tyre edhe për atë se familja ime përherë kishte qenë e lidhun me tarikatin e tyrbes së Sukës.

Ishte pikërisht Dervish Cena, që sapo më pa dhe ndërruem dy-tri fjalë ma përkujtoi këtë lidhje. Më tha se mbante mend kur si fëmijë vija këtu me time gjyshe...

Meqë e dija se ku donte me dalë, i thash se tyrbes do t'i ruhej pamja e mirëfilltë e rrethimit...

I thashë se këtë e bëja pse dëshiroja me e ruejtë të gjallë një përfytyrim të së bukures dhe harmonisë me të për të cilin njeriu ka nevojë kurdoherë për me e ushqye shpirtin dhe assesi për të tjerat...

Dervish Cenës i mjaftoi kjo. Madje, kjo e kënaqi ma shumë se çfarëdo arsyetimi tjetër, qoftë ai edhe me lidhjet tona familjare me urdhrin e tyrbes së Sukës.

Ma ktheu se kuptimi i të bukurës si dhe përjetimi i saj nga një thellësi shpirtnore paraqesin parakushtin e çfarëdo besimi...

Dhe kështu, nga aty dhe nga ajo kohë, herë mbas herë takoheshim. Dervish Cena më kishte tregue se jeta tij e asketit në atë pjesë, ishte pjesë e asaj bindjeje që e kishte fitue jo nga ndonji besim që vjen nga mësimet e shenjta, por nga ndijimi i veçantë i atij përjetimi nga brenda...

Kjo u kishte hapë rrugën bisedave tona për të bukurën dhe të madhërishmen, për fundin e pafund të gjanave dhe pse jo edhe për krijimin si çashtje që nuk mund të lidhet me librin e mbyllun, por të një libri të hapun dhe të ngjashme ku pranohet të menduemit e lirë si pikënisje e çfarëdo trajtimi...

Takimin e fundit e patëm para një viti, pikërisht atëherë kur kishin fillue me u hapë fjalë për fillimin e luftës, si diçka që tashma ishte e pashmangshme... Dervishi përkrahte luftën si e drejtë jo vetëm me u mbrojtë nga vrasësi, por edhe për me e mbrojtë vatanin, ngaqë pa të nuk kishte as liri, as dinjitet njerëzor... Tha se edhe kafshët mbrojnë hapësinën e vet dhe se kjo ishte edhe në përputhje me ligjet e natyrës...

Me ato mendime në kokë, mora rrugën e Sukës, pa qenë i sigurt se a do t'ia dal të arrij në majën ku ishte Tyrbja, ngaqë atje prej kohësh ishte vendosur një bazë e artilerisë ushtarake jugosllave prej nga derdheshin predhat e kalibrave të ndryshëm gjithandej vendit deri në kufi...

Edhe pse nga autoritetet zyrtare bahej me dije se “pushteti” i Tyrbës nuk ishte prekur e as nuk ishte penguar liria e rriteve të atjeshme, megjithatë, nuk dihej si dhe sa ishin të lirë dervishët në ushtrimin e rritit të tyne po qe se nuk i kishin besimtarët përreth... Njëherë, madje, mendja më shkoi se dervish Cena dhe të tjerët mund të mos ishin atje fare, por të vrarë në ndonjë istikam lufte ndër shumë sosh që kishte vendi gjatë asaj vere...

Sidoqoftë, këto dhe hamendje të ndryshme që po më përvijoheshin, nuk kishin qenë në gjendje me ma ndërrue mendjen.

Kështu, me atë përkushtim, kisha ba një copë rrugë, pa ia vu veshin atyne që lufta kishte lanë mbas (istikamet e mbushuna me gëzhoja armësh dhe ndonjë automobil i djegun apo i damtuem skaj rrugës).

Dhe me atë shalakatje kisha me vazhdue edhe ma, po mos të ishte roja, Lush Galani, me armën e tij të re në krah, që më doli para.

Më tha se nuk mund të shkoja përpjetë... Fjalët e tij ishin lutje dhe assesi urdhën për ndalje sado që këtë kishte për detyrë...

Ashtu i hutuem, bana me dorë kah Suka.

Tue ba me dorë në drejtim të vijës së ujit që ishte disa hapa përtej, më tha se nga aty e në gjysmë të rrugës, shtrihej pushteti i rrogëtarëve dhe i fukarenjve të rrezikshëm.

Kjo më habiti. Mendja më shkoi se mos e kishte me shaka për me e thye paksa bezdinë me heshtjen trishtuese që kishte mbërthye vendin gjithandej...

“Siç biseduem herën e fundit te Drejtorja, rrogëtarët dhe fukarenjtë tashma janë ba zot të kësaj toke... Nga kasollet nëpër plehna dhe paralagjet e kalbuna të shehrit janë sjellë këndeje me fjalët se kjo ashtë toka e tyne... U kanë dhanë armë të shumta për më e mbrojtë atë që u ashtë dhurue...”

Tue e fshehë fytyrën me dorë, sikur të mbrohej nga ndonjë marre, tregoi se shumë prej tyne ishin marrë me vete për në luftë dhe nuk përjashtohet mundësia që krimet që i bajnë vetë me ua lanë atyne shkretanëve...

“Një kushëri timin e vranë kur tha se nuk ishte i gatshëm me ua kthye pushkën atyne me të cilët ishte rritë dhe e kishin mbajtur gjallë familjen e tij... U tha se ishte fukara, por kish fytyrë... Disa u pushkatuan aty për aty mbasi që fëmijët e tyne i ishin bashkue UÇK-së...” Mbeta si i ngrimë... Pa ditë as vetë u ula në trupin e një bungu të thyem nga ndonjë predhë, që kishte zanë rrugën...

Mbas pak, sikur me e pas ditë se çfarë bluente koka ime e bame lamsh, tha se pjesa ma e madhe e dervishëve ishin largua prej andej sado kishte fillue me u rikthye ushtria... Disa prej tyne, me pushkë në dorë, ishin futë në luftë...

“Flitet se ka mbetë vetëm dervish Tali i moshuem dhe dervish Lita i verbët me dy-tre myhybë për hyzmet...”

Ashtu i thyem, shikimi m’u ngri në drejtim të Sukës...

Ndinëse Lush Galani më tha se kish me qenë mirë për me u kthye sa ma parë për mos me më vra, si tha, rrogëtarët (sado që këtë nuk do ta lejonte deri sa t’i rrihte damari i fundit), gjatë kohë mbeta aty, madje deri sa dielli që e kisha mbrapa preku majën e Shkëlzenit dhe sharroi nën Bjeshkët e Namuna.

Në atë ndërkohë, në gjendjen e një tallandie të ngjashme me atë që përjetohej në tyrben e Sukës gjatë ziqrit, seç u futa në një kajsinë prej nga gjethet e kalbuna të përmasave të jashtëzakonshme jepnin pamjen e një vendi të mbushun me skelete të gjalla, që lëviznin

ngadalë kah një kodrinë, maja e së cilës sharronte herë mbas herë në kënetë sa herë që skeletet e arrinin atë... Në atë rënie-ngritje, kodrina, që sikur ishte vetë Suka bashkë me tytat e jashtëzakonshme të armëve në të, prej nga herë mbas herë zbrazeshin predha të zjarra të fluturonin si zogj drejt një qielli të përflakur, po më afrohej, ndërsa unë largohesha... Nga ajo ndjekje e çuditshme përndjekësh me nxori një mjegull çasti, që pasi u ngrit, ma ktheu pamjen e Sukës, që po fshihej ngadalë nga terri që kishte mbërthye vendin...

I shkallmuem, ndjeva Lush Galanin të më thoshte të rrija me të ngaqë në Dushkajë tashma ishin futë ushtarët e shumtë, bashkë me rrogëtarët që i kishin vu përpara...

Lush Galani kishte të drejtë...

E dija se ai ishte fundi...

Të tjerat ishin mashtrim dhe zhgënjim...

7.

Në zyrën e EILEX-it, në pjesën e Prishtinës, që shtrihej tutje Spitalit dhe vazhdonte në lindje në kodrinat e buta që lidhen me Gërminë, si askund vërehet mundimi i kapërcimit të qytetit nga njëra pjesë në tjetrën që gjatë këtyre viteve kishte nxjerrë në pah një ambient ku rrënohen parimet e rregullit dhe të harmonisë, ku dallimet midis tyre duken të njëjta.

“Natyrrshmëria” e këtij rregulli sikur kuptohet më lehtë sapo e pi kafënë e parë në ndonjërin nga kafiteritë e shumta, të shkapërderdhura si merimanga, në një atmosferë tepër të hapur midis njerëzve, të gatshëm për çfarëdo bisede me këdo, pa marrë parasysh njihen apo nuk njihen...

I tillë m’u duk edhe Vrasësi i Penduar gjatë takimit të parë, nga tri seanca që m’u kishin caktuar nga prokurori i çështjes. Më përshëndeti përzemërsisht, sikur të njiheshim dhe tha se është i gatshëm t’ia fillonim edhe pa praninë e mbrojtësit ligjor (avokatit), i caktuar nga gjykata.

“Këtu nuk ka avokatë të profesionit, por të biznesit. Shumica prej tyre janë të lidhur me mafinë politike, siç kanë qenë edhe me policinë e dikurshme jugosllave dhe nuk bëjnë tjetër pos shikojnë hesapin e tyre...”

Kur i thashë se ishin rregullat që detyronin t’u përmbahemi, veçmas kur kemi të bëjmë me një çështje tepër të ndjeshme dhe shumë të rëndësishme, pra ta prisnim mbrojtësin ligjor, të caktuar nga gjykata, që duhej doemos të merrte pjesë në secilën seancë hetimore, gjithnjë me atë pamjen e hapur, më tha se ndjente nevojë për një bisedë të hajrit me dike, ngaqë prej kohësh e kishin bezdisur ato të zhvilluara poshtë e përpjetë me gjithfarë mashtruesish.

“Jam i interesuar për të vërtetën dhe assesit për rregullat prapa të cilave kërkohet mbrojtje në mënyrë që t’i iket përgjegjësisë dhe dënimit që duhet ta përcjellë atë...”

Pasi i tha këto, pamja e hapur që kishte sapo hyri brenda, po ia lëshonte vendin pasqyrimin të një shqetësimi të brendshëm, që ziente nga jashtë.

“Nuk më duhet kurrfarë mbrojtjeje, ngaqë nuk po fsheh gjë, pos që pranimi i veprës sime, pra vrasjes me paramendim bashkë me pendimin e thellë si dhe kërkimfaljen ndaj viktimave, në këtë rast familjes së tyre, të shihet në kuadër të rrethanave të gjithëmbarshme, prej nga do të nxirret e vërteta për faktorët përbërës, që janë shoqërorë dhe politikë njëherësh... Pra, unë kërkoj që pranimi i veprës sime, që është kriminale, të mos mbetet

çështje e shkëputur e ndonjë ‘reagimi patriotik’ dhe ndryshe-ndryshe, siç do të dëshironin ta shesin ata që e kanë përgjegjësinë për të dhe të ngjashmet e asaj kohe, por pjesë e një krimi të organizuar me prapavijë politike...”

Mbase do të vazhdonte edhe më tutje në atë mënyrë, po mos të shfaqej avokati mbrojtës, një mesoburrë me syze të trasha, i caktuar nga gjykata, i cili kërkoi fjale për vonesën, që e arsyetoi me telashet e mëdha të trafikut, të cilat andejpari ishin të pashmangshme në atë kohë...

Pa u ulur mirë, avokati mbrojtës, fillimisht ma ofroi dokumentin zyrtar, pra vendimin e gjykatës si mbrojtës zyrtar ligjor dhe kërkoi që kjo, në përputhje me rregullat, t’i komunikohet edhe mandantit të tij, për të cilin tha se nuk kishte arsye të shfaqej mospërfillës ndaj mbrojtësit të përcaktuar me ligj.

Ndaj fjalëve të avokatit mbrojtës të caktuar nga gjykata, Vrasësi i Penduar reagoi me mjaft mospërfillje. Nuk ia dha dorën të përshëndetej dhe as që pranoi që, sipas rregullores, të nënshkruante pëlqimin për angazhimin e tij. Tha se me dëshirë nuk do të fliste para tij dhe asnjë avokati vendor, por meqë kështu përcaktonte ligji, do të sillej sikur mos ta hetonte fare.

Kur pritja që e gjitha të përfundonte me kaq dhe biseda jonë të fillonte ashtu si e kisha paraparë, pra të niste nga biseda që kishte bërë me agjentët gjermanë të maskuar si misionarë në vjeshtën e vitit 1998 rreth rastit të gazetarit të zhdukur të *“Rilindjes”* si dhe *“Ditarit të luftës”* që e kishte pasur me vete, punën e ngatërroi avokati mbrojtës, i cili, kërkoi nga unë që Vrasësi i Penduar t’i nënshtrohet një kontrolli psikik.

Edhe pse e kuptova si një provokim të hapur ndaj mandantit të tij, por edhe ndaj meje dhe gjithë çështjes, për ç’gjë edhe isha paralajmëruar nga prokurori i çështjes, pas refuzimit të atypëratyshëm pa dhënë kurrfarë arsytimi, kërkova një pushim kafeje.

Ishte kjo një ndërhyrje e domosdoshme për ta parandaluar një grindje midis Vrasësit të Penduar dhe avokatit ligjor, i cili, bëri të qartë se edhe detyrën zyrtare dëshironte ta shfrytëzonte për të treguar se edhe ai ishte pjesë e atij opinionit të përhapur prej kohësh se Vrasësi i Penduar, me ato që kishte thënë publikisht dhe më vonë ishin kthyer në pjesë të hetuesisë së EULEX-it, ku edhe kishin pasuar paraburgosjet e personave të caktuar nën akuzën se i takonin grupit kriminal që kishte marrë pjesë në krim të organizuar gjatë dhe pas luftës, ishte një i çmendur me të cilin, nuk duhej të merrej drejtësia, po psikiatria...

Gjatë pushimit që e kalova vetëm në zyrën e hetuesisë, gjithnjë me shikimin nga pjesa e jashtme, ku pak më parë hetoja mundimin e thyerjes së parimeve midis rregullit dhe harmonisë, si diçka që fshin dallimin midis të kundërtave, sa ato të dukeshin pjesë e së njëjtës, pamja po më vinte tjetër - një përplasje e ashpër dallimesh, që pashmangshëm do të çonte te fitorja e njëres anë ndaj tjetrës, madje dhunshëm...

Në atë pikasje me atë ambient, se si po më përvijoheshin nëpër kokë fjalët e këshilltarit të lartë të qeverisë gjermane, që m’i kishte dhënë me rastin e dorëzimit të kredencialit për pjesëmarrje në misionin ndërkombëtar të EULEX-it në Kosovë, se atje dallimet prodhojnë armiqësi të papajtueshme, që vazhdojnë me të gjitha mjetet... Në këtë mentalitet i pushtetshmi, pra “i forti”, është “i drejtë”, ndërsa ata që e kundërshtojnë “armiq” ose të çmendur!...

Duket se fjalët e avokatit mbrojtës për vizitë psikiatrike, Vrasësin e Penduar e kishin motivuar së tepërmi që të tregojë gatishmëri për të qenë sa më i drejtpërdrejtë rreth pyetjes sime lidhur me ato që kishin të bëjnë me gazetarin e *“Rilindjes”* dhe zhdukjen e tij. Gjithnjë

duke e shikuar avokatin mbrojtës, sikur ta shihte fajtor për atë që kishte ndodhur atë ditë të nxehtë vere kur gazetari, me urdhrin e “komandantit vendor” ishte ndaluar nga “komanda vendore” dhe ishte marrë me vete deri te “baza” (një shtëpi përdhese në afërsi të Goleshit), Vrasësi i Penduar, jo vetëm që i vërtetoi ato që kishte folur ditë më vonë me “humanitarët” gjermanë (agjent të shërbimit informativ gjerman), por kishte shtuar se asaj deklarate, për arsye të rrethanave, i kishte munguar “një pjesë e së vërtetës”, pikërisht ajo më kryesorja, siç e tha, “pjesa e dytë”, ajo vendimtarja – përcjellja e gazetarit të “*Rilindjes*” nga “baza e komandantit” për në “zonën e lirë” të Drenicës, ku ai, në Llapushnik, i ishte dorëzuar një komandoje tjetër, që e kishte marrë me vete, për të cilën tha se ishte e “Shtabit të Përgjithshëm”.

“Gazetarin e *Rilindjes* e kam njohur mirë. Kryesisht shkruante për ngjarjet sportive. Por, kohëve të fundit, ishte marrë si shumë me ngjarjet vendore, të cilat i dërgonte në QIK (Qendrën Informative të Kosovës). Përshtypja ime, por edhe e të tjerëve, ishte se gazetari sillte informata korrekte, të cilat ishin në dobi të informimit të drejtë të çështjes sonë...”

Pastaj tha se gazetari në bazë ishte mbajtur deri të nesërmen në mbrëmje...

“Nuk e di se për çfarë ishte biseduar me të dhe si ishin sjellë gjatë asaj kohe. Por, mbaj mend, se pasi që na ishte urdhëruar ‘ta përcillnim’ deri në pjesën e Llapushnikut, na ishte thënë se nuk duhej t’i shtronim kurrfarë pyetjesh dhe po ashtu nuk duhej t’i përgjigjeshim në ndonjë pyetje që mund të na vinte nga ai. E gjitha duhej të mbetej brenda një urdhri që e kryenim. Ai që na e dorëzoi gazetarin dhe detyrën që kishim me atë rast, na tha se duhej të vinim maskat dhe të silleshim me korrektësi gjatë gjithë kohës pos nëse ai do të përpiqej të ikte, ose të tërhiqte vëmendjen e të tjerëve, dihej si duhej të vepronim, pra të përdornim armët. Kishim, pra, përgjegjësi që ta dorëzonim më kohë aty ku pritej...”

Vrasësi i Penduar tregoi se udhëtimi kishte zgjatur dy orë e gjysmë. Kishin ecur natyrshëm. Ndërsa gazetari i *Rilindjes*, në mesin e tyre (dy vetave), nuk kishte folur fare. Heshtjen e frikshme e kishte vazhduar edhe gjatë pushimeve të shkurtra (dy sosh për kryerjen e nevojave fiziologjike) e edhe atëherë kur i ishte bërë me dije se po i afroheshim vendit të dorëzimit...

“Mbaj mend se kur po bëheshim gati t’ua dorëzonim atyre të Llapushnikut (tre vetave nga “Shtabi i Përgjithshëm”), nuk ma dha dorën. Një copë herë dora ime mbeti e ngrirë para tij... Disa çaste me shikoi ashtu frikshëm derisa uli shikimin përdhe... Vetëm kur e dorëzuam dhe ata që e pranuan e vunë përpara, ktheu shikimin pas... Edhe pse ishte terr dhe midis nesh tashmë ishte futur fërfëllima e një ere të lehtë që vinte nga mali përtej, m’u duk se në sytë e tij të akullt kishte një porosi trishtuese që duhej ta kuptoja...”

Vrasësi i Penduar tha se thuajse të njëjtën porosi trishtuese, kishte takuar më vonë, me rastin e ballafaqimit me ish inspektorin e Policisë së Kosovës para se të shkrepte plumbat në kraharonin e tij, që dukej se i priste...

Pasi që i tha këto, Vrasësi i Penduar u ligështua fare... I mbërthyer nga disa dënesje, të ngjashme me klithmat e mbytura dhe me kokën e ulur mbi tavolinë, një copë herë mbeti i shembur. Kur u përmend, gjithnjë me shikimin e drejtuar nga avokati mbrojtës që kishte fshehur shikimin para disa letrave, tha se aty, kishte vetëm vrasës...

Nuk foli më. Mbeti si një mumie, që priste t’i lidheshin fashat e përjetësisë, që ashtu t’i ruhej pamja e fajësisë së përhershme.

Ishte e qartë se aty përfundonte seanca e parë hetimore me të cilën, sa i përket hetimit të kohës së luftës, me të cilën ngarkohej Vrasësi i Penduar, pos çështjes së *“Ditarit të luftës”*, që mbetej për seancën tjetër, thuajse ishin thënë të gjitha lidhur me zanafillën e veprimtarisë kriminale të tij që do të bartet edhe në atë të *“Komandës vrastare”*, të vazhduar edhe pas luftës, ku ai para se të fillonte hetimi i përbashkët, publikisht kishte pranuar pjesëmarrjen në vrasjen e inspektorit të lartë të ish policisë së Kosovës si dhe në disa atentate të tjera, që ishin marrë si urdhra nga një grup politik.

Pasi që i dhashë fund seancës dhe urdhërova që Vrasësit të Penduar, t’i sigurohej një qetësi e plotë deri të pasnesërmen, kur do të fillonte seanca e dytë hetimore, një copë herë mbeta i rrethuar nga jehona e fjalëve të tij rreth asaj se aty kishte vetëm vrasës që kremtoheshin heronj!

Në raportin zyrtar, shënova se Vrasësi i Penduar jo vetëm që ishte i drejtpërdrejtë, i sinqertë, me çka konfirmoi se kidnapimi dhe zhdukja e personave të caktuar, siç ishte ai i gazetarit nuk ishte rastësi, por pjesë e një veprimi të paraparë dhe të organizuar mirë nga *“persona të caktuar”*, të cilët mund të identifikoheshin me emër e mbiemër, por që mbetej për t’u parë dhe nxjerrë në pah përfshirja e të tjerëve në këtë veprim, e mbi të gjitha, mbetej për t’u sqaruar hapat e mëtutjeshme të tij, nga çasti i dorëzimit personave të Llapushnikut derisa t’i humbin përfundimisht gjurmët: diku aty, në Malishevë, apo gjetiu?...

Për këtë fazë të hetuesisë, deklaratat e Vrasësit të Penduar, së paku rreth fatit të gazetarit të zhdukur të *“Rilindjes”* ishin me interes të veçantë, ngaqë ato hapnin rrugën për ndriçimin e mëtutjeshëm të këtij rasti, nga faza e parë (ndalimi dhe dërgimi deri te komandanti vendor, ku ai ishte mbajtur një natë dhe një ditë), për te faza e dytë – te dorëzimi personave të caktuar në Llapushnik, me çka fillonte faza e tretë – ajo më e rëndësishmja dhe më e vështira, ku atij i kishin humbur gjurmët...

Mbetej, pra, që nga kryehetuesi të kërkohej intervistimi i *“komandantit vendor”*, funksionar i lartë i partisë në pushtet, si dhe hetimi i tij bashkë me të tjerët që kishin marrë pjesë në atë *“bisedë”*, por edhe në veprimet e tjera deri sa i ishte dorëzuar komandës së Llapushnikut, e lidhur me *“Shtabin e Përgjithshëm”* në mënyrë që prej andej t’i përcilleshin gjurmët...

Me interes për hetimin shfaqeshin bisedat e *“misionarëve”* gjermanë (pjesëtarëve të shërbimit informativ gjerman BND) të zhvilluara vetëm pak ditë pasi që gazetari i *“Rilindjes”* ishte ndaluar nga *“komanda vendore”* e drejtuar nga Vrasësi i Penduar me Komandantin vendor. Gjatë atyre bisedave Komandanti vendor kishte deklaruar se dinte diçka për të (pranonte një bisedë të rëndomtë rreth njoftimit për aktivitetet e luftës, që nuk kishte zgjatur shumë, prej nga gazetari thoshte se *“kishte qenë i lirë”*), ndërsa për të tjerat, pra zhdukjen e tij, ishte njoftuar nga familjarët, të cilëve u kishte dërguar porosi se do të përkujdesej për të ndriçuar rastin, ndonëse, si kishte deklaruar, *“në ato rrethana ishte bukur vështirë ngaqë armiku vepronte tinëzisht në shumë drejtime”*. I pyetur nga *“misionarët”* gjermanë nëse dinte gjë për *“Ditarin e luftës”*, që ai e kishte mbajtur me vete gjatë gjithë kohës, dhe duhej ta kishte edhe atë ditë, komandanti vendor, kishte shfaqur habi. Kishte thënë se i vinte keq që nuk kishte ditur gjë për të, sepse mund ta kishte pyetur për ndonjë hollësi që do të ishte me interes për luftën...

Pas bisedës së parë me kryehetuesin (atë pasdite) si dhe raportimit tim rreth hapave të mëtutjeshëm të hetimit të çështjes duke filluar nga *“pista e Lipjanit”* (e tillë u quajt nga rasti i

zhdukjes së gazetarit të “*Rilindjes*”, ndonëse në të u përfshinë edhe disa raste të tjera në këtë pjesë), u vendos që në cilësinë e dëshmitarit “të provave” të thirret ish komandanti vendor i asaj pjese si dhe dy të tjerë, bashkëpunëtorë të afërt të komandantit vendor gjatë kohës së luftës, të cilët mund të kishin lidhje me rastin e ndalimit të gazetarit të “*Rilindjes*” dhe qëndrimit të tij (mbajtjes së dhunshme prej njëzet e katër orësh) në shtëpinë përdhese në pjesën e Goleshit, nga çasti që Vrasësi i Penduar (bashkë me dy të tjerë) e kishte dërguar aty e deri sa ishte urdhëruar që të përcillej për në Llapushnik.

Biseda në cilësinë e dëshmitarit e ish komandantit vendor të asaj pjese, kishte rëndësi të madhe, ngaqë pos që mund të nxirrte në pah motivet kryesore të kidnapimit të gazetarit të “*Rilindjes*”, të cilat gjithsesi duhej të lidheshin edhe me “*Ditarin e luftës*” dhe ato që thuheshin në të, që me të drejtë hapte dyshimin se mund të ishte motivi kryesor i zhdukjes, u çelte rrugën edhe veprimeve të tjera, që lidheshin edhe me zbulimin e atyre strukturave, që në kuadër të një hierarkie e cila nuk mund të mohohet, kishte marrë vendime të caktuara, edhe pse pikërisht këtu dhe te kjo çështje do të bëhej çmos që t’i fshiheshin gjurmët në mënyrë që rastet që nuk mund të fshiheshin ndryshe (siç ishte i gazetarit të “*Rilindjes*” dhe të ngjashmëve) t’u krijoheshin shkoputje të palidhshme, e me çka, duke hedhur fajin te ndonjë person “i papërgjegjshëm”, ose te ata që në formë të ndryshme formalisht nuk mund të merreshin në përgjegjësi ngaqë kishin humbur jetën në fatkeqësi komunikacioni dhe në vrasje të pasqaruar e të ngjashme, përgjegjësit kryesorë të mbeteshin të paprekur...

Në të vërtetë, këtë strategji e dëshmoi edhe biseda disaorëshe me ish komandantin vendor, i cili zinte vend të rëndësishëm në hierarkinë politike të partisë në pushtet. I shoqëruar nga dy avokatë, të cilët ishin të përgatitur me të gjitha truqet e mundshme që biseda të mos kthehej në kurrfarë dëshmie, që mund t’i hapte rrugë ndriçimit të mëtutjeshëm të rastit, ish komandanti vendor, thajse në vazhdimësi dhe me përpikëri përsëriti ato që i kishte thënë para dymbëdhjetë vitesh gjatë takimit me “misionarët” gjermanë (agjentët e maskuar të shërbimit informativ gjerman BND), të ripërsëritura po ashtu pak më vonë edhe para dy hetuesve të Hagës dhe një hetuesi tjetër ndërkombëtar për krimet e kryera gjatë luftës ndaj qytetarëve.

Megjithatë, asaj që ai nuk mund t’i ikte komandanti vendor dhe, zuri t’i nxirrte telashe të shumta (edhe përkundër ndihmës së vazhdueshme që merrte nga avokatët të cilët ndërhynin dhe kërkonin pushime për konsultime), ishte deklarata e Vrasësit të Penduar rreth mbajtjes së gazetarit të “*Rilindjes*”njëzet e katër orë në shtëpinë përdhese në Golesh si dhe urdhri që ai kishte marrë prej tij të përcillej për në Llapushnik, bashkë me udhëzimet që nëse nuk tregohet i dëgjueshëm, të përdoreshin edhe armët, ku do t’u dorëzohej personave të caktuar, që ishin cilësuar “ushtarë të Shtabit të Përgjithshëm”.

Pasi që tha se mund të ishte mbajtur pak më gjatë në bisedime (ndoshta me dëshirën e vetë gazetarit ngaqë kishte pasur telashe shëndetësore), ish komandanti vendor zuri të kapej për harresën, ku vazhdimisht si shkak përmendej “çështja shëndetësore e gazetarit”, që kishte kushtëzuar ndalesën, me një rast tha se “ishin pritur disa ilaçe, që ishin kërkuar nga spitali ushtarak i zonës...”

Çështja e ilaçeve që ishin kërkuar nga spitali ushtarak i zonës, edhe pse dukej si një marifet i përshtatshëm i avokatëve me të cilin, komandanti vendor do të mund të nxirrej nga përfshirja e përgjegjësisë në këtë rast, megjithatë ishte dëshmia e Vrasësit të Penduar dhënë në

hetuesi se gazetari i “*Rilindjes*”i ishte dorëzuar me përcjellje të detyruar komandës së Llapushnikut, prej nga atij i kishin humbur gjurmët, atë e lidhte drejtpërdrejt me të.

Kështu, i shtyrë nga avokatët, të cilët e kishin gjithnjë e më të qartë se komandantit të dikurshëm vendor po i ngushtohej hapësira e lëvizjes, me arsyetimin se kishin nevojë që t’i rishqyrtonin të gjitha rrethanat dhe në përputhje me mundësitë që u ofron ligji në raste të tilla, kërkuan një pushim prej njëzet e katër orësh.

Gjatë asaj kohe, iu ktheva dy çështjeve: biografisë së gazetarit të “*Rilindjes*”si dhe rëndësisë që kishte vetë “*Rilindja*” për rrethanat kulturore, shoqërore dhe politike të kohës, prej nga mbase do të mund të shihej edhe motivi kryesor i gjithë çështjes.

Nga shënimet që kisha, biografia e gazetarit të zhdukur para se të punësohej në “*Rilindje*” thuhet nuk vërehej fare. Dihej vetëm se kishte kryer shkollën fillore në Lipjan, ndërsa gjimnazin në Prishtinë, ku edhe kishte vazhduar studimet në Fakultetin Filozofik, dega e gjuhës dhe letërsisë shqipe. Ndërsa me “*Rilindjen*” kishte filluar të bashkëpunonte gjatë viteve të fundit të studimeve, kryesisht me informata rreth ngjarjeve sportive në rubrikën e sportit. Në të njëjtën kohë, kishte bashkëpunuar edhe me gazetën e studentëve “*Bota e re*”. Në “*Rilindje*” ishte punësuar në vitin 1989 si bashkëpunëtor nga Lipjani. Gjatë kohës së shtetit paralel (1991-1998), gjithnjë i lidhur me gazetën “*Rilindja*”, që pas ndalimit nga regjimi i Millosheviqit (në vitin 1990), asokohe në Prishtinë me pengesa të mëdha botohej si “*Bujku*”, ndërsa në Tiranë dhe në Zvicër ruante emrin e përhershëm dhe vlerësohej e përditshmja më profesionale shqiptare, gazetari i zhdukur shihej i lidhur edhe me strukturat vendore të shtetit paralel, në fushën e kulturës dhe të informimit, ku informatat e tij vazhdimisht gjenin vend në buletinin e Qendrës Informative të Kosovës (QIK). QIK kishte një përhapje të gjerë brenda dhe jashtë vendit dhe si i tillë luante rolin e një bulletini zyrtar shtetëror.

Ndërsa për gazetën “*Rilindja*”, edhe pse e dija se ishte e përditshmja kryesor dhe më e rëndësishme e shqiptarëve në gjuhën shqipe jo vetëm në Kosovë, por edhe në hapësirat e tjera të ish Jugosllavisë ku jetonin ata (Maqedoni Perëndimore, Luginë të Preshevës dhe Mal të Zi), nga burimet e ndryshme (të shërbimit informativ gjerman BND, ato të NATO-s, të OSBE-së dhe mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë që merreshin me problematikën e Kosovës dhe të shqiptarëve në hapësirat e ish Jugosllavisë, dhe veçmas nga një studim i zgjeruar i “*Südosteuropa Forschung*” i Mynhenit për veprimtarinë e saj), shihej se “*Rilindja*” ishte më shumë se një gazetë informative ditore. Fjala ishte për një qendër të rëndësishme gazetareske, botuese dhe kulturore me të cilën lidhej i gjithë procesi i emancipimit shpirtëror dhe kulturor të shqiptarëve në këto hapësira nga paslufta e këndej. Gazeta “*Rilindja*”, që kishte filluar të botohet më 12 shkurt 1945, brenda një kohe ishte kthyer në një zëdhënëse të identitetit shqiptar në ish Jugosllavi.

Edhe pse, fillimisht shfaqej si një buletin i përkthyer nga gjuha serbokroate në përputhje me konceptin ideologjik të emancipimit kulturor dhe arsimor socialist, megjithatë, brenda një kohe të shkurtër, me shtypshkronjën, veprimtarinë botuese, atë të teksteve shkollërore në gjuhën shqipe, ishte kthyer në një Abetare të kulturës shqiptare, prej nga kishte buruar informim, dije dhe krijimtari e gjithanshme artistike. Mbas plenumit të Brionëve, të vitit 1966, kur Tito kishte qëruar hesapet me rivalin e tij, Ranković, i cili ishte ngarkuar me shumë deformime ndaj shqiptarëve, “*Rilindja*” kishte marrë një hov si gazetë ditore duke u kthyer në një tribunë të hapur për çështjet shoqërore, politike dhe intelektuale, por edhe në fushën e botimeve të librave, me ç’rast, Redaksia e Botimeve ia kishte dalë të nxjerrë çdo vit mbi

dyqind tituj nga autorët shqiptarë (prozë, poezi, kritikë letrare si dhe vepra nga historiografia) dhe po aq të përkthyer nga literatura jugosllave dhe ajo botërore. Një pune e madhe ishte bërë edhe me botimin e revistave dhe të përjavshmeve, që merreshin me art, kulturë, letërsi, film dhe sport, ku rëndom, gjenin vend krijuesit e afirmuar të këtyre fushave. Në këtë aspekt, thuhej, se “*Rilindja*” kishte lënë prapa gjithë shtypin ideologjik të Shqipërisë enveriste si dhe veprimtarinë e atjeshme letrare dhe artistike të ngurtësuar mbi konceptet e soc-realizmit.

Në analizën më të re të “*Südosteuropa Forschung*”, bëhej fjalë edhe për ndikimin e “*Rilindjes*” në proceset që lidheshin me ngritjen e Kosovës në njësi federative, siç ishin ato me ndryshimet kushtetuese të vitit 1974, si dhe proceset e tjera nga viti 1981 - 1989 dhe deri në vitin 1999, kur Kosova, pas fushatës ajrore të NATO-s (mars – qershorit 1999) ndaj forcave policore dhe ushtarake jugosllave, me rezolutën 1244 të KS të OKB-së të 12 qershorit u vu nën protektoratin ndërkombëtar.

Në këtë analizë gjithëpërfshirëse, roli i “*Rilindjes*” në të gjitha këto zhvillime ishte vendimtar. Për rëndësinë e saj, flet më së miri fakti se ishin gazetarët e “*Rilindjes*” ata që iu kundërvunë fuqishëm fushatës së Millosheviqit për rrënimin e autonomisë së Kosovës më 28 mars 1989 dhe do të jenë po ata gazetarë të cilët, si kundërpërgjigje ndaj puçit kushtetues të Beogradit, më 23 dhjetor 1989, themeluan partinë e parë shqiptare, “Lidhjen Demokratike të Kosovës”, e cila, me mbi 700 mijë anëtarë, me të shpejt u kthye në një Lëvizje kombëtare që udhëhoqi me sukses të madh dy procese historike: shkëputjen e shqiptarëve nga komunizmi dhe shkëputjen e Kosovës nga pushtimi serb.

Bërthama e nismëtarëve të LDK-së, që vinte nga “*Rilindja*”, do të shihet edhe në drejtimin e kësaj partie (në Kryesi dhe Këshill Qendror), po edhe në strukturat e shtetit paralel, që dolën pas Deklaratës për Pavarësi të 2 korrikut 1990, Kuvendit të Kaçanikut (7 shtator 1990) si dhe Referendumit për Pavarësi (1991) dhe Zgjedhjeve të para Demokratike dhe Presidenciale të prillit 1992.

Ajo që është shumë e rëndësishme në këtë proces historik, ka të bëjë me qëndrimin e shumicës së intelektualëve nga radhët e “*Rilindjes*”, që të përkrahin, por edhe të mbrojnë shtetndërtimin e Kosovës në të gjitha fazat, nga krijimi i shtetit paralel e deri te shfaqja e rezistencës së armatosur disa prej të cilëve do të martirizohen për të.

Ky përcaktim historik, mendësinë e “*Rilindjes*” e ballafaqoi, në njërën anë me skeptikë por me kohë edhe kritikët ndaj të ashtuquajturës “rezistencë paqësore”, që ishte institucionale, meqë ajo mbështetej mbi infrastrukturën demokratike të shtetformimit (Deklarata e Pavarësisë, Kushtetuta e Kaçanikut, Referendumi për Pavarësi dhe zgjedhjet e para parlamentare dhe presidenciale të vitit 1992), dhe në tjetrën anë me kundërshtarët e paepur të saj nga radhët e “*Lëvizjes Popullore të Kosovës, LPK*. Ndonëse shumë prej tyre, për arsye taktike dhe strategjike (marrjes “së kalasë nga brenda”), nga themelimi i LDK-së, ishin përfshirë në kuadër të veprimtarisë së saj, pas Dejtonit e këndej, kërkonin që çështja e Kosovës të zgjidhej në rrugë revolucionare, pra me luftë.

Botimet e “*Rilindjes*” në Tiranë dhe në Perëndim (në Zvicër), që konsideroheshin edhe zëdhënës të konceptit të Lëvizjes Kombëtare që drejtonte Lidhja Demokratike e Kosovës, do të mbrojnë me përkushtim kursin e rezistencës institucionale, qoftë edhe atëherë kur ishte më se e qartë se lufta që po e impononte Millosheviqi ishte e pashmangshme.

Këtu dhe te këto çështje zënë fill sulmet e ashpra ndaj “*Rilindjes*” si dhe intelektualëve përreth saj nga linja e revolucionarëve të LPK-së nëpërmes organit të tyre “*Zëri i Kosovës*”, një bulletin ideologjik, që botohej në Zvicër dhe shpërndahej edhe në Gjermani.

Pas daljes në skenë të UÇK-së, “*Zëri i Kosovës*”, fjalorin e njohur kundër intelektualëve shqiptarë - bartës të Lëvizjes Kombëtare, e kishte kthyer në një thirrje të hapur për eliminim e shumë prej tyre nën akuzën ab-billoc se ishin “agjentë të Serbisë”!

Në krye të këtyre listave, me emër dhe mbiemër, shfaqeshin gazetarët dhe redaktorët e “*Rilindjes*”, veçmas korrespondentët e saj në botë, të akredituar në qendrat kryesore të vendosjes, që si profesionistë të spikatur, me dije dhe kulturë intelektuale jashtë stereotipeve ideologjike, me të drejtë vlerësoheshin edhe ambasadorë të njëmendë të mendësisë shqiptare.

Fushata linçuese kundër intelektualëve shqiptarë nga këto qarqe kishte shqetësuar edhe PEN-klubin gjerman (ngaqë shumë nga redaktorët dhe gazetarët, si shkrimtarë të njohur në Perëndim, ishin edhe anëtarë të tij), Lidhjen Botërore të Gazetarëve Profesionistë si dhe shoqatat për të drejtat e njeriut. Të alarmuar për një fushatë të tillë që zhvillohej në një shtet demokratik siç ishte Gjermania ku liria e fjalës së lirë mbrohej me ligj, nga prokuroria gjermane ishte kërkuar që fletushkës t’i ndalohej shpërndarja në Gjermani, ndërsa ata që qëndronin prapa saj të ndiqeshin penalisht.

Sipas analistëve të “*Südosteuropa Forschung*”, që si shihet ishin marrë shumë kohë me zhvillimet e brendshme shqiptare në hapësirën e ish Jugosllavisë si dhe përvijimet e tyre në raport me Beogradin dhe Tiranën si referenca të pashmangshme shoqërore-politike dhe ideologjike, ndeshja e ashpër e “*Rilindjes*” me propagandën enveriste dhe tellallët e saj në perëndim, nuk ishte as e re e as e rastit. Ajo shfaqej nga mesi i viteve të shtatëdhjeta dhe do të vazhdojë deri në fillim të vitit 2000, kur pasi të vendoset protektorati ndërkombëtar në Kosovë, gazeta “*Rilindja*” do të mbyllet, edhe pse ajo ishte e vetmja që i plotësonte kushtet për t’u kthyer në një amzë të vërtetë të shtypit të lirë dhe demokratik në rrethanat e reja!

Pra si e tillë kjo ishte një luftë midis dy koncepteve shoqërore dhe politike brenda për brenda ideologjisë komuniste: në njërën anë atij jugosllav – me vetëqeverisjen socialiste, që konsiderohej si formë liberale dhe kishte mbështetje edhe në Perëndim dhe në Botën e Tretë (lëvizja e painkuadruar), dhe në tjetrën anë atij stalinist – të kultivuar në Shqipëri me një fanatizëm të madh, paçka se vendi ishte kthyer në një gulag të njëmendtë.

Natyrisht, në këtë luftë “*Rilindja*” kishte përparësi të mëdha, si nga pikëpamja profesionale, po ashtu edhe shoqërore-politike, meqë mbronte kursin e emancipimit dhe të barazisë brenda federatës jugosllave, kurs ky që pas ndryshimeve politike në vitin 1966 dhe atyre kushtetuese në vitin 1974, me barazimin e Kosovës me njësitë e tjera të federatës, atë e nxirrte nga tutela e Serbisë të vendosur dhunshëm në vitin 1945 me ndihmën e komunistëve shqiptarë. Gjatë këtij zhvillimi të hovshëm ekonomik dhe shoqëror, ndonëse nuk do t’ia dalë që t’i ngushtojë gjithaq dallimet me pjesët e tjera të vendit, Kosova krijoi institucionet kombëtare nga Universiteti i Prishtinës, Akademia e Shkencave, teatri, filmi, baleti, veprimtaria botuese e deri te ato sportive, me çka shqiptarët po faktorizoheshin gjithnjë e më shumë në kuadër të federatës jugosllave.

Nga ana tjetër, lëvizja ilegale, e cila fillimisht angazhohej për një bashkim revolucionar të shqiptarëve me Shqipërinë si dhe më vonë transformimi i saj në mbrojtje të republikës shqiptare në përbërje të federatës jugosllave, ishte ideologjike. Kjo lëvizje fund e krye ishte e ndikuar nga enverizmi dhe e lidhur me të në forma të ndryshme. Pasqyrimi i kësaj

lidhjeje shihej më së miri në Perëndim, ku grupe të caktuara të migracionit politik shqiptar do të luftojnë për “çlirim” dhe më vonë edhe për republikën e Kosovës nën platformën e marksizëm-leninizmit. Buletinet e saj si dhe pamfletet e tjera ideologjike do ta tregojnë këtë më së miri, ndonëse, më vonë, disa prej tyre do të deklarojnë se “enverizmin” e kishin “mburojë të nacionalizmit” dhe se ky përcaktim i kishte shërbyer “mobilizimit kundër pushtimit serb”.

Kjo “luftë” e pakompromis midis krahut intelektual (me përcaktim properëndimor), që kishte marrë përsipër përgjegjësinë politike duke u vu në krye të lëvizjes shtetformuese dhe atij ideologjik (“çlirimtar”), kur nuk ishte më Jugosllavia e Titos e as vetëqeverisja socialiste, por një realitet kalimtar, siç ishte ai i ripushtimit të Kosovës nga regjimi i Millosheviqit, që me gjithë që ishte e natyrshme të përfundonte me një çlirim të pashmangshëm që për pasojë do ta kishte shtetin e Kosovës, e bartur në Tiranë, duhej të vendoste për profilet e garniturave politike që duhej të vihehin në krye të tij.

Dhe, siç kishte ndodhur pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore kur, po ashtu, në Tiranë ishte vendosur për fatin e Kosovës, që të mbetej në kuadër të Jugosllavisë komuniste, e majta ideologjike, e ndihmuar nga socialistë shqiptarë, e kishte fituar betejën për Kosovën, betejë kjo që kishte kaluar nëpër prapaskenat e krimit (me atentate, vrasje dhe forma të tjera të kërcënimit) ndaj vijës intelektuale-institucionale.

Fitorja e të majtës, nuk kishte si të mos e qëllonte së pari “*Rilindjen*”, e cila do të nënçmohet dhe mbyllet. Ajo paraqiste një hakmarrje të vonuar ndaj saj dhe koncepteve intelektuale dhe demokratike me të cilat ishte thadruar lëvizja kombëtare në vitet e tetëdhjeta dhe ato të nëntëdhjeta.

Ndonëse ky epilog duket paksa absurd përballë rrethanave të reja të mbikëqyrura nga faktorët ndërkombëtarë (SHBA-të dhe NATO), dhe faktit se asgjë nuk mund të ndodhte jashtë skenarit të tyre, megjithatë, raportet politike të vendosura në Tiranë midis komandantëve të luftës që vinin nga resurset ideologjike të lidhura tradicionalisht me enverizmin (në këtë rast si fitimtarë) dhe intelektualëve properëndimorë (në këtë rast si humbës), kishin vazhduar edhe në Kosovën e pasluftës me pasoja të rënda për skenën e saj politike, ngaqë ajo kishte sjellë në pushtet një mendësi revolucionare, të etshme për pushtet me çdo kusht, që për armik kishte vazhduar t’i konsiderojë intelektualët e devotshëm, ndaj të cilëve nuk kishte ngurruar as të përdorte plumbat.

Një copë herë mbeta mbi analizën e “*Südosteuropa Forschung*”. E gjitha, bashkë me disa vlerësime të shprehura rreth këtyre çështjeve edhe në gazetat “*Franfurter Allgemeine*”, “*Die Zeit*” dhe “*Die Welt*”, po ma krijonte bindjen se bota shqiptare gjatë situatave vendimtare historike, për armik kryesor kishte luftën e brendshme politike midis koncepteve shoqërore, atij demokratik dhe atij ideologjik me mjete revolucionare, qoftë edhe në rrethanat e pluralizmit demokratik, siç ishin ato në të cilat po hyhej pas vendosjes së protektoratit ndërkombëtar, ku edhe duhej parë motivin kryesor për të gjitha vrasjet politike të kryera gjatë dhe pas luftës e deri në prag të shpalljes së pavarësisë.

Edhe pse në e parë, krijimi i këtij fiksimi, nuk i takonte natyrës së një hetimi të paanshëm dhe gjithëpërfshirës, i cili duhej të mbështetej mbi fakte dhe assesi mbi paragjykime politike, siç e kërkonte ai në të cilin isha përfshirë, pa marrë parasysh se shumë prej tyre ishin ushqyer pikërisht nga mungesa e shtetit juridik dhe mosveprimi i gjyqësorit ose

edhe veprimi i gabueshëm në të shumtën e rasteve (fjala është për UNMIK-un përgjegjës për sistemin e sigurisë dhe të drejtësisë prej nga edhe mund të adresohen shumë nga gabimet dhe lëshimet), megjithatë, realiteti i krijuar politik dhe shoqëror, me të drejtë shton dyshimin se një pjesë e faktorit ndërkombëtar të vendosjes, kishte ndikuar që partnerët e tyre politikë në Kosovë të jenë të shantazhuar shumanshëm dhe me “dosje të hapura të krimit”, pa përjashtuar edhe atë politik në mënyrë që me ta Kosovës t’i imponohen marrëveshje në përputhje me interesat e tyre?...

Duket se edhe këtë herë, te shqiptarët, interesi gjeostrategjik ia kishte përcaktuar kahun gjeopolitikës në një mënyrë fare të ngatërruar, madje edhe të panatyrshme për rrethanat pas rënies së bipolaritetit bllokist dhe luftës së ftohtë, ku ideologjia duhej “të drejtonte” demokracinë!...

## 8.

Seancën e dytë me Vrasësin e Penduar e caktova pasi që kisha kryer bisedën e ndërprerë me Komandantin Vendor, funksionarin e lartë të partisë në pushtet, rreth rastit të dërgimit me dhunë të gazetarit të *“Rilindjes”* për në Llapushnik, pas mbajtjes njëzet e katër orë në një shtëpi përdhese diku në anën e Goleshit, që Komandanti Vendor, dikur, në bisedë me hetuesit e Hagës, e kishte quajtur “shtab të zonës operative”, ndërsa tash e quante “strehë të përkohshme”, si “shumë të ngjashme në ato rrethana”, që ishte braktisur pas një qëndrimi të shkurtër.

Edhe pse ndryshimi i cilësimit nga “shtab i zonës operative” në atë “të strehës së përkohshme” ishte i një natyre taktike, me të cilën, mbrojtësit synonin që Komandantin Vendor edhe formalisht ta lironin nga çfarëdo përgjegjësie me të cilën ai do të mund të ngarkohej, me ç’rast tumireshin dyshimet se pranë “shtabeve të zonave” kanë ekzistuar edhe “qendrat ndaluese”, pra burgje, të cilat i dëshmojnë edhe komunikatat e lëshuara gjatë kohës së luftës të botuara në *“Zërin e Kosovës”* dhe mediat e tjera në Perëndim dhe, ndonëse Komandanti Vendor, gjatë gjithë kohës u thirr në “harresë”, megjithatë, krijova bindjen se gazetari i *“Rilindjes”* ishte mbajtur dhunshëm në atë pjesë dhe prej andej, me përcjellje të armatosur, ishte dërguar në Llapushnik, ku mandej i kishin humbur gjurmët. Ky veprim del se nuk ishte i shkëputur, por i ndërlidhur me një qëllim të caktuar (*“Ditarin e luftës”*), prej nga rridhte edhe motivi kryesor për zhdukjen e gazetarit me dyshimin se mund të mos ua kishte dhënë shkrimin, ose që ua kishte dhënë, por mund të ishin të dhënat në të dhe mundësia që ato të rrjedhin në forma të ndryshme, që kishin ndikuar për zhdukjen e tij fizike?...

Kjo më shtyri që hetuesit t’i propozoj që Komandanti Vendor, zyrtar i lartë i partisë në pushtet, bashkë me tre bashkëpunëtorët e atëhershëm, të përfshiheshin në hetime dhe t’u caktohej edhe paraburgimi. Si do të shihet, qëndrimi im nuk u mbështet “për arsye formale”, ngaqë dy nga bashkëluftëtarët e Komandantit Vendor, të përfshirë në rastin e gazetarit të *“Rilindjes”* doli se kishin humbur jetën në një fatkeqësi komunikacioni, në rrethana të pasqaruara, ndërsa i treti, kishte emigruar ilegalisht “në një drejtim të panjohur” mu në kohën kur atij po i bëhej gati thirrja për hetime.

Ishte edhe një “rrethanë tjetër teknike”, që kishte penguar qarkun hetues të rastit sipas shtrirjes kohore dhe hapësinore, pra nga çasti i ndalimit (kidnapimit) të gazetarit të *“Rilindjes”*, mbajtjes së tij njëzet e katër orë në shtëpinë përdhese në afërsi të Goleshit (në

shtabin e zonës operative) e deri te dorëzimi i tij në Llapushnik. Pra, gjurmët u kishin humbur edhe atyre që kishin përcjellë gazetarin e “*Rilindjes*” nga Goleshi deri në Llapushnik bashkë me Vrasësin e Penduar, siç u kishin humbur gjurmët fare atyre që e kishin pranuar gazetarin kur Vrasësi i Penduar, me detyrën e ngarkuar nga Komandanti Vendor, ua kishte dorëzuar.

Ky vakum dëshmitarësh dhe të ngjashmit që do të shfaqen gjatë hetimeve, që si do të shihet, nuk do t’i kursejë as dëshmitarët e mbrojtur, seç po ma tumirnin paralajmërimin e tim atë se “*Dosja B*” është një bombë e kurdisur, së cilës duhet t’i laget baruti nga të gjitha anët, në mënyrë që edhe po shpërtheu, të nxjerrë veç tym...

Që të mos mbetesha në ndonjë tymnajë, çastin që duhej ta filloja seancën e dytë hetimore me Vrasësin e Penduar, nëpërmes internetit, në “*Udhëzimet për hulumtime*” po më thuhej se nuk duhej t’i ndahesha hetimit të rastit të gazetarit të “*Rilindjes*” dhe të Lekë SH, meqë me anën e tyre dilnin në pah dy qëllime të parashtruara: që vrasja e kulturës, e historisë, e shpirtit liridashës dhe vlerave të një qytetërimi perëndimor, të përcillej me lindjen e një sistemi tjetër, atij të “çlirimtarëve” me modelin e “heronjve” ideologjikë, me të cilët fillon historia pa histori...

“Gjurmët e tyre duhet kërkuar në drejtim të Malishevës, në Kleçkë... Atje gjendet nyja e konfrontimeve tragjike mbi bazat ideologjike si dhe prapaskenat e ndryshme me të cilat mund të kuptohet si duhet ndërhyrja e vazhdueshme e të huajve në skenën politike shqiptare që në të përherë të instalohen ata që kryejnë detyra, pa marrë parasysh çfarë janë ato, ndërsa, me hipoteka të ndryshme, të eliminohen idealistët dhe ata që nuk shiten...”

Në të vërtetë, ndërlidhja e rastit të gazetarit të zhdukur të “*Rilindjes*” me atë të Lekë SH., dhe atyre të tjerëve që kishin ndodhur në rrethanat e luftës, ishte e natyrshme dhe e pashmangshme, sado që kishte një përpjekje që ato të shikoheshin të ndara, ose të ndryshme fare.

Që këtë e kërkonte mbrojtja e atyre që ishin përfshirë në hetime, kjo ishte e pritshme.

Por, e pakuptueshme dukej kur kjo kërkohej nga ana e prokurorit, i cili, e kishte më se të qartë se me anën e atij procesi, bashkësia ndërkombëtare duhej t’i ndihmonte rikthimit të një rrjedhe shoqërore dhe politike në binarët historik, me çka pak a shumë, do të zhdëmtohej një veprim i gabueshëm dhe i dëmshëm për të cilin ajo mbante përgjegjësi pse kishte ardhur deri aty...

Kundruall këtyre përvijimeve dhe nga bindja se “ngatërrimi i pistave hetuese” do të ishte pikërisht ajo që im Atë thoshte se dikush dëshiron që i gjithë procesi të kthehet në një shpërthim tymi, pra shkas për kusuritje dhe rikusuritje brenda llojit për t’u ruajtur pushteti dhe jo për ta nxjerrë në pah një të vërtetë tragjike bashkë me pasojat, përfundimisht u përqendrova te hetimi i rastit të gazetarit të “*Rilindjes*” dhe zhdukja e tij, duke pasur gjithnjë parasysh se Kleçka dhe vetëm Kleçka duhej t’u jepte përgjigje edhe rasteve të tjera të ngjashme, përfshirë edhe atë të Lekë Sh.

Mbi këtë qëndrim, nga i cili nuk do të heq dorë, e fillova edhe seancën e dytë hetimore me Vrasësin e Penduar.

Si në takimin e parë, Vrasësi i Penduar dukej i hapur. Më tha se takimin e kishte pritur me padurim.

Meqë e dija se ai thujse pareshtur gjatë gjithë kohës merrej në pyetje edhe nga pesë hetues të tjerë, që secili për vete, kërkonte të nxirrte sa më shumë nga dëshmitë e tij, të cilat gjithë rastit mund t’i jepnin kahun e zbërthimit ose edhe të ngatërimit, siç kërkonin avokatët

e mbrojtjes, por edhe nga jashtë, u përpoqa që hetimin ta filloja me fjalët rreth motit të mirë me shumë diell që mbante atë ditë dhe harenë që sjell ai. I thashë, madje, se në Gjermani dhe pjesët e tjera veriore të kontinentit, një orë me diell mjaftojnë për zbrazjen e dyzet orëve të stresit të akumuluar në mendje.

Si me shaka, ma ktheu, se këtu ishte e kundërta...

Kështu, pasi që u solla paksa rreth motit të mirë dhe disponimit, nga e para i hyra rastit të gazetarit të *“Rilindjes”*. Kërkova që të përshkruheshin të gjitha hollësitë e takimit me të nga çasti i ndalimit, shkuarja në shtëpinë përdhese në afërsi të Goleshit, mbajtja atje prej njëzet e katër orë e deri te dorëzimi në Llapushnik treshes së armatosur që ishte e lidhur me atë që quhej Shtabi i Përgjithshëm. Paraprakisht kërkova mendimin e tij rreth gazetës *“Rilindja”* si dhe botimeve të saj (librave), të cilat kishin përcjellë shkollimin e tij po edhe emancipimin nëpër të cilin kishte kaluar nga ditët e para e deri sa mori diplomën e Fakultetit Filozofik.

Sikur ta kishte pritur atë pyetje për t’i ikur atyre me të cilat ishte përballur gjatë atyre ditëve me hetuesit e shumtë, tha se *“Rilindjen”* e merrte për një abetare shpirti.

“Jemi rritur me të dhe shkronjat e saj...”

Tha se tash që nuk ishte, humbja e saj përjetohej edhe më rënd, ngaqë i ashtuquajtimi shtyp i lirë, jo vetëm që nuk e kishte zëvendësuar, por kishte krijuar një rrëmujë të papërballueshme, ku askush më nuk i zë besë askujt.

Në pyetjen time si kishte mundësi që një bashkëpunëtor i asaj (fjalën e kisha te gazetari i *“Rilindjes”*) që ai e merrte për abetare shpirti me të cilën ishte rritur, të trajtohej në atë mënyrë (përmenda fjalën kidnapim dhe mbajtje e dhunshme në një burg privat prej nga pastaj dhunshëm do të dërgohet në Llapushnik dhe do të dorëzohet aty prej nga nuk do të kthehet më), pasi një copë herë uli shikimin dhe zuri fytyrën me duar sikur të dëshironte që të fshihej para atyre që do të nxirrte...

I vetëdijshëm se kishte ardhur çasti kur duhej të rrëfehej, si tha që kjo të pranohej si krim ndaj vetvetes dhe krim ndaj shpirtit, Vrasësi i Penduar, pasi kërkoi një pushim të shkurtër “për me i qitë në terezi të gjitha ato që e mundonin”, kërkoi që rrëfimi i tij të gjirohej filmikisht në mënyrë që t’i shërbejë si dëshmi hetuesisë dhe gjykatës, po sipas nevojës, të hidhet në internet dhe të transmetohej në televizionin publik, në mënyrë që, ajo që e quante vrasje shpirti, të kthehet në një debat publik, prej nga secili mund të shohë pjesën e vetë të përgjegjësisë nga e cila nuk mund të lirohet pa një vetëpastrim...

Meqë rregullat e hetuesisë lejojnë xhirimin filmik të dëshmisë, me të cilën paraprakisht duhej të pajtohej edhe mbrojtja dhe të sigurohej autorizimi i saj për t’u përdorur si dëshmi edhe në rastet e mospranisë së të pandehurit (për shkaqe shëndetësore e të tjera, siç është edhe rasti i vdekjes), dhe pas një konsultimi me avokatin mbrojtës i cili nuk pat nga t’ia mbante, ngaqë këtë e kishte kërkuar vetë i pandehuri, u soll e gjithë pajisja e duhur për xhirim automatik, e shoqëruar edhe me aparate për incizimin e pavarur të zërit.

I qetë fare, me sy nga kamera, pasi u prezantua dhe theksoi të drejtën ligjore që të parashtrohet një dëshmi filmike, me fuqinë e plotë të dëshmisë ligjore, Vrasësi i Penduar tha:

*“Kjo luftë ka prodhë heronj të vramë dhe vrasës të gjallë...”*

*Të parët kanë mbetë në luftë. Dhe të tillë ka shumë. Ndërsa të dytët, paqja i ka ba të pushtetshëm deri aty saqë shumë prej të tyne janë kthye në vrasës...*

*Unë jam vrasës, por jo edhe i vramë, siç dëshiruen me më pa ata që më banë të tillë mue dhe shumë të tjerë...*

*Se jam vrasës, i penduem thellësisht, por jo edhe i vramë përfundimisht sa që atë ta pranoj si gjendje të përhershme me të cilën duhet me jetue, kjo ka të bajë me atë se në saje të disa miqve dhe mbështetjes së familjes sime (bashkëshortes dhe fëmijëve), kam gjetë forcë për me e nxjerrë të vërtetën haptas, në mënyrë që ajo, të shërbejë për fillimin e një pastrimi nga e keqja që na përfshiu (kënd rastësisht e kënd qëllimisht, por që iu nënshtruem ) si dhe vetëdijesimin nëpër të cilin duhet të kalohet pa marrë parasysh çmimi që duhet të paguhet nga të gjithë...*

*Vetëdijesimi nuk ka të bajë vetëm me pendimin për veprat e këqija siç ishin ato në të cilat u përfshiva bashkë me të tjerë, që ashtu i duhet pastrimit tonë prej saj, por ka të bajë edhe me lirimin përfundimtar prej asaj, që me vetëdije ose pa të, e kemi ushqye...*

*Kështu, edhe rruga ime deri te vrasësi kaloi nëpër kërcënime dhe mashtrime ndër ma të paparashikueshmet nga propaganda e nduarduartë e deri te shfrytëzimi i Qendrës Psikiatrike për qëllime të tilla...*

*Pak ma vonë, do të flas edhe për atë se a kishte mundësi me u pengue e gjithë kjo?...*

*Por, po i kthehem mashtrimit, që nuk ia vumë gjithaq veshin. Ai nisi herët. Fillimisht me thashetheme kundër atyne që ishin bartës të Lëvizjes Kombëtare (intelektualëve që drejtonin Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe gjithë atyne që u përfshinë në Lëvizjen Institucionale që krijoi shtetin e Kosovës), dhe pak nga pak, vazhdoi me shpife dhe gënjeshtër ndër ma të randat, të cilat një ditë shkuan edhe deri aty saqë për ta të flitet si për “tradhtarë”, “vegla të Beogradit”, gja që nënkuptonte edhe kundërpërgjigjen ndaj tyne.*

*Këto thashetheme dhe shpifje kundër intelektualëve dhe atyne që ishin të përfshimë në Lëvizjen Institucionale (shtetin paralel), fillimisht vinin “nga anash”.*

*Pak ma vonë, si pëshpërma dhe “shqetësime”, rreth asaj “se mos rruga e zgjedhun, pra rezistenca paqësore, ndrydhte shpirtin liridashës dhe rezistencën” e të ngjashme, nisën me u bartë edhe nëpër degët dhe nëndegët tona?...*

*Ata që nisën me folë për këto “shqetësime”, të shumtën vinin nga disa që deklaroheshin pjesë e lëvizjeve ilegale, paçka se midis tyne kishte patriotë të devotshëm, të cilët ishin në gjendje me dhanë çdo gja për lirinë e vendit.*

*Kur të tillëve u thuhej pse ishin aty, në një “lëvizje të dyshimtë”, ata përgjigjeshin se “duhej të ndihmonin që punët mos të merrnin anën e gabueshme”.*

*Dhe të tillët, pasi që u futën thuajse në të gjitha forumet dhe qeverisjen vendore, filluan të flisnin se “kishin për detyrë për me e marrë Kalanë nga mbrenda”.*

*Mbas një kohe, aty ku shihej se ishte marrë “Kalaja nga mbrenda”, gjithnji e ma hapun thuhej se “qërimi i hesapeve me paqësorët”, ishte detyrë parësore, ngaqë ashtu i hapej rruga rezistencës së armatosun.*

*“Lëvizja duhet me u lirue nga tradhtarët. Ajo u takon atyne që janë në gjendje me vdekë për të...”*

*Me kalimin e kohës, hetuem se në periferi të Qytezës, po mbaheshin disa kruzhoqe. Flitej se në këto kruzhoqe, ku të shumtën mblidheshin të rinjtë dhe ata që nuk kishin gjithaq*

qasje as në shkollimin paralel, gjithnji e ma shpesh shfaqeshin persona të panjohur që thoshin se vinin me detyrë “nga baza” për “me e nda shapin nga sheqeri...”

Në atë “ndamje të shapit nga sheqeri”, intelektualët ma të njohun të vendit akuzoheshin agjentë të Beogradit, titistë, tradhtarë, të cilëve duhet me iu marrë, si thuhej, mandati i popullit, ngaqë ata ishin mashtrues...

Ndodhi që në këto kruzhoqe, filluen të shfaqen edhe të maskuar, për të cilët thuhej se vinin “me detyra partiake” nga dika (aludohej në Shqipërinë dhe përkujdesjen për frymën e bashkimit kombëtar), identiteti i të cilëve,” për arsye sigurie”, nuk duhej të njihej.

Pas përshëndetjeve revolucionare (me grushtin lart) dhe sloganit “Vdekje tradhtarëve”, komisarët me maska, fillonin fjalimet e zjarrra kundër “tradhtarëve” nga “lëvizja paqësore” që ishte “në shërbim të Beogradit”.

Aty nuk kurseheshin as veprat e tyne letrare dhe shkencore.

Flisin për “orët e tyne të fundit”.

Denoncimet e intelektualëve, të cilat ktheheshin në çirrje, përcilleshin me recitimin e poezive “patriotike”, me këngë folklorike dhe aso revolucionare për Enver Hoxhën.

Tallanditë mbylleshin me krijimin e atmosferës revolucionare, me çirrje kolektive për shkreptjen e plumbave kundër “tradhtarëve”.

Pak nga pak, atmosfera e kruzhoqeve, e drejtueme nga komisarët e njohun dhe të panjohun, që vinin nga diaspora, po edhe nga Shqipëria, filloi me na u afrue edhe neve që i takonim qeverisjes vendore, meqë, sipas tyne edhe na duhej me u njohtë me “tradhtarët” vendorë dhe me u shkëputë prej tyne sa ashtë koha, në mënyrë që “lufta e armatosun” të mos sabotohej prej bashkëpunëtorëve të Beogradit, që sipas komisarëve me maska, “gjendeshin kudo”, veçmas në radhët e arsimtarëve “të edukuar me arsim titist”, e që gjendeshin edhe në administratë, gjendeshin edhe në radhën e gazetarëve e kudo tjetër...

Kur përmendeshin gazetarët, atëherë gishti drejtohej nga ata të “Rilindjes”, për të cilët thuhej se “ishin qendra e tradhtisë”, që si titistë, “me urdhnat e Beogradit, “kishin themelue Lidhjen Demokratike të Kosovës dhe lëvizjen paqësore” e të ngjashme, “me të cilët duhet qërue hesapet së pari, në mënyrë që t’i jepej fund mashtrimit dhe tradhtisë...”

Në listën e “tradhtarëve”, si shumë të tjerë (në mos të gjithë), një ditë, u përmend edhe im atë, ndonëse prej vitesh i vdekun. Për të u tha se “ishte bashkëpunëtor i policisë së Rankoviqit”, meqë “sillej me armë në krah”.

Shpifësit nuk e thoshin të vërtetën se ai ishte një roje e thjeshtë pylli, që bartnin çifte me fishekë qorr...

“Njerëz të Beogradit”, pos pylltarëve dhe rojeve të rëndomta, shpalleshin edhe nëpunësit, shpalleshin edhe arsimtarët, shpalleshin edhe mjekët, shpalleshin dhe artistët që mbanin të gjallë aktivitetet artistike, shpalleshin edhe këngëtarët dhe të tillë, pra tradhtarë shpalleshin edhe sportistët që garonin nëpër ligat e vendit...

I dyshimtë dhe tradhtar shpallej kushdo që nuk ishte futur nëpër burgjet serbe gjatë viteve të pesëdhjeta, të gjashtëdhjeta dhe veçmas gjatë viteve të shtatëdhjeta dhe të tetëdhjeta, pale se as disa prej tyne nuk u shpëtonin këtyre nofkave po qe se hiqnin dorë nga konceptet revolucionare dhe ideologjia...

Kështu, në këtë fushatë të shpalljes së tradhtarëve, njollosja e familjes sime nuk ishte e rastit, ngaqë në të, ndonëse në rrethanat e një anatemimi shumëvjeçar si “familje reaksionarësh”, që e kishte nga Gjyshi im, pjesëtarë i Nacionaldemokratikes shqiptare

NDSH, aty ruhej fryma e emancipimit nëpërmes arsimit kombëtar dhe jo me ngarendje pas ideologjive të ndryshme, siç ishte ajo komuniste...

Meqë e zura për gushe njanin nga ata që përhapte shpifje të tilla dhe iu kërcënova se mund t'ia mbyllja gojën edhe ndryshe (ishte një dështak që merrej me kontrabandë cigaresh që si shumë të tjerë, flisnin kundër shtetit paralel dhe trumbetonin luftën e armatosun nëpër çajtores), ai ma pranoi se paguhej nga “njerëz të panjohun” me përhapë ato që ia thoshin...

“Unë jam tellall i atyne që paguejnë kushdo qofshin... Nuk çaj kokën se kush shpallet tradhtar e kush patriot, pos për paratë që marr...”

Kështu, erdhi koha, kur pak nga pak, disa nga veprimtarët e devotshëm të përfshimë në strukturat e shtetit paralel nisën me firue. Dikush për arsye “shëndetësore”, dikush për ndonji “telashe familjare”, e disa pse heshtas largoheshin nga Kosova ngaqë nuk pajtoheshin me atë që po ndodhte, pra me rikthimin e militantizmit ideologjik majtist, që me këto veprime, gjithnji e ma haptas po i përgatitej terreni...

Në këto rrethana, një pjesë e madhe e veprimtarisë së pushtetit vendor sikur u shua. Kërcënimet e shumta që vinin nga të gjitha anët, banë që disa nga nëndegët të kalonin në anën e atyne që, në emën të luftës çlirimtare, luftonin rezistencën institucionale.

Të pambylluna kishin mbetë vetëm shkollat, që punonin disi, por tashma nën mbikëqyrjen e komisarëve, të cilët kishin marrë me i kontrollue edhe tekstet shkollore si dhe plan-programet.

Nëpër disa shkolla “komisarët politikë”, kryenëvete, ia dolën me i heqë nga programi shumë autorë të njohur dhe veprat e tyre me arsyetimin se “për tradhtarët dhe titistët nuk duhej me pasë vend nëpër shkolla...”

Rreth shpartallimit të një pjese të mirë të shtetit paralel në nivel vendor si dhe shfaqjen e komisarëve të ndryshëm si autoritet i dhunshëm, u bisedua në një takim në Ferizaj me përfaqësuesit e mbetun të shtetit paralel të pjesës sonë. Anëtari i Këshillit Qendror të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe nënkryetar i Parlamentit të Kosovës, pasi pranoi se fillimi i luftës kishte ndryshue edhe rrethanat, tha se kyçja në luftë mbetet mjeti i vetëm me të cilin duhet me u çue deri në fund koncepti i shtetit tonë të pavarur.

“Ka ardhë koha që lufta e diplomacisë me ia lëshue vendin diplomacisë së luftës, të cilën mund ta marrin në dorë amerikanët dhe aleatët e tyre. Kjo mundet me u arritë vetëm me luftë... Lëvizja jonë institucionale asnjherë nuk e ka përjashtue luftën, por ka mbrojtë qëndrimin se po qe se duhet me hy në të, atëherë kjo të bahet në marrëveshje dhe bashkëpunim me amerikanët dhe aleatët tanë perëndimorë dhe e drejtue me prej ushtarakëve tanë që kemi në dispozicion...”

Mbasi pranoi se edhe në kreun ma të naltë politik kishte mendime të ndryshme rreth dinamizmit të rezistencës së armatosun, bani të ditun se për me qenë në përputhje me përgjegjësinë historike, udhëheqja ma e naltë e shtetit të Kosovës kishte vendosë për me u kyçë në luftën që tashma Beogradi e kishte imponue dhe se për këtë qëllim, në Oslo të Norvegjisë ishte mbajtur një takim midis përfaqësuesve të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës dhe atyne që flisnin në emën të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ishte arritë një marrëveshje rreth luftës së përbashkët të të gjithë patriotëve nën flamurin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

“Duhet me i lanë manash dallimet... Të gjithë duhet me luftue për të njajtin qëllim...”

*Qëndrimet e liderit të njohun të Lidhjes Demokratike të Kosovës, që fliste në emën të Kryesisë Qendrore, por edhe të Kryesisë së Parlamentit të Kosovës dhe të Forcave të Armatosuna të Republikës së Kosovës (FARK), si dhe disa lajme që mund të ndëgjoheshin nga radiot e jashtme (Dojçe welle, Zëri i Amerikës, BBC e të tjera), na kthyen kah lufta e përbashkët, së cilës duhej me ia ruejtë kursin institucional.*

*Nuk e pata të vështirë që, pasi u morëm vesh me aktivistët e shumtë të shtetit paralel dhe në përputhje me disa këshilltarë të çështjes së sigurisë që erdhën nga Prishtina (kryesisht ushtarakë me përvojë luftarë), të formojmë një njisit luftarë. E quejtëm “Njësiti vendor i vetëmbrojtjes”, ngaqë dëshironim të ruanim frymën e patriotizmit vendor simbas qëndrimit të njohun patriotik se “mbrojtja e pragut të shtëpisë është detyrë e secilit”.*

*Këshilltarët për çështjet e sigurisë, që vinin me mandatin e Forcave të Armatosuna të Republikës së Kosovës, krahas disa pajisjeve logjistike për lidhje me “shtabin e luftës”, na sollën edhe armët e para dhe premtuen se do të përkujdeseshin edhe për armatime të tjera.*

*Aty u zgjodha drejtues i “Njësitet vendor të vetëmbrojtjes” me autorizime që në përputhje me marrëveshjen e Oslos për luftën e përbashkët me vu lidhje me njësitë e tjera që tashmë operonin përreth.*

*Nuk vonoi dhe vëzhguesit e njësitetit vunë lidhje me “Komandën e zonës vendorë”, që i takonte Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.*

*Mbas dy ditësh, në afërsi të Goleshit, u takuem me Komandantin e zonës. Ai na priti mirë dhe tha se respektohej përcaktimi ynë që në radhët e “Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës” të merrnim pjesë si “njësit” që vinte nga radhët e lëvizjes institucionale...*

*Aty njoha edhe disa anëtarë të shtabit, të cilët deri para pak kohe kishin qenë në strukturat drejtuese të “Lidhjes Demokratike të Kosovës” dhe në ato të shtetit paralel. Mes tyre ishte edhe një deputet i Parlamentit të Kosovës. Thanë se lufta ishte mjet i fundit dhe se ajo nuk pyeste për parti e as dallime të tjera...*

*Kjo më mbushi me shpresë se lufta jonë do të jetë e përbashkët dhe larg thashethemeve, fushatave dhe shpifjeve të shfrenueme ndaj atyne që me shumë mund dhe sakrificë kishin drejtue shtetin paralel dhe institucionet e tij për vite të tana...*

*Uroja që kështu me mbetë.*

*Por, nuk vonoi dhe u pa se nuk ishte fjala për luftë të përbashkët, por për luftë për pushtet mbi luftën dhe drejtimin e saj të përgjithshëm. Ajo zhvillohej midis institucionalistëve dhe majtistëve nga radhët e “Lëvizjes Popullore të Kosovës LPK”, shumë prej të cilëve, për vite, kishin marrë pjesë në atë që shfaqej “marrje e kalasë nga brenda”, sado që kishte ndër ta edhe patriotë të gatshëm me punue po edhe me deke për shtetin e Kosovës që po e ndërtonim.*

*Ndonëse dëshironim që kjo përçamje, për të cilën flitej gjithnjë e ma shumë, mos me ndodhë, ajo megjithatë ndodhte dhe shkonte në dam të FARK-ut.*

*Aty nga fillimi i shtatorit, kur nga ofensiva e madhe e forcave policore-ushtarake serbe filluem me u tërheqë në drejtim të Nerodimes dhe maleve të Berishës, Komandanti vendor na bani të ditun se nuk kishte ma, si tha Farkistë dhe as komandë të tyre, pos të UÇK-së.*

*Dha urdhër për me i ndërpre të gjitha lidhjet me eprorët tanë, që ishin edhe pjesë e UÇK-së. Tha se nga ai çast nuk kishte “Njësit të mbrojtjes vendorë” por vetëm “Brigada Pararojë” që, sipas nevojës, kryente detyra përgjimi në prapavijë.*

Nuk foli tjetër pos që tha se Brigada jonë, si njësi rezervë, ishte sistemue në kuadër të një "Shërbimi të Kundërzbulimit". Duhej të operonte në përputhje me detyrat që merrte me anën e kodeve, të cilat vetëm ai mund t'i çkodonte.

Mbas këtyne, Komandanti vendor, më skajoi, dhe vetëm për vetëm, me një revole që e mbante në dorë në drejtim timin, me një gjuhë goxha cinike, nisi me m'i tregue detyrat që kisha, që tha se ishin shumë të rëndësishme dhe kërkonin përgjegjësi të madhe.

"Ashtë nder i madh me punue në një shërbim të tillë... Aty marrin pjesë vetëm të besueshmit dhe ata që janë në gjendje me dekë për detyrën që merret, por edhe me shkrepë në emën të detyrës kurdo dhe ndaj kujtdo..."

Me qëndrimin e atij që fliste nga lartë dhe me revolen që e mbante në dorë tue e sjellë në drejtimin tim, mbasi ma bani me dije se kisha familje për të cilën duhej për me u kujdesë që ajo për më mbetë gjallë dhe mbasi më tha se përpara kisha një mundësi të jashtëzakonshme për me i ndreqë disa gabime "nga e kaluemja me paqësorët", para se të ndahem ma dha një liste me emna.

"Lexo me kujdes dhe pasi t'i ngulitësh në kokë emnat, mos me dalë kurrë prej saj, shkyeje."

Ishin njizet emna, disa prej të cilëve i njihja, por kishte edhe që nuk i njihja. Disa kishin adresa dhe disa jo.

"Midis këtyne ashtë njani që drejton të gjitha veprimet... Ke me e njohtë së shpejti... Ai vepron me kode dhe përgjigjet për të gjitha... Ashtë si hije, sa shihet sa nuk shihet... Por, kur shihet dihet se duhet me i shkue mbas dhe me zbatue urdhnat e tij me fanatizëm... Fjala e tij nuk bahet dysh...."

Në ndamje ma dha një letër të mbyllun dhe më tha se atë duhej me e hapë vetëm kur të shfaqej ai që fshehtas "drejton veprimet", meqë aty ashtë shifra deshifruese e identifikimit të tij...

Atë mbramje, pas dy muajsh nën uniformën e UÇK-së së përbashkët, edhe pse nuk kisha pasur rast të marr pjesë në ndonjë betejë ngaqë të tilla andejpari as që kishte, po kthehesha pa të. Ndjehesha jo vetëm i përjashtuar nga një luftë për të cilën ishim në gjendje edhe me dekë, por edhe i kërcënuar tmerrësisht bashkë me familje dhe me gjithë ata që i kishim takue një lëvizjeje shtetndërtuese...

Pra, nga ai çast, gjithnjë nën kërcënimin e armës që nuk më ndahej nga parafytyrimi, isha vetëm një numër "i fshehur", që duhej me u vu në veprim nga dikush dhe dika vetëm për me zbatue urdhna me anën e të cilave fitoja rastin për me i ndreqë gabimet "si paqësor"! Ky kusht përcaktonte edhe fatin e familjes sime.

Kjo gjendje ma përkujtoi fushatën e komisarëve dhe atyne me maska që shfaqeshin nëpër kruzhoqe dhe flisnin kundër nesh si dhe dënimin që do të na gjente doemos! Ndonëse asokohe nuk ua kishim vu gjithaq veshin doli se ato ishin të njëmendta.

Ashtu, i shkallmuem, nga një ditë e lodhshme dhe i shpronësuem nga ato që më kishin mbajtë deri më atëherë në kambë dhe më kishin dhanë forcë për me u ba ballë të gjitha sfidave dhe me kërcënimin se tash e mbas duhej për me krye detyra për me e shpëtue familjen nga ndëshkimi, po i afrohesha periferisë së Qytezës, e cila, dukej e shkretë. Disa shtëpi të rrënueme dhe të djeguna tregonin përmasat e dhunës së ushtrueme andejpari nga forcat policore dhe ushtarake jugosllave.

*Për habi, aty nuk kishte as rrethim, e as forca policore dhe ushtarake edhe pse dihej se pas një tërheqje prej dy-tre muejsh ishin rikthyer deri te hymja e Grykës, ku kishin vendosë postblloqe të rrethueme me tanke dhe njisi të blindueme.*

*I dëshpëruem se tashma po futesha në një luftë të papastër për me e mbrojtë familjen nga ma e keqja dhe i trishtuem që po ndeshja një realitet të trishtë fare, ku nuk kishte as njerëz e as bagëti, pos ndonjë qeni endacak dhe shpezëve jashtë mbikëqyrjes, për me i shpëtue disi asaj gjendjeje katandisëse, më shkoi mendja për me iu drejtue “Spitalit Psikiatrik” në dalje të Qytezës, apo “Shtëpisë së të Çmendunve”, siç e njihnim të gjithë.*

*Sepse, mendija, vetëm aty nuk vlenin urdhnat e as fuqia e “të mençurve” të pushtetshëm që ishin të gatshëm për çfarëdo marrëzie...*

*Sepse, mendija, vetëm aty, heronjtë, çfarëdo qofshin, talleshin deri në pëshurrje...*

*Ç’ashtë e vërteta, ishte edhe një arsye tjetër, e mbrendshme, që më çonte te Shtëpia e të Çmendunve. Nga ato që diheshin në familjen tonë, thuhej se aty kishte kalue ditët e fundit im Gjysh, i dënuem me burgim të përjetshëm si pjesëtarë i Naconaldemokratës shqiptare. Nga im atë, kisha marrë vesh se Gjyshi, pas dështimit të NDSH-së, në ikje e sipër, ishte strehuar në Shtëpinë e të Çmendunve, e hapun asokohe, ku regjimi komunist kishte mbyllë një pjesë të mirë të kundërshtarëve, të cilët duhej të eliminoheshin me anën e çmendjes... Thuhet se për me gjetë strehë aty, tim Gjysh i kishte ndihmue një psikiatër serbë, i ardhun nga Beogradi, i cili i kishte takue lëvizjes nacionaliste serbe. Çuditërisht, mjeku serb dhe im Gjysh, kishin gjetë gjuhë të përbashkët deri aty saqë psikiatri Gjyshin ta trajtojë “të sëmunë” me një emën tjetër, nga të çmendun që nuk ua vinte kush veshin as kur i lidhnin e as kur i gjuanin në gropën e madhe (vorrin e përbashkët) ngjit me kodrinën e Grykës, ku me siguri se një ditë kishte përfundue edhe ai.*

*Një copë herë koka ime bloi mëdyshjet rreth fatit të Gjyshit si dhe Çmendinën si strehë të tij të fundit shpirtënore, prej nga ai kishte vërejtë realitetin e trishtë përtej rrethojës së saj.*

*Asokohe, si nacionalist që ishte, duhej të përfundonte në një çmendinë...*

*Kjo mund ta kishte ngushëllue, ngaqë nuk kishte “kushtin e dëshmimit” për me u kthye në vrasës për me e shpëtue familjen, siç m’u dha mue...*

*M’u ba se Gjyshin po e shihja diku tue ma ba me dorë... Sikur po më thoshte se kohët përsëriten...*

*Ato përthymje qofshin edhe ngushëlluese me përfytyrimin e tim Gjyshi, i cili kishte pasë një ideal, sadoqë bashkë me të kishte përfundue në Gropën e Grykës, gjë që këtë do t’ia dëshiroja vetit për me e shpëtue familjen nga ma e keqja, ndoshta edhe mund të zgjasnin, po mos të ishin disa të shtëna nga mbrapa dhe një lëvizje e njisive policore që po krijonin një rreth nga gryka në drejtim të kodrinës përballë ku gjindej Shtëpia e të Çmendunve...*

*Hetova se para tyne, tashma një grup njerëzish, kryesisht të moshuem dhe disa fëmijë po vinin nga unë...*

*Nuk vonoi dhe turma e të moshuemve dhe ata pak fëmijë (pesë a gjashtë fare të shkallmuem) më morën me vete në drejtim të Shtëpisë së të Çmendunve, me dyer të hapuna...*

*Në hymje të saj, rrinin roja (me uniforma të kaltra) dhe disa të huej, që fotografonin secilin prej nesh dhe sapo e banin këtë, me një mirësjellje të ftohtë, na jepnin nga një bukë, një shishe ujë dhe një batanije...*

*Ma tutje, në pjesën e lulishtes që lidhet me pavijonin në të djathtë ku ne drejtoheshim, rrinin dy motra nderi, që ndihmonin të shkallmuemit me hy mbrenda.*

*Nuk e di pse, por më pëlqeu trajtimi i viktimës, i atij që kishte mbetë i humbur në vijat e turbullta të luftës, por as i dobishëm në “vijat e pages...”*

*Në atë gjendje, në thellësinë e terrimit të pavijonit, iu dhashë një fashe të çuditshme shpirtnore, ku njeriu, i zhveshur nga të gjitha, kthehet në një qenie pa emën dhe pa vlerë fare çfarë ndjehesha në ato rrethana...*

*Më kujtohet se nga ajo gjendje ku do të rrisha përgjithmonë më nxori çirrja e njanit që më kishte zanë përfundi...*

*I trishtuem, hetova një me fytyrë të çartun, me vija gjaku të përzieme me lot dhe jargë, që po më mëshonte shkujdesshëm me grushte...*

*Nga pesha e atij trupi dhe të rënat sipëri, u lirova atëherë kur dy veta, me veshje të bardha (roje të shtëpisë), e nxorën zvarrë prej aty...*

*Përreth hetova një pamje tepër të mjerueshme të të shkallmuemve, disa prej tyre rrinin të shtrimë si të vdekun...*

*Nuk e di pse më erdh mirë kur nuk i pashë fëmijët që hynë me ne në atë pavijon...*

*I “çliruem” disi nga kërcënimi i ngufatjes dhe i dëshpëruem se gjendja ime kishte mbetë e njëjtë, gjithë ditën e kalova aty si një zvarranik...*

*Drita e dobët që mezi hynte nga dritaret me xhama të megjulluem si dhe ajri i ndotun, ndonëse nxirrnin pamjen e një mjerimi të thellë katandisës, megjithatë, mbronte nga realiteti trishtues, ku vriteshin të dinjitetshmit dhe kremtoheshin vrasësit...*

*Vetëm nga mbramja, kur sekush hapi dyert e prapme, një shkuj i lehtë, më nxori nga kollofitja në të cilën po sharroja gjithnjë e ma shumë...*

*“Këtu frymojnë të gjallët e vdekur”, po më thoshte një asmatik që e kisha pranë dhe mezi merrte frymë.*

*Me një të lëvizur koke ia miratova ato që tha, ndërsa ai nis me më tregue për masakrat që kishte pa para dy ditësh në dy katundet në drejtim të Grykës.*

*“Shkijet m’i vunë në thika nipat e vegjël...”*

*Kur i tha këto e zuni një kollë e thellë që iu kthye në gufatje që nuk po i hiqej... Nisi me vjellë dhe ashtu i shkallmuem u shemb për dysHEME...*

*Ata që e morën, ishin dy veta nga shërbimi shëndetësor, thanë se e kishte pasë puna e tij...*

*Fjalët për nipat që ia kishin vu në thika si dhe gufatja e randë, që ia shtjerri frymën, më krijuan asi ngërçi përmbrenda saqë brofa në kambë dhe dola jashtë si i krisur...*

*I shkalluem fare dhe me ndjenjën e neverisë, me sy po kërkoja pavijonin e të çmendunve...*

*Një za i fshehun diku në mue po më thoshte se aty e kisha vendin... M’u ba se ishte i tim Gjyshi që po më përqueshte...*

*I bamë dyfish, iu afrova pavijonit të skajshëm. Nga dritaret pa xhama, po më hapej pamja e një rituali lakuriq, në të cilin ishin përfshi disa veta, të zhveshun deri në lëkurë...*

*Të zhveshunit lëviznin poshtë-nalt me disa flamuj të shkyer në duer (jugosllavë, shqiptarë dhe një i kaltër, i bamë fitil).*

*Flamujt për ibret, herë i puthnin, herë ia përplasnin njani tjetrit, e herë i fshinin koqet dhe bythen...*

*Përballë asaj përhumbjeje neveritëse, së cilës thuejse po i bashkohesha, ishte një dorë e fortë nga mbrapa, që më ndaloi... Po më thoshte se më duhej edhe pak kohë me hy aty ku nuk kishte kthim mbrapa...*

*Pa kthye kokën me pa atë që po më largonte prej andej, i shpronësuem fare nga çfarëdo mendimi dhe pa ndonji qëllim, hetova që kambët po më çonin drejt portës kryesore, ku përskej rojeve dola në rrugë prej nga në të djathtë të saj, mora rrugicat që çonin në pjesën lindore të Qytezës, ku ishte lagjja ime...*

*Çuditërisht, në atë ecje si pa kokë, kisha përshtypjen se lëvizsha nëpër një askundje të pafund, ku kanë vendin ata si unë...*

*Kjo edhe më pëlqeu saqë nisa me lëvizë shturshëm andej-këndej me çirrje të ngjashme të atyne në pavijonin e të çmendunve...*

*Nuk e di sa kishte zgjatë kjo, por e gjitha kishte marrë fund në një shtrat druni, në një dhomë të mbyllun, me një qarshaf të bardhë mbi trupin tim lakuriq, që kundërmonte fliqti...*

*Heshtjen shurdhe aty e thyen dy veta që më kapën zvarrë dhe pasi kaluem një korridor me dritë të verdhë, më futën në një dhomë tushi, prej nga uji i vaktë, nxirrte një avull të lehtë. Përplasja e currilave të ujit mbi lëkurën e plasarit ma krijoi përshtypjen e një lirimi nga diçka e pistë...*

*Prej aty, mbasi m'i dhanë disa rroba të përhimta në të cilat sharrova fare, më dërguan në një dhomë të ndritshme, me një tavolinë të madhe në të djathtë, ku, nga manteli i bardhë dhe syzat e thella hetova dikë që më dha shenjë të ulesha.*

*Pasi më përshëndeti në serbishte dhe më pyeti se a e kuptoja, gjë që me një të lëvizun të kokës pohova, më tha se sjellja ime e mbramshme, diku në pjesën e skajshme të Qytezës, ndonëse nuk mund të përshkruhej si e një të çmenduni siç ishte e shumicës së atyne që gjendeshin në atë ambient, megjithatë jepte shenjat e një thyemje të randë shpirtënore, që lehtë mund të kthehej në një çrregullim shpirtënor me pasoja të randa, që nënkuptonte nevojën e një trajtimi psikiatrik...*

*Më tha se duhej të qetësohesha dy-tri ditë në pavijonin ndihmës në mënyrë që mandej me u pa gjendja e njëmendë...*

*Ai tha se në pavijonin ndihmës kishte shumë e shumë si unë për të cilët ai ndjente keqardhje ngaqë ishin viktimat të dhunës së përgjithshme...*

*Tue folë për dhunën, tha se ajo vinte nga të gjitha anët, më tha edhe fjalë të tjera, të cilat, në kokën time lamsh po i humbnin kuptimet...*

*Me atë pështjellim në mendje, u futa në pavijonin ndihmës, ku mezi gjeta një vend... E habitshme më erdh se në atë mori nuk njihja kënd dhe nuk më njihte kush...*

*Dukej se të gjithë ishim pjesë e një shpërfytyrimi që na kishte zhvlerësue njëjtë, prej nga nuk kishte kthim mbas...*

*Por, ajo gjendje zhytëse që sikur po më pëlqente, njëherash më trishtonte, ngaqë ma përkujtonte Gjyshin tim, që kishte përfundue ashtu pse kishte një ideal, që i frikësohej regjimi komunist, ndërsa nga unë, i vramë nga brenda, nuk frikësohej askush...*

*Dukej se as pranimi i realitetit të çmendisë dhe nënshtrimi asaj nuk ishte në gjendje për me e ndalë çmendinë e realitetit...*

*Kështu, të nesërmen në mbramje, kur po rrija me sy të pikasun në një pikë në tavan ku kishte mbetur e kyçur një mushkonjë, m'u rras njëri, që më tha se më kërkonte gjithandej, po që nuk e kishte të vështirë të më gjente, ngaqë aty përfundonin frikacakët e mençur...*

*E shikova qetë dhe sërish iu ktheva mushkonjës së kyçur me bindjen se ishte njëri nga ne që kërkonte paksa të hapej.*

*“Punës sonë sikur i shkon roli i atij që gjen strehë këtu...”*

*Kur m’i tha këto, nxori letrën, të ngjashme me atë që ma kishte dhënë Komandanti vendor kur me revolen që e mbante në dorë ma pat ba me dije se i takoja “njisitet të veçantë”, që komandohej nga një i panjohur, pra nga një Komandant tebdil, që shfaqej herë pas herë për me krye detyra...*

*Mjaftoi ai shikim i letrës, që sa ora të ndjehem pjesë e një gjësendi të zbrazur nga qenia e vet, i shpronësuem deri aty, t’u nënshtrohet urdhnave çfarëdo qofshin...*

*Mbasi që më kot u mundova me gjetë ndonji gjurmë të kundërshtisë në vetvete apo diç të ngjashme, me ndjenjën e atij që për me e shpëtue familjen nga ndëshkimi që nuk e meritonte, lëviz simbas urdhnave, pa folë, u nisa mbas tij...*

*Në atë buzëmbërme me ajër ngulfatës, gjithnjë me përfytyrimin përpara të fëmijëve që kërkonin për me i mbrojtë nga ata që i mbanin diku me thika në fyt, me rrobat e spitalit, nëpër përroskë kaluem nga ana e kodrinës, në drejtim të Grykës. Heshtja e thellë, që lëshohej me terrin e parë, thyhej nga ndonjë e lehur e qenve.*

*Para se të futeshim në Grykë, ndaluem te një shtëpi gjysmë e rrëzuar nga predhat. Komandanti i panjohun, që më drejtonte, i ra përreth dhe ma bani me dorë ta ndiqja mbas në pjesën që lidhej me përroskën. Në një si kasolle të mbushun me sanë dhe pajisje pune (lopata, tërfurq e të tjera), zhveshi rrobat e spitalit dhe i veshi një palë të zeza, që i rrinin ngjitë për trupi. Një palë të ngjashme m’i la para, që kur i veshja më rrinin ngjitë për trupi. Nga pjesa e errët e kasolles nxori dy strajca. Njërin e mbajti për vete dhe tjetrën ma dha mue. Kërkoj që prej saj të nxirrja revolen me fishekë si dhe bombat varëse bashkë me rripin, që duhej ta veja në brez. Aty ishte edhe një thikë si dhe një bateri dore. Më tha se duhej të pritnim deri nga gjysma e natës kur do të vinin edhe të tjerët nga njisiti për me marrë pjesë në një aksion të rëndësishëm, i caktuar nga baza.*

*Fjalën “bazë” e theksoi dukshëm për me ma ba me dije fuqinë e urdhnit që duhej me iu nënshtrohej pa asnjë fjalë.*

*Nga dëshira mos me e pa e as mos më e ndëgjue, pra si një hiç-hiç që ka parasysh vetëm shpëtimin e familjes nga thikat në fyt, u shtriva i thyer mbi barin e thatë me përshtypjen e të zanunit peng, por pa dhunë...*

*Në atë gjendje se si më shkoi mendja te pavijoni ndihmës, ku kisha kaluar natën e fundit i liruar nga çfarëdo mendimi...*

*Nga përhumbla më nxorën ardhja e dy-tre vetave, që hynë heshtas dhe u përshëndetën me të panjohurin, tue e quejtë “Komandant”.*

*Kjo mjaftoi që edhe unë i zbrazur nga vetja dhe i kthyer në një qenie që përulësisht pranonte gjithë ato që i vinin nga jashtë, t’ua kthej përshëndetjen me grusht nalt.*

*Mbasi u rreshtuem, Komandanti tha se në vend të emnave, kishim shifra, dhe se ato duhej me i përdorë në komunikim me njani-tjetrin.*

*Mue m’u dha shifra M.*

*Komandanti tha se shifra e tij ishte X.*

*Komandanti X nuk tha tjetër, pos asaj se po niseshin për me krye detyrën.*

*Treshja, së cilës i takoja përshëndeti me grusht dhe iu vu mbas.*

Mbas një orë udhëtimi në drejtim të lindjes, pra kah Nerodimja, u ndalëm para një shtëpie të rrasur skaj malit. Agsholi i mëngjesit kishte fillue me i nxjerrë në pah kunorat e drunjve përreth.

Komandanti X, eci para dhe na bani me dorë me e rrethue shtëpinë nga ana e mbrapme. Dha shenjë me u takue te dritarja e parë. Aty na tha se detyra jonë ishte kapja dhe nxjerrja jashtë e një personi të kërkuem nga Shtabi, që duhej marrë me vete... Po që se do të kundërshtonte, do të përdorej nënshtrimi i shpejt fizik, pa armë dhe qetësimi me një sprej, që e kishte ai. Nëse, rastësisht shfaqej ndonjë pengesë përreth, ato duhej eliminuar me anën e përdorimit të armëve. Aksioni duhej me përfundue brenda njizet minutash.

Për habi, Komandati X, kaloi me shpejtësi nga dhoma e parë deri te një në skaj, ku u fut, pasi hapi derën dhe iu hodh sipër njërit që flinte.

Ia mbylli gojën me disa fasha dhe sytë me një shami. Mandej ia futi një strajcë të zezë në kokë. Dhe pasi ia lidhi duert, e ngriti në këmbë dhe e vuri para.

Njeriu i trishtuem, nuk bani asnjë kundërshtim. U dorëzue sikur me pas pritë atë që i ndodhi. Në atë gjendje, m'u duk se pashë veten time para Komandantit vendor kur ma kumtoi vendimin për shpërbërjen e njisitit tonë në kuadër të FARK-ut dhe shkrirjen e dhunshme në UÇK-në e tij.

Nëpër ferkun e dritës ecëm në drejtim të katundit Z. Komandanti X përpara, ndërsa na, me të lidhunin në mes.

Mbas një ore pamë katundin Z. Komandanti X, mori personin e lidhun me vete dhe na tha të ktheheshim te baza, pra te kasollja ku ishim takue dhe aty të linim uniformat dhe armët. Më tha se duhej me u kthye në çmendenë...

“Aty e ke vendin deri sa të përfundojë lufta...”

Më erdh mirë që do të kthehesha në çmendenë, por më erdh keq që kipci im me përkushtimin që të shpëtonte familjen, kishte mbetur edhe ma tutje të nëpërkambej nga të tjerët...

Këto veprime u përsëritën edhe gjashtë herë brenda tre muajsh. Gjithnjë nën trysinë e ilaceve që më jepeshin nga të cilat më turbullohej koka, i përhumbar fare, mora pjesë në kidnapimet që kryheshin natën, nëpër prita të ndryshme, me përjashtim të gazetarit të “Rilindjes”, që e bëmë ditën, sikur të dukej një shoqërim i rastit, kur ai po lëvizte në drejtim të Lipjanit. Ngjashëm vepruem edhe ndaj njërit nga Prizreni, që ishte argjendar, të cilin na u dha detyra që, kur po shkonte në drejtim të Suharekës, me anën e një mashtrimi, gjoja kërkonim ndihmë për automjetin që na kishte lënë në rrugë, ta nxirrnim nga vetura, ndërsa bashkudhëtarin i tij ta linim të alivanosur në hendekun skaj rrugës, sikur të kishte pësuar ndonjë aksident.

Këto dy veprime i kryem pa uniformat e zeza, por me maska. Duhet me cekë, se në këto kidnapime, nuk mori pjesë Komandanti X, meqë këto detyra bashkë me udhëzimet si duhej me veprue, m'u besuan si “mirënjohje për lojalitetin tim ndaj UÇK-së”.

Po ashtu, me vete kisha bashkëluftëtarë nga “njësiti vendor”, që i njihja mirë e mirë e me të cilët kishim filluar luftën ndryshe, atë kundër pushtuesve, por që kishim përfunduar në një tjetër, kundër vetes... E dija se edhe ata ishin njësoj të kërcënuar...

Se isha përfshi në një luftë me shumë ngatërresa, që do të hajë edhe ata që në të kishin hy pa hile, këtë e kisha të qartë çastin që njësiti ynë dhe të ngjashmet në atë pjesë, që u takonin Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK), u shpërbënë, ndërsa ne, të

të kërcënuem dhe të kushtëzue me fatin e familjeve, u shpërndamë në formacione dhe në detyra të ndryshme pa u pyetur fare.

Por, që ky veprim do të përcillej edhe me kurthe të ndryshme deri te vrasjet e kurdisura, siç u ndodhi dy luftëtarëve që kisha me vete gjatë dy kidnapimeve (të gazetarit të “Rilindjes” dhe të një argjendari nga Prizreni) për të cilët u tha se kishin humbë jetën në një fatkeqësi komunikacioni diku në Grykë, ketë nuk ma kishte marrë mendja.

Te kjo pikë, megjithatë, duhet me u ndalë për me tregue qëndrimin tim prej ma shumë se tre muajsh në Pavijonin ndihmës të Spitalit Psikiatrik në pjesën e skajshme të Qytezës në drejtim të Grykës, që ishte kthye në një vend prej nga vepronte një “komando e veçantë lufte”, që merrej me kidnapimin e njerëzve shumë prej të cilëve, si mora vesh ma vonë, do t’u humbin gjurmët përgjithmonë në atë luftë.

Sa herë që sjell dhe përcjell nëpër kokë atë lëmsh që edhe ma tutje shumëçka e tij në mue ka mbetë e ngatërrueme, mendja më ndalet te ajo se a ishte rastësia që e krijoi këtë fakt, pra futja në Spitalin Psikiatrik që më doli para atij udhëkryqi si strehë e përshtatshme përderisa ta merrja veten, apo çdo gja ishte parapa që me përfundue aty ku mandej, fare “rastësisht”, do të më gjente Komandanti X?

Edhe pse këtij pështjellimi nuk kam qenë në gjendje me ia dhanë përgjigjen, ngaqë siç thashë edhe në fillim, nga çasti i shpërbërjes së “njësitit të mbrojtjes vendore” së cilës i kisha takue nga fillimi i luftës dhe dërgimi në një komando “me detyra të veçanta”, siç ndodhi kur FARK-u u përjashtue dhunshëm nga lufta e përbashkët, kisha ndjenjën e një gjasendi të zbrazur që nga pesha e kërcënimit ndaj familjes si dhe përkushtimi që ajo me çdo kusht të shpëtohet, pa marrë parasysh çmimi, vetëm lëviz dhe i nënshtrohet çfarëdo urdhni të kujtdo, megjithatë do të përpiqem që gjatë kësaj dëshmie të përshkruej gjithë ato që kanë ndodhë aty dhe prej andej, në mënyrë që prej tyne me dalë e vërteta.

Pra, në Pavijonin ndihmës të Spitalit Psikiatrik ose të Shtëpisë së të Çmendunve, gjithnji me ndjenjën se isha një gjësend i zbrazët dhe i lëvizshëm nga kushdo, pra një hiç-hiç që mendon vetëm për shpëtimin e familjes së kërcënueme, u ktheva mbramjen e kidnapimint të parë, viktimë e të cilit ishte një postier i rëndomtë, “faji” i vetëm i të cilit kishte qenë se dinte për çequet e të hollave nga Beogradi, që merrte rregullisht familja e një “komandanti” të vetëshpallur në emër të pensioneve nacionale që Serbia ua kishte ndarë bashkëpunëtorëve të tyre besnikë midis shqiptarëve që nga koha e krallësinës e këndeje. Këto çeqe, nuk ishin ndalur as në kohë lufte, e as ma vonë, kur Kosova ishte futë nën protektoratin ndërkombëtar si dhe mbas shpallje shtet i pavarun...

Mbas kidnapimit të parë, pra postierit të shkretë, që na dridhej në duar gjatë asaj ecjeje deri te katundi Z, gjithnji sipas urdhnave që sillte Komandanti X, u erdhi radha edhe personave të ndryshëm (një pylltari, një roje, një postieri, dy tregtarëve si dhe tre mësuesve).

Këto detyra “të veçanta”, që shfaqeshin “si pjesë e luftës”, merrnin fund me dorëzimin e të kidnapuemeve “shtabeve vendore” prej nga ata dërgoheshin në qendrat e ndalimit, ose në burgjet e përkohshme pranë “shtabeve të tjera” deri te ai “i përgjithshmi”, që si u muar vesh pak ma vonë, shumicës prej tyne u kishin humbë gjurmët përgjithmonë, për çka, edhe pse nuk kam marrë pjesë në likuidimin e tyne, ndjehem thellësisht fajtor, madje edhe fajtori kryesor, ngaqë pa veprimet e mia dhe të komandos që i takoja, paçka se në të veproja si një telekomando që drejtohej nga jashtë, zor që kishin me u ra në dorë...

Unë, pra, (ndonëse i mbërthyem nga ajo gjendja e shkatërrimit të personalitetit për të cilën u desh vite qetësie që pjesërisht ta riktheja ), jam vrasës i dyfishtë...

Ndërsa Spitali Psikiatrik ose Shtëpia e të Çmendunve në hymje të Grykës, u kthye në një strehë të atyne të sëmurëve, që u shërbenin vrasjeve...

Ç'ashtë e vërteta, Spitalit Psikiatrik ose Shtëpia e të Çmendunve në hymje të Grykës, vazhdoi me qenë strehë e atyne të sëmurëve shpirtërisht (e jona), që u shërbenin vrasjeve edhe pas përfundimit të luftës, gja që i jep të drejtë dyshimit se ajo nuk ishte e rastësishme as gjatë luftës, e as ma vonë, por që, si do të shihet, ishte zgjedhur qëllimisht, që edhe po që se një ditë zbulohen ato që kanë nisë prej atje dhe paraqesin kapitullin ma trishtues të kësaj lufte të mbrendshme, e gjitha t'i vishej çmendinës dhe të çmendunve...

Kur mendoj shumë e shumë rreth kësaj pune, atëherë, del se krahas vrasësve, pra neve që me kërcënime dhe mënyra të tjera ishin kthyer në pjesë të komandos që kryente detyra sipas urdhnave që vinin nga dika, në Shtëpinë e të Çmendunve kishte edhe mjekë që aty ishin futur me këtë detyrë, kishte edhe pjesëtarë të sigurisë e deri te rojat, që i shërbenin këtij zinxhiri, që ashtë vështirë t'i gjendet filli po edhe fundi ngaqë e vërteta shpallet për çmendi, ndërsa çmendia si e vërtetë...

Dhe kur ato ngatërrohen dashas, si në rastin tim, atëherë ai që e thotë të vërtetën shpallet i çmendun, ndërsa ata që e fshehin të vërtetën, kërkojnë “mbrojtje” nga “liria” e të çmendurve!...

Sidoqoftë, unë thuajse përfundova në Shtëpinë e të Çmendunve prej nga, me etiketën e të shthururit të pashërueshëm nga “tmerret e luftës” e të ngjashme që u visheshin atyne që nuk mund t'u hiqej flama në rrethanat e vendosjes së protektoratit ndërkombëtar, nuk do të dilja kurrë. Duhej pra me luftue me mish e me shpirt kundër kësaj gjendje që kërcënonte të më shkatërronte përgjithmonë.

Që nuk përfundova në Pavijonin e Mbyllun, ku futeshin “të pashërueshmit”, e prej nga nuk kishte kthim, ia di për nderë pikërisht psikiatrit që më kishte trajtue herën e parë kur kisha dalë nga Pavijoni i Skajshëm dhe në kërkim të shtëpisë, kisha përfundue në një bllaçuk afër fare i shthurur, me ç'rast ai më kishte dërgue në Pavionin Ndihmës, ku sado kudo trajtoheshin përkohësisht të shkallmuemit shpirtnisht nga lufta...

Pra, po ai mjek (që mora vesh se ishte kroat nga Janjeva), fillimisht nuk kishte lejue me më dërgue në Pavijonin e Mbyllun, e më vonë më kishte ndihmue për me u ra në dorë amerikanëve, me çka u lirova nga kthetrat e atyne që nga frika se mund të nxirrja në pah ato që kishin ndodhë gjatë dhe menjherë mbas luftës (kidnapimet dhe vrasjet e shumta në rrethanat kur gjendja ime shpirtnore ishte jostabile), banin çmos për me më lanë aty me etiketën e të çmendunit të pashërueshëm, që duhej mbajtur të lidhun.

Natyrisht se gjendja ime u përkeqësue mbasi që nuk më lejonin të largohesha nga Spitali, me arsyetimin se “kisha nevojë për mbikëqyrje psikiatrike”.

Ishin të kota arsyetimet se ndjehesha me shqetësime, por assesi “i rrezikshëm” për familjen dhe mjedisin. Disa herë tentova edhe të ikja, por vazhdimisht më kthenin, ku më jepnin qetësues tepër të randë...

Nji mbramje, erdhi prapë Komandanti X. Më tha se edhe ai kishte telashe shëndetësore, dhe se, bashkë me dy-tre të tjerë, aty kërkonte shërim.

Edhe pse shtirej se kishte depresione, nuk i besova. Dhe kisha të drejtë. Sepse, nuk vonoi, dhe mbasi më “nxori për me shetitë” në anën e skajshme, më futi në një barakë të

ndërtueme së voni, ku thuhej se rehabilitoheshin ata që lufta e fundit u kishte lënë telashe shpirtërore. Baraka kishte pajisje të reja dhe rregull që dallonte shumë nga ato të pjesës tjetër të spitalit, gjendja e të cilave ishte përkeqësue edhe ma shumë pas luftës, në vend se të ndodhte e kundërta.

E mora me mend se ajo ishte pjesë e Komandos së dikurshme, prej nga vepronim “me detyra të veçanta” për me kidnapue njerëz.

“Lufta ende nuk ka përfundue... Kemi për detyrë me vazhdue punën tonë, ngaqë uji fle e anmiku jo...”

Pranë kisha disa të tjerë, që nuk i njihja, po mendja ma thoshte se ishin pjesë e “komandos” që do të vazhdonin punët e veta.

“Mos mendo se po punojmë kryenëvete... Ndërkombëtarët i kemi padronë kryesorë... Tash bajmë edhe punën e tyne...”

Kur m’i tha këto, ma përkujtoj familjen, për të cilën më tha se më priste pasi që të kryheshin disa punë të papërfundueme që i duheshin vendit...

Dy ditë e dy net mbeta aty. Nga ilaçet që m’u futën në gojë me kërcënim ndjeja një shkallmim të atillë shpirtnor, saqë nuk baja ma dallimin midis andrrës dhe zhgandrrës, midis të mirës dhe të keqes... Kisha harrue madje edhe mallin për familjen (gruen dhe vajzat për të cilët më thuhej se ishin diku në Tetovë dhe do të ktheheshin së shpejti bashkë me refugjatët e shumtë).

Në atë gjendje fare të megjullueme, një mbarmje, më morën me vete dhe pasi iu afruem Prishtinës, ndaluem pranë një shtëpie, ku na u tha se duhej me krye një detyrë të randësishme (likuidimi i një njeriu tepër të rrezikshëm përgjegjës kryesor për masakrën e Reçakut, ku më kishin mbetë katër nga kushërinjtë).

Mbasi na u dhanë armët dhe na u tha edhe një herë se duhej me ia heqë flamën fajtorit kryesor për masakrën e Raçakit, se si më erdhi një dëshirë e bëftë me e përdorë armën sa ma parë dhe me vra...

Ma vonë mora vesh se dëshira për me vra vinte nga një lloj droge që u jepej vrasësve... Këtë e përjetova edhe unë ngaqë mezi prita me dalë te dera ai që ishte dënue me vdekje, që sapo u shfaq, pa ndonji shenjë, nga “Shkorpioni”, ia zbraza breshërinë e plumbave në krahnor...

Me siguri se do të vazhdoja të gjueja mbi të edhe me plumbat e karikatorit të dytë, por ishin dy të tjerët, që morën pjesë në këtë veprim (nuk e di se a kishin zbrazë armët) që më ngrehën drejt veturës që na priste poshtë, ku më përplasën në pjesën e mbrapme dhe sharrova në një megjullim të qetë jashtë çdo ndijimi...

Nuk e di sa zgjati ajo gjendje, por kur u zgjova, hetova se isha i vetmuem në pavijonin ku më kishte dërgue Komandanti X.

Aty ishte qetësi e thellë. Kisha etje dhe megjullim në kokë...

Në atë gjendje jashtë vetes, m’u afrue dikush dhe bashkë me një gotë ujë, më futi në gojë një grusht hapa...

Ndodhesha në Pavijonin e Mbyllun, me këmishën e të çmendunve në trup i lidhun për shtrat. Shikimi im i turbullt mezi dalloi dritën e flashkët që përthyhej nga grilat e një dritareje që gjendej sipër...

Edhe ma tutje kisha etje të madhe... Kërkoja ujë... Po ulërija deri sa m’u shtjerr zani...

*Etja e tmerrshme dhe përfytyrimi i një shpërthimi gjaku diku që po vinte nga unë, m'u hoqën dikur i shtrirë në një shtrat të fortë por të pastër pa këmishën e të çmendunit dhe pa prangat në duar.*

*Pranë kisha mjekun kroat nga Janjeva, i cili më tha se kisha kalue krizën e thellë.*

*Pasi e shikova me mosbesim, ai ma bani me dije se nuk kisha arsye për frikë, ngaqë nuk isha në Shtëpinë e të Çmendunve, por diku tjetër, në një vend tepër të sigurt, ku duhej të pushoja dhe vetëm të pushoja për me u lirue nga barra e të gjitha ngarkesave shpirtnore që më kishin prurë në këtë gjendje...*

*Nga bindja se tashma isha një qenie e shpronësuar skajshmërisht nga çfarëdo vlere dhe në pritje të ndonji urdhni tjetër (kryemja e ndonji vrasje ose të ngjashme), prapë iu dhashë gjumit të thellë mundësisht të përhershëm...*

*Edhe pse gjumë të përhershëm nuk mund të kishte, kur u këndella paksa, hetova se përnjëmend nuk ndodhesha në Shtëpinë e të Çmendunve, sado që edhe këtë e merrja si një mashtrim, që më krijohej nga ilaçet e shumta që m'i jepnin dërlidhën.*

*Në atë ndryshim gjendjeje vërejta se mjekun kroat nga Janjeva, tashma po e shoqëronin edhe dy të tjerë, që flisnin një gjuhë të huaj (anglisht).*

*Atyngë iu bashkue edhe një tjetër, me disa pajisje në dorë (një si telefon me kamerë), me të cilën vazhdimisht përcillte fjalët dhe lëvizjet e mia, sjellje kjo që më frikësoi, gjë që mbylla gojën dhe sytë...*

*Mund të ishte veprimi im, që i kishte detyrue me e largue atë që më rrinte sipër me ato aparate.*

*Por, kjo nuk ma hoqi shtrëngimin që më bani dyshues edhe ndaj asaj gjendje të cilën e merrja si mashtrimtare...*

*Këtë e vërejti edhe mjeku kroat nga Janjeva, i cili, bashkë me të tjerët, u largue me fjalët se duhej edhe matutje me e vazhdue qetësimin...*

*Më tha se trupi im, i mbushun me gjithfarë ilaçesh që ndjellin çmenduri si dhe drogë që u jepet vrasësve, kishte nevojë të pastrohej...*

*Megjithatë, ajo nuk ishte gjendje mashtrimtare, siç dyshoja. Përkundrazi, pa ilaçet që m'i fusnin në gojë dhunshëm dhe pa praninë e Komandantit X dhe atyre që silleshin andejpari me shtrirjen se ishin të sëmurë dhe më merrnin me vete për punë të pista, pak nga pak po e merrja veten...*

*Gjendja ime ndryshoi për të mirë, kur një ditë ma sollën bashkëshorten dhe dy vajzat, me të cilat kalova atë pasdite...*

*Ishte një ndjenjë e jashtëzakonshme, që nuk dija ta shpjegoja ç'ishte në të vërtetë, ngase, siç m'u tha nga mjeku kroat nga Janjeva, fillimisht kërcënimet se ajo do ta pësonte po që se nuk u përmbahesha detyrave të parashtruara si dhe ilaçet e shumta ma kishin çrregullue edhe këtë ndjesi...*

*Sidoqoftë, pak nga pak, fillova me u mësue edhe me familjen, mbrojtjes dhe shpëtimit të së cilës ia kisha nënshtruar të gjitha... Imë shoqe zuni me i shpeshtue vizitat. Me to shtuhej edhe koha e qëndrimit bashkë, nga një orë deri në gjysmë ditë, e ndonjëherë edhe gjithë ditën...*

*Mbas disa muejsh, m'u tha se do t'i kthehesha familjes. Kjo më gëzoi, por edhe më shqetësoi, ngaqë kisha frikë nga jeta pa mbikëqyrjen me të cilën isha mësue nga koha e largimit nga Shtëpia e të Çmendunve në ambientin e ri... E mbi të gjitha kisha frikë nga*

Komandanti X dhe pushteti i tij i gjithëpushtetshëm, që një ditë, mund ta arrinte familjen time, meqë të tillët ishin të pamëshirshëm...

*Këtë ia thashë edhe mjekut kroat nga Janjeva.*

*Ai më tha se druajtjen e kisha me vend, por do të mbrohesha nga kthimi në gjendjen e maparshme.*

*Kur më dorëzoi në duart e atyne, që kishin marrë përsipër sigurinë time, më uroi që ta gjeja paqen dhe qetësinë shpirtnore, që më takonte...*

*“Duhet me u pajtue me fatin e zi se me metoda të ndryshme e mbi të gjitha me ilaçe të kanë kthye në vrasës, por përpiqu mos me mbetë i vramë... Kësaj mund t’i shpëtosh po qe se ballafaqohesh me të vërtetën dhe nxjerrjen e saj në shesh me pranimin e përgjegjësisë për fajin, dënimin si dhe pendimin...”*

*Dhe lufta ime nga vrasësi për mos me mbetë i vramë, megjithëqë nuk ka marrë fund, nuk kishte me fillue pa ata që më nxorën nga Shtëpia e të Çemendunve (veçmas mjekun kroat nga Janjeva), dhe atyne që më ndihmuen me e marrë veten në mënyrë që mandej me u përballë edhe me ndërgjegjen time të vrame...*

*E gjithë kjo nuk ndodhi mbrenda një natë, por u dasht kohë e kohë, madje edhe vite që te vij deri aty sa me qenë në gjendje me dalë para botës dhe me tregue atë që kishte ndodhë, tue marrë kështu përgjegjësinë e plotë ligjore (dënimin e merituem) dhe atë morale (pendimin dhe kërkim faljen nga viktimat) për humbjet dhe vuajtjet e shkaktueme viktimave të pafajshme...*

*Natyrisht se kjo rrugë e gjatë e shërimit shpirtnor dhe mental, por jo edhe nga damka e vrasësisë, nuk do të thoshte shumë pa gatishmërinë me iu nënshtruar gjykimit të drejtësisë...*

*Edhe ky hap tepër i randësishëm kur një vrasës, që për mos me mbetë i vramë përgjithmonë, vendos me nxjerrë në pah gjithë ato rrethana dhe faktorë që e kanë ba të tillë e me këtë edhe shkaktarin kryesor të asaj gjendjeje, pa marrë parasysh forcën reale politike që ka, nuk ishte i lehtë, ngaqë kërkonte, së pari gatishmërinë me u përballë me vrasësin e brendshëm, atë që ishte futë në mue dhunshëm (me kërcënimin familjes) dhe më kishte nënshtruar deri në atë masë saqë më kishte kthye në vrasës, ndërsa ma vonë, kur të fitohej lufta me vrasësin e mbrendshëm, atëherë duhej të kërkohet vetëpastrimi publik nëpërmes vetëdenoncimit, që për mos me u kthye në një farsë tallëse “të një të çmenduni” të ikun nga çmendia dhe mund të bahej vetëm mbi të dhana që dëshmohej dhe assesi mbi thashetheme, i duhej edhe ndërhyrja e organeve të caktueme të hetuesisë dhe të gjyqësisë që e gjithë çashtja me dalë para drejtësisë ashtu si duhet...*

*Edhe këtij përcaktimi iu deshën biseda e biseda me hetues të ndryshëm ndërkombëtarë, që zgjatën ma shumë se dy vite prej nga, ma në fund, mbasi që u vërtetuen shumë nga dëshmitë e mia në kuadër të “Komandës vrastare” (kidnapimet dhe vrasjet), m’u dha statusi i dëshmitarit të aktpadisë, që si parakusht kishte marrjen time në mbrojtje si dhe të familjes, me zotimin që asaj, sapo të fillojë procesi, t’i mundësohet dalja jashtë dhe vendosja e përhershme në një vend të sigurt, me identitet të ndryshuem prej nga ajo do të mbrohej nga unë dhe vepra ime...*

*Përcaktimi që familja ime të merret në mbrojtje nga unë dhe vepra ime tue iu mundësue edhe dalja jashtë shtetit dhe vendosja e përhershme në një vend të sigurt me identitet të ndryshuem, nuk ishte vendim i lehtë, por i domosdoshëm, meqë ata kishin të drejtë për një ardhmëni qoftë edhe të tillë, ndërsa mue më mbetej ngushëllimi se nxjerrja e të*

vërtetës, pendimin tim e kthente në një dënim të përhershëm, të merituem, që duhej ta vuaj përgjithmonë...

***“Koha e vdekjes”***  
( Në Londër, së voni)

Në Pikadelli të Londrës, çdo të diel, në mesditë, mbledhen pa paralajmërim, shumë nga mërgimtarët nga Kosova, kryesisht të rinjtë...

Këto takime kanë filluar qysh viteve të nëntëdhjeta, kur shumë nga të rinjtë e atjeshëm, pasi që u mbyllën shkollat nga regjimi i Beogradit, “përkohësisht” iu drejtuan Londrës dhe këtu gjetën strehim...

Të shkapërderdhur në pjesë të ndryshme të Londrës së madhe, të rinjtë nga Kosova, thuajse spontanisht, ia kishin dalë që duke u takuar një herë në javë në qendër të qytetit, ta zbusin disa shokëputjen nga familjet dhe vendlindja...

Për disa, këto takime, ishin kthyer në lidhje dashurie dhe jetësore madje...

Një e tillë ishte edhe ajo e të rinjve Prizren SH., me Leze G.

Rruga për në Londër e Prizren Sh., kishte kaluar nëpër Kroacinë e përfshirë nga lufta (Zagreb), ku ai kishte qëndruar një vit. Ndërsa ajo e Leze G., kishte kaluar nëpër Shkup, prej nga ishte larguar pas një qëndrimi të shkurtër...

Të ulur në verandën e kafesë “Joel”, Prizren Sh., dhe Leze G. bashkë me vajzën e tyre pesëmbëdhjetë vjeçe, Kosova Sh., e lindur dhe e rritur në Londër, kishin përpara disa foto thuajse të zverdhura nga prekja dhe një letër që e mbanin përfundi tyre.

Shikimi nëpër to përcillej me lot.

Prizren Sh., thotë se ato pak fotografi (shtatë sosh) i kishin nga takimi i fundit me të etë, kur po i përcillte për në Zagreb.

“Pasi na përqafoi dhe uroi që herdokur të shiheshim në rrethanat që do të ishin siç i dëshironim, dhe për të ato ishin shteti i pavarur i Kosovës i shpallur në vitin 1990 pas shokëputjes nga Serbia, që i besonte dhe për të cilin edhe u flijua, na tha se ato kujtime duhej të na lidhnin përgjithmonë, pa marrë parasysh kohën që mund të hynte në mes si dhe ngjarjet e ndryshme...”

Fotoja e parë ishte nga gazmendi i martesës, në ambientet e Shoqërisë Kulturore “Agimi”. Pamja e një çifti të gëzuar, plotësohej me sfondin e një shoqërie, po ashtu, të gëzuar: muzikantë, artistë dhe të tjerë, që merrnin pjesë në atë hare.

Fotoja tjetër, ishte e së ëmës me violinë, nga e cila nuk ndahej kurrë...

Fotoja e tretë ishte nga manifestimi “Zambaku i Prizrenit”, kur e ëma (Nora) ishte nderuar me çmimin e Festivalit (Zambakun e Prizrenit).

*Fotoja e katërt ishte nga spitali i qytetit: fëmija i parë (Prizreni) me prindërit e lumtur.*

*Fotoja e pestë, po ashtu ishte nga spitali i qytetit: fëmija i dytë (Theranda) me prindërit e lumtur.*

*Fotoja e gjashtë paraqiste familjen në një darkë të përbashkët në restorantin “Theranda”.*

*Dhe fotoja e shtatë, paraqiste Lekë Sh., me presidentin e Kosovës, i shoqëruar nga ideologët e lëvizjes kombëtare (një shkrimtar e historian dhe një profesor universiteti) gjatë një takimi në Prizren, me rastin e mbajtjes së zgjedhjeve të para parlamentare dhe presidenciale në prill të vitit 1992.*

*Prizren Sh., ma la në dorë foton e fundit, në të cilën i ati, Lekë Sh., ishte me presidentin e Kosovës dhe bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë.*

*Një copë herë e shikova foton që kishte një domethënie me të cilën mund të lidheshin edhe arsyet e kidnapimit dhe më vonë edhe të zhdukjes së Lekë Sh., nga “revolucionarët” pikërisht ashtu siç e kishte paralajmëruar gjatë bisedës së fundit që kishim në dalje të Prizrenit.*

*U mata dhe u çmata rreth përmendjes së atij takimi me të atin e tyre, paçka se ai mund të kishte fituar përshtypjen se isha ndonjë “zhbirues” (informant), siç kishte shumë midis misionarëve të huaj asokohe në Kosovë, por hoqa dorë nga druajtja se ndalja te ajo, mund të zhvendoste bisedën tonë nga njohuritë e tyre për fatin e të etë nga çasti i kidnapimit e deri te zhdukja, tek ndonjë emocion që është i mundshëm në rrethana të tilla.*

*Sikur ta kuptonte kërshërinë time, Prizren Sh., më tha se bashkë me foton, që mund ta merrja (meqë e ishte e kopjuar), ishte edhe një kopje e një letre nga i ati, që dorë mbas dore, u kishte ardhur nga një Qendër Ndalimi (burgje private), diku në Drenicë, për të cilën tha se mund të merrej një dëshmi bindëse për një vrasjeje politike me paramendim, të ngjashme me atë nëpër të cilën kishin kaluar edhe gjyshi dhe stërgjyshi i tij gjatë atij shekulli.*

*“Kush do të thoshte se do të rikthehej ideologjia sllavo-komuniste për të marrë prapë haraç në rrethanat kur Perëndimi bëri luftë për çlirimin e Kosovës dhe ndihmoi edhe shtetësinë e saj për t’iu bashkuar vlerave demokratike dhe qytetërimit të saj?... Kjo duket paksa e pakuptueshme, por ç’e do që është një realitet i kobshëm që duhet pranuar... Ndaj, neve nuk na mbetet tjetër pos të largohemi përgjithmonë në një vend të harruar nga bota...”*

*Pasi i thanë këto, u larguan të thyer...*

*I thyer mbeta edhe unë duke përcjellë me sy largimin dhe humbjen e tyre të pandalshme në mesin e kalimtarëve të shumtë në pjesën e rrugës...*

*Kjo dhembje bëhej edhe më sëmbuese nga ato që thanë rreth largimit përgjithmonë në një vend të harruar nga bota...*

*Por, ishte kureshtja për letrën që më ndanë për pak nga ai dëshpërim i thellë, që nuk ma kishte marrë mendja se do ta përjetoj aty dhe në ato rrethana kur një gjeneratë e viktimizuar, siç ishte ajo e të rinjve që u detyruan ta braktisin atdheun, përcillet me hapa edhe më të rëndë – ikjen demonstrative jo nga frika se kujtesa e saj mund t’u kthehet në një përndjekje të re, siç u ka ndodhur prindërve të tyre sa herë që është dashur të shënohet një rifillim i mbarë, por nga pesha e një mallkimi si dhe traumat që prodhon ai, që mund t’u shpëtohet vetëm po qe se këputen të gjitha lidhjet me të, qofshin ato edhe fizike?...*

*Sidoqoftë, mbetej, që letra që kisha para, t'u jepte përgjigje atyre që tashmë m'u kishin kthyer në një lëmsh. Me këto mendime të frikshme iu qasa asaj, meqë e dija se ajo vinte nga një njeri që sillte mesazhe të frikshme...*

“Ma të dashunit e mi,

Nuk e di se a ka me ju ra në dorë kjo letër, por shpresoj se edhe nëse ajo mbetet diku rrugës, do të jetë porosia dhe fryma e saj, që do t'ju gjejë...

E randësishme është që këto që i qita në letër me u ditë, ngaqë ma e keqe se çdo e keqe është ajo që nuk merret vesh nga harresa e dhunshme ose pse fshihet...

Edhe pse kjo letër është personale, megjithatë, ajo kapërcen kufijtë e saj, jo vetëm nga detyrimi që një prind ka ndaj fëmijëve që ata ta mësojnë të vërtetën në mënyrë që asaj t'i hiqet gënjeshtria me të cilën mund të ngarkohet, por edhe nga përgjegjësia e secilit, që kur ballafaqohet me diçka të tillë, me e nxjerrë në shesh një të vërtetë shoqnore dhe politike si dhe rrethanat nëpër të cilat ajo ka kaluar dhe është ndikuar pa marrë parasysh se mund t'u qesë telashe pikërisht atyre që u drejtohet...

Kur them kështu përpara kam përfytyrimin e tim atë Lekës, si dhe fundin e tij (pushkatimin nga komunistët pse i takonte Nacionaldemokratikes Shqiptare), që ndonëse dukej si një iluzion (fjala është për konceptin e saj me u luftue pushtimin sllavo-komunist me ndihmën e aleatëve perëndimorë), ajo mbeti në kujtesën tonë historike si një përpjekje e përgjakshme për mos me u pajtue me pushtimin e as me ideologjinë komuniste pa marrë parasysh fuqinë e saj, që nuk vonoi dhe u kthye prapë si një murtajë midis nesh nën mashtrimin e “bashkimit ideologjik”, pa marrë parasysh fatkeqësitë që na i solli...

Po ashtu, kam përpara edhe përfytyrimin e gjyshit tim Simonit, që bashkë me patriotët e tjerë që morën pjesë në kryengritjen e madhe të Kosovës të vitit 1912, mori pjesë në luftën kundër pushtuesve serbë, që plasi në vjeshtën e atij viti, e që doli të ishte e kobshme jo vetëm për familjen tonë, por edhe për qindra dhe mijëra të tjera, që u asgjësuan nga ushtria serbe, ose u detyruen me e lëshue atdheun (kush me kaluar në Shqipni e kush me ikë në Turqi dhe gjetiu).

Gjyshi im, Simoni, mbasi që i përjetoi gjithë këto tragjedi, mbasi luftoi në mbrojtje të Princ Vidit në Durrës dhe të qeverisë së tij, mbasi aty në luftë me ata që kërkonin rikthimin e osmanëve la njanën dorë, nuk reshti së punuari për Shqipninë dhe çashtjen shqiptare, sado që kjo iu kthye në kob. U vra në Junik, në vitin 1923, në kuadër të forcave të Komitetit të Kosovës, që po luftonin atje me e pengue rikthimin e dytë të Serbisë në trojet tona...

Për fat të keq, gjysh Simoni, si dhe qinda e mija patriotë të tjerë, në Junik nuk e vrau vetëm pushka e shkaut, por edhe ajo e shtetit shqiptar, që për hir të interesit të vet, e tradhtoi çashtjen...

Por, im gjysh Simoni, si qinda dhe mija të tjerë patriotë nga Kosova, edhe kur u vranë, nuk e hoqën shpresën se Shqipnia ka me u ba një ditë...

Këtë shpresë e kishte edhe im atë, Leka... Ai këtë e tha edhe para atyre që po baheshin gadi me e qëllue me plumba...

“Kosova nuk ka me mbetë gjithmonë e robnueme... Bijtë e saj ma të mirë kanë me luftue për lirinë e saj dhe të drejtën e bashkimit me Shqipninë deri në frymën e fundit...”

Ndërsa unë, kur tashma i kam shpresat e humbuna për jetën time, e di se Shqipnia ka me u ba ashtu siç e deshën ata që dhanë aq shumë mund, dije dhe gjak për të, ngaqë këtë ka me e mundësue shteti i Kosovës, që e kemi shpallë dhe ai ka me u pranue për me e përmbyllë këtë rrugë historike...

Pra, gjatë këtyne dhetë vjetëve, dëshmuem se duem shtet, se dimë me e mbajtë dhe se dimë edhe me dekë për të kur këtë e lyp puna...

Megjithatë, shteti ynë, ka para vedit përballimin e disa vështirësive, që ma shumë vijnë nga mbrenda se nga jashtë...

Fjala ashtë për ndeshjen e konceptit patriotik me atë ideologjik...

Për fat keq tonin, po shihet se ideologjia e majtë, pas rikthimit në Shqipni (me fitoren e neoenveristëve), prapë ka me i hy pazareve me Beogradin dhe të tjerët, ngaqë nuk e do një Kosovë demokratike, properëndimore, por një Kosovë të dobët, me farën e neokomunistëve në pushtet dhe të hyzmeqarëve të njoftun dhe të panjoftun të Beogradit, të cilët, për një asht në gojë, pra për pushtet në dam të shtetit dhe të çashtjes së tij, siç kanë ba edhe në vitin 1944, janë të gatshëm me hy në çfarëdo pazaresh me e sakrifikue atë dhe çashtjen e saj...

Dhe pazaret e tyne, dihet se çfarë janë dhe çfarë çmimi kërkojnë...

U pa, pra, se ata që deri më dje shpërndanin parulla marksiste-leniniste jashtë dhe brenda vendit, tash, me parullat gjoja për bashkim kombëtar, kanë nisë luftën vendimtare kundër intelektualëve dhe gjithë atyne që i prinë lëvizjes kombëtare nga viti 1989 e këndej...

Të tillët, nuk duen luftë të përbashkët, luftë që ka mbas shtetin dhe institucionet, pa marrë parasysh çfarë janë ato, por duen luftë ideologjike, të drejtueme nga komisarë të caktuem nga “shtabi” i Tiranës dhe nga komandantë të vetëshpallun, sado që midis tyne ka edhe patriotë të njëmendë, që janë në gjendje me dhanë çdo gja për atdhe madje edhe jetën, pale se edhe të tillët do t’i hajë lufta e mbrendshme, siç i ka ngranë edhe deri më tash...

Dhe, për mos me e zgjatë shumë, due me thanë se, njani ndër ata që ka me ia hangër kryet lufta, jam edhe unë, por jo vetëm unë...

Kjo ka me ndodhë, ngaqë si aktivist i devotshëm i Lëvizjes Kombëtare (nga themelimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës) dhe së fundi edhe pjesëtar i ushtrisë së Kosovës (FARK) në radhët e mbapavijës së saj, nuk kam pranue që lufta jonë me mbetë luftë ideologjike, luftë komisaresh me maska dhe parulla revolucionare, luftë kaçake ku sekush mundet me i futë duert në të për interesat e veta, por kam punue që lufta jonë me u drejtue nga shteti i Kosovës dhe ushtria e tij...

“Fesati” rreth drejtimit të luftës, nuk ashtë i vonshëm e as i panjohun, sado që tash ka marrë përmasat e një lufte të mbrendshme. Ai ka fillue prej kohësh, kur u vendos me pas rezistencë të armatosun, njisi guerile të mbikëqyrura, veprimet e së cilës do të përshkallëzohen në përputhje me marrëveshjet me amerikanët dhe assesi ndryshe.

Në fillim, pra kur rezistenca e armatosun ishte e pashmangshme, ngaqë këtë e kushtëzonte agresioni i armatës serbe pas përfundimit të marrëveshjeve të Dejtonit e këndej, nuk kishim telashe.

Daljen në skenë të UÇK-së, e mirëpritëm të gjithë.

Na e merrnim si luftë të përbashkët në të cilën duhej me hy të gjithë pa dallime.

Të tillë e përcaktonin edhe marrëveshjet e Oslos.

Të tillë e dëshironin të gjithë patriotët e gatshëm me e dhanë edhe jetën për çlirimin e vendit...

Por, pak ma vonë ato marrëveshje nisën me u prishë nga ata që nuk e donin luftën e përbashkët. Kjo u kthye në një përçamje të hapun dhe u ashpërsue shumë kur lufta po humbej para ofensivës policore dhe ushtarake serbe, që filloi në qershor dhe tashma, kur po e shkruaj këtë letër (mesi i dhjetorit 1998) ajo është humbun, ndërsa te ne ka fillue ajo e brendshme midis “heronjve” dhe “tradhtarëve”, luftë kjo që ka me u drejtue prej atyne që na duen të pushtuem, të përçamë dhe me ideologji të huaja e assesi me shtet tonin të udhëhequn prej intelektualëve patriotë...

Dhe, për me u pa tabori “i tradhtarëve”, ku tashma jam unë me dhjeta të tjerë, mjafton me qenë në duert “e heronjve”, në një “burg lëvizës”, diku në Drenicë...

Në këtë burg më futën para ma shumë se një muaji, kur një komando e maskueme më ndali në dalje të Prizrenit dhe më thanë se kishin urdhën nga “Shtabi Përgjithshëm” me më ndalë dhe me më marrë me vete për një bisedë...

Nuk rezistova, edhe pse e kisha armën dhe mund t’ua shkrepja... Nuk dëshiroja luftë vëllavrasëse... Mendja ma thoshte se mbas ndonji bisede e gjitha do të merrte fund me ndonji marrëveshje...

Ata që më ndaluen, më futën në një “Ladë”, që mori drejtimin e Rahovecit. Në lakimin për në Malishevë, më dorëzuan te një komando tjetër, që po priste me një xhip.

Sapo më futën në xhip, m’i lidhën duart dhe ma vunë një strajcë në kokë. Më thanë se kishin urdhën me më dorëzue në bazë, që i thanë “Shtab i Përgjithshëm”.

Ashtu të lidhun, mbas një udhëtimi bukur të gjatë (me disa ndalime), kur tashma kishte ra terri, më nxorën dhe, mbasi ma hoqën strajcën nga koka, më përplasën në një dhomë të errët me shumë lagështi dhe kundërmim të randë ajri...

“Gjumë të mirë, tradhtar”, më tha ai që doli i fundit dhe mbylli derën nga jashtë...

Nata ishte e ftohtë, por më të ftohtë e kisha mendjen nga gjendja në të cilën u ndodha... Aty më shkoi mendja se ishte dashtë mos me u dorëzue...

Të nesërmen nga mesdita, dera u hap dhe ishin dy roja me maska që më nxorën dhe me strajcë në kokë, më drejtuen nëpër një shteg me borë dhe ngricë, që mori fund në hymjen e një shtëpie rrëzë mali...

Kur më futën në një dhomë të ngrohët, ma hoqën strajcën dhe më lanë vetëm. Nuk voni dhe hynë tre veta me uniforma të UÇK-së. U ulën në tavolinën e drunjtë dhe ai që rrinte në mes, një mesoburrë me mustaqe të holla dhe fytyrë të zbetë, më tha se gjendesha përpara Gjykatës Ushtarake të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si i pandehur për “sabotim të luftës”.

Ai që m’u drejtue me ato fjalë dhe tha se ishte kryetar i gjykatës ushtarake më vinte i njohur. Mbas pak mendja ime kthjelloi një aktivist të ditëve të para të LDK-së, anëtarë i kryesisë së një degë të Dukagjinit, me të cilin kishim marrë pjesë në një takim të përbashkët të komisioneve për informim, që në të vërtetë ishin bërthama të strukturave vetëmbrojtëse mbi të cilat ishte ndërtue ajo që ma vonë do të kthehet në rezistencë të armatosun deri te UÇK-ja.

Edhe tjetrin, në të djathtë, e njihja si aktivist të LDK-së, fillimisht anëtarë i Këshillit të Parë Qendror të partisë dhe ma vonë anëtarë i Fondit të Emergjencës të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ishim takue disa herë në takimet rajonale ku vendosej për ndarjen e fondeve për arsim dhe shëndetësi. Largimin nga kryesia e LDK-së e kishte deklarue në kuvendin e tretë të kësaj partie, të mbajtur në Prishtinë para disa muajsh me arsyetimin se kur vendi po shkonte kah lufta e pashmangshme, nuk kishte kuptim “me ba politikë paqësore”.

Bashkë me te ishin largue edhe disa të tjerë që për vite me radhë kishin qenë bashkëpunëtorë të ngushtë të Presidentit, disa prej të cilëve pa një pa dy ishin gjendur në Shtabin e UÇK-së!

Sikur të dëshironte për me më nda nga ato mendime, që assesi t'u vija rreth, kryetari i gjykatës ushtarake lexoi disa paragrafe nga një dosje ku përcaktohej edhe dënimi nga 5 vjet deri në pushkatim.

Në arsyetim thuhej se si pjesëtar i “shtetit të paqenë paralel”, që “nuk ishte tjetër pos krijesë e Beogradit”, kisha sabotue luftën nga fillimet, siç kishin veprue edhe “paqësorët” të tjerë, të cilët do të marrin të njëjtat dënime.

Kryetari i gjykatës ushtarake tha se kështu kisha ba një tradhti ndaj luftës me çka ishte dobësue rezistenca e armatosun, që për pasojë kishte edhe rikthimin e ushtrisë serbe bashkë me terrorin e saj në “zonat e çliruese”.

Në fund, ai tha, se vepra ime ishte me paramendim, edhe për faktin se vija nga një “familje tradhtarësh”, e cila ngjashëm ishte sjellë edhe gjatë luftës nacional-çlirimtare, “kur ishte vu në shërbim të okupatorit fashist...”

Para se të jepej një pushim, që trupi gjykues të sillte vendimin, ma dha fjalën, që tha se “më takonte për me u mbrojtë...”

E shikova me neveri keqardhëse siç shikohet një vrasës të cilit viktimi i shkakton kënaqësi për me u lirue nga ndjenja e inferioritetit të shërbëtorit, që ndërron padronët sipas interesit... Dhe pasi ia bana me dije se nuk kam se çka me thanë para një realiteti kur gjykatat serbe zëvendësohen nga ato “të çlirimtarëve” tanë, kërkoja që së paku të më lejohej një njoftim. M'u dha me kusht që mos ta zgjasja ngaqë çdo çast pritej bombardimi nga aviacioni serb e me këtë edhe evakuimi i “Shtabit të Përgjithshëm”.

Me pak fjalë thashë se familja ime, konkretisht im atë Lekë Sh., me dy vëllezër dhe gjashtë kushërinj kishte luftue kundër regjimit sllavo-komunist dhe se për këtë, si pjesëtarë të “Nacional demokratikes Shqiptare”, ishte pushkatue.

“Kush kishte me thanë se pas një gjysmë shekulli nationalistët shqiptarë, që e shpallën dhe e themeluan shtetin e Kosovës, gjykohen nga revolucionarët shqiptarë!...”

Kjo e tmerroi kryetarin e Gjykatës Ushtarake. Zuni me u çirrë me sa za kishte me fjalët se duhej me më vra në vend. Ndërsa ai që po i rrinte në të djathtë, më qëllloi në ballë me një shish uji prej nga humba vetëdijen...

Kur erdha në vete, pash se gjendesha në një dhomë të errtë, me shtatë të tjerë, që secili ishte ma i ngrysun se tjetri. Njani më tha se ashtë ma mirë kur njeriu vdes një herë dhe jo shumë herë...

Mbas një heshtje, një mesoburrë, me kokën e lidhun me disa fasha të papastra, foli e tha se kishte me qenë mirë nëse përpiqemi me u lirue disi dhe me shpëtue kokën para se të kthehet togu i ekzekutimit...

“Këtu të gjithë jemi të dënuem me vdekje... Sigurisht që edhe ty të ka rrokë i njëjti kandar...”

Nuk dija çka me thanë, ngaqë ishte gjuajtja e shishes në kokë dhe alivanosja që më kishte pengue për me e ndëgjue shqiptimin e vendimit, që më thanë se jepej pas një pushimi të shkurtër.

Vendimi mund edhe të mos ishte shqiptue fare ngaqë edhe mund të ishte pengue nga bombardimet e aviacionit serb që thanë se priteshin në çdo çast?...

Këto dhe fjalë të ngjashme në ato rrethana as që kishin kuptim kundruall atij realiteti kur edhe ashtu ishim të pa shpresë.

Duket se këtë mendje kishin të gjithë, ndaj pjesën tjetër të kohës (nga mbramja e deri të nesërmen nga mesdita), kush nuk hapi gojën.

Heshtja u thye të nesërmen nga një e hapur e lehtë e derës me ç'rast u duk njani, pa uniformë, me një armë në krah, që e mbante si me siklet.

Ishte Roja e burgut. U përshëndet me të gjithë përzemërsisht... Së fundit m'u drejtue mue më fjalët se puna ime kishe mbetë mjegull ngaqë ishte bombardimi serb që kishte pengue gjykatën për me marrë vendim...

“Sapo ranë bombat e para rrotull ia mbathën të gjithë... Nuk besoj se kthehen shpejt... Mund edhe të mos kthehen fare?... Ndoshta kjo edhe ashtë hajr?...”

Nxori paqetën e duhanit dhe disave ua hodhi nga një cigare përpara.

Ma gjuajti edhe mue, por i thashë që nuk e pija...

“Kjo e shkretë, boll dam bon, po edhe ndihmon...”

Pak nga pak, mësova se roja e burgut kishte qenë një aktivist i hershëm i LDK-së në pjesën që ndante Drenicën me Rahovecin. Meqë vinte nga një familje me traditë “kaçake” dhe e zonja me e mbrojtë secilin mashkull, në vend që të merrej në përgjegjësi dhe madje edhe të dënohej, siç ndodhte me shumë prej tyre në “zonat e lira”, punën e rojës së burgut e kishte pranue si detyrim që në pjesën që ai e mbronte, e ku përkohësisht ishte vendosë edhe ai që i thonin Shtab i Përgjithshëm, ata që ndaloheshin ose burgoseshin, mos me u keqtrajtue...

Por, simbas fjalëve të atyne që, kush ma pak e kush ma shumë kishin kalue në burgjet “lëvizëse”, që rëndom ndiqnin kahun e lëvizjeve të komandantëve të lartë deri te ata të Shtabit të Përgjithshëm, Rojtari i burgut sillej me shumë njerëzi me secilin, madje edhe atëherë kur merrte urdhna ndryshe... Kështu, në burgun që ai ruante, kishte lejue Gjykatën Ushtarake për me ba hetime dhe gjyqe, ngaqë atë e konsideronte pjesë të institucionit (sado që edhe ndaj saj ishte mosbesues), por assesi komandantët që hynin e dilnin me keqtrajtue ata për të cilët ai kishte përgjegjësi...

Bombardimet e fundit si dhe lëvizjet nga vendi në vend, ku jo rrallë harroheshin të burgosurit dhe ata që thuhej se për “arsye taktike” mbaheshin të mbyllun, Rojën e përgjegjshëm e kishin mbushë me telashe, ngaqë nuk lejonte që atyne që kishte në përgjegjësi t'u ndodhte diçka nga hallakama ose pse dikush mund t'i shfrytëzonte ato gjendje që ndonjanit ashtu qorras t'i hiqej flama, siç kishte ndodhë nëpër disa burgje të tjera andejpari...

Këtë herë tha se punën e kishim pisk nga dimni i fortë, që gjithnji e ma shumë mbushte malet me borë dhe me këtë vështirësonte edhe sigurimin e ushqimit, kurse aviacioni serb i ndiqte kamba-kambës...

Në të vërtetë, ushqimi thuajse ishte sosur fare. Kjo u mor vesh të nesërmen kur mbaruen edhe konservat e fundit të mishit si dhe biskotat italiane.

Krahas mungesës së ushqimeve, Rojës i dolën telashe edhe me dy prej të burgosurve me plagë në trup (njanit në kokë dhe tjetrit në gjoks që i kishin nga torturat në një vend tjetër), të cilët kishin nevojë për ndërhyrje të shpejtë kirurgjike. Qenë të kota përpjekjet e tij me anën e një telefoni satelitor të vente lidhje me dike nga Shtabi që mund të ndodhej andejpari. Ngaqë, për arsye “sigurie”, ndaj të cilëve Roja ishte shumë mosbesues kur e dinte se prej nga kishin ardhë dhe kush i përdorte, kishin ndryshuar kodet...

Në atë gjendje, Roja që kishte mbetë vetëm, u mundue disa herë me e ça rrethin e borës, por nuk ia doli, ngaqë vendbanimi ma i afërm ishte mbi dy orë rrugë në kambë në kushte normale.

Mbramjen e tretë, kur nuk kishim ushqime e as barna ndër ma të thjeshtat, tha se ishim të lirë. Këtë përgjegjësi e merrte krye në vete...

Por, liria që na e “dhuroi” Roja nuk ishte e mundshme, ngaqë dimni dhe bora e madhe e pengonte atë...

Ditën e katërt, ai që kishte plagë, vdiq thuajse i pavërejtur, në pjesën e skajshme ku rëndom mbrohej nga tymi, që lëshonte oxhaku i mbyllun. Ishte një veprimtar i njohur i LDK-së nga një komunë e Drenicës, i akuzuar për “kolaboracionizëm” ngaqë gjatë luftës, kishte mbajtur të hapun një dyqan me ushqime dhe një kafe përskaaj, ku paramilitarët serbë kishin pi birra gjatë gjithë kohës.

Një natë ma vonë, shenjat e fundit po i jepte edhe i plagosuni në gjoks. Edhe ai ishte një veprimtar i njoftun i LDK-së nga rrethina e Malishevës, deputet i Kuvendit të Kosovës. Ishte arrestue para tri javësh dhe të nesërmen Gjyqi Ushtarak e kishte dënue me vdekje. Aktakuza e kishte ngarkue “me faj” ngaqë në fillim të shatorit, ndonëse ishte kryetar i një bashkësie të rëndësishme lokale atje, në vend se të luftonte deri në fishekun e fundit, kryenëvete kishte hy në bisedime me pushtuesit serbë për nxjerrjen e popullatës së disa katundeve të asaj pjese nga rrethimi, të strehuem në xhaminë e qendrës (mbi dymijë frymë, të shumtën fëmijë, gra dhe të moshuem), me kusht që gjatë largimit të dorëzoheshin të gjitha armët që mbaheshin pa leje andejpari, me ç’rast bartësit e tyne “amnistoheshin” dhe largoheshin bashkë me të tjerët... Roja, që e njihte mirë dhe gjatë gjithë kohës nuk kishte lejue që komandantët ta nënçmonin, siç vepronin gjetiu, u mundue me mish e me shpirt për me ia mbajtur disi frymën e fundit... I thoshte se mjeku sa nuk kishte ardhë, se po ia ndiente hapat dhe çmos, por infeksionet e randa, ishin ma të forta se fjalët ngushëlluese...

Në shenjë dëshpërimi, tha se nga ai dakik nuk ishte tjetër pos një “dorëzan” yni që merrte përgjegjësinë e plotë për ne përderisa të largoheshim sipas dëshirës...

Tha se sa të jetë kështu, ndante fatin tonë...

Nga pesë që kishin mbetë, mora vesh se njani ishte serb i Drenicës, postier me profesion. Ishte kapë para një mueji në një katund malor, kur po dërgonte një dërgesë me të holla nga jashtë...

I thoshin, Rajko dhe fliste shqipen rrjedhshëm... Ishte një hallexhi, si shumë të tjerë, që nuk kishin gjithaq lidhje me zullumqarët e Beogradit...

Këtë e dinin edhe ata që e kishin sjellë dhe e dëshmonte edhe sjellja korrekte me të me çka ushqehet dyshimi se mbahej për ndonji kusuritje me Beogradin rreth të burgosunve...

Por, rrethanat e reja (shpallja e fitores së Beogradit ndaj Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, siç trumbetohej me të madhe ngado), Rajkos ia kishin humbë shpresat. Ngaqë Beogradi nuk kishte kurrfarë arsyeje për me u interesua për një postier të thjeshtë katundi, të miqësuem me shqiptarët... Madje, kishte dyshimin se vrasja e tij, Beogradit, mund t’i interesonte ma shumë se lirimi i tij ngaqë kjo mund të shfrytëzohej për propagandë kundër shqiptarëve...

Njani nga dy mësuesit sa ishin, si me shaka, por që e kishte përnjëmend, tha se Rajko mund të kthehej në një shkas të mirë që aviacioni serb të hedhë ndonji bombë mbi ta...

Kjo e shqetësoi së tepërmi Rajkon e shkretë, saqë dha shenja fajësie...

Nga kjo nuk e liruam as shakatë e Rojës me ato që tha se “gjithë sa ishim aty nuk vlenim sa një raketë...”

Ndoshta i shtymë nga kjo fajësi që e hetonte, një ditë, nga ato me fërfëllizë dhe acar, Rajko nuk u kthye nga nevojtorja jashtë.

Në fillim kjo nuk u vërejt, por pak ma vonë, ishte pikërisht mësuesi, që e bani të madhe mungesën e Rajkos.

Roja, që e dinte se ku mund të shkonte puna, nxitoi jashtë... Nuk vonoi dhe u kthye qeherthyem, me lot në sy... Tha se Rajko kishte mbetë i ngrimë, skaj nevojtores...

Atë mbramje, mbetëm edhe pa Thatanin, që nuk dihej pse ishte aty dhe a ishte i dënuem fare. Tha se, meqë ishte “i lirë”, kishte vendosë për me shfrytëzue atë, paçka se dyshonte se mund t’ia dilte.

“Ma mirë me provue diçka se me u ngri...”

Roja, që kishte përvojë të mirë gjatë atyne tre muejve me të burgosun të ndryshëm, të dënuem e të padënuem si dhe të ndaluem që hynin e dilnin sipas urdhnave që “vinin nga lart”, por edhe asi që futeshin qëllimisht aty me detyra, nuk tha tjetër pos që i uroi fat.

Të nesërmen, edhe njani nga dy mësuesit, u largue pa asnjë fjalë. Heshtja dhe ngrysjat e ashpër që iu kishte ngjitur në fytyrë jepnin me dyshue se kishte ndonji shkallim të mbrendshëm...

Largimet e fundit, Rojën e mbushën me siklet. Sikur ndjehej fajtor që ata mund të përfundonin të ngrimë ose në kthetrat e ndonji bishe (fliste për ujë që kishte shumë në këto anë).

Kur mbetën gjithsej tre veta, Roja tha se kishte me qenë mirë me u ngjitur në pjesën e epërme të shtëpisë, në zyrën e Shtabit, ngaqë kishte bindjen se nuk do të rikthehej ma...

“Së paku të përfundojmë si njerëz...”

Në zyrën e Shtabit, shkova vetëm. Dy të tjerët nuk pranuen të ngjiteshin naltë. Ndoshta nga bindja se meqë i merrnin të pathyeshëm ata do të ktheheshin dhe se po i gjetën aty do t’ua merrnin lëkurën...

Dhoma e ndriçue nga dy dritare të mëdha me shikim nga mali, ishte e përshtatshme. Kishte një tavolinë të madhe në mes, disa karrige të drunjtat dhe një kanape të madhe të lëkurës.

Shihej se pajisjet e ndryshme (kompjuterët, fakset dhe telefonat) ishin shkyçur me shpejtësi dhe largue prej andej...Kishin mbetur disa letra të bardha dhe ndonji disketë e dëmtueme...

“Këtu je komandant dhe çka të duesh”, më tha si me shaka. Shtoi se në dollapët e poshtëm kishte uiski dhe konjak “Skënderbeg”.

Kur po largohej tha se atë mbasdite, ngaqë moti po qetësohej paksa, ia bante mendjen me vëzhgue përreth për ushqime, po edhe mos takonte ndonji nga Shtabi i strehuem në ndonjanën nga bazat e afërme rrotull të parapame për raste të tilla, sado që kësaj të fundit nuk i besonte...

Ashtu i vetmuem dhe i pashpresë në një humbnajë të pafund se si ndjeva një çlirim trishtues nga vetvetja...

Me atë ndjenjë seç më shkrepri mendja për me ua lanë fëmijëve një letër, pa marrë parasysh se a u bie në dorë... E randësishme ishte që me u thanë disa gjana si përjetime për me u marrë vesh ndonjiherë ajo që ndodhi mbrapa perdes së përgjakun...

Me atë përkushtim, mora disa nga letrat e shpërndame mbi tavolinë. Ishin me memorandumin e “Shtabit të Përgjithshëm”. Aq ma mirë, thashë. Kanë fuqinë e një dokumenti...

Në kërkim të një stilolapsi, hapa kutinë e parë dhe të dytë, por nuk po gjeja gja... Zuna me i hapë edhe të tjerat... Krejt në fund, hasa një fletore të madhe me një stilolaps të zi, të lidhun për të.

E hapa me kujdes dhe pashë se ishte një si regjistër burgu, me shënime të shkurta (emni, mbiemni, dita e lindjes, numri i dokumentit zyrtar, vendbanimi, profesioni etj..) për secilin që kishte kalue nëpër burg nga data 3 prill 1989 e deri në ditën e tetëmbëdhjetë të dhjetorit. Lista prej njëzet e dy emnash mbyllej me mue.

Krahas këtyne të dhanave për të burgosunit, aty kishte edhe shënime të shkurta, por të përpikta, për marrjen në pyetje të të burgosunve ngahetues të Gjykatës Ushtarake, për bisedat informative nga komandantë vendorë dhe të zonave si dhe nga persona të ndryshëm, që u shënoheshin vetëm inicialet. Aty shënoheshin edhe vizitat e disa nga anëtarëve të “Shtabit të Përgjithshëm” si dhe të “Drejtorisë Politike”.

Se ishte fjala për një dokument “zyrtar”, kjo dëshmohej edhe me shifrën “secret” që e mbante në pjesën e epërme të ballinës. Mund të merrej me mend se përgjegjës për të ishte Roja, i cili shënimet i mbante në përputhje me detyrat e ngarkueme.

Duket se në hallakatën e ikjes, regjistri i burgut ishte harrue nga përgjegjësit për ruajtjen e dokumentacioneve “sekrete”.

Mbasi i rashë disa herë në fund asaj që e merrja për ditar burgu, prej nga më dilnin para gjendjet e randa shpirtnore të atyne shumë prej të cilëve nuk ishin ma, pa ia vu veshin urisë e as të ftohtit, i hodha në letër gjithë ato që më shkonin në mendje: nga koha e ndalimit, lidhjes, burgosjes, gjyqit e deri në çastet kur nisi të më shterojë mendja, sikur prej saj të ishte lirue edhe fuqia e fundit...

Letrën e lash në fletoren e “ditarit të burgut” me bindjen që edhe nëse nuk kthehet Roja, që e merrja për njeriun ma fisnik që e kisha takue në atë vorbull vrastar, ajo do t’i bie në dorë dikujt...

I çliruem nga një barrë e mrendshme, i mbylla sytë dhe vullnetshëm iu dorëzova fundit me bindjen e plotë se e kisha të pashmangshëm, në mos nga acari, atëherë nga ata që së pari do të hynin aty, kushdo qofshin: pushtues ose “çlirues”...

Krejt një!

(Diku në Drenicë, në ditët e fundit të dhjetorit 1998).

## 7.

Seancën e tretë me Vrasësin e Penduar e prita jo gjithaq me detyrën e një hetuesi, që ngarend pas secilës hollësi, në mënyrë që me to të ndërtojë ngrehinën e padisë me të cilën prokurori duhej të dalë para trupit gjykues, por me ndjesinë e një psikiatri, që ka për detyrë që

gjatë një bisede me “pacientin” të futet sa ma thellë tek simptomat e një patologjie ideologjike që kishte ushqyer një shtresë të caktuar për të ardhur në pushtet politik me mjete të arsenalit revolucionar dhe infrastrukturës së tij nga shërbimet speciale, e deri te togjet vrastare...

Vrasësi i Penduar kishte pranuar se qe pjesë e një komandoje vrasëse siç kishte shpjeguar edhe mjetet dhe metodat e përdorura për të ardhur deri te veprimet konkrete (fillimisht mashtrimet dhe kërcënimet, mandej shfrytëzimin e ilaçeve, pa përjashtuar edhe drogën në Spitalin Psikiatrik ku komandoja kishte strehën e parë dhe të përhershme). Mbetej për t’u parë struktura organizative si dhe hierarkia e saj në të gjitha rrafshet gjatë luftës dhe pas saj kur ajo do të kthehet në një institucion “të padukshëm” të luftës politike...

Fokusimi te Vrasësi i Penduar, përkundër dëshmime tepër të rëndësishme dhe të pamohueshme (atentati ndaj Inspektorit të lartë ish Policisë së Kosovës dhe disa të tjerëve), pa nxjerrjen në shesh të kësaj strukture, gjithë çështjen mund ta mbyllte me dënimin e “një grupi” ose edhe të disa “të tjerëve” përreth që edhe mund të cilësohen “kriminale”, por jo edhe shkaktarin kryesor të kësaj gjendje - konfliktin e thellë të kahershëm shoqëror dhe politik midis dy rrymave: asaj intelektuale dhe ideologjike, të cilat shpërbërja e ish Jugosllavisë si dhe konfliktet e shpërthyer me atë rast i kishte vu përpara përgjegjësisë historike që t’i jepej përgjigje ardhmërisë në rrethanat e reja tepër të turbullta ku opsionet çfarëdo qofshin pashmangshëm përkufizohen me limitet e gjeostrategjisë dhe ato të gjeopolitikës, që duhej njohtë dhe kuptuar për të mos u shpërputhur me to.

Natyrisht se në këtë përvijim tepër të rëndësishëm, rryma intelektuale me përkushtim patriotik, kishte qenë shumë e drejtpërdrejtë në të dy planet (atë gjeostrategjik – në binarët perëndimorë dhe atë gjeopolitikë – në binarët e parlamentarizmit demokratik), mbi të cilën ishte mbështetur edhe platforma e lëvizjes institucionale (shtetit i pavarur i Kosovës, që si parakusht kishte shpëputjen e lidhjeve me Serbinë). Ndërsa ajo ideologjike, e thadruar në ilegalitet, ndonëse fillimisht kishte shfrytëzuar infrastrukturën e Lëvizjes Kombëtare (shtetin paralel dhe strukturat e tij), kishte dalë me opsionin e luftës çlirimtare (fillimisht për bashkim kombëtar, por që shpejt kishte hequr dorë prej tij ngaqë binte ndesh me konceptin gjeostrategjik të Perëndimit), që pas daljes në skenë të “Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës”, kishte kërkuar edhe monopol politik mbi zgjidhjen e çështjes së Kosovës, duke eliminuar dhe luftuar në tërësi faktorin intelektual me mjete revolucionare...

Edhe pse e dija se “ndriçimi” i kësaj çështje nuk mund të kthehej në një gjykim politik të saj dhe as që mund të përdorej gjykata për qëllime të tilla, megjithatë, sa më shumë që thellohesha në dosjen e Vrasësit të Penduar dhe rrethanat që e kishin kushtëzuar, veçmas ato që më vinin në adresën e internetit nga im atë në bredhje të hetimit të tragjedisë së familjes së gjyshes sime të dashur Mari SH., e gjitha më shfaqej si një vazhdimësi e asaj lufte politike nga Lufta e Dytë Botërore e këndej midis të djathtës dhe të majtës, të cilën, kjo e dyta, me mjete revolucionare e kishte fituar vazhdimisht, me ç’rast ideologjia kishte instaluar diktaturën si një mendësi dhune me pasoja fatale për një shoqëri të tërë, e cila ishte bartur nga gjenerata në gjeneratë edhe në rrethanat kur pas rënies së sistemit komunist nga Moska e deri në Tiranë ky model do të duhej të merrte fund.

Përjetimet e Martin Sh., në Shkodër dhe të familjes së tij nacionaliste atje kur thuajse në tërësi ishte shuar nga terrori i komunistëve shqiptarë si dhe tragjedia e kushërinjve të tij në Prizren, siç ishte ajo e Lekë Sh., nga koha e “*Nacionaldemokratikes Shqiptare*” dhe të birrit të tij Lekë Sh., nga radhët e “*Lidhjes Demokratike të Kosovës*” gjatë luftës së fundit (i vrarë në

një burg “lëvizës” diku në Drenicë), flisnin qartë për këtë luftë ideologjike, që nuk ishte bërë pa dijen dhe madje mbështetjen nga jashtë të atyre që kanë punuar që tranzicioni të shqiptarët (në Shqipëri dhe në Kosovë) të mos kthehet në një proces të natyrshëm kah qytetërimi perëndimor, por në një luftë tjetër të brendshme midis demokracisë dhe ideologjisë e ku do të përzihej edhe faktori religjioz (islami politik) si aleat i natyrshëm i së dytës në të cilin ata ishin kurthuar në përputhje me skenarët e huaj që kishin qenë në qarkullim nga shekulli i kaluar e këndej!

A nuk e dëshmonte këtë, më së miri, edhe letra që Lekë SH., e shkruar nga burgu pa emër në çastet e fundit si dhe përjetimet e tij me dhunën revolucionare të ushtruar aq brutalisht ndaj tij po edhe ndaj të tjerëve qysh nga kidnapimi, ballafaqimi me të ashtuquajturën Gjykatë Ushtarake si dhe aktpadia e “sabotuesit” të luftës si “tradhtar” pse kishte luftuar për shtetin e Kosovës e deri te mbetja në mëshirën e pamëshirë të motit të ligë ku edhe kishin përfunduar!

Këto hamendësime dhe të ngjashme të kësaj natyre mund të ktheheshin në një shkumë sapuni po qe se do të mbeteshin të shkëputura nga dëshmitë e Vrasësit të Penduar rreth një sistemi të ngritur, ku komando vrastare ishte vetëm një mjet për realizimin e qëllimeve politike për marrjen e pushtetit me çdo kusht.

Ndaj, seancën e tretë dhe të fundit me Vrasësin e Penduar, siç kisha kërkuar sqarime dhe dëshmi për fatin e gazetarit të “*Rilindjes*” nga kidnapimi me urdhrin e Komandantit vendor e deri te dorëzimi i tij togës së Llapushnikut prej nga do t’i humbin gjurmët diku në burgjet e atjeshme private, u përpoqa që edhe fatin e Lekë Sh.,ta shoh të lidhur me një kidnapim të ngjashëm ku mund të kishte marrë pjesë grupi i tij.

Vrasësit të Penduar nuk i është dashur shumë që ta kuptojë qëllimin tim. I gatshëm për me marrë pjesë në ngritjen e çfarëdo fakti të mundshëm që do të shkonte në të mirë të bindjes së tij se mbrapa “vrasësve të krijuar, por të pafalshëm”, siç e quante veten dhe ndonjë nga “togjet vrastare”, tha se gjatë luftës pjesë e likuidimeve, ishin edhe kidnapimet dhe burgosjet, pa marrë parasysh se shumë prej tyre nuk bëheshin me shkrepje, por nga rrethana të tjera, që u shkonin për shtati të mbesin të megjelluara...

Me këtë rast ai theksoi se shumë nga ata që kishte kidnapuar dhe ndaluar komandoja e tij, por edhe të ngjashmet që kishin vepruar në tërë rrjetin, u ishin dorëzuar “komandove qendrore”, prej nga thuhej se ndaj tyre “zhvilloheshin procedurat korrekte” në përputhje me rregulloren e Gjykatës Ushtarake, nga burgosja, mbajtja e gjyqeve e deri te dënimet, në të vërtetë ishin vrasje me paramendim për vetë faktin se në ato rrethana Gjykatat, merreshin vetëm me “tradhtarë” (kryesisht aktivistë të njohur të Lidhjes Demokratike të Kosovës”) dhe “dezertorë” (luftëtarë që u nënshtroheshin urdhrave të FARK-ut).

“Nëpër zonat ushtrake, pranë shtabeve, kanë ekzistuar të ashtuquajturat qendra parandaluese - burgje, prej nga thuhet se pakkush kishte dalë i gjallë dhe, edhe po qe se dilte, dënimi e gjente në rrugë e sipër ‘për në liri’. At fat kishte edhe gazetari i “*Rilindjes*”. Fat të tillë mund të ketë pasur dhe argjendari nga Prizreni dhe shumë e shumë të tjerë...”

Meqë kërkoja përgjigje rreth asaj se a kishte marrë pjesë në kidnapimin e Lekë Sh., nga Prizreni në të dalë të Prizrenit, Vrasësi i Penduar, pasi u mat për pak, tha se, meqë gjatë qëndrimit në Shtëpinë e të Çmendurve me anën e gjithfarë ilaçesh kishte marrë vesh se ishte programuar për diçka të tillë, mund ta kishte kidnapuar edhe atë po qe se kishte qenë aktivist i njohur i LDK-së...

Kur i thashë se dëshmia ishte e vlefshme vetëm po qe se mbulohej me fakte të sigurta në gjykatë, pa një pa dy foli e tha se kishte marrë pjesë në kidnapimin e argjendarit nga Prizreni dhe se këtë mund ta dëshmonte.

“Para një kohe, me kanë ballafaquar me një Roje të njërit nga burgjet e Drenicës, dëshmitar i mbrojtur nga shumë sish që hetuesit e ndryshëm po edhe ekipet mjekësore (të shumtën psikiatër) përpiqeshin t’i aftësonin për dëshmi përpara gjykatave, edhe pse shumë prej tyre kësaj nuk do t’ia dalin ngaqë në rrethana të paqarta do të vriten ose dekonspirohen. Sidoqoftë, njëri nga hetuesit e shumtë, kishte kërkuar nga unë të dija se a kisha marrë pjesë në kidnapimin e një argjendari nga Prizreni për të cilin thuhej se ishte gjetur i vrarë në rrethana tepër enigmatike, madje edhe të pabesueshme në zyrën e braktisur të Shtabit të Përgjithshëm në fund të dhjetorit të vitit 1998.

Ndër rrethanat tepër enigmatike përmendeshin dëshmitë e Rojës së burgut, sipas të cilave në atë rrethim, asokohe, nga bora e madhe dhe acari, nga gjysma e dhjetorit e deri nga gjysma e janarit, kishte qenë e pamundur të depërtohet. I ngujuar nga bora dhe i harruar nga “shefat” e deridjeshëm që ia kishin mbathur pas rikthimit të forcave policore dhe ushtarake në ato anë, ai kishte pasur nën mbikëqyrje tetë veta, dy prej të cilëve kishin vdekur nga plagët që kishin në trup të shkaktuara nga torturat, dy të tjerë nga i ftohti i madh që kishte mbërthyer vendin asokohe, një kishte bërë vetëvrasje (një postier serb), një ishte larguar dhe një ishte zhdukur, ndërsa i fundit, argjendari, ishte gjetur i vrarë në zyrën e Shtabit, pasi që Roja e kishte lejuar të qëndronte atje...

Meqë Roja ishte larguar për të kërkuar ushqim, kur ishte kthyer (pas disa orësh), e kishte gjetur të vrarë argjendarin nga Prizreni. Plumbi e kishte qëlluar në ballë dhe i kishte ardhur nga jashtë në kohën kur po shikonte nga dritarja acarin paçka se xhami ku i kishte mbetur koka e përgjakur kishte mbetur i paprekur. Po ashtu, jashtë nuk ishte gjetur asnjë gjurmë, ngaqë asokohe askush nuk i ishte afruar asaj shtëpie të vetmuar në mal meqë këtë e pengonte bora e madhe dhe acari...

Për të qenë habia edhe më e madhe, edhe trupat e të vdekurve, që Roja i kishte lënë në borë, në afërsi të shtëpisë që të varrosen sapo të shkrihej bora, nuk ishin gjetur në vendin e fshehur... Meqë askush nuk ishte kthyer në atë shtëpi edhe pasi që dimri kishte filluar të tërhiqet para syrit të pranverës, ndërkohë që kishin filluar edhe bombardimet e NATO-s ndaj forcave policore dhe ushtarake jugosllave, Roja kishte njoftuar disa nga luftëtarët që njihte, të cilët sillleshin andejpari, por hezitonin të ktheheshin në strehën e dikurshme edhe pse forcat policore dhe ushtarake jugosllave kishin braktisur atë pjesë, siç kishte njoftuar edhe përfaqësuesit e kryqit të kuq ndërkombëtar, që përkujdeseshin për viktimat e luftës.

Por, askush nuk kishte marrë mundimin të merrej me atë çështje, ngaqë të vrarë dhe të zhdukur andejpari kishte me bollëk. Vetëm pas vendosjes së trupave ndërkombëtare dhe çarmatosjes së luftëtarëve të ndryshëm, dikush e kishte marrë në pyetje Rojën e dëshpëruar nga çlirimi i hidhur, që po shkaktohej nga sjellja e shumë luftëtarëve të shpifur, të cilët, aty ku mundeshin, me anën e uzurpimeve dhe kërcënimeve, vazhdonin të bënin ligjin e të fortit. Mbas disa kohësh ishin shfaqur edhe hetues të ndryshëm si dhe ushtarakë që kishin kërkuar të dhëna të hollësishme rreth ndalimeve, burgosjeve po edhe për fatin e atyre që ishin mbajtur nëpër ato vende për të cilat kishte filluar të flitej me dyshim se kishin qenë shtëpi private torturash e çka jo tjetër...

Thashethemeve të ndryshme se mund të ishte ndonjë komando e fshehur në afërsi që kishte vrarë argjendarin e Prizrenit, ngaqë dinte shumë rreth atyre që kishin ndodhur para dhe gjatë luftës midis rrymave të konfrontuara, veçmas për fondet e luftës që kishin përfunduar në xhepat e tyxharëve të shumtë që kishin gojën plot patriotizëm, ndërkohë që luftëtarët e përkushtuar në front mbeteshin pa armë, municion po edhe pa bukë, Roja e burgut ua kishte mbyllur shtegun me atë se edhe po qe se kishte pasur komando vrasëse, asokohe ato nuk kishin qenë në gjendje t'i afroreshin vendit, ngaqë këtë e pamundësonin kushtet e rënda atmosferike (bora e madhe dhe shtigjet e pakalueshme gjatë një muaji)... Po ashtu, mungonin edhe shenjat që ishin të pashmangshme andejpari asokohe...

Por, kur kishin filluar të gjenden disa varre, ku ai kishte identifikuar ata që i njihte nga koha kur për ta ishte përkujdesur, i tmerruar nga ato zbulime, i rralluar mendjeje, Roja kishte përfunduar në një spital psikiatrik ushtarak të trupave amerikane. Pas dy vitesh qëndrimi nëpër spitale të ndryshme edhe jashtë vendit, kur dukej se e kishte marrë veten, kishte përfunduar në duart e hetuesve të ndryshëm ndërkombëtarë, të cilët e kishin kthyer në dëshmitarë të mbrojtur të gjykatës. Fillimisht kishin qenë hetuesit e UNMIK-ut, ata të Gjykatës së Hagës, e më vonë ata të EULEX-it, që nuk e kishin lënë të qetë për asnjë çast sa të ndjehet një i dënuar përjetë për një faj që u takonte atyre që e kanë nisur luftën dhe e kanë drejtuar atë që të jetë e tillë dhe jo ai që ishte kthyer në viktimë të saj...

Kështu, për më shumë se dy vite, kishte dhënë shumë e shumë deklarata dhe dëshmi rreth atyre që kishte përjetuar gjatë pesë muajve si roje e burgut lëvizës diku në Drenicë, ku binte në sy se merrte përsipër përgjegjësinë e plotë për ato që kishin ndodhur ngaqë burgu kishte qenë në pjesën që mbikëqyrte familja e tij. Atyre dëshmimeve u kishte shërbyer si mbulesë kryesore regjistri i burgut, që thoshte se e kishte mbajtur dhe për fat u kishte shpëtuar rrethanave të luftës...

Regjistri i burgut u kishte rënë në duar hetuesve ndërkombëtarë bashkë me një letër që argjendari Lekë Sh., gjatë qëndrimit në zyrat e braktisura të Shtabit, ua kishte drejtuar fëmijëve..."

Mbas një heshtjeje të shkurtër, Vrasësi i Penduar, prapë përsëriti fjalët se pranonte se e kishte ndaluar argjendarin nga Prizreni dhe se ia kishte dorëzuar në afërsi të Rahovecit komandës së Malishevës.

"Edhe për këtë vrasje, si për atë të gazetarit të *Rilindjes* dhe për të gjitha vrasjet që kanë ndodhur në rrethana të tilla, ndihem fajtor, paçka se isha qenie e shpronësuar nga çfarëdo ndjesie dhe përgjegjësi..."

Kur i tha këto u shemb poshtë. I shtrirë përmbys, me duar të hapura, herë mbas here, qëllonte dyshtemenë me grushte...

Pamja e shkallmimit të Vrasësit të Penduar më përcolli gjithë atë padiste dhe më përcolli edhe në mbrëmje e deri në orët e vona të natës dhe, do të mbante ashtu, po mos të ishte ndërhyrja e rëndomtë e tim ati në internet, me ç'rast në "*Udhëzime për hulumtime*" ma dërgonte një dokument disa faqesh (*Thashetheme në kohën e Facebook-ut*), me porosinë se të tilla ka aq shumë, saqë mjaftojnë për hapjen e shumë e shumë proceseve... Thoshte se disa prej tyre duhet marrë me rezervë ngaqë midis tyre ka edhe shkrime që futen qëllimisht nga qarqe të caktuara të cilat janë të interesuara që ato, në mënyra të ndryshme, të pengojnë nxjerrjen e të vërtetës...

### ***“Thashetheme” në kohën e Facebook-ut***

(Fragmente nga një debat, për të nxitur debat midis atyre që mund dhe duhet të jenë pjesë e hetimit të “*Dosjes B*” si dhe disa shënime të shkëputura nga kujtimet e disave që kishin kaluar në burgun e Sedllarit dhe prej andej ishin liruar me ndihmën e Misionit të OSBE-së dhe ambasadorit amerikan, W. Woker... Shkëputja si dhe bartja në kronikë ruan strukturën e mirëfilltë të tyre gjuhësore nga rrjeti social...)

**N. N:**

**Letër individuale S. R., dhe H. S.**

*Uroj të jesh sa më mirë.*

*Besoj, para ca ditësh duhet të kesh lexuar një dëshmi irrituese të M. Z. Ishte fjala për F. G., nga Shtimja, i përfshirë në “*Rastin B*”.*

*Për F.G., ka të dhëna kontradiktore, nga ajo se ishte mik me komandirin e policisë në Shtime, Dragan Gjorgjeviq, rrjedhimisht spiun i tyre, deri te vlerësimi nga A. S. për “*njeri besnik*” (më 6 qershor 1998, kur i është bashkangjitur grupit prej 64 pjesëtarëve të UÇK-së, për t’u futur ilegalisht nga Shqipëria në Kosovë).*

*Gjatë lufte duhet të jetë arrestuar nga UÇK-ja dhe është mbajtur në “*burgun*” e Llapushnikut, i dyshuar si informator i forcave pushtuese serbe. Por tashmë mban edhe statusin e veteranit të ZOP (Pashtrikut).*

*Ja dëshmia konkrete e M. Z.:*

*„Me 06.06.1998, me koordinim të „komandant dajës“ (A. S.), jemi nisur në rrugëtim për t’u futur në Kosovë 64 veta. Ishim tre bashkëveprimtarë të LPK-së. Unë, S. H., dhe R. S.*

*“Daja” duhet ta kishte angazhuar M. Z., i cili incizoi me kamerë nisjen e grupit tonë...*

*“Daja” na e besoi neve të LPK-së si shok të sigurt F. G., si kuadër të sigurt, që duhej të përkujdesemi mos t’i ndodhë gjë.*

*Në natën e 7/8 qershorit jemi ballafaquar me forcat serbe, mbi Demjan, Malet e Pashtrikut. Nga ana jonë ka ra dëshmor H. H., dhe janë plagosur disa të tjerë. Nga pala serbe, siç jemi informuar nga EURONEWS, janë vrarë 5 ushtarë.*

*Në atë ballafaqim pat munguar F. G., rreth katër orë. Pastaj na rrëfeu se i kishte rënë të fikët...*

*Kemi vazhduar rrugëtimin në Kosovë.*

*F. G., është shkëputur nga grupi në Carralevë, buzë Shtimes. Më nuk e kam takuar gjatë Lufte.”*

*Është korrekt dëshmia e M. Z.?*

*Me respekt,*

*N.N.*

\*\*\*

**R. S.**

**(Përgjigje publike N. N. përmes fcb)**

*Përshëndetje,*

*F. G., që ne për herë të parë e kemi takuar më 6 qershor të vitit 1998 në fshatin Vlanë, është e vërtetë që ka hyrë në Kosovë, me grupin prej 64 personave si pjesëtarë të UÇK-së. F. G-në, në fillim na e prezantoi A. S., dhe na sugjeroi që të kujdesemi për të, sepse ka probleme shëndetësore në shputat dhe në mesin e këmbëve. Ato probleme ishin shfaqur nga ecja në këmbë gjatë hyrje-daljes së tij Kosovë-Shqipëri, duke shoqëruar grupe të rinjsh me armatim.*

*Problemet e tija shëndetësore edhe ne i kemi parë me sy kur në një moment zbathi këmbët dhe na tregoi, se këto çarje iu kanë shkaktuar nga rrugëtimi i vazhdueshëm.*

*Pastaj, shkëputja e F. G-së për disa orë nga grupi kur ne kemi rënë në pritë është e vërtetë. Por një shkëputje e tillë ka ndodhur me shumicën e grupit tonë. Disa nga ta si kemi takuar fare gjatë rrugës duke hyrë për në thellësi të Kosovës. Gjatë atij rrugëtimi, F. G., ka pasur sjellje të shkëlqyera me neve dhe gjithë të tjerët. Vetëm pasi që kemi arritur në Carralevë, kemi dëgjuar fjalë nga njerëzit që e akuzonin për bashkëpunëtor të policisë serbe. Me të thënë të drejtën akuzat kundër F. G., nuk më bënë përshtypje mua, sepse ato vinin kryesisht nga njerëzit që bënë sehir ndaj luftës dhe në mënyrë të heshtur ishin kundër pranisë së formacioneve të UÇK-së në atë pjesë...*

*Prej atij momenti që jemi ndarë me F. G., në grykë të Carralevës, më kurrë s'e kamë takuar. Identitetin e tij të vërtetë e kamë mësuar pas shfaqjes në RTK nga akuzat dhe kundërakuzat në mes N. L. dhe F. G.*

*Të përshëndes e kalo mirë!*

\*\*\*

I. Zh.

(Koment):

*“Unë edhe me para kam shkruar se F. G., e ka motër te babës K. G., e cila ishte dënuar nder te parat vajza, me 5 vite burgim pas demonstratave të vitit 1981...”*

\*\*\*

N. N.

(Përgjigje/koment):

*I.,*

*N.,*

*R.,*

*në këto debate nuk do të duhej të angazhohemi vetëm për hir të tifozërisë ose për inat ndaj ish-shokëve e bashkëveprimtarëve. Distanca kohore është e bollshme që të mos kemi emocione.*

*Ta zëmë, bashkëveprimtar për disa vite e kisha S. N. Edhe tapinë e patriotit veteran e ka siguruar. Por, kur dalin prova se ai paskësh qenë njeriu i I. K. (ish-shefit të UDB-së së Prishtinës), nuk kemi pse ta heshtim e fshehim, vetëm pse S. paskësh qenë udhëheqës i J. G., ose bashkëveprimtar me M. K., A. D., etj.*

*Shërbimet sekrete të KSA Kosovës, RS të Serbisë, RSFJ-së i kanë pasur të shtrira metastazat bukur thellë në popullsinë tonë.*

*Tani, meqë Ju e njihni personalisht F. G., si e komentoni arrestimin e tij nga PU e UÇK-së, me urdhër të komandantit të Zonës Sh. B.?*

*Disa pjesëtarë të UÇK-së më kanë shkruar në privat për angazhimet e F. G., para e gjatë lufte, në bashkëpunim me strukturat e Serbisë. Si t'i (ç)vlerësojmë ato!?*

*Se është nip i veprimtares veterane K. G., nuk është argument i mjaftueshëm mbrojtës, meqë K. nuk ka pasur mundësi t'i përzgjedh nipat ose edhe t'i mbajë nën kontroll. Çfarëdo që të flasë dikush për G. K., djalën e djalit të Axhës tim, unë nuk i kundërvihem, sepse është karakter që për përfitime personale edhe nënën e vet do ta dhunonte, jo më t'u shërbente shërbimeve armiqësore (siç duket t'u ketë shërbyer). Kushdo që do ta mbronte G. K., duke u bazuar në argumentin se e ka xaxha Prof. Dr. M. K., ose se më ka kushëri mua, do të disfavorizonte hetimet e sakta për të.*

*Sa i përket karakterit të F. G., mua më ka rastisur të angazhohem si “pleqnar” para disa viteve në një zënkë të rëndë mes ca pjesëtarëve të UÇK-së dhe F. G., për mashtrimet ordinere*

që ua kishte bërë ca hallexhinjve që grumbullonin për të mbeturina metalike. Por, as ky karakter pisanjor e inkriminues i tij nuk është argument bazik për ta demaskuar atë si marionetë të Serbisë.

M. Z. ka ofruar vetëm dëshmi fizike, se A. S. më 06.06.1998 ua ka “ngarkuar” F. G., tre ish-bashkëveprimtarëve të LPK-së (S. H., M. Z., dhe R. S.), që të kenë përkujdesje ekstra ndaj F. G., meqë e çmonte për “kuadër besnik” (nuk u kishte thënë se është udhëzues teknik për t’u treguar 64 pjesëtarëve të UÇK-së se nga duhet të ecnin për të mos rënë në prita të policisë e ushtrisë serbe). Dëshmisë së tij “teknike” M. i ka shtuar edhe “humbjen” e F. G., për rreth 4 orë, pasi janë futur në territor të Kosovës, dhe arsyetimin e tij se paskësh pasur dhimbje stomaku.

Pyetje: Përse F. G., është “ende”, – hyn e del “ilegalisht” Kosovë-Shqipëri, dhe për atë shkak edhe iu paskëshin plasaritur këmbët, – kur nuk paskësh pasur rol ekstra nga UÇK-ja, as si shoqërues, as si transportues armësh?

Tifozërive folklorike duhet t’u ketë skaduar afati, besoj.

Për mua, ta zëmë, vetë A. S., me gënjeshtërën e tij skandaloze se paskësh qenë komandant i përgjithshëm i UÇK-së, dhe me sabotimet e komplotet që ia ka bërë UÇK-së gjatë viteve 1994-1999, ka qenë dhe është më i dëmshëm se sa vetë I. K., i cili duhet të jetë vrarë me urdhër të A.

Përse argatët dhe shërbëtorët aktivë dhe pasivë të A. po heshtin, nuk po i dalin atij në mbrojtje, (pos ortakut i tij, Xh. H., dhe ndonjë përfitues nga ajo bandë sabotuesish e komplotistësh)?

Përse askush nuk po ofron ndonjë provë, që dëshmon se ndonjë institucion kompetent e paskësh zgjedhur ose emëruar A. për “komandant të përgjithshëm” të UÇK-së!?

\*\*\*

Sh. M.

(Koment):

“S’ka më keq se kur flitet me hamendje apo me qëllim të caktuar, aq më tepër kur nuk e qartëson si duhet dëshminë që jep me shkrim...”

\*\*\*

N. N.

(Përgjigje/koment):

Sh., komenti yt se “tani kjo dëshmia e dytë e R. S., është shumë më e qartë”, është përshtypje jote subjektive. Unë e kuptova si fragment plotësues, por jo përcaktues.

Ty të paskësh bërë më shumë përshtypje informimi i R. S., “problemet e tija shëndetësore edhe ne i kemi parë me sy kur në një moment zbathi këmbët dhe na tregoi, se këto çarje ju kanë shkaktuar nga rrugëtimi i vazhdueshëm”, se sa informimi “shkëputja e F. G., për disa orë nga grupi kur ne kemi rënë në pritë është e vërtetë.”

Pyetjet që kanë nevojë për sqarim:

1. Përse i është bashkëngjitur “grupit” prej 64 pjesëtarëve të UÇK-së F. G., “i sëmurë”, që as nuk e ka pasur rolin për të udhëzuar “grupin” në rrugicat që duhej të kalonte, as nuk paskësh pasur ngarkesë me armë?

2. Përse F. G., qenkësh shkëputur i vetëm nga “grupi” për disa orë, në momentin kur “grupi” po ballafaqohej me pritën?

3. Sipas M., për shkëputje F. G., qenkësh arsyetuar se i kishte rënë të fiktë. I ka qëlluar dikush pranë për t’i ofruar ndihmë?

4. Cilat “grupe” të hyrje-daljeve ilegale (Shqipëri-Kosovë) duhet t’i ketë shoqëruar F. G., siç informon me këtë rast R. (“Ato probleme ishin shfaqur nga ecja në këmbë gjatë hyrje-daljes së tij Kosovë-Shqipëri, duke shoqëruar grupe të rinjsh me armatim.”)?

5. Përse atëherë Policia Ushtarake e UÇK-së e ka arrestuar F. G., me urdhër të Komandantit Sh. B.?

6. Në prag të Konferencës së Rambujesë F. L. duhet të ketë dhënë urdhër për demobilizim të F. G., nga UÇK-ja. Mund ta konfirmojë ndokush këtë urdhër dhe nëse është i vërtetë, si është arsyetuar?

Një (ç)vlerësim subjektiv: Një mashtrues skandaloz, që ka gënjyer se ishte komandant i përgjithshëm i UÇK-së, si rasti i A. S., dhe as një F. G., për të cilin është angazhuar vetë A. S., që të lirohet nga arrestimi që i kishte bërë UÇK-ja, assesi nuk do të duheshin të niveloheshin në veprimtari inkriminuese, në bashkëveprim edhe me policë të Serbisë, për t’ia plaçkitur pronat sa më shumë Shtetit të Kosovës.

Në ndërkohë, ndoshta është bërë e qartë se kush janë kuadrot e prokurorisë së Serbisë (N. B, F. G...) në këto veprimtari të krimit të organizuar dhe të kujt argat paskëshin qenë ata gjatë Luftës...

Sh..., të lutem, ke mirëkuptim për shqetësimin dhe angazhimin tim, sepse unë nuk mund të rri indiferent si shumë konformistë e frikacakë, meqë A. S., mediat po e prezantojnë rrejshëm si “komandant i përgjithshëm” i UÇK-së, në kohën kur është në burg hetues, i dyshuar për udhëheqës të krimit të organizuar për veprimtari tepër ordinere.

\*\*\*

Sh. M.

(Përgjigje/koment):

Mirë shumë N. N., po unë s’mund të jem më objektiv në cilësinë e spektatorit. M. e R., si dëshmitarë të drejtpërdrejt kanë treguar ashtu si i kanë parë gjërat atëherë, kurse tash pas 18 vitesh dikujt i konvenojnë këto fakte për t’i përshtatur në favorin e tij, kjo është çështje tjetër.

Në pyetjet që po kërkon sqarime 1) Duhet me shkuar në Dyz me marrë përgjigje. Pyetja 2/3. deklarime të ndryshme për një nuancë të M. e R., njëri thotë u nda i vetëm, tjetri me disa të tjerë. Për pikët 4 , 5 dhe 6 unë s’di gjë jo, për të tjerat në rregull , po të them në rregull se as këto s’i di..... ! Mësues i keq je N. N., dje më tha “bravo” për një koment me temë të njëjtë , e sot më bërë pus, veç R. po thotë se s’është ndarë i vetëm F. G.

\*\*\*

N. N:

Sh., me të lavdëruar përherë, të rritet mendja.

R. nuk e ka saktësuar, nëse F. G., është ndarë i vetëm, ose me të tjerë.

Mund ta marrim me mend se si shpërndahen natën kur 64 veta bien në pritë (ndoshta për shkak të spiunimit dhe GPS që mund të kishte me vete F. G., meqë për tjetër gjë nuk duket se është infiltruar në “grup...”)

Do të kishte vlerë ta saktësonin vetë pjesëmarrësit e “grupit”, kur vërtet është shkëputur F. G.,

Pyetjet nuk t’i drejtova ty por secilit që ka informacion konkret.

R. po duket se është i zënë ose nuk po i duket me rëndësi t’i kujtojë detajet (meqë djalli fshihet në detaje), sepse tashmë kanë kaluar gati 18 vite.

Nëse del se F. G., edhe para Luftë ishte spiun i Serbisë, siç spekulohet edhe për disa të tjerë që i ka angazhuar A. S., atëherë ndërgjegjësohemi se ai nuk e ka sabotuar e komplotuar UÇK-në për shkak të injorancës së tij, por për shkak se ashtu është komanduar nga eprorët. Fatkeqësisht bashkëveprimtarët po heshtin për t’i kompletuar e konkretizuar të dhënat që kanë të bëjnë me sabotimet e komplotet e tij.

*E vërtet e hidhur është se ai dhe Xh. H., i kanë sabotuar e komplotuar tre bërthamat e para dhe kryesore të UÇK-së (Drenicë, Llap, Dukagjin), i kanë sabotuar gjatë luftës disa luftëtarë të shquar, për të cilët janë frikësuar se do të mund t'i izolojnë këta sabotues e komplotistë, etj. Tragjike është fakti që R. Ll. informoi se R. S. e ka dëbuar nga Kosova Luftëtarin epik "Abeja", dhe askush nuk u mor me të, meqë po na mungojnë strukturat, qoftë vetëm morale, për të grumbulluar e (ç)vlerësuar të dhënat.*

*Uroj të zhbllokohen edhe hetimet për vrasjet e I.K., dhe H. M...*

\*\*\*

Sh. M.

(Përgjigje/koment):

*Jo, jo, s'ke nevojë të më lavdërosh fare, po unë preferoj t'i ndajmë gjërat, unë si lexues po komentoj, jo si dëshmitar. Ja pse e kam shkruar komentin e parë këtu dhe në çka jam bazuar: Citat nga komenti i R. "Pastaj, shkëputja e F. G., për disa orë nga grupi kur ne kemi rënë në pritë është e vërtetë. Por një shkëputje e tillë ka ndodhur me shumicën e grupit tonë. Disa nga ta s'i kemi takuar fare gjatë rrugës duke hyrë për në thellësi të Kosovës" – fund citati., se harrova, a tregon kjo që F. G., s'u nda i vetëm apo me një grup njerëzish, sqaroma N. N., se s'po kuptoj !*

\*\*\*

I. Zh.

(Përgjigje/koment):

*N. N., Unë kam respekt për familjen G., përderisa nuk vërtetoj diçka të tillë që Ti e M. e shumë të tjerë flasin e shkruajnë kundër F. G. Nëse i biem dikujt në qafë vetëm pse ai person nuk ka mundësi të dalë e t'i mohojë këto gjëra, mendoj se hyjmë në gjynah jo vetëm ndaj tij, por edhe ndaj familjes dhe shoqërisë së tij. A ka më vështirë për një familje që është sakrifikuar për çështjen kombëtare të dëgjojë gjëra të tilla të pavërtetuara për një familjar të tyre, nga njerëz, që ne mendojmë se kanë kontribuar shumë për këtë Kosovë? Nëse F. G., për ato momente që paska munguar në grup (ku shtisi thotë se është larguar i vetëm, ndërsa tjetri thotë se: janë larguar shumë dhe disa fare s'i kane takuar më), do të kishte lajmëruar forcat serbe, siç mundohet të paraqitet situata, atëherë besoj se nuk do të kishte qenë vetëm një i vrarë nga shqiptarët, por ndoshta më shumë se gjysma e tyre. Është krejt normale, kur flitet shumë kundër dikujt e sidomos në situata lufte, të merret ai person në pyetje. Përderisa nuk është dënua, d.m.th., nuk qenka vërtetuar asgjë për të, dhe është lënë i lirë. Kam dëgjuar se e kanë parë në helikopter të policisë serbe. Mund të jetë e vërtetë, por kjo s'do me thanë se ka qenë bashkëpunëtor i tyre. Forcat serbe kanë mundur ta bëjnë me qëllim që ta komprometojnë para mendjelehtëve dhe atyre që ia kanë patur inat familjes së tij.. Një gjë të tillë N. N., e ka bërë UDB-a serbe edhe me Ty. A mendon se UDB nuk ka mundur me të vra edhe ty kur vrau vëllezërit G. dhe K.?! Të kanë lënë të gjallë vetëm që të mundohen me të komprometue Ty para shoqërisë dhe familjes. Por nuk ka mundur, sepse shoqëria, rrethi nuk ka patur pretendime të caktuara kundrejt teje. Siç u pa nga ajo që po shkruan po më duket se je tue ia ndihmue ndonjë prokurorie që të ngre pretendime se në filan vend paska patur ndonjë të burgosur?!... Kjo nuk po më duket e hijshme prej teje.*

\*\*\*

N. N:

*I., unë nuk e njoh Familjen G., por meqë e kanë dhëndër N. M., kolegun tim të studimeve, shokun e respektuar e të çmuar deri te Dielli, kam gjithsesi respekt!*

Njerëzit madhorë janë përgjegjës individualisht! Nuk do të më vinte mirë nëse ndokush do të më (dis)kualifikonte pse Familjes tonë i ka ra hise devijanti plangprishës G. K.! Prandaj, as Familjen G., nuk do ta (dis)kualifikoja për shkak të bëmave të F. G. E se ishte pis, ishte, gjithsesi! Më ka rënë hise me u marrë me pajtim të sherrnajeve vulgare të tij... Çështja e F. G., është mbajtur nën plaf pse komplotisti, krimineli e marioneta A. S., i qëndronte mbrapa. Përndryshe, moti është dashur të pleqërohet, pse UÇK-ja e zonës përkatëse e kishte arrestuar atë, kurse marioneta A. S., kishte intervenuar për ta liruar. Do të duhej të pleqërohej, përse A. S., ua bashkëngjiste atë marionetë “grupeve” që hynin fshehurazi nga Shqipëria. Etj., etj.

### **Dëshmi të tjera nga Facebook-u**

#### **Si i arrestoi „Gjarpri” aktivistët e LDK-së**

...Mbas të pames kemi shkuar në **Zyrën Amerikane** që ishte në shtëpinë e I. P., djalit të Z. Sh., që punonte në Francë, tash i ndjerë, nga Dragobili, familje tepër bujare, bukëdhënëse dhe shumë e ndershme.

E kishim kohën e caktuar që kishim me bisedue në Zyrën Amerikane me zyrtarë të OSB-së. Kështu quhej kjo zyrë nga popullata e asaj ane, si Zyrë Amerikane.

Pas bisedës me zyrtarin e lartë të OSB-s (?), Shoën Burns, Diplomati Amerikan, jemi arrestuar pabesisht nga një “ushtarak” i lartë i UÇK-së i njohur tashme për opinion me nofkën “Gjarpri”.

Deri sa ne ishim në takim duke biseduar në Zyrën Amerikane, në Dragobil, “ushtari” F. K., nga Bubaveci ka hyrë dy herë brenda në ZYRË dhe e ka ndërprerë bisedën duke na lënë një “thirrje”.

Shefi i Zyrës së OSB-së, Shën Berns i thoshte ushtarit:

-Pritni jashtë, edhe pak, derisa ta kryejmë bisedën!

Pas bisedës e cila ishte ndërprerë disa herë, falënderuam Zyrtarin e lartë amerikan dhe dolëm.

Jashtë na kanë pritur 4 ushtarë: S. H., nga Carralluka, D. L – K., nga Drenofci, F. K. nga fshati Bubavec dhe Sh. M, nga Malisheva.

Ushtarët kanë qenë me uniformë “ushtarake”, me emblemë të “UÇK-së” dhe të armatosur.

Çka kemi biseduar në Zyrën Amerikane dhe çka kemi kërkuar nga Ata?

Unë, J. K. dhe C. D., kemi kërkuar nga përfaqësuesi i Zyrës dhe OSB-ja që ta ushtrojnë autoritetin dhe të ndikojnë te qeveritë e tyre që të bëjnë presion mbi Serbinë:

Që të largohet policia dhe ushtria serbe nga kjo anë,

Të kthehet popullata shqiptare në shtëpitë e veta dhe

Që të fillojë mësimi nëpër shkolla fillore dhe të mesme në komunën tonë.

Këto kanë qenë tri kërkesat dhe temat e bisedës sonë me zyrtarin e lartë amerikan, përfaqësues i OSB-se. Takimi ka filluar në orën 11:45 minuta dhe ka përfunduar në orën 13:30 minuta, ka zgjatur afro dy orë, më 30 tetor 1998, në fshatin Dragobil.

“Ushtarët”, na pritnin para derës. Kur dolëm nga zyra, njëri nga ushtarët na tha, më duket ka qenë Sh. M.:

-A ka mundësi që të flasim nja 15 minuta me juve, me mua, J. dhe C.?

-Me kënaqësi i kemi thënë të dytë me një gojë dhe kemi shkuar te automjeti që na priste jo fort larg.

Një i afërm që kishte qenë me neve n`t`pame na tha ngadalë:

-Jo 15 minuta po kanë me iu burgosë!

Nuk besonim se janë kaq të pabesë e aq të poshtër, “ushtarakët e ushtrisë së popullit ushtar”.

S. H. K., ishte shoferi i "ushtarakut". E njihnim sepse kishim qenë te ai. Ishte vëllai i S. Sh. nga Kleçka që ishte vrarë në Rahovec. Kemi hyrë në automjetin ku ishte edhe "ushtaraku i lartë".

Automjetij tonë, e lamënë territorin e "çliruar" na shoqëronin edhe dy të tjera plot me ushtarë e "ushtarakë me grada të larta".

Pra, na arrestuan dhe po na dërgonin në burg, sikur cjapi te kasapi.

Rrugës deri në "burg", kemi kaluar nëpër këto fshatra: Dragobil, Marali, Pagarushë, Gariq, Kravasari, Bajë, Senik, Lladrofc, Kizhnarekë, Bincën e Shefqet Kapetanit e Sadllar dhe kemi biseduar "për Shkup e për Shkodër". Deri në Lladrofc biseda ka qenë e qetë dhe e rrafshët. Më vonë "ushtaraku" ka pyetur:

– Çka biseduat në zyrat e OSB-së?

Në fshatin Senik, "Gjarpri" ka zbritur nga automjeti dhe ka hyrë në një shitore. Aty, ai na ka blerë nga një lëng (pije joalkoolike) ndërsa mua dhe J. edhe një pako me cigare pasi që unë e pija duhanin. Biseda ka vazhduar deri në Lladrofc "n' terezi".

Aty, ai m'u ka drejtua me fjalët:

-Ti kryetar i LDK-së:

Rugova është tradhtar!

Qeveria e Bukoshit e ai është tradhtar!

Këtu kemi me iu pushkatue juve dhe krejt ravinat kemi me i mbush me LDK-në. Ishte monologu i monologizuar i "kryeushtarakut", por me zë të lartë, ish studentit të "shkencave humanitare". "Kryeushtaraku" ka bërë titull edhe më shumë, si "ushtarak" dhe "profesor" i "akademisë ushtarake të Drenicës":

-Shymni cigaret!

-Jeni të arrestuar! "Ushtaraku" e ka bërë gati revolen T-T dhe na e ka drejtuar neve duke bërë titull:

-Mos luani!

Ushtari dhe shoferi kanë dal jashtë dhe na kanë urdhëruar që edhe ne të dalim një nga një. Pasi kemi dalë nga vetura, (J. K.) dhe C. D., na i kanë lidhur duart dhe na i kanë vut "Maskat". Sytë na i kanë mbyllur me shamia, kurse kokën na kanë mbuluar me qese, thasë të najlonit.

Prej këtij momenti fillojnë maltretime, fyerjet, ofendimet dhe rrahjet të shoqëruara me shprehje më banale, me fjalor të ndytë, gjuhë primitive e sjellje arrogante.

Agresiviteti, dobësia, primitivizmi dhe etja për të qenë "i madh" e "ushtarakut", ka "filluar" në fshatin Lladrofc, në kthesën e parë të rrugës që çon për në lagjen e Buqajve. Në të vërtetë sjelljet e pista të tij e kanë fillin te edukata familjare e më vonë, rrethi, "shkolla", "ilegaliteti" e "mërgimi", "mali për vendlindje".

Pas mesnate, ndërsa vazhdonim rrugën, kemi kuptuar se jemi në fshatin Nekovc. Që jemi në Nekovc e kuptuam nga "ushtarakët", sepse edhe ata nuk e dinin rrugën. Në një vend e kanë ndaluar automjetin dhe e kanë hapur dritaren dhe i kanë pyetur "rojet e fshatit":

-Ku jemi? Rojet përgjigjen:

-Jeni në Nekovc!

Rrugën e kemi vazhduar prej Nekovcit, Bincës e deri në Sadllar.

Në Kishnarekë na kanë shti me "pushua" në podrumin me ujë të një shtëpie të djegur, si peng për ekzekutim. C. D., ia kanë prurë një karrige për t'u ulur për shkak se ishte i sëmurë nga veshkat, ndërsa unë kam ndejë në këmbë. Pas afro dy orëve na kanë çuar në një vend tjetër, më të terur, në të njëjtën shtëpi. Aty na lejuan të ulemi në do thasë me kashtë.

Diku në mesnatë na kanë dërguar në një kamp, burg, në fshatin Sadllar, pasi na plaçkitën dhe na i morën të gjitha gjërat tona personale: shënimet, të hollat e pakta ...dhe kapelën që e kam pasë në kokë e na kanë bërë vishkëll...

Në Burgun e Sadllarit na kanë mbajtur, prej 30 tetorit deri më 27 nëntor 1998. Ambulancën e fshatit e kishin kthyer në “burg”. Aty na kanë mbyllur, në ambulanten e fshatit, në ordinancën e mjekut që e kishin kthyer në burg. Ordinanca e mjekut derën e kishte në oborr dhe bënte shume ftoftë natën sa që edhe uji ngrihej e nuk mund të flinim nga të ftohtit që bënte.

Natën në mes 26 dhe 27 nëntorit, na kanë çue më herët prej gjumit dhe me një traktor na kanë afrua deri në Divlakë. Rugës, na i kanë vënë përsëri maskat në kokë që të mos e shihnim “ushtrinë”, “rojet ushtarake” dhe “dephanet”.

Duhet shtuar edhe kjo: gjatë kohës sa ishim në burg nuk na kanë lejuar që të kemi as ujë të pastër. Ujë të mjaftueshëm nuk kemi pasë as me pi e as me u pastrue. Më 24 nëntor, tinëzisht i kemi larë këmbët. Edhe kur kishim nevojë, nuk na lenin me dalë pa maska e pa “roje”. Nuk jemi pastruar e as rruar deri më 27 nëntor, kur “lirohemi”.

Ditën e lirimit na kanë dorëzue në Dragobil, tash me automobil, te **Shefi i OSB-së Ambasadori Uilliam Uoker**.

Në pritje përveç përfaqësuesit më të lartë të OSBE-së Uoker-it, merrnin pjesë edhe disa “komandantë”, S. B. e ushtarë të rreshtuar me uniformë e rroba të reja, si në paradat ushtarake para “Kremlinit”, kamera, gazetarë të huaj dhe një grup i të vogël i dragobilasve. Nuk kanë munguar as fjalimet e “komandantëve” për “zemërgjerësi” e “transparencë”, “shtet” të lirë e demokratik me “burgje”, “polici ushtarake” e gjepura të ngjashme.

J. K., C. D., dhe Shën Berns me veturë të blinduar amerikane kanë shkuar në Turjakë. Shën Berns, përfaqësues i OSBE-së për atë rajon ka ndejë disa orë në odën e Rr., nipit të Sh. S. Aty, ai ka biseduar me U. I., babën e autorit të këtyre rreshtave (S. K.)

### ***Të arrestuarat e Qirezit***

Në shtator të vitit 1998, një grup aktivistësh të subjekteve të ndryshme, përfshirë edhe tri gra (N. K., E. T. dhe S. H.) kishin shkuar në Drenicën e përfshirë në flakët e luftës për të parë gjendjen në terren dhe sidomos pozitën e rëndë të popullsisë së zhvendosur.

Në shkollën e Qirezit ata arrestohen nga Gjarpri dhe një bashkëmendimtar i tij dhe trajtohen mizorisht prej tyre...

Për këtë sjellje çnjerëzore ka dëshmi të detajuara me shkrim dhe me gojë (incizime), të viktimave, të cilat ato-ata ua kanë dorëzuar me dorën e tyre edhe institucioneve ndërkombëtare...

8.

Me mbylljen e seancës së tretë hetimore, së cilës i ishte dashur ndërhyrja e mjekut, kishin marrë fund takimet e mia me Vrasësin e Penduar, edhe pse nga prokurori i çështjes kisha kërkuar edhe dy seanca të tjera me arsyetimin se “ishin shfaqur edhe disa faktorë të tjerë të dobishëm për hetimin”, ndër të cilët kisha theksuar rëndësinë e Rojës së burgut (si dëshmitar i mbrojtur i gjykatës) si dhe ditarit të burgut, ku edhe letra e gjetur e argjendarit nga Prizreni Lekë Sh., luante rol të madh jo vetëm për nxjerrjen në dritë të gjithë asaj që kishte ndodhur nëpër burgjet private, por edhe për ndriçimin e rrethanave shoqërore dhe politike të kohës që kishin mundësuar një zhvillim të tillë. Andaj, kërkoja që pista hetuese të zgjerohet me përfshirjen e Rojës së burgut si dhe hetimin e personave të tjerë që kishin urdhëruar hapjen e “qendrës parandaluese”, siç shënohej në disa raporte vendore ose “burgjeve private” nëpër “zonat të lira”, siç quheshin nga vëzhguesit e jashtëm dhe përfaqësuesit e asokohshëm

të misionëve ndërkombëtare në Kosovë (OSBE-së, Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, shoqatës humanitare gjermane Capanamur e të tjerë), term ky që më vonë ishte futur edhe në gjyqësinë e UNMIK-ut, atë të Hagës dhe të EULEX-it.

Ndinëse dukej se kryehetuesi tregoi mirëkuptim ndaj propozimit tim dhe premtoi se e gjitha do të bartej te prokurori i çështjes dhe kolegji kryesor i EULEX-it, ndërlikimi i Rojës së burgut në pistën kryesore të hetimit, ndonëse më në fund u pranua, si do të shihet, me vrasjen e tij, si dëshmitar i mbrojtur në Gjermani, iu kthye në bumerang gjithë hetimit, gjë që më shtyri që në shenjë proteste të tërhiqem nga hetimi, në të cilin kisha punuar me përkushtim të madh për afër tri vjet edhe për faktin se në gjithë atë çështje përshkohej edhe njëri nga aktet e fundit të tragjedisë së familjes së gjyshes sime të dashur, Mari Sh., nga Shkodra dhe kushërinjve të tyre në Kosovë e nisur në fundin e Luftës së Dytë Botërore dhe e vazhduar në këtë të fundit në Kosovë me ç'rast asaj do t'i shuhen gjurmët, tragjedi kjo që fillova ta përjetoj personalisht dhe ta ndjej edhe pjesë timen...

Por, para se të vijë kjo thyerje e rëndë dhe me pasoja për këtë rast dhe për ndriçimin e gjithëmbarshtëm të kësaj problematike që kishte ngarkuar kohën e pasluftës deri aty sa edhe t'ia përcaktojë politikës së vendit profilin kriminal, duhet thënë se kthimi i hetimit kah Roja e burgut si dhe ditari i tij, gjithë çështjes ia ndryshonte qasjen themelore, ngaqë e nxirrte nga një dosje e rrudhur e një grupi kriminal, që thuhej se "kishte vepruar gjatë një lufte të paqartë e me interesa të shumta të ngatërruara", ku parashihej të mbetej, për ta bartur te një dosje komplekse, ku vrasësit e porositur ishin mjet i një koncepti politik ideologjik për marrjen e pushtetit me dhunë revolucionare, që duhej për me u përcjellë edhe me rrënimin e shtresës intelektuale dhe sistemit të gjithëmbarshtëm të vlerave, në mënyrë që ajo, në rrethanat e reja të kapërcimit nga protektorati deri te pavarësia, të mos lejohej për ta marrë përsipër përgjegjësinë për ndërtimin e një shoqërie të lirë dhe demokratike të kthyer nga qytetërimi perëndimor.

Mendja ma merr se ekipi i hetuesve, që çështjes i kishte hyrë me një qasje profesionale, kishte përkushtimin e një hetimi të gjithanshëm, por më kohë, zuri të çorientohej sa nga koncepti i prokurorit që atë ta mbante në kornizat e një përcaktimi, siç thoshte, "që të mos e humbte orientimin prej nga i kanosej rreziku i dështimit", e sa nga destrukcionet e shumta, siç ishin zhdukja e dëshmimeve dhe pengimi i dëshmitarëve (kërcënimet e hapura atyre dhe familjeve të tyre) qofshin ata edhe të mbrojtur, pa përjashtuar këtu edhe dekonspirimin gjatë hetimeve si dhe eliminimin fizik të tyre në rrethana tepër të dyshimta, por që ndiqnin thujtë të njëjtin skenar (fatkeqësitë e pasqaruara të komunikacionit, "vetëvrasjet" ose edhe zhdukja e personave në prag të gjykimeve!)

Rreth mundësisë së zhdukjes së dëshmimeve dhe kërcënimit të dëshmitarëve si një vështirësi që duhej pasur parasysh, me të cilin ishin përballur thujtë të gjithë hetuesit ndërkombëtarë nga paslufta e këndej në secilin proces, ishim njoftuar edhe gjatë punës përgatitore. Nëpërmes kanaleve zyrtare dhe atyre të tërthorta, dinim për shumë e shumë raste të dështuara ose të papërfunduara të gjyqësorit të UNMIK-ut, pikërisht pse hetuesia nuk kishte qenë në gjendje ose nuk kishte deshur t'i parashtrojë para gjyqit dëshmitë dhe dëshmitarët e paraparë, ngaqë ato, gjatë procesit hetimor, ishin shkatërruar ose zhdukur në momentet e duhura, ndërsa dëshmitarët (nga kërcënimet) ishin tërhequr, ose kishin ndryshuar dëshmitë deri në atë masë sa që merrnin në mbrojtje të pandehurit për krime të ndryshme gjatë lufte ose të pasluftës! Gjatë një procesi të tillë, njëri nga dëshmitarët që disa hetuesve ua

kishte parashtruar historinë e kidnapimit dhe maltretim të rëndë fizik në një burg të tillë “në një zonë të lirë”, i ballafaquar me njërin nga komandantët e akuzuar për maltretim, fuqia politike dhe ekonomike e të cilit ishte rritur gjatë qëndrimit në burgun hetues, në gjykatë kishte deklaruar se ishte pikërisht “kidnapimi dhe mbajtja e tij në arrest për një muaj që e kishte shpëtuar nga ma e keqja, pra nga vrasja”.

Dëshminë e kishte mbyllur me fjalët:

“Ky është shpëtimtari im! Këtij njeriu ia kam borxh jetën!...”

Ajo që kishte qenë më e kobshmja për drejtësinë në këto rrethana që dekonspirimi si dhe vrasja e dëshmitarëve të mbrojtur edhe atëherë kur ata vendoseshin nën masat e ashpra të sigurisë ndërkombëtare, siç do t'i ndodhë edhe Rojës së burgut në Gjermani, me çka “*Dosja B*”, do të mbetet e papërfunduar, pa marrë parasysh dënimet që mund t'u jepen disave dhe pa marrë parasysh kohëzgjatjen (zvarritjen e çështjes).

Dhe, dekonspirimi i dëshmitarëve të mbrojtur, në forma të ndryshme, kishte filluar gjatë kohës së UNMIK-ut, kishte vazhduar gjatë Procesit të Hagës dhe edhe gjatë kohës së mandatit të EULEX-it.

Në këtë degradim të gjyqësisë kishin marrë pjesë edhe qarqe të caktuara të organeve policore dhe atyre të hetuesisë nga radhët e ndërkombëtarëve, prej nga dyshohej me të drejtë që kishin rrjedhë informata në shtyp prej nga ishin shpërndarë (në një televizion me ndikim dhe në një gazetë ditore), po edhe në radhët e mbrojtëseve (avokatëve). Edhe pse Gjykata e Hagës kishte marrë masa ndaj kryeredaktorit të televizionit dhe të kryeredaktorit të gazetës ditore, duke i shpallur fajtorë dhe dënuar (njëri tre muaj burgim dhe tjetri me gjobë), këtyre mediumeve nuk u ishte marrë licenca, ndërsa përgjegjësit kishin vazhduar të mbanin postet drejtuese edhe më “të forcuar”! Kjo nuk mund të shpjegohet ndryshe pos si veprim i qëllimshëm për të parandaluar që të dalin para drejtësisë garniturat e caktuara politike të ngjitura në pushtet edhe me hipotekën e krimit të organizuar, ngaqë për faktorin ndërkombëtar të vendosjes, në një vend të përplasjeve të vazhdueshme gjeostrategjike, siguria (me të korruptuar dhe të shantazhuar shumëfish) shfaqet më e rëndësishme se vendosja e demokracisë me intelktualë.

Kjo më bëhej me dije edhe nëpërmes postimit më të ri “*Udhëzime për hetime*”.

Fjala ishte për një shpëputje nga shënimi sekret i njërit nga këshilltarët e lartë të qeverisë gjermane (emri me shifër), paraqitur Këshillit për Siguri Kombëtare me rastin e afërës së agjentëve gjermanë në Kosovë. Nga ky shënim kuptohet qartë se politika gjermane, si pjesa më e madhe e simotrave nga vendet perëndimore, nëpërmes shërbimeve të tyre në vazhdimësi ka qenë e informuar mirë e mirë për profilin e politikanëve që kanë ardhur në pushtet në Kosovë si dhe metodat që kanë përdorur ata para, gjatë dhe pas luftës (kryesisht kriminale), për ta fituar atë, gjë që nxjerr në pah qëndrimin e njohur se në Kosovë partnerët politikë kërkoheshin nga radha e atyre që mund të përdoreshin për hesape të ndryshme dhe jo intelektualët patriotë që mund të pengonin kusurijtë në dëm të saj, siç do të ndodhë në të vërtetë...

### ***Shkëputje nga materiali sekret, me shifër(XXX...)***

...Shërbimi informativ (BND) dhe ai ushtarak (MAD) prej kohësh kanë tërhequr vërejtjen se një pjesë e klasës politikenë Kosovë kanë të kaluar kriminale. Kjo vlen veçmas

për ata të “krahut të luftës” të ndërlidhur me milieun ideologjik jashtë vendit, të cilët lidhjet ideologjike i kanë kthyer në fuqi mafioze-kriminale.

...Dihet se shumë prej tyre, ndonëse nga mesi i viteve të shtatëdhjeta dhe fillimet e të tetëdhjetave gjetën strehim politik në Gjermani, vepronin nga platforma ideologjike marksiste-leniniste, identike me atë që kultivonte regjimi stalinist në Tiranë, me çka ata shfaqeshin si oponentë të socializmit vetëqeverisës jugosllavë, kjo nuk përkonte me realitetin shoqëror dhe politik të shumicës shqiptare atje...

...Shërbimet informative asokohe dhe më vonë, vlerësonin se propaganda e tillë marksiste-leniniste në Gjermani ushqente grupet ideologjike në Kosovë, që vepronin ilegalisht atje, komprometonin të gjitha kërkesat për republikën e Kosovës në përbërje të federatës jugosllave, të dala nga demonstratat e vitit 1968 dhe të rikthyera në ato të vitit 1981. Komprometimi i kësaj kërkeje në këtë mënyrë përkonte me politikën serbe të Beogradit ndaj kësaj çështjeje...

...Në radhët e këtyre aktivistëve janë infiltruar edhe militantë të enverizmit si dhe stalinistë të drejtuar nga Moska, e cila ishte e përkushtuar që atje të krijonte rrethana të cilat do t'i shkojnë për shtati, që pas vdekjes së Titos, Jugosllavia dhe Shqipëria të rikthehen në sferën sovjetike...

...Përgjegjës për këtë rrymë, në kuadër të migracionit politik shqiptarë në Gjermani, por edhe atij serb, malazias, grek dhe të tjerë, pa përjashtuar këtu edhe celulat e njohura gjermane dhe ato franceze dhe holandeze nga radhët e “Frontit të kuq”, kanë qenë agjentët e STAS-it nga Berlini Lindor...

...Shërbimi informativ (BND) posedon dokumentacion të bollshëm me informata rreth veprimtarisë së militantëve marksistë-leninistë, që janë dirigjuar drejtpërdrejt ose tërthorazi nga Moska gjatë viteve të shtatëdhjeta dhe të tetëdhjeta si dhe detyrave të marra prej tyre...

... Shërbimi informativ (BND), në kuadër të bashkëpunimit me shtetin jugosllav dhe shërbimet e tij përkatëse, gjatë viteve të shtatëdhjeta dhe të tetëdhjeta, ka shkëmbyer informata të natyrës sekrete me Beogradin rreth veprimtarisë së grupeve ideologjike ekstremiste në përfundim si dhe veprimtarisë së disa militantëve të “Brigadave të kuqe” të dislokuar në Jugosllavi nga shërbimet sovjetike...

...Nga gjithë kjo dosje informative, e cila është rikonstruktuar me informata të ndryshme pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, shpërbërjes së Jugosllavisë së Titos si dhe bashkimit gjerman, është krijuar dosja e re për veprimtarinë e migracionit politik shqiptar në Gjermani dhe vendet perëndimore, me theks te veçantë të ndjekjes së rreshtimit dhe fizionomisë së atyre që u kanë takuar grupeve marksiste-leniniste të lidhura me shërbimet informative të Tiranës, Beogradit dhe të Moskës.

... Edhe pse një pjesë e këtyre militantëve pas rënies së sistemit komunist si dhe rrethanave të reja pas shpërbërjes së Jugosllavisë dhe të bashkimit gjerman formalisht janë tërhequr nga konceptet ideologjike, disa prej tyre, ndonëse me parullat e “bashkimit kombëtar” dhe të “çlirimit kombëtar”, edhe më tutje kanë mbetur të lidhur me Beogradin, po edhe me Tiranën...

...Në të vërtetë, shumë nga këta militantë, veprimtarinë ideologjike e kanë zëvendësuar me atë kriminale pasi që kjo është kërkuar nga bosët e tyre të deridjeshëm në Tiranë nga radhët e sigurimit të shtetit shqiptar, të cilët, pas rrënimit të shtetit shqiptar, i janë kthyer kriminalitetit të gjithanshëm...

*...Kështu, me direktivat e bosëve të tyre nga sigurimi i shtetit shqiptar, që tashmë me kolegët e tyre të deridjeshëm nga Moska, Bukureshti, Beogradi dhe gjetiu kanë krijuar një rrjet ndërkombëtar të krimit të organizuar, janë përfshirë në klanet e mafisë së drogës, të prostitucionit, të armëve e deri te trafikimi me qenie njerëzore...*

*...Qendra e tyre e re logjistike shfaqet Italia, po edhe Beogradi dhe Athina... Prej andej kanë operuar, të dirigjuar në vendet perëndimore...*

*...Kriza e Kosovës dhe më vonë lufta e saj, ka qenë një faktor tepër i rëndësishëm ku ata, gjithnjë të dirigjuar nga ky rrjet ndërkombëtar i mafiozëve të bashkuar nga shërbimet e dikurshme policore të vendeve lindore, kanë gjetur hapësirë për zhvillimin e veprimtarisë së tyre kriminale, nën firmën “patriotike”...*

*...Lufta është kthyer në një mjet tepër të përshtatshëm përfitimi, ngaqë militantët e deridjeshëm ideologjikë, të lidhur me bosët e tyre në Tiranë, kanë filluar të mbledhin para për luftën (pak me vullnet e të shumtën me detyrim) nga biznesmenët shqiptarë jashtë, po edhe nga refugjatët e rëndomtë...*

*...Të tillëve u është dashur edhe politika si një mjet për t'i maskuar qëllimet e tyre kriminale...*

*...Në emër të luftës, ata kanë mbledhur fonde të shumta, por njëherësh luftën e kanë kthyer në biznes të madh me armë...*

*...Biznesi me armë ka kaluar nëpër kanale të dyshimta ngaqë shumë prej armëve janë blerë nga armata jugosllave, ajo rumune, po edhe nga ajo shqiptare...*

*...Me këtë pedigre ata janë futur edhe në politikë... Shumë nga militantët të drejtuar nga qendrat ideologjike nga Gjermania dhe Zvicra, të vendosur në hotelet luksoze të Tiranës, kanë dirigjuar luftën në Kosovë duke e kthyer atë në një plaçkë për pushtet...*

*...Kjo ka ndodhur mbasi që kanë eliminuar krahun “paqësor” të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe të aktivistëve të saj të përfshirë në shtetin paralel, veçmas pasi në Tiranë, (në bashkëpunim me SHIK-un e qeverisë së Shqipërisë) është vrarë kolonel Ahmet Krasniqi, ministër i mbrojtjes i Qeverisë së Kosovës në ekzil. Koloneli ishte një autoritet ushtarak i dëshmuar në luftërat kundër armatës jugosllave në Kroaci dhe Bosnje e Hercegovinë dhe kishte mbledhur rreth vetes ushtarakët profesionistë (pjesëtarë të dikurshëm të ish armatës jugosllave shumë prej të cilëve kishin luftuar në frontet e Kroacisë dhe të Bosnjës dhe Hercegovinës kundër armatës jugosllave)... Ai kërkonte që lufta të udhëhiqej nga profesionistë dhe jo komisarë politikë, ku kishte edhe barinj të vetëgraduuar gjeneralë!*

*...Pas vrasjes së kolonel Krasniqit, me infiltrimin e njerëzve të vet, “krahu i lutës”, ka mbikëqyrur edhe Ministrinë e Mbrojtjes të Qeverisë së Kosovës, të cilën e kanë kthyer në një vegël të veten...*

*...Edhe pse, pas përfundimit të luftës, sipas rezolutës 1244 të KS të OKB-së, Kosova kalon nën mbikëqyrjen ndërkombëtare, “krahu i luftës”, pikërisht me “kapitalin e luftës” (nëpërmes veprimtarisë së SHIK-ut), do të vazhdojë të sfidojë faktorin ndërkombëtar dhe “krahun e paqes”, të dr. Rugovës.*

*...Edhe pse partia e Rugovës fitoi bindshëm zgjedhjet e para (ato vendore) dhe dy të tjerat në nivel të vendit, “krahu i luftës”, nëpërmes SHIK-ut (Shërbim Informativ i Kosovës) i themeluar në luftë, vazhdoi veprimtarinë e vet kriminale...*

*...Ndonëse ilegal dhe në praninë e faktorit ndërkombëtar ky shërbim, vazhdoi legalisht të punojë për marrjen e pushtetit ekonomik dhe politik dhe atij medial, duke përdorur metoda të ndryshme, ndër to edhe kriminale...*

*...Ndër këto metoda janë vrasjet politike të praktikuara edhe gjatë luftës... Nga vendosja e protektoratit ndërkombëtar e deri në vitin 2008, kur do të shpallet pavarësia, vriten 102 aktivistë politikë të Lidhjes Demokratike të Kosovës (midis tyre një anëtar i kryesisë së kësaj partie nga radhët e themeluesve të saj, dy kryetarë komunash, dy deputetë, dy hetues të lartë policie, një prokuror që merrej me hetimin e krimeve të luftës dhe të pasluftës si dhe këshilltari i lartë për çështje sigurie i Presidentit, ministër i mbrojtjes gjatë luftës). Po ashtu, në mënyra të ndryshme vriten edhe disa komandantë të UÇK-së (komandant Drini, komandant Hoxha dhe të tjerë), nga radhët e ushtarakëve profesionistë.*

*...Të gjitha këto vrasje do të mbesin të pazbardhura, edhe pse këto hetime janë marrë përsipër fillimisht nga UNMIK e më vonë edhe nga EULEX-i... Ndonëse të gjitha pistat e hetimeve kanë qenë të drejtuara kah SHIK-u, ato kanë mbetur në gjysmë të rrugës sa nga vrasja e dëshmitarëve si dhe kërcënimi i atyre që kanë mundur të dëshmojnë, po edhe nga mosgatishmëria e një pjese të faktorit ndërkombëtar që t'i dëmtojë partnerët e saj politikë si dhe interesat e lidhura për ta dhe me ta...*

*...SHIK-u ka qenë aktiv dhe në ngjarjet tragjike të vitit 2004, me të cilat është destabilizuar vendi...*

*...Mbas vdekjes së presidentit Rugova dhe përçarjes së LDK-së (në përputhje me planet e SHIK-ut nga njerëzit e futur në të), “krahu i luftës” do të vijë në pushtet...*

*...Ardhja në pushtet e Partisë Demokratike lidhet kryesisht me meritat e SHIK-ut, shërbim paramilitar i kësaj partie i përfshirë edhe në instalimin e rrjetit kriminal në ekonomi, veçmas në fushën e privatizimit të pronës publike, në dobi të fuqizimit materialisht të bosëve të kësaj partie shumë prej të cilëve janë bërë milionerë brenda natës...*

*...Nga koha e ardhjes në pushtet të Partisë Demokratike do të marrin fund edhe vrasjet politike...*

*Kjo do të thotë se “krahu i luftës” ka përmbushur qëllimin kryesor – marrjen e pushtetit me çdo kusht... Marrja e pushtetit me çdo kusht, po ashtu ka për moto betimin e ruajtjes së pushtetit me çdo kusht!...*

*...SHIK-u , në rrethanat e reja, pra të marrjes së pushtetit nga Partia Demokratike dhe bosët e saj të lidhur me kriminalitet ekonomik, me anën e instalimit të bashkëpunëtorëve të vet në gjyqësi, në polici, në FSK, pastaj në shëndetësi, në kulturë, në medime publike dhe ato “të pavarura” si dhe në të gjitha bordet e ndërmarrjeve të vendit, ka vazhduar kapjen e plotë të institucioneve në përputhje me betimin e ruajtjes së pushtetit me çdo kusht...*

*Këtë rrugë ka ndjekur edhe në fushën e arsimit nga caktimi i drejtorëve të shkollave fillore dhe atyre të mesme, këshilltarëve pedagogjikë dhe kuadrove drejtuese në universitet nga shefat e katedrave, dekanëve e deri te rektori...*

*SHIK-u ka krijuar kuota të veçanta për regjistrimin e fëmijëve të veteranëve të luftës në universitet jashtë konkurseve dhe jashtë testit të dijës...*

*SHIK-u, me emra të caktuar, ka dirigjuar edhe listën e studimeve pasuniversitare si dhe specializimet formale...*

*SHIK-u ka “rekomanduar” edhe temat e magistraturës dhe të doktoratës si dhe bartësit e tyre në fusha të caktuara, që janë konsideruar “me interes nacional”!...*

*Në përputhje me këtë praktikë, SHIK-u ku ka dirigjuar edhe pranimin e anëtarëve dhe bashkëpunëtorëve në institutet shkencore (atë të Historisë dhe Albanologjik) e deri në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve...*

*Madje, në Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, SHIK-u ka “kotapultue” edhe një shkrimtar mesatar nga radhët e themeluesve të vet në Tiranë, me qëllim që të pengohet pranimi i shkrimtarëve të mirënjohur të Kosovës, nga frika se ata mund ta nxirrnin nga ndikimi i politikës dhe krijuesve mediokër!...*

*...Krahas kapjes së institucioneve kryesore të arsimit, kulturës dhe shkencës, SHIK-u, në mënyrë tinëzare, nëpërmes krijimit hibrid të shoqatave të krijuesve (pesë a gjashtë sosh të shkrimtarëve kryesisht mediokër, senilë dhe servilë), që nga fillimi ka komprometuar dhe marginalizuar fuqinë intelektuale të krijuesve në relacion me politikën dhe shoqërinë, veçmas atë kritike, duke e anatemuar si “tradhtarë”, “projugosllave” e ndryshe-ndryshe... Nëpërmes krijuesve të shumtë mediokër të kallëpit socrealist të përfshirë në rrjetin e vet, në mediat e mbikëqyrua, SHIK-u ka drejtuar edhe fushata kundër intelektualëve dhe krijuesve (historianëve të njohur dhe shkrimtarëve), që kanë qenë kritikë ndaj zhvillimeve ku liria e fituar është pushtuar nga “çlirimtarët”...*

*...Në këtë rrugë, pra të kërcënimit dhe të terrorizimit të intelektualëve kritikë si dhe atyre që lirinë dhe demokracinë e Kosovës e kanë shikuar si një të arritur historike ku do të ketë vend për ardhmëri dhe qytetërim perëndimor dhe jo zëvendësim të një pushtuesi me një tirani të re nga brenda nga një klasë kriminale, SHIK-u ka shfrytëzuar shumë nga “veteranët” e Luftës për shërbime paramilitare... Ata janë kthyer në dorë të djathtë të këtij shërbimi të gatshme për çfarëdo militantizmi...*

*...Nga të dhënat e shumë shërbimeve informative del se SHIK-u ka instaluar rrjetin e vet në firmat kryesore dhe fitimprurëse të vendit siç është “Telekomi” i Kosovës, KEK e të tjera, ku vlerësohet se mbi 40% të të punësuarve në to janë të lidhur drejtpërdrejt me këtë shërbim... Në sajë të instalimit të kësaj strukture në vendet kyçe, vetëm nga “Telekomi”, nëpërmes formave të dyshimta dhe marifeteve e firmave “familjare”, derdhën miliona në kontot e fshehta jashtë vendit...*

*Nën vëzhgimin e përhershëm të SHIK-ut ndodhet edhe Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) si dhe Trusti pensional i Kosovës.*

*...Me direktivat e SHIK-ut është dizajnuar edhe pjesa më e madhe korit diplomatik të Kosovës, madje edhe ambasadorët dhe këshilltarët e tyre si dhe stafi zyrtar nëpër ambasada, është caktuar kryesisht nga militantët e vet, shumë prej të cilëve nuk plotësojnë as kriteret elementare profesionale dhe morale për një punë të tillë...*

*Kështu është vepruar edhe me policinë e Kosovës, zyrtarët e lartë në administratën e qeverisë si dhe me emërimin e prokurorëve dhe gjykatësve të të gjitha niveleve. Kjo ka bërë që policia e Kosovës të mos jetë në gjendje të veprojë në përputhje me detyrat, kurse gjyqësori vendor të mos zbardh krimet që vijnë nga politikanët e korruptuar dhe të përfshirë në kriminalitet ekonomik...*

*...Rreth këtyre zhvillimeve shërbimet kompetente të vendeve perëndimore (të NATO-s) kanë dhënë informata të mjaftueshme... Ndonëse të reteshuara dhe të redaktuara, opinionin di shumëçka për dosjet e UNMIK-ut nga viti 2002, 2004 dhe 2008 si dhe informatat e BND nga viti 2004 dhe 2006 rreth kësaj problematike...*

*...Janë të njohura edhe shqetësimet e Tribunalit të Hagës rreth implikimit të disa bashkëpunëtorëve të SHIK-ut në shkatërrimin e dëshmimeve, kërcënimin e dëshmitarëve si dhe vrasjen e disave prej tyre.*

*...Edhe raporti i Dik Martit rreth trafikimit me organe njerëzore implikon disa nga bashkëpunëtorët e këtij shërbimi në këtë veprimtari kriminale...Mbi këtë dyshim, nga Këshilli i Evropës dhe KS i OKB-së është kërkuar edhe themelimi i "Gjykatës speciale"...*

*...Në përputhje me këtë zhvillim, pra në fuqinë e këtij shërbimi ilegal,që ka vepruar në mënyrë legale dhe ia ka dalë që të kapë shtetin dhe institucionet e tij deri në atë masë sa të ndikojë drejtpërdrejt edhe rrjedhat e gjithëmbarshme shoqërore dhe politike të vendit me pasoja të rënda, duhet parë edhe dorën e disa shërbimeve të huaja. Sepse, pa ndihmën e tyre profesionale, një grup i vogël "luftëtarësh", të shumtën injorantë për nga dija ushtarake dhe ajo e spiunimit, nuk do t'ia dilte të vepronte dhe të fuqizohej aq lirshëm sa të kthehej në një monstrum shoqëror...*

*... Mbetet që kësaj t'i japë përgjigje politika, sidomos faktorët ndërkombëtarë që kanë marrë përsipër përgjegjësinë për kohën kalimtare (tetëvjeçare) si dhe atë që lidhet me shtetin e Kosovës si të pavarur, të mbikëqyrur nga jashtë...*

*...Faktori ndërkombëtar i pranishëm në Kosovë, veçmas misionet me mandatin e OKB-së: KFOR-i për sigurinë e vendit, si dhe EULEX-i për rend dhe ligj, kanë për detyrë, që të tregojnë të vërtetën se pse edhe disa vjet pas shpalljes së pavarësisë Kosova është e ndarë në dy pjesë (veriu me pakicën serbe dhe jugu me shqiptarë), ku ligjin e bën mafia politike dhe ajo ekonomike?...*

*...Vendet perëndimore, të pranishme në këto misione aq të rëndësishme, po ashtu kanë përgjegjësinë që në mënyrë kritike të sqarojnë gjendjen e tillë, duke nxjerrë në dritë edhe rolin e njëmendë të përfaqësuesve të tyre në këto misione veçmas kur dihet se lëshimet, dështimet por edhe gabimet e shumta, lidhen me punën e tyre...*

*...Qeveria gjermane, e cila është angazhuar fuqimisht në Kosovë që nga koha e shpërthimit të krizës së refugjatëve, por edhe më vonë, sidomos në fazën kalimtare tetëvjeçare të administrimit ndërkombëtar me donacione, investime të shumta po edhe me kuadro të ndryshme të nevojshme për ekonomi, administratë dhe gjyqësor, ka për detyrë që të angazhohet që kjo politikë të marrë fund në mënyrë që shteti gjerman të mos e humbë besimin që gëzon te popullata e atjeshme, por edhe te diaspora e saj në Gjermani...*

*...Ky zotim bëhet edhe më i domosdoshëm kur kihen parasysh informatat që ka marrë vazhdimisht nga burimet e besueshme të shërbimeve informative (BND dhe MAD)...*

*Në të kundërtën, qytetarët e Kosovës, që u shpëtuan nga një gjenocid çfarë ishte ai i regjimit të Millosheviqit, me të drejtë do të ndjehen të tradhtuar, që në rrethanat e lirisë të kthehen në plaçkë të një grupi kriminelësh të mbështetur nga ndërkombëtarët...*

## 9.

Kërkesa që regjistri i burgut në Drenicë (fletorja me emrat e atyre që kishim kaluar në të) të futet në kuadër të dëshmimeve meritore materiale me çka hetimit i hapej edhe një pistë tjetër në drejtim të përfshirjes së Shtabit Qendror në të si dhe kërkesa që Roja e burgut të përfshihet në hetimin e përgjithshëm të "Dosjes B" shënuan fillimin e fundit të mospajtimit tim me punën e hetuesisë, që do të sjellë edhe dorëheqjen dhe largimin tim nga ekipi i

EULEX-it që merrej me hulumtimin e “Rastit B”, por jo edhe largimin përfundimtar nga ky rast, të cilit do t’i qasem me ngritjen e një padie private në një gjykatë speciale ose në atë gjermane për ndriçimin e vrasjes së Lekë Sh. Në këtë mënyrë do të vihet në veprim një proces kompleks, i cili duhet t’i nxjerrë në dritë gjithë ato krime, veçmas ato ndaj dëshmitarëve të mbrojtur, që gjyqësori i EULEX-it i ndikuar nga politika dhe bosët e saj, qëllimisht i ka penguar.

Në të vërtetë kjo rrugë nisi kohë më parë, kur nga prokurori kërkova që hetuesia të përfshinte edhe të tjerë, gjithë ata, të cilët nga lufta e këndeje, ishin intervistuar nga hetues të ndryshëm (të UNMIK-ut dhe ata të Hagës si dhe të EULEX-it pas shpalljes së pavarësisë) prej nga kishin dalë shumë informata të denja për një proces gjithëpërfshirës ndaj atyre që luftën e kishin shfrytëzuar për pushtet politik me mjete kriminale.

Fillimisht, prokurori, i cili lente përshtypjen se tregohej i vëmendshëm ndaj kërkesave të mia, zgjodhi kolegjin hetues, si njëfarë frenuesi, me arsyetimin që “cikërrimat” nuk do të duhej të ktheheshin në vështirësi që do ta nxirrnin hetimin nga binarët kryesor...

Një ditë, madje, tha se “nëse vazhdojmë për t’u kapur për bishti, mund ta harrojmë edhe kalin...”

Por, kur unë zura në gojë maksimën e njohur juridike se “qimja e zbulon ujkun”, prokurori tha se “ujkun e kishim përpara” dhe se “nuk kishim nevojë t’ia kërkonim gjurmët” (mendonte në grupin e atyre që tashmë ishin në paraburgim si dhe dëshmitarët “e sigurt”, siç i quante të mbrojturit, që si do të shihet ata do të jenë më të pasigurtit me këtë status), qasje kjo që sikur nisi të kthehej në moto të punës sonë, me çka në të vërtetë, ne duhej “të rrudheshim”, që t’u krijoheshin mundësi dy apo tri proceseve të parapara të mbylleshin me sukses.

Dhe, sukses për gjyqësorin e EULEX-it, pas afër tri vjet fjalësh të mëdha dhe premtimesh, ishte dënimi i një agjenti të vetëdeklaruar dhe të penduar të SHIK-ut, Vrasësit të Penduar, për një vrasje me paramendim si dhe marrjen pjesë në disa atentate të tjera bashkë me atë që ai e quante “Komandë vrastare”, tre prej të cilëve ishin burgosur, ndërsa të tjerët mbroheshin në liri.

Gjithnjë në përputhje me këto dëshmi që mbulohehin nga *korpus delikti* (rasti i vrasjes së inspektorit të lartë të ish policisë së Kosovës dhe plagosja e disa të tjerëve, që po ashtu dihehin me emra dhe mbiemra), në një proces maratonik duhej të dënoheshin edhe dy a tre të tjerë (nga ata që mund t’u kishin shpëtuar atentateve ose që ishin të sakrifikuar qëllimisht për t’u fshehur vrasësit e njëmendë nga radhët e bosëve që tashmë ndodheshin në politikë).

Se ky qëndrim ia kishte marrë anën një hetimi të gjithanshëm, kjo u pa nga kërkesa ime që hetuesia ta përfshijë në hetim edhe Komandantin vendor bashkë me disa të tjerë (politikanin i lartë nga partia në pushtet), ngaqë shumë dëshmi e lidhnin drejtpërdrejt me rastin e zhdukjes së gazetarit të “*Rilindjes*”. Heqja dorë nga kjo me arsyetimin “e mungesës së dëshmive relevante”, pasi që dy nga ata që bashkë me Vrasësin e Penduar e kishin përcjellë gazetarin nga qendra e shtabit vendor (diku në afërsi të Goleshit deri në Llapushnik), kishin gjetur vdekjen në një fatkeqësi komunikacioni tepër të dyshimtë vetëm disa ditë pasi që ishin marrë në pyetje nga hetuesia, duhej ta sfurconte edhe më tepër këtë dyshim për më tepër ngaqë hetuesia tashmë i kishte deklaratat e tyre zyrtare me anën e të cilave ata dëshmonin shkurt e trup se me urdhër të Komandantit vendor kishin marrë pjesë në përcjelljen e gazetarit

të “*Rilindjes*” për në Llapushnik si dhe dorëzimin e tij komandës së atjeshme të atij që quhej Shtab Qendror.

Krahas kësaj kërkesë, që u refuzua “për mungesë të sjelljes së dëshmitarëve në gjykatë” (dy rojave që kishin humbur jetën tragjikisht), thujse me të njëjtin arsyetim u anashkalua edhe kërkesa për hapjen e hetimeve ndaj një Komandanti vendor nga Malisheva, i cili, po ashtu, ngarkohej me dyshimin se krahas shumë kidnapimeve të tjera me pasoja tragjike për ta, kishte urdhëruar edhe kidnapimin e argjendarit nga Prizrenit, Lekë Sh., kushëririt të gjyshes sime Mari Sh.

Por, siç ndodhte në raste të tilla me dëshmitarët e besueshëm që përfshiheshin në hetuesi, me ç’rast atyre u humbnin gjurmët ose pësonin në ndonjë fatkeqësi komunikacioni, edhe atyre që kishin marrë në dorëzim Lekë Sh., në të dalë të Prizrenit nga komando në të cilën kishte marrë pjesë edhe Vrasësi i Penduar, për në drejtim të Malishevës, u kishin humbur gjurmët befas. Për njërin ishte thënë se kishte migruar po ato ditë në një vend të Perëndimit me shumë e shumë të tjerë që asokohe me dhjetëra autobusë nga Prishtina niseshin në drejtim të Serbisë prej nga pastaj pa dokumente identifikimi, ose të falsifikuara me ndihmën e mafisë shqiptaro-serbe kalonin në Hungari dhe tutje në vendet europiane. Ndërsa tjetri assesi t’i përgjigjej ftesës së hetuesisë, edhe pse në përputhje me ligjin, kjo ishte bërë me anën e policisë. Familja e tij thoshte se ai prej ditësh nuk ishte kthyer në shtëpi dhe se po kërkohej në të gjitha anët, sado që mungesa e tij nuk ishte paraqitur në polici.

Eliminimi i dëshmitarëve çastin që për ta bisedohej për përfshirjen e mundshme në proces ose edhe “zhdukja” e tyre kur ata merrnin ftesa për biseda nisi të marrë përmasa shqetësuese, ngaqë i gjithë hetimi mund të përfundonte në një farsë, për t’u rrudhur deri aty sa të dënohej njëri që prej shumë kohësh kishte pranuar një vrasje për të cilën ishte penduar, gjë që këtë farsë për ndërkombëtarët e bënte edhe më të madhe fakti se nga mediat që mbikëqyreshin nga bosët e politikës të dalë nga krahu i luftës, ishte shpallur i çmendur.

Nga frika se ky përfundim i mundshëm do ta diskreditonte gjithë misionin e EULEX-it që ishte përcjellë me shumë e shumë premtime dhe fjalë të mëdha, prokurori i çështjes pranoi kërkesën time që në hetuesi të përfshihej Komandanti vendor nga Malisheva, që ngarkohej me dyshimin e veprimeve që kishin përfunduar me zhdukjen e argjendarit Lekë Sh., nga Prizreni, me çka në hetim pashmangshëm përfshihej edhe Roja e burgut të Drenicës bashkë me ato që kishin ndodhur atje në përputhje me regjistrin e burgut, që ishte gjetur në shtëpinë ku për një kohë kishte qëndruar Shtabi i Përgjithshëm bashkë me Gjykatën Ushtarake.

Meqë zgjerohej dukshëm pista e hetimeve, kolegji hetues u përforcua edhe me tre hetues të tjerë të sapoardhur (një holandez, një suedez dhe një italian), të cilët dukeshin shumë të përkushtuar ndaj hetimit.

Ndonëse u vërejt përpjekja që të anashkalohesha nga “pjesa e hetimit shitesë”, siç u quajt e gjitha, megjithatë, kjo nuk ndodhi, ngaqë isha ndër të parët që kisha kërkuar këtë gjë, dhe po ashtu, isha ndër hetuesit, që fillimisht isha ngarkuar me hetimet për krimet e kryera gjatë luftës, ku me mund të madh ia kisha dalë që të identifikoja disa nga faktorët kryesorë mbi të cilët ishte ngritur edhe platforma e strukturës së krimit të organizuar, e cila kishte vazhduar edhe mbas luftës, me çka, me këtë mund të ndikohej edhe fizionomia përfundimtare e procesit për nxjerrjen në gjyq të krimit të organizuar si mjet për arritjen e qëllimeve politike, që si do të shihet do të pengohet me çdo kusht nga faktorët me fuqi politike (të jashtëm dhe të brendshëm), të interesuar që pikërisht kjo të pamundësohej deri në pikë të fundit nga frika se

hapte edhe shumë e shumë çështje të tjera me të cilat vihej në dyshim kredibiliteti i faktorit ndërkombëtar të vendosjes si dhe mekanizmave të tjera ndërkombëtare përgjegjëse për sigurinë dhe krijimin e rrethanave që prania ndërkombëtare të kthehet në një garantuese zhvillimi ekonomik, politik dhe demokratik të vendit dhe jo në shpërdorues të këtij procesi historik.

Dhe, që të pengohet kjo kthesë për shumëkënd e rrezikshme, gjithë çështjes duhej t'i merrej atuja kryesore: Roja e burgut si dhe ditari i tij (amza apo regjistri i burgut) që kishte mbajtur ai, e ku bënte pjesë edhe letra e Lekë SH., që e kishte lënë të shkruar nga bindja se do ta gjente dënimi, siç kishte ndodhur në të vërtetë kur ishte gjetur i vrarë nga një plumb i pashpjegueshëm që i kishte ardhur në rrethanat tepër misterioze në atë mjedis të shkëputur për ditë të tëra nga bota nga bora e madhe dhe acari që asokohe kishte pamundësuar çfarëdo lëvizjeje andejpari... Kjo madje ishte vërtetuar edhe nga xhirimet e NATO-s nga ajri si dhe të disa shërbimeve të tjera ushtarake, të cilat pareshtur kishin përcjellë të gjitha lëvizjet në atë pjesë...

I vetëdijshëm se kjo mund të ndodhte dhe nga njëfarë parandjenje se edhe do të ndodhte çastin më kritik, kërkova që hetuesia, me procedurë të përsheptuar, të caktonte dy seanca hetimore me Rojën e burgut, i cili kishte statusin e dëshmitarit të mbrojtur... Kolegji gjykues aprovoi kërkesën time dhe ndodhi që brenda një jave Roja e burgut u gjend përballë nesh.

Takimi me Rojën e burgut si dhe bisedat e zhvilluara me të para nesh nxorën një njeri të frikësuar dhe të shkallmuar fare, të shpërqendruar edhe për nga mendja... Duket se statusi i dëshmitarit të mbrojtur si dhe shkëputja e tij nga familja dhe ambienti si dhe mbajtja nën trysninë e pasigurisë për disa vite, e kishin bërë të veten...

Andaj, kërkova që dëshmitë e tij të gjiroheshin filmikisht në përputhjen me udhëzimin e gjyqësorit para kolegjit *ad hoc* si dhe në praninë e mbrojtësve ligjorë, që ato të fitonin fuqinë juridike në gjykatë edhe në qoftë se shfaqeshin rrethanat *vis major* (pamundësia e paraqitjes në gjykatë si dëshmitar nga sëmundjet psikike ose vdekja).

Mbas një diskutimi bukur të mundimshëm midis kryetarit të kolegjit hetues dhe prokurorit të çështjes, u vendos që kjo të kërkohej nga prokuroria, gjë që, për habi timen dhe të trupit gjykues, u aprovua brenda afatit prej njëzet e katër orësh.

Njoftimi që iu bë Rojës së burgut rreth dëshmisë së tillë ndonëse në fillim u duk se u pranua me shqetësim nga ana e tij, pas pak tha se atë ditë, për herë të parë ndjehej i qetë dhe i gatshëm për t'u ballafaquar me atë që thoshte se iu kishte kthyer në makth...

Dëshmia e Rojës së burgut zgjati dy orë e njëzet e shtatë minuta. Në përputhje me procedurën hetimore në rrethanat *vis major*, dëshmitari nënshkroi deklaratën dhe u pajtua që ajo të deponohet në gjykatë në mënyrë që të shfrytëzohet si dëshmi e autorizuar... Këtë e bënë edhe përfaqësuesit e gjykatës si dhe mbrojtësit ligjorë. Si e tillë, ajo fitonte forcën e plotë ligjore për t'u shfrytëzuar në gjykatë.

Kur po largohej tha se përpara kishte pamjen e një gjurme gjaku të ngrirë në fytyrën e argjendarit të vrarë në zyrat e braktisura të Shtabit të Përgjithshëm, që nxirrte një trishtim të brendshëm...

“E kisha në besë... Shkelësit e besës dënohen dyfish... Kjo luftë ishte një luftë midis besës dhe pabesisë, çmimin e së cilës e paguajnë të parët...”

Ato që Roja e burgut i tha gjatë deklaratës prej dy orësh dhe njëzet e shtatë minutash mund të përmbliken në këto pika:

- ishte aktivist i Lëvizjes Kombëtare nga themelimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës, dhe se, idesë së saj për shtetin e Kosovës i mbetej besnik përherë. Te kjo çështje rridhte edhe ajo që ai e merrte luftë midis *besës* dhe *pabesisë*;
- kishte punuar me mish e me shpirt në strukturat vendore të shtetit paralel, të ngritura nga Lëvizja Kombëtare;
- kishte qenë ndër ata që në kuadër të Komisionit për informim, siç quheshin bërthamat e rezistencës së armatosur, kishte marrë pjesë në grupet e shkapërderdhura guerile;
- në kuadër të kësaj veprimtarie, në vitin 1991 dhe 1993, kishte marrë pjesë në disa shkëmbime zjarri me forcat policore serbe në afërsi të Malishevës pa pasoja ngaqë qëllimi ishte demonstrimi i gatishmërisë para armikut që të mbrohet vendi;
- mbas shfaqjes së grupeve të ndryshme të armatosura në Drenicë kishte kërkuar nga strukturat politike në Prishtinë qëndrim të prerë rreth drejtimit të rezistencës nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, me ç'rast i ishte thënë se lufta duhej të ndihmohej por pa u dëmtuar shteti paralel, meqë kishte filluar koha kur faktori ndërkombëtar luftën e diplomacisë kërkonte ta zëvendësonte me diplomacinë e luftës;
- kur kishte dalë në skenë Ushtria Çlirimtare e Kosovës i kishte dhënë përkrahje, por nuk kishte pranuar që të hiqet dorë nga pushteti paralel dhe strukturat e tij, siç kërkohej nga disa komisarë për të të panjohur;
- ky qëndrim i kishte sjellë edhe telashet e para, ngaqë grupe të maskuara kishin filluar të ndalonin dhe të kërcënonin aktivistët e LDK-së në atë pjesë, gjë që ai kishte marrë mundimin dhe kishte takuar njërin nga komandantët (kushëri) me të cilin ishte marrë vesh që ta respektonin njëri-tjetrin (strukturat e shtetit paralel dhe luftën ngaqë ishin të ndërvarura);
- mbas fillimit të ofensivës së forcave ushtarake dhe policore serbe në verën e vitit 1998, kur forcat pushtuese kishin filluar të rrënonin çdo gjë, iu kishte bashkuar grupeve të armatosura në atë pjesë bashkë me të gjithë aktivistët e shtetit paralel;
- nga komandanti vendor (kushëri i tij) kishte kërkuar që të merrte përgjegjësinë për të ndaluarit, të burgosurit dhe personat e tjerë, që mbaheshin në afërsi të Shtabit Qendror;
- këtë detyrë e kishte marrë me përkushtimin e atij që do të ndihmonte që lufta të mos kthehej në një armiqësi të brendshme, siç ndodhte në disa pjesë të tjera kur “krahu i luftës” luftonte “krahun paqësor” para forcave pushtuese;
- si roje e burgut nuk kishte lejuar maltretime ose qërim hesapesh mbi bazat e ndasive “tradhtarë” - “heronj” siç kishte ndodhur në burgje te tjera përreth;
- në fund, kur nga ofensiva serbe pjesëtarët e Shtabit të Përgjithshëm kishin ikur në drejtim të maleve të Shalës, kishte vendosur që t'i lirojë gjithë ata që kishte nën përkujdesje, edhe pse kjo ishte me rreziqe nga bora e madhe po edhe prania e forcave serbe andejpari që vëzhgonin me helikopterë çdo lëvizje;
- për ato që kishin ndodhur gjatë muajve dhjetor 1998 dhe shkurt 1999, kur një nga një, kush nga moti i keq, kush nga plagët e kush pse ishte larguar, kishin gjetur

vdekjen (gjithsej tetë veta), ndër të cilët, rasti më i dhimbshëm kishte qenë ai i argjendarit nga Prizreni, i vrarë në rrethana të pashpjegueshme për të, thoshte se mbante përgjegjësi të plotë dhe kërkonte t'i bëhej një gjyq i ndershëm nga ndërkombëtarët, edhe pse kishte filluar ta humbte besimin në ta;  
- përgjegjësinë për ato vdekje (vrasje) e mbante jo nga shkaku se ai kishte qenë në gjendje për të parandaluar fatin e tyre, që të ktheheshin në pre të atyre që shfrytëzonin fuqinë e armës, sado e përkohshme ishte, por pse nuk kishte qenë në gjendje që t'u ndihmonte që të shpëtonin nga vdekja kur ata nuk kërcënoheshin më nga vrasësit e tyre, gjë që mendonte se i kishte pre në *besë* dhe se prerja e besës kërkonte dënim të rëndë – me vdekje.

Opsesionin që jetën e mundimshme e kishte dënim pse kishte *prerë në besë*, që megjithatë, një gjykatë e ndershme duhej t'i jepte fund (që edhe e priste me këtë rast), kërkoj ta veçonte si një vetakuzë për vetëdënim në mënyrë që shpirti t'i prehej në paqe. Atë e arsyetoi me fjalët:

*Kolegj i ndëruem,*

*Ka kohë që po pres një rast të tillë për me u ballafaque me të vërtetën dhe vetveten në mënyrë që të lirohem nga barra e fajësisë dhe e turpits...*

*Fajësia ka të bajë me atë se kam jetue në një kohë vrastare, që si moti i ligë që nuk kursen kend, të kthen në vrasës ose në të vramë...*

*Në ato rrethana të jesh i vramë, do të thotë viktimë, që sado kudo paraqet një ngushëllim moral, ngaqë dallon nga vrasësi...*

*Ngushëllimi moral, megjithatë, nuk mjafton të lirohesh nga gjendja e fajësisë ngaqë ashtë ndërgjegjja ajo që vret...*

*Në rastin tim ashtë paaftësia për me i mbrojtë ata që duhej të mbroheshin për me mbetë gjallë edhe pse në ato rrethana, kjo ishte shumë e vështirë..*

*Fajësia ime nuk ashtë çashtje personale, por çashtje morali, sepse ajo ka të bajë me besën dhe mbajtjen e saj...*

*Dhe, besë, për mue dhe për familjen time, ishte besa ndaj çështjes kombëtare si dhe pjesëmarrjes në të e që lidhej me shtetin e Kosovës, tashma të shpallun, që duhej me e jetësue edhe në rrethanat e pushtimit dhe assesi me hy në ndonji lojë tjetër me të cilën rrezikohet ai...*

*Meqë Kosova, në vitin 1991, me referendum ishte shpallë e pavarme, neve na lidhte besa me të, që ia kishim dhanë dhe duhej me e mbrojtë...*

*Edhe luftën e nisëm me këtë betim, sado që kishte edhe qasje tjetër, me të cilën ai duhej me u anashkalua...*

*Megjithatë, dhamë besën se do të luftojmë bashkarisht...*

*Por, në atë luftë kishte edhe shkelës të besës... Na e kthyen pushkën...*

*Kur ndodhi kjo, nuk mbet tjetër, pos që në katundin tim dhe në rrethim, ta parandalojmë luftën vëllavrasëse...*

*Bamë me dije se kush nuk shikon pushtuesin por manash, ka punë me ne...*

*Kështu edhe ndodhi...*

*Mora përsipër mbikëqyrjen e burgut, në mënyrë që mos me lanë me u vra vëllaznit me vëllazën, ngaqë burgjet ishin vendet ku ma së shumti përthyheshin ndasitë dhe kundërshtimet tona që shkuan edhe deri te vrasjet mes veti...*

*Por, ata që kisha në përgjegjësi, nuk mujta me i mbrojtë as nga komandantët që i kishin sjellë aty, e as nga pushtuesit që u rikthyen...*

*Edhe pse moti i ligë ishte shkaktari kryesor, kujtoj se i vrava unë, që kisha për detyrë me i nxjerrë prej andej dhe nuk ia dola...*

*Ma e randë se kjo ashtë vrasja e Argjendarit nga Prizreni, nga një plumb në ballë pranë dritares sikur me i pasë ardhë prej qielli, që pasi kam mendue e çmendue për vite të tana për të, nuk ka si me u shpjegue ndryshe pos si mbetje endezun e asaj shkrepje të komunitëve, që para pesëdhjetë vitesh ia kishte gjetë kokën e të atit, ngaqë i kishte takue Nacionaldemokratikes shqiptare...*

*Dhe, e njëjta shkrepje, duhej me ia gjetë kokën edhe të birit se i kishte takue Lidhjes Demokratike të Kosovës, bartëse e lëvizjes antikomuniste, së cilës i takuem i madh e i vogël, me të cilën duhej të ndreqej një padrejtësi historike...*

*Kaq..."*

10.

Deklarata e Rojës së burgut si dhe xhirimi si dëshmi e deponuar shkaktuan një termet që e rrënuan gjithë hetimin...

E gjitha nisi me një shqetësim të prokurorit të çështjes, që pak nga pak u bart edhe te një pjesë e kolegjit hetues (kryetari), i cili gjithnjë e më shumë fliste “për një çrregullim të përgjithshëm që mund të rrëronte konceptin e deritanishëm të hetimit”.

Në mbledhjen e radhës, prokurori i çështjes, tha se “disa gjëra duhej nisur nga e para, disa të tjera duhej rishikuar, e disa për t’u anashkaluar madje”, gjë që çështjen e përmbyste në një drejtim fare të panjohur dhe të paparashikuar me të cilin nuk mund të pajtohej kush.

Edhe pse fjalët e fundit i tha pa takt dhe u mundua që sado kudo t’i tërheq, megjithatë ato ishin një paralajmërim i qartë se hetimi, e me këtë edhe procesi duhej të kthehej te kornizat që iu kishin paraparë nga sajuesit e saj në Bruksel dhe Prishtinë, që në ato rrethana vetëm “ndonjë e papritur” mund ta rikthente në shtratin prej nga kishte dalë.

I çliruar nga dëshmia e xhiruar e Rojës së burgut, por edhe i brengosur nga shenjat e shqetësimit që po shfaqeshin manash se procesi mund të merrte një kah fare të paparashikuar, vendosa që fundjavën ta kaloja në Prizren. Mund të ishte ndjenja e përkatësisë familjare si dhe nderimi për kushërinin e fundit të sime gjyshe nga ky qytet, (Lekë Sh., të vrarë në luftën e fundit diku në Drenicë), ajo që më kishte ngrehur kah ai?...

Para se të nisesha për në Prizren, nga dyshimet që m’u kishin lidhur për kokë se mund të ndodhte diçka që hetimi të përmysej, ose, së paku, të kthehej te pika që i ishte paraparë nga prokurori i çështjes, pra që të mbetej i kufizuar vetëm në veprimet kriminale të individëve ose të grupeve kriminale “të shkapërderdhura” dhe jashtë ndonjë platforme politike, ktheva në hetuesi dhe mora kopjen e dëshmisë së Rojës së burgut si dhe të tjerat, që shfaqeshin shtylla të “Procesit B”.

I futa në çantën e kompjuterit dhe i mora me vete, siç veproja rëndom gjatë fundjavave kur ngarkohesha me materialet që i merrja nëpër duar sa rrija në banesë.

Atë pasdite të ftohtë tetori, një diell i qetë me rreze të zbehta, gjetheve të drurëve në të dy anët e grykës së Carralevës, ua nxirrte në pah ngjyrat e shumta, gjë që udhëtimin e kthente në një përjetim çlodhës.

Kështu ndodhi deri te pika më e lartë, prej nga hapej panorama e thellë e Dukagjinit, që zbriste shkallë-shkallë në drejtim të Prizrenit, ku edhe fillonte kufizimi i saj me malet e Sharit në jug dhe Pashtrikun në perëndim, të kthyer në hije.

Meqë dielli i zbetë tashmë po i fikte rrezet e fundit prapa Pashtrikut dhe hapësira pak nga pak po zhytej në mugun e parë të mbrëmjes, në të hyrë të Prizrenit, e gjitha u kthye në terr nate.

Kur taksia u ndal para hotelit “Theranda” dhe nuk më mbetej tjetër pos me marrë plaçkat për të hyrë brenda, në atë kapërcim të shkurtër, shikimi më treti në drejtim të kalasë përballë. E ndriçuar mirë, ajo dukej si një ngrehinë në një lartësi e shkëputur nga toka. Duke mos iu ndarë asaj pikasje ktheva në taksi dhe bëra me dorë në drejtim të atyre dritave. Taksisti i qetë nuk kishte nevojë për tjetër. Iu dha një kthese në të majtë, që pas një lakimi në të djathtë, kur lamë prapa kompleksin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ndoqi rrugën rrjedhës së lumit. Pas një ngjitimeje të ndjeshme në anën tjetër, vetura u ndal te hyrja e kështjellës.

Edhe pse një erë e ftohtë më vinte përpara, nuk e ndjeva të ftohtit. Përkundrazi, ajo më joshi që të ecja në drejtim të pjesës së skajshme, aty ku muri i trashë ngjitej me rrëpirën e gurtë që zbriste në lumë. Nga ajo lartësi, dritat e neonit qytetit ia nxirrnin në pah gjymtyrët e shkapërderdhura (xhamitë e shumta si dhe pirgjet e kishave me kryqet e spikatura në maje), ndërsa urat e gurta mbi lumë ia bashkonin pjesët e ndara...

Në atë pikasje syri ma zuri Shatërvanin e ndriçuar me kalimtarët e paktë që humbnin në rrugicat ngjit me të... Se si në njërën prej tyre m’u bë se po shihja edhe argjendarinë e Lekë Sh., kushëririt të sime gjyshe, i gjetur i vrarë në zyrat e braktisura të Shtabit diku në Drenicë...

Një copë herë shikimi im mbeti i lidhur për atë pjesë prej nga çuditërisht po më ripërtërihej pamja e një njeriu të lidhur atypari që mandej tërhiqet zvarrë rrugicave të errëta... Në atë tërheqje zvarrë, që e merrte me mend se do të përfundonte në dhomën e braktisur të Shtabit me atë plumbin e panjohur në kokë sikur t’i kishte ardhur prej qielli, ai po fliste diçka për të e të se si para më se gjysmë shekulli komunistët e kishin nxjerrë të lidhur për diku prej nga një krismë e vetme i kishte dhënë fund gjithë atyre që ai dëshironte t’i thoshte haptas rreth lirisë dhe botës së lirë nga e cila ishin privuar dhunshëm...

Rikthimi i pamjes së argjendarit Lekë Sh., nipit të gjyshe Mari, që e kisha dashtë aq shumë, sikur ma kthyene dhe pikëllimin e ngrirë në fytyrën e saj me të cilën edhe do të vdesë...

Për t’u ikur atyre përfitimeve, të cilat nga hetimet e fundit sa vinin e më shtoheshin dhe në njëfarë mënyre sikur nga aty padisnin pse kishin mbetur të anashkaluara dhe të harruara, i thyer si kurrë, u ktheva në taksi me shpresën se ashtu mund t’u ikja atyre që m’u qasen atje. Por, ato nuk m’u ndanë as në restorant e as gjatë një shëtitje të lehtë skaj lumit.

Sigurisht se ato shqetësime do të më përcillnin edhe më tutje, po mos të ishte një thirrje telefonike tepër e shkurtë (nga një numër i paidentifikuar nga jashtë) prej nga m’u bë me dije se Roja e burgut ishte gjendur i vetëvrarë në Gjermani!...

Aty për aty m’u lidhën një palë të dridhura bashkë me një ligështim të paparë që sa s’më rrëzuan përtokë... Një copë herë e shkunda telefonin dhe madje desha edhe ta përplasja për t’i bërë të paqena fjalët që më erdhën prej andej...

Me atë turbullim të jashtëzakonshëm në kokë, u ktheva në hotel dhe u mbylla në dhomë...

Në atë gjendje të rëndë përhumbe, shkyça edhe telefonin dhe nga një tërbim i jashtëzakonshëm që më mbërtheu të tërin e përplasa për tokë dhe e shqelmoja deri sa u bë copë-copë, sado që më dukej se prej atyre copave të shkapërderdhura, edhe më tutje, gjithë tingëllimë liroheshin fjalët “vrasje”, si një kërcënim i përgjithshëm...

I trishtuar dhe i hakërruar njëherësh shpëtimin e kërkova te medikamentet qetësuese, që i mbaja pranë.

Nuk vonoi dhe qetësuesit ma krijuan një pehatje turbulluese sikur po sharroja në një ujë amull, në një varkë të harruarqë përpëlitej me sharrim...

Kur m'u bë se megjithatë lash prapa barkën diku në atë ujin amull dhe pashë se ora kishte shkuar te katërshi i natës, mundimshëm mblodha çaklat, zbrita poshtë dhe nga recepsionisti i përgjumur, kërkova një taksì për në Prishtinë.

Sikur ta kisha dëshiruar atë gjendje, rrugën deri në të hymë të Prishtinës e kalova në njëfarë kllapie të ngjashme me atë sikur të isha nëbarkën në ujin amull.

Gjithnjë me përfytyrimin e ndodhjes në atë barkën që pehatej, sikur të fliste një tjetër në mua, te rrethi i thash taksistit ta merrte drejtimin e aeroportit.

Në atë gjendje e kalova edhe fluturimin prej afër dy orësh deri në Berlin.

Por, sapo zbrita aty dhe ajri i lagësht dhe i ftohtë - një përzierje sqote që atje paralajmëron dimrin e hershëm - ma hoqi pamjen e ujit amull dhe barkën e ftohtë.

Në atë përmendje kur po lirohesh nga ato që më kishin bërë lëmsh, se si m'u qep një mëdyshje se telefonata që kisha marrë në Prizren nga numri anonim nga jashtë dhe njoftimi për (vetë)vrasjen e Rojës së burgut diku në Gjermani, mund të kishte qenë pjesë e ngarkesave të mëdha psikike me të cilat isha rënduar ato ditë dhe asgjë më shumë?...

Duke ndjekur përvijimin e atij mendimi u ndala dhe sakaq shikova pjesën e aeroportit të madh të mbushur me gumëzhimin e atyre që hynin dhe dilnin në të... Lëvizjet e shumta në drejtim të metrosë, linjës së autobusëve, të trenit dhe taksive sakaq më kthyen në një udhëtar të rëndomtë që duhej të vendoste për mënyrën e largimit nga aeroporti: për në qendrën e qytetit, në Ministrinë e Drejtësisë, ose në shtëpi, te familja?...

Një copë herë, pa qenë në gjendje që të parashikoj hapat e mëtutjeshëm, mbeta ashtu i përhumbur deri sa një çast mendja ma tha të silllesh sikur e gjitha të ishte pjesë e një udhëtimi të rëndomtë nga ato të parapara me rregulloren e punës (një herë në tre muaj) për vizitë familjes prej nga duhej t'i kthehesha punës.

Madje, sikur të kthehesha nga një vizitë familjes, më shkoi mendja këtë edhe ta bëja me fluturimin e parë për në Prishtinë, por serish ishte zilja e telefonit “e fshehur” (anonim) që e mbaja vetëm për komunikim me familjen dhe një thirrje (këtë herë nga Brukseli nga ish prokurorja e EULEX-it, zonja H. Z., e larguar nga misioni kohë më parë), që më shtangu jo vetëm pse ma bëri të ditur tragjedinë e Rojës së burgut në Gjermani, por tha se fjala ishte për një vrasje me paramendim, që të theksuar e përsëriti disa herë...

Pas një pushimi të shkurtë, prokurorja e rebeluar, zonja H. Z., më tha se ishte për të mirën time që, po atë ditë të takoheshin në Bruksel, ngaqë tashmë, i lidhur me këtë rast, ishte përhapur edhe lajmi për largimin tim demonstrativ nga Prishtina dhe procesi i hetimit, gjë që sipas saj, kjo kërkonte prononcimin timin në kohën dhe gjuhën e duhur!

“Kësaj farse tragjike duhet t'i vijë fundi...”

Ishte, pra, një tjetër thirrje telefonike në telefonin “e fshehur”, që prapë ma ktheu gjendjen e rëndë nëpër të cilën kisha kaluar nga Prizreni e deri në Berlin për të cilën pak më

parë mendoja se mund të ishte pjesë e ndonjë lajthitjeje nga lodhja e madhe, që me shpalljen e dorëheqjes sime nga hetime, sikur po më sillte para një akti të kryer, për çka hë për hë nuk kisha menduar, por ishte i pashmangshëm...

Dhe, në atë kapërcim, nga njëra gjendje në tjetrën, kur më dukej se i gjithë aeroporti me ato që kishte po më shembej sipër dhe se për të shpëtuar disi duhej të ikja sa më parë nga andej, nuk më mbeti tjetër pos të pranoja takimin e Brukselit me ish prokuroren, zonjën H. Z., në kohën dhe vendin e caktuar prej saj...

Natyrisht se kohën nga Berlini deri në Bruksel (me gjithë pritjen dhe fluturimin që kishte zgjatur tri orë) u përpoqa ta plotësoja me ato që do të sillte takimi me prokuroren, zonjën H. Z., e cila nga fillimi kishte qenë e angazhuar në misionin e EULEX-it në Kosovë, ku ishte përfshirë në disa hetime të pasuksesshme. Ditë më parë kishte dalë në opinion me një letër, në të cilën bënte të ditur për vështirësitë që i kishin dalë gjatë hetimit të disa zyrtarëve të lartë të vendit, të dyshuar për krim të organizuar, ngaqë kjo i ishte pamundësuar nga disa prokurorë dhe gjyqtarë të këtij misioni, të cilët, kishin abuzuar me detyrën zyrtare duke i zvarritur ose sabotuar me perfiditet thuajse të gjitha pistat hetuese, me çka kanë ndikuar drejtpërdrejt që bosët e krimit të organizuar në Kosovë nga radhët e politikanëve të lartë (të shumtën të partisë në pushtet PDK si dhe partnerëve të tyre nga koalicioni qeverisës LDK) të lirohen nga veprat penale me të cilat ngarkoheshin!...

Prokuroja “e rebeluar dhe e korruptuar”, siç ishte thënë në një kumtesë të vetë EULEX-it, gjë që për këtë nuk iu kishte vazhduar kontrata, megjithatë, kishte sjellë shumë e shumë të dhëna të ndërhyrje së politikës në gjyqësorin, duke bërë me gisht edhe në drejtim të qarqeve të rëndësishme ndërkombëtare, për të cilat ajo kishte thënë se “ashtu mbronin vetën”, ngaqë si përfitues kryesor nga krimi i organizuar në Kosovë në dëm të shtetit (përmendej procesi i privatizimit), “u duhen politikanë të korruptuar dhe të shantazhuar me ndihmën e të cilëve fitohen tenderë me përfitime të mëdha qindramilionëshe...”

“Kosova është kthyer në një biznes të krimit të organizuar nga jashtë e nga brenda”.

Së voni, kur shumë nga kritikët drejtuar gjyqësorit të EULEX-it rreth paaftësisë që të luftojë krimin e organizuar dhe korrupsionin do të merren si të drejta nga shumë anë, veçmas kur ato do të vijnë nga institucionet më të rëndësishme ndërkombëtare (Këshilli i Sigurimit i OKB-së, Këshilli i Europës, Banka Botërore etj.,) e edhe nga disa qeveri të fuqive të mëdha që kanë investuar shumë në çlirimin e saj si dhe shpalljen e shtetit të Kosovës (e SHBA-ve, Britanisë së Madhe), misioni evropian do të shfrytëzojë “*Dosjen B*” për të thënë se në radhë tashmë ishte “ndjekja dhe vënia e peshqve të mëdhenj para drejtësisë...”

Prokurorja e rebeluar, zonja H. Z., me këtë rast, “*Dosjen B*” dhe ato që EULEX-si i trumbetonte gjoja si “futje në gjenezën e krimit të organizuar, pra nga koha e luftës dhe e pasluftës”, e quan mashtrim. Në një deklaratë për opinionin vendor dhe atë të jashtëm, duke shënjuar institucionet e saj më të rëndësishme si fajtorë për gjendjen e krijuar, theksonte se, bazuar në përvojën e deritanishme të zvarritjeve të parapara si dhe dekonspirimit ose eliminimit të dëshmitarëve edhe me vrasje, qofshin ata edhe të mbrojtur, e gjitha do të përfundojë me një farsë.

“Me dënimin e një vrasësi të vetëshpallur dhe të penduar si dhe dënimin e dy-tre të tjerëve nga radhët e komandës vrastare, që pas pak edhe mund të lirohen ngaqë do të shpallen të çmendur me justifikimin se shumë prej tyre kishin qenë “pacientë të qendrës psikiatrike”,

bosët e krimit të organizuar nga lufta dhe paslufta, jo vetëm që do të shpëtojnë siç ka ndodhë me proceset e deritanishme, por ata do të dalin edhe më të fuqishëm...”

Prokurorja e rebeluar, zonja, H. Z., përmend proceset maratonike në të cilat disa ministra dhe zyrtarë të lartë , pasi që për vite të tëra janë sjellë nëpër gjykata, janë liruar me arsyetimin se drejtësia nuk ka qenë në gjendje që para gjyqit të sjellë dëshmitë dhe dëshmitarët e paraparë herë pse disa prej tyre kanë humbur jetën në rrethana të pashpjeguara dhe tepër të dyshimta, herë pse disa prej tyre kanë migruar në vende të panjohura, e herë pse disa prej tyre gjenden në arrati e të ngjashme!...

“Të tillët, kanë dalë fitues të dyfishtë, ndaj drejtësisë së korruptuar dhe, sidomos, ndaj viktimave të tyre...”

Në fund, prokurorja e rebeluar, zonja H. Z., kishte akuzuar drejtpërdrejt gjyqësorin ndërkombëtar (të UNMIK-ut dhe EULEX-in pas tij), si bashkëfajtor për këtë gjendje, që sipas saj, qarqe të caktuara ndërkombëtare kanë interes që klasa politike e Kosovës të mbahet e shantazhaur dhe në kthetrat e krimit të organizuar, në mënyrë që të përfitohet prej saj paçka se kjo shkon në dëm të vendit, duke e kthyer atë në një poligon të mafisë ndërkombëtare...

Fjalëve për “Kosovën poligon të mafisë ndërkombëtare” nisen t’u shtoheshin edhe ato për “Kosovën sherr ndërkombëtar”, për “Kosovën e sëmurë”, për “Kosovën murtajë” dhe çmos...

Me këtë lëmsh në kokë, në kohën e caktuar, hyra në restorantin që kishim lënë takimin. Vepropa sipas udhëzimeve që m’i kishte dërguar zonja H. Z., sapo mbërrita në aeroportin e Brukselit, ku si vendtakim ishte caktuar tavolina numër 6.

Për habinë time, sapo u ula në tavolinën e rezervuar më numër 6, kamerieri i sjellshëm, më solli një pije (uiski me akull) dhe bashkë me menynë edhe një pliko të madhe, të shoqëruar me një pliko të vogël, ku ishte emri dhe mbiemri im me shkronja të mëdha...

Tjetër nuk tha pos që u larguar sikur të kishte kryer gjithë punën.

Pas një shtangie të lehtë, nga e cila u lirova shpejt, dora ime zuri plikon e vogël me emrin tim dhe e hapi sikur të nxirrte prej saj diçka të njohur.

Në të vërtetë ajo që shkruante në të ishte e pritshme dhe më se e njohur. Prokurorja rebele, zonja H. Z., duke thënë se ashtu kishte vepruar në të mirë timen, por edhe të çështjes që priste të kthehej në një kauzë me të cilën ia vlente që të punohet në mënyrë që të fitojë drejtësia por edhe e vërteta, bënte të ditur se rasti tragjik i Rojës së burgut në Gjermani, dëshmitari i mbrojtur, ishte një vrasje me paramendim, që nuk kishte si të përfundonte ndryshe, ngaqë gjithë “*Procesit B*” do t’ia jepte një kah tjetër, pra të nxjerrjes në dritë të krimit të organizuar nga grupet kriminale para dhe gjatë luftës si dhe përkrahjes së tyre nga qendra të ndryshme ndërkombëtare edhe në rrethanat e pranisë së misionit ndërkombëtar në Kosovë përgjegjës për instalimin e demokracisë dhe të shtetit të ligjit, për fat të keq, të dyja të dështuara...

“Të gjendur midis trysnisë së të vërtetës, siç ishte ajo që dilte nga dëshmia e Rojës së burgut, si dhe dëmit që mund të sjellë likuidimi i një dëshmitari të mbrojtur, bosët e krimit të organizuar në Kosovë si dhe mbrojtësit e tyre nga radhët e faktorit ndërkombëtar të vendosjes, u përcaktuan për këtë të dytën, pra për eliminimin e tij me gjoja vetëvrasje, paçka se kështu dhe në këtë mënyrë dëmtohet pariparueshëm kauza e gjyqësorit si dhe autoriteti i tij në një vend të brishtë ku mos mbrojtja e dëshmitarit kthehet në mbrojtjen të krimit të organizuar...”

Në fund, prokurorja, zonja H. Z., pasi që e akuzon drejtpërdrejtë segmente të caktuar të shtetit gjerman për pjesëmarrje në atentat ndaj drejtësisë dhe vrasje me paramendim, bën të ditur se në plikon e madhe ka me qindra dëshmi dhe dokumente të ndryshme, me të cilat dëshmohet korrupsioni i disa nga prokurorëve dhe gjyqtarëve të misionit evropian të drejtësisë “EULEX” dhe të atyre paraprak UNMIK si dhe lidhja e tyre me struktura të ndryshme kriminale që mbajnë peng institucionet e shtetit, me çka ata kanë ndikuar që shumë nga proceset e deritanishme të dështojnë ose të përfundojnë në përputhje me interesat e bosëve të krimit të organizuar në Kosovë (me ndonjë dënim të ndonjë personi të parëndësishëm ose të sakrifikuar qëllimisht).

“Uroj që të luftoni për dinjitetin e të drejtës, por edhe për mbrojtjen e viktimave nga vrasësit e tyre...”

Në rrugë e sipër për në Berlin, pasi që e nënshkrova dorëheqjen time nga hetuesi i misionit të “EULEX”-it në Kosovë dhe si shkak theksova vrasjen e Rojës së burgut në Gjermani, me një mesazh telefonik iu falënderova prokurores së rebeluar, zonjës H. Z., për plikon me materiale.

“Për mua *Rasti B.* jo vetëm që nuk ka përfunduar, por sapo fillon, meqë ashtu mbroj edhe familjen time nga vrasësit e përsëritshëm...”

Kur përmenda mbrojtjen e familjes mendjen e kisha te dajë Martin SH., nga Shkodra, Lekë Sh., nga Prizreni, dhe për më tepër, te Prizreni dhe Theranda Sh. diku në një skaj të botës...

Prishtinë, maj-shtator 2016.

....

## SHËNIME PËR AUTORIN

**Jusuf Buxhovi** lindi në Pejë, më 4 gusht të vitit 1946. Shkollën fillore e nisi në Gjakovë dhe e kreu në Ponošec të Dukagjinit. Ndërsa shkollën e mesme në Gjakovë. Në vitin 1968 u diplomua në Universitetin e Prishtinës (Dega e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe). Në vitin 1979 kreu studimet pasuniversitare në degën e Historisë të Universitetit të Prishtinës. Magjistroi në temën *"Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet gjermane"*.

Karrierën e gazetarit e filloi në gazetën *"Rilindja"* të Prishtinës në vitin 1967, fillimisht si gazetar i kulturës, e më vonë redaktor i saj. Nga viti 1976 deri në vitin 2000 ishte korrespondent i përhershëm i kësaj gazete, i akredituar në Bon të Gjermanisë. Ndërsa nga viti 2000-2008, krahas veprimtarisë letrare, u mor me hulumtime historiografike nëpër arkivat gjermane.

Deri tash ka botuar këto vepra:

1. *"Cirk"*, tregime, "Rilindja" – 1972
2. *"Pioni"*, tregime, "Rilindja" - 1975
3. *"Matanëkrena"* – roman, "Rilindja" - 1976
4. *"Çaste"* - vështrime letrare, "Rilindja" -1978
5. *"Dinozauri"* – dramë, "Rilindja" - 1979
6. *"Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit"* – roman, "Rilindja" - 1982
7. *"Ura e Fshejit"* – novela, "Rilindja" - 1983
8. *"Pranvera e zhveshur"* - dy drama, "Rilindja" - 1984
9. *"Nata e shekujve"* - roman, "Rilindja" - 1985. (Fitoi Çmimin vjetor të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës)
10. *"Galeria e të vdekurve"* - roman, "Rilindja" - 1987
11. *"Libri i të mallkuarve"* - roman triptik, "Rilindja" -1989. ( Fitoi çmimin letrar "Hivzi Sulejmani")
12. *"Prapë vdekja 1"* - roman, "Rilindja" - 1991 (Fitoi Çmimin vjetor të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës)
13. *"Prapë vdekja 2"* - roman, "Rilindja" -1993
14. *"Prapë vdekja 3"* - roman, "Rilindja" - 1995
15. *"Qyteti i dënuar me vdekje"* - roman, "Faik Konica" - 2000
16. *"Letrat për Kryepincin"* - roman, "Faik Konica" - 2003
17. *"Vdekja e Kolonelit"* – roman, "Faik Konica" - 2004
18. *"Vera e fundit e Gjin Bardhit"* – roman, "Faik Konica" - 2004
19. *"Kujtimet e zonjës Von Braun"* - roman, "Faik Konica" - 2005
20. *"Kodi i dashurisë"* - roman, "Faik Konica" - 2006. (U nderua me çmimin kombëtar "Azem Shkreli", si vepra më e mirë e vitit)
21. *"Udhëtimi i Mendim Drinit"* - roman, "Faik Konica" - 2006.
22. *"Libri i Bllacës 1 - Shënime nga psikiatria"* – trilogji, "Faik Konica" - 2007.
23. *"Libri i Bllacës 2 - Bota e përmbysur e Urtakut"* – trilogji, "Faik Konica" - 2007.
24. *"Libri i Bllacës 3 - Etër e bij"* – trilogji, "Faik Konica" - 2007.
25. *"Fletëza gjermane"* – publicistikë, "Faik Konica" - 2008.
26. *"Kongresi i Berlinit 1878"* – historiografi, "Faik Konica" - 2008.
27. *"Libri i Gjakovës"* – roman, "Faik Konica" - 2008.
28. *"Kthesa historike 1 - Vitet e Gjermanisë dhe Epoka e LDK-së"* – historiografi. Botoi "Faik Konica" – 2008.
29. *"Jeta lakuriqe"*, tregime. Botoi "Faik Konica" – 2009.
30. *"Kthesa historike 2 - Shteti paralel dhe rezistenca e armatosur"* – historiografi. Botoi "Faik Konica" – 2009.

31. **"Kthesa historike 3 - Lufta e Perëndimit për Kosovën"** – historiografi. Botoi "Faik Konica", 2009.
32. ***Nga Shqipëria Osmane te Shqipëria Europiane***, historiografi. Botoi "Faik Konica", Prishtinë, 2010.
33. **"Kosova"** I,II,III – historiografi. Botoi "Faik Konica" Prishtinë – "Jalifat Publishing" Houston, 2012.
34. **"Jeniçeri i fundit"**, roman. Botoi "Faik Konica" Prishtinë – "Jalifat Publishing" Houston, 2013.
35. **"Dosja e hapur"**, roman. Botoi "Faik Konica" Prishtinë – "Jalifat Publishing" Houston, 2014.
36. **"Kosova"** I, II,III,IV,V – historiografi. Botoi "Jalifat Publishing" Houston – "Faik Konica" Prishtinë, 2015.

*Përkthime në gjuhët e huaja:*

- "Zapisi Dzona Nikolle Kazazija"**, *"Jedinstvo"*, Prishtinë, *"Nolit"*, Beograd, 1986.
- "Beleske Dzona Nikolle Kazazija"**, Maribor, Slloveni, 1989.
- "Qui resiste a la peste resiste au diable"**(*Le Journal de Gjon Nikollë Kazazi*), botoi *"L'Harmattan"*, Paris, 2010.
- "Kosova"**I,II, III anglisht. Botoi "Jalifat Publishing", Houston 2013.

....